

**TITULLI I DISERTACIONIT¹:
PJESËMARRJA E TË RINJËVE NË NIVEL LOKAL,
PREMISË PËR DEMOKRATIZIM**

Emri Mbiemri i doktorantit: Rifat Demalija

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Sociale, me profil Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, për
marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Tonin Gjuraj

Numri i fjalëve: 53,256

Vendi, muaji viti i dorëzimit: Tiranë, Janar 2017

¹Titulli i disertacioni shkruhet me shkronja kapitale, bold, madhësia 16. Gjithë të dhënat e tjera me font 14, siç paraqiten në format. Lloji i shkrimit: Times New Roman.

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, unë Rifat Demalija, deklaroj se ky punim doktore është kryer nga unë dhe se nuk është kopjuar nga ndonjë punim i ndonjë personi tjetër (i botuar ose i pabotuar) dhe se nuk është parqitur për vlerësim në asnjë Universitet tjetër. Konfirmoj se jam i njohur dhe e kam kuptuar rregulloren e plagjiaturës së Universitetit European të Tiranës.

.....

ABSTRAKTI

Studimi fokusohet në pjesëmarrjen e grupeve rinore në nivel lokal në Shqipëri, për të hulumtuar rolin e të rinjve dhe forumeve rinore në jetën publike dhe ndikimin që ata mund të kenë në demokratizimin e vendit duke vëzhguar rolin e forumeve rinore dhe shoqërisë civile gjatë periudhës 1991 - 2014. Implikimi i politikës me shoqërinë civile dhe anasjelltas gjatë periudhës së tranzicionit, bazuar në njohje dhe marrëdhënie reciproke, më shumë sesa në ide konkrete, është një nga karakteristikat kryesore të tranzicionit në Shqipëri, duke penguar demokratizimin e vendit dhe duke lënë në hije grupet e vogla komunitare. Strategjitë e importuara nga vendet e zhvilluara gjatë periudhës së tranzicionit, duket vetëm se kanë ndikuar në humbjen e lidhjeve me realitetin duke mënjanuar pjesëmarrjen reale aktive të të rinjve në nivel lokal.

Angazhimi i të rinjëve në proceset demokratike të konsideruar si partnerë nga aktorët politikëbërës dhe qeverisës, duke ndarë me ta pushtet dhe përgjegjësi, është hipoteza që vë theksin se të rinjtë kanë potencial për të sjellë ndryshime pozitive, duke kontribuar në vendosjen e paqes dhe zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe demokratike. Pjesëmarrja e grupeve rinore joformale në nivel lokal është e domosdoshme si kusht për demokratizimin dhe njohje me realitetin, për të lënë kështu mënjanë praktikën e importuara nga vendet e zhvilluar gjatë periudhës së tranzicionit, tashmë eksperimente të dështuara.

Analiza përdor kryesisht të dhëna empirike që rrjedhin nga rastet studimore në rajone të ndryshme të Shqipërisë për të shqyrtuar pyetjen kërkimore kryesore të mëposhtme: Çfarë roli mund të luajë pjesëmarrja aktive e grupeve rinore lokale në konsolidimin e demokracisë?

Pjesëmarrja rinore si një strategji në zhvillimin komunitar, është bazuar në studiuesit postmodernistë Sherry Arnstein (1969) dhe Roger Heart (1997), si dy artikulet më të famshme dhe serioze në drejtim të pjesëmarrjes komunitare dhe rinore. *Shkalla e Pjesëmarrjes*, trajtuar dhe zhvilluar nga këta studiues, përmban tetë hapa dhe përfaqëson nivelet në rritje të pjesëmarrjes rinore në forma të ndryshme bashkëpunim të rriturit. Kritikët dhe studiuesit e sotëm pranojnë se nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes janë të përshtatshme në rrethana të ndryshme. Megjithatë, kritikët e *Shkallës së Pjesëmarrjes* pohojnë se pjesëmarrja nuk është medoemos aq e thjeshtë sa trajtohet nga Arnstein dhe Heart, dhe se përfundimet përgjithësisht nuk marrin në konsideratë faktin se pjesëmarrja është një proces kompleks dhe interaktiv (të cilin qytetarët mund ta manipulojnë gjithashtu) (McCallum, Tritter, 2006).

ABSTRACT (English version)

The study focuses on the participation of youth groups at local level in Albania, investigating the role of young people and youth forums in public life and the impact they may have on the democratisation of the country, by observing the role of youth forums and civil society during the period of 1991 - 2014. The implication of politics with civil society and vice versa during the transitional period based on mutual recognition more than concrete ideas, is one of the main features of the transition in Albania, hindering democratisation of the country and overshadowing small local community groups. Strategies imported from developed countries by different agencies during the transition period, it appears that have caused only the loss of connections with reality and has avoided the real participation of active local young people.

Young people's engagement in democratic processes, considered as partners by policymakers and governors, sharing both power and responsibilities, is paradigm that emphasizes that young people have the potential to bring social change, contribute to peacebuilding and the development of a more just and democratic society. Participation of informal groups at local level is a MUST condition for the democratization and recognition of reality, leaving aside practices imported from developed countries during the transition period, as they are failed experiments already.

The analysis uses empirical data mainly, derived from case studies in different regions of Albania, to examine the following main research question: What role can play the active participation of local youth groups in the consolidation of democracy in Albania? Youth participation as a strategy for community development, is based on the postmodernists researchers, Sherry Arnstein (1969) and Roger Heat (1997) as the two most famous articulations and serious ones in terms of community and youth participation. Participation method, treated and developed by these aforementioned researchers, contains eight steps and represents the rising level of youth participation in various forms of cooperation with adults. Critics and scholars today recognise that different levels of participation are appropriate in different circumstances. However, critics of the Ladder of Participation claim that the level of participation is not necessarily as simple as treated by Arnstein and Heart, and the findings generally do not consider the fact that participation is a complex and interactive process (where citizens and social setting can manipulate)

Mirënjohje

Ky studim është produkt i një angazhimi të gjatë jo vetëm personal, por edhe i një mbështetje dhe bashkëpunimi me individë dhe grupe të shoqërisë civile dhe forume rinore lokale në rajone të ndryshme në Shqipëri. Jam thellësisht mirënjohës ndaj të gjithë personave që kanë ndihmuar dhe mbështetur këtë studim, duke siguruar informacion në forma të ndryshme, pa përtuar asnjëherë. Ky studim nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e Shoqatës ‘*Rinia në Sipërmarrjen e Lirë*’ në Kukës, e cila ka mbështetur pjesën më të madhe të studimit, duke organizuar shumë takime, anketime dhe intervista, gjithashtu edhe duke më dhënë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme gjatë studimit.

Një falenderim i madh shkon për udhëheqësin tim, Prof. Dr. Tonin Gjuraj. Orientimet e vazhdueshme dhe komentet kritike kanë qenë edukimi më i vlefshëm që unë kam patur ndonjëherë. Prof. Gjuraj, ka qenë gjithmonë i gatshëm, sa herë më është nevojitur ndihma, prandaj edhe duhet të pranoj se pa mbështetjen dhe inkurajimin e tij, nuk do të kisha mundur ta mbaroj këtë studim. U detyrohem shumë Dr. Roland Lami, për kritikën dhe mbështetjen që ka dhënë, gjithashtu edhe PhD. Elvis Iljazaj gjatë përgatitjes së draftit përfundimtar.

U detyrohem shumë kolegëve dhe miqve të mi në Kukës, por kryesisht dua të përmend Lavdrim Shehun, si një kritik dhe mbështetës i punës time përgjatë gjithë periudhës së këtij studimi. Gjithashtu, duhet të falenderoj drejtuesit e Forumeve, shoqatave dhe Qendrave Rinore në rrethet, Fier, Vlorë, Pukë, Tiranë dhe Kukës, të cilët më kanë mbështetur të siguroj rastet studimore dhe punën në terren. Numri i personave që kanë mbështetur punën time në terren janë të shumtë, prandaj edhe u jam mirënjohës dhe i falenderoj shumë.

Një falenderim i veçantë për familjen time të shtrenjtë, që më ka mbështetur për të realizuar synimet e mia; për bashkëshorten time Arjana dhe fëmijët e mi, Ariola, Brisilda dhe Brilanti, të cilëve u ka munguar koha që duhet të kaloja me ta, dhe me dashuri ua dedikoj atyre këtë punë të madhe.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Lista e shkurtimeve.....	xi
--------------------------	----

Kapitulli I: Hyrje..... 1

Objekti i studimit.....	1
-------------------------	---

Struktura dhe përmbajtja e kapitujve	3
--	---

Kapitulli II: Trajtimi teorik, metodologjia dhe hipoteza

2.1. Shpjegime të përgjithshme mbi projektin kërkimor	5
---	---

2.2. Metodat studimore të përdorura (intervistat gjysëm të strukturuar, fokus grupet dhe pyetsorët), avantazhet dhe kufizimet	8
---	---

2.3. Periudha e studimit, pozicioni im si “i jashtëm” dhe kufizimet.....	10
--	----

2.4. Trajtimi teorik dhe kërkimet e mëparshme	12
---	----

2.5. Debatet kritike mbi pjesëmarrjen rinore	20
--	----

2.6. Pyetjet specifike kërkimore	22
--	----

2.7. Hipoteza kryesore dhe hipotezat ndihmëse	25
---	----

2.8. Pëshkrim i përgjithshëm dhe motivimi	27
---	----

Kapitulli III. Teoritë e Demokracisë pjesëmarrëse dhe Referendumet

Lokale.

3.1. Pjesëmarrja e të rinjve në Europe: Vendet e Lindjes përballë Perëndimit.....	32
---	----

3.2. Grupet e vogla rinore dhe pjesëmarrja në kontekstin lokal në Shqipëri.....	35
---	----

3.3. Grupet e vogla, pushteti i tyre dhe interesat e përbashkëta	38
--	----

3.4. Nevoja për pjesëmarrjen e grupeve të vogla në demokraci	41
--	----

3.5.Çfarë kuptojmë me pjesëmarrje komunitare.....	43
---	----

3.6. Demokracia e praktikuar, referendumet lokale	46
---	----

3.7. Praktikant Ndërkombëtare për Referendumet	49
--	----

3.7.1 Pse Kemi Nevojë për Referendum Lokal?.....	50
3.7.2. Informacionit dhe vështirësitë e përcjelljes tek publiku	54
3.7.3. Historiku dhe Praktikën me Referendumet në Shqipëri.....	56
3.7.4. Kush përfiton nga referendume lokale, shumica apo pakica?.....	58

Kapitulli IV: Pjesëmarrja e grupeve rinore dhe shoqëria civile gjatë periudhës së tranzicionit.

4.1. Të rinjtë dhe e ardhmja e demokracisë në Shqipëri	59
4.2. Pjesëmarrja e të rinjve në forumet politike.....	64
4.3. Shoqëria civile dhe grupet rinore lokale në Shqipëri (1991-2011).....	68
4.4. Roli i shoqërisë civile në demokratizim	77
4.5. Shoqëria civile gjatë periudhës së tranzicionit	83
4.6. Grupet e vogla në nivel lokal.....	89
4.7. Pjesëmarrja rinore dhe ndikimi në demokratizim.....	91
4.8. Pjesëmarrja e të rinjve në demokraci: mënyrat institucionale dhe të përditëshme, perspektivat ndërkombëtare	98
4.9. Përdorimi i medias sociale si mjet për pjesëmarrje dhe pjesëmarrja e të rinjve përmes internetit.....	101
4.10. Ndryshimet sociale përmes pjesëmarrjes së të rinjve.....	108
4.10.1 Aksione rinore me impakt komunitar	110
4.11. A janë të rinjtë të interesuar për ndryshim social?	115
4.12. Pjesëmarrja si kontribut vullnetar.....	117
4.13. Mobilizimi dhe pjesëmarrja e grupeve rinore	122
4.14. Pjesëmarrja, një mjet për të luftuar korrupsionin.....	125
4.15. Sektori jofitimprurës në qeverisjen vendore	127

4.16. Barrierat e pjesëmarrjes rinore	131
---	-----

Kapitulli V: Raste Studimore me shoqata rinore dhe grupe komunitare

lokale në; Kukës, Pukë, Fier, Tiranë dhe Vlorë.....134

5.1. Rasti Studimor Kukës: Shoqata Rinia në Sipërmarrjen e Lirë.....	135
5.2. Mbështetja e të rinjve për të marrë pjesë	138
5.3. Ndarja e pushtetit me të rinjtë	141
5.4. Rasti Studimor Pukë: Qendra Levizja rinore per Demokraci (LRD)	143
5.5. Rasti Studimor Fier: Qendra Rinore Epoka e Re	146
5.6. Rasti Studimor Tiranë: CRCA	150
5.7. Rasti Studimor Qendra Rinore Vlorë	154
5.8. Konkluzione nga rastet studimore	157

Kapitulli VI: Zgjedhjet dhe roli i të rinjve

6.1. Votuesit për herë të parë: marrëdhëniet me politikën, pjesëmarrja dhe sjellja gjatë fushatës elektorale.....	158
6.2. Ndikimi i prindërve tek fëmijët e tyre Votues për herë të parë	161
6.3. Marrëdhëniet e të rinjve me partitë politike dhe pjesëmarrja në zgjedhje...165	
6.4. Efekti i medias tek të rinjtë	169
6.5. Vëmendja e politikës ndaj të rinjve	171
6.6. Konkluzione për votuesit për herë të parë dhe rolin e tyre në zgjedhje ...173	
6.7. Zgjedhjet e Përgjithëshme të 2013-ës. Pjesëmarrja dhe roli i të rinjve në fushatën elektorale dhe zgjedhje	173
6.8. Debatet publike me grupe rinore gjatë fushatës zgjedhore 2013.....	176

Kapitulli VII: Përfundime dhe Konkluzione.....180

Shenime	187
Shtojca	190
Bibliografia	198

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ACER	Albanian Center for Economic Research
AESSH	Albanian Alliance of Students
ASET	Forumi Shqiptar Social Ekonomik
BB	Banka Botërore
BE	Bashimi Evropian
CoE	Council of Europe
CRCA	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
CRS	Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FRESSH	Forumi Rinor Eurosocijalist Shqiptar
FRPD	Forumi Rinor i Partisë Demokratike
ILO	International Labor Organization
INSTAT	Instituti i Statistikës
ITU	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit
KE	Komisioni Evropian
KESH	Korporata Elektro-Energjitike Shqiptare
KSE	Karta Sociale Europiane
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Koalicioni i Vëzhguesve Vendor
LGP	Local Governance Programme
LRD	Lëvizja Rinore për Demokraci
LRI	Lëvizja Rinore për Integrim
LSMS	Leaving Standards and <i>Measurement</i> Survey

LSE	London School of Economics
MTKRS	Ministria Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjes Sociale dhe Shanceve të Barabarta
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
QRV	Qendra Rinore Vlorë
RSL	Shoqata Rinia në Sipërmarrjen e Lirë
TIA	Transparency International Albania
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNDP	United Nations Development Program
UNESCO	<i>United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization</i>
UNICEF	United Nations Children's Fund
UNIFEM	United Nations Development Fund for Women

Kapitulli I. HYRJE

Objekti i studimit

Ky studim merr përsipër të sjellë në vëmendjen e studiuesve pjesëmarrjen e grupeve rinore në nivel lokal si premisë dhe mundësi për ndryshim social, zhvillim komunitar dhe një transformim demokratik në Shqipëri. Pjesëmarrja e të rinjve aq shumë e kërkuar dhe e synuar vetëm gjatë fushatave elektorale, nuk mund të prodhojë politika zhvillimi dhe përfshirjen e të rinjve në hartimin e politikave efektive që u përkasin atyre, për sa kohë politika dhe vendimmarrësit nuk ndajnë pushtetin me të rinjtë. Nisur nga fakti se grupet rinore dhe të rinjtë përdorën dhe janë manipuluar për qëllime vetëm elektorale gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, duke mos marrë përgjegjësitë reale dhe përfitimet që duhet të ketë, mora përsipër të trajtoj çështjen e pjesëmarrjes, kryesisht në nivel komunitar, si një ndër aspektet kryesore që mund të sjellë ndryshim social dhe demokratizimin e shoqërisë.

Studimi trajton në mënyrë të veçantë pjesëmarrjen e grupeve rinore dhe rolin e tyre në nivel komunitar në Shqipëri, duke analizuar strukturat e tyre si pjesë e shoqërisë civile, pa anashkaluar rëndësinë e forumeve rinore politike. Maksimizimi i pjesëmarrjes të të rinjve në nivelin komunitar, duke shfrytëzuar aftësitë dhe kompetencat e grupeve rinore, do të rrisë rolin e këtij grupi social dhe njëkohësisht premtën për politika zhvillimore më efektive dhe përfshirëse.

Diskutimi dhe gjetjet në terren do të identifikojnë elementët thelbësor për një pjesëmarrje aktive dhe të qëndrueshme të grupeve rinore në nivel komunitar, duke krijuar modele dhe standarte për grupet dhe individët të cilët udhëheqin ndryshimet sociale me target të rinjtë.

Pjesëmarrja rinore ka të bëjë me përfshirjen e të rinjve në aksione të përgjegjshme sfiduese, të cilat plotësojnë nevojat reale me mundësitë për të planifikuar dhe ndikuar vendimmarrjen për një aktivitet, impakti i të cilit shtrihet tek të tjerët, dmth përtej vetë të rinjve pjesëmarrës. Rakesh Rajani² nga Universiteti Harvard, tërheq vëmendjen se ‘zhvillimi i aftësive tek të rinjtë, rritja e kompetencave, krijimi i aspiratave dhe vlerave, arrihet vetëm përmes pjesëmarrjes’. Kjo konfirmon pikëpamjen se pjesëmarrja është një produkt dhe strategji e zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor.

Implikimi i shoqërisë civile, kyesisht *organizatave rinore* në politikë gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri, ka zbehur rolin e të rinjve në jetën komunitare, duke rritur ndjeshëm pritshmëritë e të rinjve për të kapur majat e pushtetit pa kaluar fazat e shkallës së pjesëmarrjes³ (Arnstein, 1969). Ky model, i cili synon përdorimin e OJF-ve si mjet për të arritur tek politika, ka vazhduar përgjatë gjithë periudhës së tranzicionit, nga grupe të ndryshme politike, duke lënë mënjanë rolin shumë të rëndësishëm që grupet rinore mund të luajnë në nivelin lokal dhe demokratizimin e shoqërisë.

Ky studim fokusohet në të dhënat e mbledhura nga terreni, intervistat dhe pyetsorët, takimet me grupet e interesit, kryesisht forumet rinore të shoqërisë civile dhe ato politike në nivelin komunitar. Hulumtimi fokusohet dhe identifikon lidhjet midis *grupeve të vogla*, rolin e pjesëmarrjes direkte si proces demokratik dhe *ndikimin e tij përtej kontekstit lokal*, duke trajtuar periudhën 1992 - 2014. Studimi merr përsipër të analizojë pjesëmarrjen e grupeve rinore në nivel kombëtar në Shqipëri, për të vëzhguar gjithashtu edhe në veçanti grupet rinore lokale dhe ndikimet në zhvillimet komunitare

²Promoting Strategic Adolescent Participation: a discussion paper for UNICEF, Rajani, R. 1999

³“A Ladder of Citizen Participation” është artikulli i botuar nga Arnstein, Sherry R, në revistën e Shoqatës Amerikane të Planifikimit (Jurnal of the American Planning Association) në vitin 1969. Ky artikull, shpjegon pushtetin e strukturave të shoqërisë dhe sesi ata ndërveprojnë.

Struktura dhe përmbajtja e kapitujve

Në **kapitullin e parë** përmes një hyrje të përgjithëshme jepen shpjegime rreth objektit të këtij studimi, duke vazhduar me shpjegimin në detaje për çfarë ndodhet në secilin kapitull. Në qendër të **kapitullit të dytë** shpjegimi për skeletin teorik, metodologjinë e përzgjedhur, debatet kryesore mbi pjesëmarrjen duke u drejtuar tek pyetjet kryesore dhe hipoteza e këtij studimi. Pjesëmarrja e të rinjve në nivel komunitar është e domosdoshme si kusht për demokratizimin dhe njohje me realitetin, për të lënë kështu mënjane praktikave të importuara nga vendet e zhvilluar gjatë periudhës së tranzicionit, tashmë eksperimente të dështuara, është argumenti kryesor mbështetës i tezës së këtij studimi. Periudha e tranzicionit ka provuar praktika të ndryshme, të cilat më shumë sesa kanë praktikuar pjesëmarrjen direkte të grupeve dhe forumeve rinore, kanë përdorur dhe manipuluar interesat e të rinjve për qëllime elektorale, me mungesë të theksuar të strategjive gjithëpërfshirëse të çështjeve që ju interesojnë të rinjve, duke rezultuar në pamundësinë për tu zbatuar dhe dështime të vazhdueshme.

Teoritë e demokracisë pjesëmarrëse, janë çështjet kryesore që trajtohen në **kapitullin e tretë**. Pjesëmarrja e të rinjve duke krahasuar atë të vendeve të perëndimit me vendet e lindjes, Trajtimi i grupeve të vogla komunitare duke ndërlidhur interesat e përbashkëta dhe pushtetin e tyre, dhe demokracia e drejtëpërdrejtë pjesëmarrëse e lidhur me referendumat lokale si mjet i rëndësishëm në duart e qytetarëve, përbëjnë diskutimin në rrafshin teorik, duke i paraprirë kështu më mirë edhe kuptimit të pjesëmarrjes të të rinjve në forumet rinore lokale.

Pjesëmarrja e grupeve rinore lokale dhe roli i shoqërisë civile gjatë periudhës së tranzicionit trajtohen në **kapitullin e katërt**. Forumet rinore politike dhe jo politike,

organizatat e shoqërisë civile dhe përdorimi i medias sociale si mjet për të mundësuar pjesëmarrjen e të rinjve, sjellin me vete identifikimin e barrierave që ndikojnë në pjesëmarrjen rinore, për të mbrojtur argumentat të lidhur me teoritë e pjesëmarrjes në kapitullin e dytë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që trajtohen në kapitullin e tretë, ka të bëjë me pjesëmarrjen si fenomen vullnetar. Pjesëmarrja në takime, fushata elektorale, fushata ndërgjegjësuere apo edhe ditën e zgjedhjeve, duhet të konsiderohet si një kontribut vullnetar, pavarësisht argumentit se njerëzit mbledhen ose marrin pjesë për interesat e tyre, kjo është një vlerë e papaguar dhe si e tillë duhet vlerësuar dhe njohur.

Rastet studimore nga organizata dhe forume rinore në rajone të ndryshme të vendit, përbëjnë **kapitullin e pestë** si një bazë e shëndoshtë për të mbrojtur argumentat që sjell në kapitullin e dytë, të lidhur me teoritë e pjesëmarrjes. Me qëllim për të sjellë eksperiencat dhe praktikat e grupeve rinore lokale, janë vëzhguar nga afër dhe studiuar disa forume, shoqata dhe grupe komunitare në rajone të ndryshme. Periudha e tranzicionit ka provuar se një pjesë e mirë e organizatave me veprimtari në nivel kombëtar, kanë humbur lidhjet me realitetin dhe grupet e interesit që përfaqësojnë; kanë qenë të implikuara në politikë; apo kanë rezultuar vetëm si institucione për të thithur fonde, por pa mundur të kenë ndikim në demokratizimin e vendit. Ndërsa grupet e vogla rinore dhe komunitare, pavarësisht lidhjeve të drejtëpërdrejta me realitetin dhe kontributit të tyre, nuk janë pranuar apo ftuar për të hartuar politika që mund ti shërbenin më mirë sesa strategjitë apo praktikat e importuara nga vendet e zhvilluara.

Për shkak të kohës në të cilën studimi është shtrirë dhe mundësive që na jep kjo mundësi për të vëzhguar në mënyrë të drejtëpërdrejtë pjesëmarrjen aktive gjatë fushatës dhe ditën e zgjedhjeve, **kapitulli i qashtë** trajton procesin e zgjedhjeve të përgjithshme

të vitit 2013. Trajtesa për votuesit për herë të parë dhe marrëdhëniet e tyre me politikën gjatë fushatës elektorale, përbëjnë praktikën reale nga aktorë e përfshirë drejtëpërdrejtë si aktivistë apo përfaqësues të forumeve rinore në nivel lokal. Ky kapitull merr përsipër të trajtojë ndikimin e prindërve tek fëmijët e tyre, gjithashtu edhe ndikimin e medias sociale tek të rinjtë. Përdorimi i medias sociale nga politikanët për të tërhequr vëmendjen e të rinjve ka ndryshuar mënyrën e të bërit politikë. Debatet e forumeve rinore lokale gjatë fushatës elektorale, janë një shembull i mirë për të argumentuar rolin e tyre në demokratizimin e vendit dhe premisë për ndryshimet sociale. Rezultatet e zgjedhjeve, duket se na japin të drejtë, për sa kohë qeveria e re e dalë nga zgjedhjet e Qershorit 2013 ka zgjedhur nga forumet rinore drejtues institucionesh, duke u dhënë besimin për poste të rëndësishme. E gjithë trajtesa e këtij kapitulli përmbledh një periudhë njëvjeçare, duke filluar me fushatën parazgjedhore deri në krijimin e qeverisë pas zgjedhjeve dhe ndarjes së përgjegjësisë tek disa përfaqësues të forumeve rinore.

Kapitulli shtatë është akti përmbyllës me konkluzionet dhe rekomandimet, për të përmbledhur rezultatet kryesore të këtij studimit, duke lidhur trajtesat teorike me eksperiencën e mbledhur nga terreni për të kontribuar në një debat shkencor.

Kapitulli II: SKELETI TEORIK , METODOLOGJIA DHE HIPOTEZA

2.1. Shpjegime të përgjithshme mbi projektin kërkimor

Diskutimi teorik është gjithnjë në kontekstin e përgjithshëm. Për këtë hulumtim, do të përdoren dy implikime, një i përgjithshëm dhe një tjetër më shumë specifik. Para së gjithash, është e nevojshme që analizat të përfshijnë verifikimin e duhur (të matshëm),

përfashtimi i të cilit mund të sjellë interpretime të shtrembëruara. Ky shqetësim është shumë i përgjithshëm për tu zgjidhur në thellësi këtu. Konteksti i veçantë i problemeve të hulumtimit trajton vëzhgime empirike të veçanta dhe kompozim kërkimor, prandaj, edhe problemi i verifikimit të analizë së veçantë tejkalohet në mënyrën e duhur.

Implikimi i dytë ndoshta është më i rëndësishëm, e gjithashtu i lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në grupet e vogla dhe demokracinë e praktikuar, meqenëse lidhet me vëzhgimin e një variable shumë të veçantë – të paktën për rastin e Shqipërisë pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal - në të shumtën e modeleve dhe debateve supozohet se pjesëmarrja e tyre është e garantuar dhe e lirë. Shumica e analizave ofrojnë vëzhgim për grupimet rinore të shoqërisë civile dhe sjelljet e saj gjatë periudhës së tranzicionit, pa trajtuar pjesëmarrjen e të rinjve në grupet e vogla apo efektin që mund të japin në demokracinë e praktikuar. Në politikën lokale, ky lloj vëzhgimi statistikor mund të jetë dyfish i rëndësishëm, në sensin se shumica e grupimeve rinore janë degë e forumeve kombëtare apo qendra dhe shoqata me veprimtari të thjeshta lokale.

Një pjesë e madhe e grupimeve apo forumeve të cilat janë degë e atyre kombëtare, në të shumtën e rasteve janë direkt të varura në kapriçot e forumeve politike apo jo politike kombëtare, për të prodhuar suksesin në politikat dhe aktivitetet vendore.

Me sa duket ky tipar i demokracisë lokale bashkëvepron ngushtë me çështjen e përmendur më sipër, duke e bërë politikën lokale të vështirë për tu kuptuar qoftë nga të rinjtë si votues apo edhe si konsumator të demokracisë pjesëmarrëse. Për pjesën më të madhe të teorive të cilat fokusohen në fushën e pjesëmarrjes dhe grupet e vogla sistemi i demokracisë së praktikuar është shumë funksional dhe rezultativ (Gastil, 1993). Në vendet e zhvilluara me demokraci të praktikuar, kjo teori është e provuar. Në kontekstin

lokal shqiptar, gjërat janë mjaft të ndërlikuara. Grupet rinore lokale janë rrënjësisht të mënjanuara nga organizimi funksional strukturor. Më fjalë të tjera, pavarësisht strukturave të forumeve të ndryshme egzistuese, të cilat në të shumtën e rasteve janë produkt i viteve ta para të tranzicionit, sikurse janë; parlamentet rinore, unionet studentore, apo degët e disa organizatave të tjera kombëtare, nuk ka një mënyrë rregullatore funksionimi ku mund të gjenerojë debat kritik dhe demokraci pjesëmarrëse. Për këtë qëllim, të dyja bashkë, funksionimi i grupeve të vogla lokale dhe mundësitë reale të pjesëmarrjes së të rinjeve si aktorë të demokracisë së praktikuar, do të udhëheqin analizat e ndryshme të këtij studimi.

Për shkak se mungojnë të dhënat mbi funksionimin e grupeve rinore dhe pjesëmarrjen e të rinjve në hartimin e politikave dhe strategjive në interes të tyre, ky hulumtim do të fokusohet drejt mekanizmit të shoqërisë civile, kryesisht atyre të cilat kanë lidhje direkt me nivelin lokal, me synim për të mbledhur të dhëna të matshme dhe fakte nga komunitet vendore, të cilat do të përdoren për të mbështetur hipotezën dhe shpjeguar pyetjet kërkimore të hulumtimit.

Diskutimi i mësipëm lidhur me varësinë e forumeve të pavarura lokale tek ato kombëtare është lehtësisht i krahasueshëm edhe me forumet e partive politike. Pa u thelluar shumë në detaje gjatë këtij paragrafi, çështja kryesore është aplikimi i modeleve të ndryshme të pjesëmarrjes, demokracia e praktikuar në grupet dhe forumet e vogla lokale dhe mundësia e këtyre për të ndikuar në nivel përtej atij lokal. Këto komente të trajtuara gjatë këtij hulumtimi, e ftojnë lexuesin kritik të vrojtojë dhe të marrë në konsideratë traktimin e veçantë të çështjeve të renditura në kapitujt e kësaj teze.

2.2. Metodat studimore të përdorura (intervistat gjysëm të strukturuar, fokus grupet dhe pyetsorët), avantazhet dhe kufizimet.

Analiza cilësore është bazuar në metodat e ndryshme kërkimore të mëparshme. Pjesa kryesore e informacionit të këtij studimi, e pasqyruar në kapitujt në vazhdim e mbledhur në terren është produkt i punës kërkimore të periudhës prej vitit 2011-2014.

Për të arritur në përmbushjen e qëllimit të këtij kërkimi dhe për të adresuar pyetjet kërkimore të studimit, kam përzgjedhur një përjasje metodologjike të përzier. duke mundësuar përfshirjen e drejtuesve të forumeve/grupeve rinore dhe aktivistë të shoqërisë civile në nivel lokal të cilët kanë bashkëpunuar edhe gjatë takimeve për grupet e fokusit. Një nga metodat ka të bëjë me intervistat gjysëm të strukturuar përmes së cilës është arritur në mbledhjen e informacionit të detajuar për periudhën e grupeve rinore të aktivizimit në të shkuarën dhe ditët e sotme. Intervistuesit janë përzgjedhur bazuar në referencat e marra nga forumet/organizatat aktive, drejtuesit dhe aktivistët e tyre.

Për të kompletuar kërkimin janë përdorur edhe metodat e mëposhtme:

1. Rishikim i dokumenteve dhe raporteve të institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare të lidhura ngushtë me fushën e shoqërisë civile dhe pjesëmarrjes qytetare. Arkivat e shtypit të ditës kanë ndihmuar gjithashtu në mbledhjen e informacionit për periudhat e ndryshme të tranzicionit.
2. Intervista për rastet studimore me drejtues dhe aktivistë të organizatave dhe grupeve rinore lokale në Tiranë, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë, Durrës, Lezhë dhe Pukë.

3. Pyetsorë gjithsej për 290 pjesëmarrës; 92 përmes rrjeteve sociale, 128 përmes adresave elektronike dhe drejtëpërdrejtë për të rinjtë të përfshirë ose jo në grupet rinore, për të pasqyruar opinionet rreth pjesëmarrjes dhe 70 për të anketuarit gjatë zgjedhjeve të përgjithëshme 2013. Shpërndarja gjeografike ka qenë një nga kriteret për të arritur një shtrirje në pjesën më të madhe të Shqipërisë, sidomos në ato zona ku forumet dhe grupet e ndryshme rinore janë më aktive. Shpërndarja tek aktivistët e periudhave dhe organizatave të ndryshme ka qenë një shqetësim për tu respektuar gjatë kryerjes së këtyre pyetsorëve. Pyetsorët me përmbajtje të strukturuar, pasi janë testuar janë shpërndarë në periudha të ndryshme tek grupet dhe individët e synuar, duke shfrytëzuar njohjet dhe lidhjet me organizatat e ndryshme rinore në Shqipëri.
4. Takime me fokus grupe me pjesëmarrës 3-7 persona nga organizatat dhe grupet rinore lokale. Kjo metodë ka ndikuar në grumbullimin e të dhënave cilësore. Janë zhvilluar 8 takime të tilla me pjesëmarrës nga 3-7 persona për secilin takim. Takimet janë kryer gjatë periudhës 2012-2013, me aktivistë të forumeve dhe organizatave të ndryshme rinore. Për të organizuar këto takime kanë ndihmuar drejtuesit e organizatave, duke shfrytëzuar takimet e tyre të planifikuara për aktivitete të ndryshme.
5. Vëzhgime direkte gjatë takimeve të forumeve rinore politike dhe parlamenteve rinore kryesisht në periudhën e zgjedhjeve brenda këtyre forumeve, për të monitoruar funksionimin e demokracisë brenda tyre dhe pjesëmarrjen reale.

Përdorimi i metodës së përzier ka bërë të mundur krahasimin midis të dhënave nga përdorimi i tyre dhe kontrollin e informacionit për të vëretuar të dhënat nga burime të

ndryshme. Qasja cilësore e këtij studimi e përdorur gjatë fokus grupeve me forume të ndryshme rinore në komunitete të ndryshme, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit të drejtëpërdrejtë lidhur me pjesëmarrjen reale të të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel vendor.

Eksperienca e gjatë personale, e cila lidhet direkt me shoqërinë civile; praktikën e pjesëmarrjes së të rinjve në grupet e vogla në nivel lokal, - pjesëmarrja dhe menaxhimi i projekteve që lidhen direkt me demokracinë pjesëmarrëse dhe të drejtat e njeriut - i japin avantazh dhe akses tezës për të organizuar dhe mbledhur të dhëna në terren. Ndërsa kufizimet lidhen mundësinë e përfshirjes së grupeve të vogla lokale në të gjithë rajonet e vendit. Megjithë përfshirjen e grupeve të ndryshme në rajonet më të mëdha të Shqipërisë, prapëseprapë mbeten grupe të tjera, të cilat është e pamundur të përfshihen dhe të vëzhgohen për mënyrën e funksionimit dhe demokracinë praktikuese që ushtrojnë ato. Prandaj, është e nevojshme të bëhen kërkime të tjera të shtrira në këtë fushë duke përfshirë sa më shumë grupe të vogla lokale. Një kufizim tjetër lidhet me grupet të cilat do të kontaktohen direkt në terren. Për shkak të mungesës së informacionit për grupet e përfaqësimit dhe antarësisë së forumeve rinore, mund të qëllojë që të mënjanohej jo qëllimisht ish-anëtarë dhe aktivistë, të cilët mund të ishin një kontribut i rëndësishëm për studimin. Megjithatë, përpjekjet për të marrë pjesë në aktivitetet e grupeve në terren do të minimizojnë përjashtimin e individëve nga intervistat. Grupet e fokusit janë një mundësi e mirë për të kapërcyer pengesat e ngjashme.

2.3. Periudha e studimit, pozicioni im si “i jashtëm” dhe kufizimet

Studimi i referohet periudhës së tranzicionit duke përfshirë periudhën prej 1992-2014, me fokus të veçantë në periudhën e ndërmjetme dhe atë të viteve të fundit, e cila përkohet edhe me aktivizimin e forumeve dhe grupeve rinore në rajone të ndryshme. Periudha kryesisht pas viteve 1997 është momenti kur lindin edhe organizatat e para rinore jashtë Tiranës, dhe jashtë ombrellës së organizatave me veprimtari kombëtare. Vitet e fundit kanë një intensitet më të madh përse i përket angazhimit të grupeve rinore në nivel lokal, e reflektuar kjo edhe nga rastet studimore me organizata të shoqërisë civile në rrethe të ndryshme të Shqipërisë.

Gjatë kryerjes së intervistave, takimeve të fokus grupeve dhe pyetsorët, jam përpjekur të jem sa më shumë ‘asnjanës’ që të ishte e mundur. Asnjanësia në këtë rast, nënkupton mospërfshirjen në diskutime dhe ndikimin në përgjigjet e të intervistuarve, mbajtjen e distancës dhe mos-shfaqjen e bindjeve të mia politike apo eksperiencës time me grupet rinore. Në rastin më të parë dhe gjatë gjithë punës së kryer në terren me drejtues apo aktivistët e komunitetit të synuar, kam shpjeguar pozicionin tim personal si një hulumtues për shkak të studimit të Doktoraturës. Ky shpjegim ka qenë i rëndësishëm në shmangjen e keqkuptimeve me njerzit e ndryshëm të përfshirë gjatë punës në terren. Në të shumtën e rasteve individët dhe grupet e targetuara janë përgjigjitur interesit tim për të marrë pjesë në intervista, grupe fokusi dhe pyetsorë, pa përjashtuar edhe rastet kur kanë refuzuar për shkaqe të ndryshme.

Pavarësisht përpjekjes për të qenë ‘asnjanës’ gjatë punës në terren, njohjet dhe prezenca në disa takime dhe intervista kanë ndikuar sadopak tek të pyeturit. Në disa raste kam hasur vështirësi në gjetjen e kontakteve për aktivistët në forume të ndryshme, kur është

kërkuar informacioni dhe intervistat me drejtues të forumeve politike rinore apo drejtues të qeverisjes vendore.

2.4. Trajtimi teorik dhe kërkimet e mëparshme

Teoritë e pjesëmarrjes së komunitetit kanë tërhequr një vëmendje në rritje të akademikëve veçanërisht në fillim të viteve 1990, ndërsa debati për këtë ka nisur prej viteve 1960. Ky hulumtim merr përsipër të sjellë në vëmendjen e hulumtuesve një pasqyrë të shkurtër të disa teorive më të rëndësishme të trajtuara deri më sot, si një mjet efikas për të kuptuar më së miri pjesëmarrjen në nivel lokal dhe demokracinë praktikuese në grupet e vogla. Kjo qasje siguron një kontekst teorik brenda të cilit, mund të vlerësohet përshtatshmëria e qasjeve të ndryshme pjesëmarrëse komunitare në ndryshimet sociale dhe zhvillimin demokratik në Shqipëri.

Kufizimet e përfshirjes direkte të grupeve rinore lokale në zhvillimet sociale, mosegzistenca e politikave efektive rinore dhe mungesa e koordinimit ndërmjet shtetit dhe zhvillimit komunitar kanë qenë të pamjaftueshme në angazhimin rinor në pjesëmarrjen e proceseve demokratike gjatë periudhës së tranzicionit. Një rishikim i teorisë për zhvillimin e të rinjve zbulon se krijimi i mundësive për të rinjtë për tu përfshirë në pozicione drejtuese, mund të ofrojë vlera të mëdha në zhvillimin e personaliteti të tyre dhe komuniteteve ku ata bëjnë pjesë. Një nga objektivat e zhvillimit komunitar ka të bëjë me pjesëmarrjen e të rinjve në krijimin e komuniteteve sociale dhe angazhimin në programet e vetë-përmirësimit (Girvan, 1993).

Kur flasim për pjesëmarrjen, me të drejtë, shumë shpejt të vjen ndërmend se shumë njerëz kanë kocnepte të ndryshme për atë që pjesëmarrja merr kuptimin e saj. Politkiana Carole Pateman, që në vitin 1970, i referohet pakapshmërisë së pjesëmarrjes, kur ajo

vuri në dukje se; ‘përdorimi i gjërë i termit ka tentuar të nënkuptojë se përmbajtja e saktë dhe kuptimplotë e termit pothuajse është zhdukur; ‘Pjesëmarrja’ është përdorur për t’iu referar një shumëlloshmërie të situatave të ndryshme nga njerëz të ndryshë’. Kjo shpjegon arsyen se përse në literaturën e teorisë politike, pjesëmarrja ka tendencë të hetë e diferencuar në shkallë të ndryshme të pjesëmarrjes. Pateman ka prezantuar dallimin midis pjesëmarrjes së plotë dhe të pjesëshme, ku me të parën i referohet fuqisë së barabartë për të përcaktuar rezultatin e vendimeve ‘për të gjithë pjesëmarrësit, ndërsa me të pjesëshme i referohet konsultimit’ (Pateman, 1970: 70)

Në të njëjtën linjë qëndrojnë edhe studiuesit postmodernistë Sherry Arnstein (1969) dhe Roger Heart (1997), si dy artikulumet më të famshme dhe serioze në drejtim të pjesëmarrjes komunitare dhe rinore me shkallën e pjesëmarrjes, të cilët akoma më shumë bëjnë dallimin e konceptit të pjesëmarrjes edhe më të thelluar se Pateman specifikisht në kontekstin politik. *Shkalla e Pjesëmarrjes*, trajtuar dhe zhvilluar nga këta studiues, përmban tetë hapa dhe përfaqëson nivelet në rritje të pjesëmarrjes rinore në forma të ndryshme bashkëpunimi me të rriturit. Shkalla e pjesëmarrjes së Arnstein (1969) identifikon disa shakllë, duke nisur nga mungesa e pjesëmarrjes, përmes tokenizmit deri tek pushteti qytetar. E ngjashme me Arnstein është edhe OECD (2001: 2), kur bën dallimin ndërmjet shpërndarjes së informacionit, konsultimit dhe pjesëmarrjes aktive, çka përsëri tregon për shkallë të ndryshme të përfshirjes dhe ndikimit. Këto teori hierarkike, tregojnë për vështërsitë për të arritur pjesëmarrjen e ‘plotë’, si ‘një fuqi e barabartë që përcakton rezultatin’ (Pateman, 1970), e cila është konsideruar si një ideal normativ për të cilin duhet të luftojmë, ndërsa nuk duhet te heqim dorë asnjëherë derisa ta arrijmë atë.(Cammaerts and Carpentier, 2005). Kështu,

shumë studiues kanë zhvilluar teoritë e tyre në përpjekje për të arritur realitetin, në vend që të nxisin idealin e pakapshëm të pjesëmarrjes.

Studiuesit e konsideruar si realist të teorisë së pjesëmarrjes ndryshe nga teoritë normative, nxisin qytetarët të ndikojnë politikë-bërjen, por pa pushtetin për të vendosur, duke bindur ‘pjesëmarrësit’ për përshtypjen që ata mund të ndikojnë dhe marrin pjesë, duke e konsideruar si nocion të pseudo-pjesëmarrjes (Verba, 1961), apo pjesëmarrje e manipuluar (Strauss, 1998). Për Pateman, përkufizimi i pjesëmarrjes është një nocion që në mënyrë thelbësore është i lidhur me pushtetin. Megjithatë, pushteti ngec në baltë përmes përpjekjeve të shtetit, organizatave ndërkombëtare apo vendore me diskursin dhe përpjekjet e tyre për të përfshirë qytetarët apo shoqërinë civile në proceset e vendimarrjes. Ky pështjellim në lidhje me marrëdhënien që duhet për pjesëmarrjen reale, shton rrezikun e krijimit të një mungese besimi, pritshmërive ndaj qeverisjes duke krijuar një hendek të madh midis atyre që qeverisin dhe të qeverisurve.

Kritikët dhe studiuesit e sotëm pranojnë se nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes janë të përshtatshme në rrethana të ndryshme. Megjithatë, kritikët e *Shkallës së Pjesëmarrjes*, McCallum dhe Tritter pohojnë se pjesëmarrja nuk është medoemos aq e thjeshta sa trajtohet nga Arnstein dhe Heart, dhe se përfundimet përgjithësisht nuk marrin në konsideratë faktin se pjesëmarrja është një proces kompleks dhe interaktiv (të cilin qytetarët mund ta manipulojnë gjithashtu) (McCallum, Tritter, 2006).

Marrëdhënia ndërmjet pjesëmarrjes politike dhe pushtetit politik është gjithashtu një nga debatet sa i përket kuptimit të demokracisë pjesëmarrëse. Për disa studiues, demracia është kryesisht procedurale – një metodë për të zgjedhur dhe ndryshuar elitat që qeverisin në një periudhë të caktuar (Schumpeter, 1942, Downs, 1957, Mills, 1956). Për

të tjerët, demokracia pjesëmarrëse është më shumë e lidhur me kulturën politike dhe shtrirjen e demokracisë dhe vendimarrjes demokratike në jetën e përditëshme (Pateman, 1970; Habermas, 1994).

Studimi nis me sigurimin e përkufizimit të pjesëmarrjes, e cila na ndihmon për të qartësuar kuptimin e thjeshtë ndërsa krijon një kufi për keqkuptimet e mundshme. Për këtë arsye, një përkufizim i dobishëm i pjesëmarrjes së publikut apo komunitetit është përshtatur nga Stoker për 'pjesëmarrjen politike' (Stoker, 1997) kur e përkufizon si: *Pjesëmarrja e anëtarëve të komunitetit në një nga proceset e formulimit, miratimit dhe zbatimit të politikave publike*. Ky është një përkufizim i gjerë, i cili e shtrin theksin e pjesëmarrjes publike përtej zhvillimit të politikave, vendimarrjes dhe zbatimit. Ndoshta koncepti themelor mbi teorinë e pjesëmarrjes së komunitetit është trajtuar në një mënyrë më të plotë nga Arnstein (1969). Puna kërkimore më e rëndësishme e Arnstein buron nga vlerësimi i qartë se në shoqëri ndodhen nivele të ndryshme pjesëmarrjeje, duke i ndarë ato në tetë shkallë: 1. *Manipulim*, 2. *Terapi*, 3. *Informim*, 4. *Konsultim*, 5. *Pozicionim*, 6. *Partneritet*, 7. *Pushtet i deleguar*, 8. *Kontrolli qytetar*.

Prej shfaqjes së Arnstein, janë zhvilluar teori të tjera komplekse të cilat kanë prodhuar teori të ndryshme në lidhje me pjesëmarrjen. Në fakt këto përpjekje kanë ndihmuar në kuptimin e pjesëmarrjes në termat e fuqizimit të individëve dhe komuniteteve. Kjo ka ardhur nga rëndësia e idesë së pjesëmarrës qytetare si aktor, duke e parë atë si mjet drejt pushtetit. Ballafaquar me këtë model, njerëzit supozohet të jenë të përgjegjshëm për veten e tyre dhe kështu duhet të jetë në fakt, të jenë aktiv në vendimarrjen për shërbime publike. Në këtë kontekst, Burns (1994) modifikoi shkallën e pjesëmarrjes së Arnstein dhe propozoi shkallën e pushtetit të qytetarëve si më poshtë;

MOSPJESËMARRJE QYTETARE:

- Promovim qytetar
- Konsultime cinike/përbuzëse
- Informacion i pakët
- Kujdes për klientin

PJESËMARRJE QYTETARE:

- Konsultime të vërteta
- Bord konsultativ i dobishëm
- Vendimarrje e limituar dhe decentralizuar
- Partneritet
- Delegimi i kontrolluar

KONTROLLI QYTETAR

- Kontroll i besueshëm
- Kontroll i pavarur

Kjo shkallë pjesëmarrje është përshtatur përtej asaj të Arnstein, duke zbërthyer në mënyrë më cilësore nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes. Si zhvillim i konceptit të shkallës së pjesëmarrjes Wilcox (1999), identifikoi pesë nivele të ndërlidhura të pjesëmarrjes komunitare:

Trajtimi i Wilcox, ka lindur në kontekstin e rigjenerimit të Britanisë dhe reflekton një avancim rreth kuptimit të pjesëmarrjes. Kjo nënkupton se nivelet e pjesëmarrjes janë të pranueshme në kontekste dhe mjedise të ndryshme, dhe ky progres pranon se pushteti nuk është gjithnjë i transferuar në proceset e dukshme pjesëmarrëse, megjithatë këto procese kanë përsëri vlerat e tyre.

Informim
Konsultim
Vendimarrjen e përbashkët
Të vepruarit sëbashku
Mbështetjen e individëve për iniciativat komunitare

Ndërsa Roger Hart, modifikon teorinë e pjesëmarrjes komunitare për grupet rinore⁴ (Hart, 1997). Për Hart, demokracia pjesëmarrëse është bërthama kryesore e bashkëpunimit që krijon zgjidhje efektive e cila shpjegohet përmes tetë hapave si më poshtë:

8. Të Rinjtë & të rriturit marrin pjesë njësoj në vendimarrje
7. Të rinjtë ndërmarrin dhe drejtojnë veprimin/aksionin
6. Të rriturit konsultojnë vendimet me të rinjtë
5. Të rinjtë të konsultuar dhe informuar
4. Informim i të rinjve
3. Tokenizm⁵ për të rinjtë
2. Të rinjtë përdoren për dekorim
1. Të rinjtë janë të manipuluar

Modelet e trajtuara më sipër na japin njohuri të vlefshme në lidhje me pjesëmarrjen komunitare. Prapëseprapë, për nga natyra e prezantimit të tyre, ato përfaqësojnë thjeshtëzimin e një realiteti më kompleks. Studimet të cilat lidhen me pjesëmarrjen e të

⁴ Modeli i shkallës së pjesëmarrjes së Hart, në të vërtetë është një version i përshtatur i “the ladder of citizen participation” krijuar nga Sherry Arnstein, e cila shfaqet në një artikull në “Journal of the American Planning Association”, në vitin 1968

⁵ Tokenizmi ndodh atëherë kur të rinjtë u dëgjohet zëri, por në fakt kanë pak ose aspak zgjedhje për atë se çfarë bëjnë apo si marrin pjesë.

rinjve, kanë nxjerr në pah pengesat për një pjesëmarrje efektive të komunitetit. Këto studime na çojnë drejt identifikimit të nevojës për proceset dhe strukturat të cilat lehtësojnë pjesëmarrjen e grupeve të vogla komunitare duke theksuar se një vëmendje në rritje i duhet dhënë angazhimit të kapaciteteve lokale. Megjithatë, të gjitha shkallët e pjesëmarrjes, të trajtuara në teoritë e mësipërme duhen mbështetur përderisa ato janë të ndërlidhura me njëra tjetrën, dhe një mbështetje e tillë do të ndihmonte njerëzit për ti përdorur këto mundësi.

Një rishikim i literaturës mbi angazhimin komunitar, sugjeron se efektiviteti për një qasje të një angazhimi komunitar, përcaktohet nga popullsia dhe sjellja e shëndetshme (Swainston & Summerbell, 2008). Gjetjet nga studimet e mëparshme sugjerojnë se ndërsa qasje dhe modele të ndryshme egzistojnë, vlerësimi i tyre ka qenë i shpërndarë dhe i pa-dokumentuar.

Konceptet si, *diversitet i partnerëve, metodat deliberative për gjetjen e konsensusit dhe përfaqësimit të barabartë*, janë identifikuar si pika për reflektim kur planifikohet dhe zbatohet një iniciative për angazhimin komunitar. Bazuar në gjetjet e këtij studimi, rekomandohet që:

- a) Një qasje për angazhimin komunitar duhet të ndërthuret me interesat e banorëve dhe sjelljen e shëndetshme të grupit të synuar
- b) Efektet e mundshme kundërshtuese gjatë iniciativës për angazhim komunitar duhet të merren në konsideratë dhe të zbuten
- c) Grupet komunitare të organizuara ose jo duhet të përfshihen prej fillimit në iniciativat për angazhim komunitar

- d) Përfshirja e aktorëve të ndryshëm nuk duhet të jetë në kurriz të ndërtimit të një konsensusi
- e) Angazhimi komunitar dhe qasja e tyre duhet të vlerësohet.

Një nga detyrat kryesore në mobilizmin e grupeve komunitare, ka të bëjë me gjetjen e një organizate apo grupi lokal i cili ka vullnetin dhe mundësitë për të qenë një partner në iniciativën e planifikuar (Lane & Tribe, 2008). Megjithatë, duhet të pranojmë faktin se nuk ka një dakortësi mbi atë sesi mund të arrijmë qëllimin për një pjesëmarrje komunitare. Me përdorimin e disa koncepteve të lidhura ngushtë me komunitetin, është e nevojshme të ngrejmë pyetje rreth praktikave të veçanta që mund të jenë përdorur. Kjo është e rëndësishme, pasi mund të hedhë dritë mbi vlerat të cilat lidhen me pjesëmarrjen komunitare. Mesa duket, nga një analizë dhe eksperiencia e hulumtuar gjatë këtij studimi, praktikat e pjesëmarrjes komunitare janë të lidhura në mënyrë të ngushtë me çështjet rreth pushtetit, përfitimeve, statusit dhe burimeve njerzore.

Duke trajtuar teoritë e pjesëmarrjes pak më sipër, me të drejtë mund të shtrohet pyetja, “Pse demokracia e praktikuar është pjesë vendimtare e forcimit të rolit komunitar? Kur ne përballemi me probleme serioze komunitare, a nuk duhet tju drejtohem profesionistëve për të zgjidhur problemet dhe për të shmangur procesin rrëmujë të cilin e kemi quajtur demokraci? Përgjigjia e kësaj pyetje është me zë të lartë *JO*. Ndërsa profesionistët, teoricienët dhe analistët ofrojnë marrëveshje që çojnë drejt zgjidhjeve, ata e shikojnë zgjidhjen e problemit nga sipër, jo nga pamja prej ku buron problemi.

Pyetje të ndryshme mund të shtrohen për të kuptuar më mirë demokracinë praktikuese që lidhet direkt me pjesëmarrjen e të rinjve në jetën sociale, politike dhe ekonomike.

Cilët hapa të shkallës së pjesëmarrjes praktikohen në realitet dhe a kanë dhënë ndikim në zhvillimin e demokracisë në grupet e vogla në nivel lokal?

Një pikënisje për diskutim, është të ngrejme edhe pyetje të tjera mbi rolin që ka demokracia përfaqësuese në nivel vendor në Shqipëri. Këtu do të arsyetojmë për të gjithë nivelet të cilat dalin nga zgjedhjet që zhvillohen brenda grupeve komunitare, duke nisur me kryetarin e lagjes, fshatit, kryetarët e nëndegëve dhe degëve të partive politike, këshilltarët dhe kryetarët e Komunave/Bashkive e deri tek përfaqësuesit e zgjedhur të Këshillit të Qarkut, aty ku mund ta konsiderojmë të mbyllur kufirin e qeverisjes vendore.

2.5. Debatet kritike mbi pjesëmarrjen rinore

Pavarësisht se pjesëmarrja e të rinjve në pamje të parë nuk paraqet problem dhe promovohet si një mjet demokratik, kritikën për pjesëmarrjen e të rinjve dhe debatet nuk mungojnë. Kritikën drejtohen në veçanti rreth problemeve që lidhen me cilësinë dhe efektivitetin e pjesëmarrjes. Megjithatë pjesëmarrja trajtohet si një ‘gjë e mirë’, efektiviteti i saj në termin e impaktit dhe mundësisë për të përmirësuar kushtet sociale dhe demokracinë pjesëmarrëse ka ngritur pikëpyetje të ndryshme. Pikëpyetje të tjera ngrihen rreth mundësisë për mbështetje institucionale për pjesëmarrjen rinore dhe nëse kjo pjesëmarrje është e vërtetë, apo nëse është vlerësuar sa duhet (Sapin, 2008), (Batsleer, 2008), (Arnstein, 1969). Kritikën përqendrohen shpesh në aktivizimin dhe adresojnë aftësitë dhe njohuritë e domosdoshme që aktivistëve apo drejtuesit e forumeve rinore duhet të zotërojnë, me qëllim për të nxitur dhe arritur pjesëmarrje efektive të të rinjve (Sapin, 2008, Batsleer, 2008, Wade 2008). Bazuar në debatet e studiuesve, efektiviteti i pjesëmarrjes komunitare në praktikë është një dyshim i

vazhdueshëm. Kërkesa për një performancë, rritje të kapaciteteve dhe efikasitetit në pjesëmarrje, nxit më shumë kritikën kur pjesëmarrja trajtohet si një mundësi për fuqizimin komunitar. Ky diskutim është trajtuar nga studiuesit e mësipërm bazuar në dikotominë ndërmjet klasifikimit të pjesëmarrjes komunitare si një mjet që nxit pjesëmarrjen demokratike dhe së dyti si mjet efektiv në rritjen e kapaciteteve për pjesëmarrësit.

Megjithëse pjesëmarrja është një koncept teorik që pranohet si ‘gjë e mirë’, në praktikë ajo përballlet me barriera dhe kufizime të ndryshme. Në analizën e tij mbi ‘Pjesëmarrjen në Organizatat Vullnetare’ Brett (1996) shpjegon arsyet se përse ndonjëherë *pjesëmarrja* nuk funksionon. Ai trajton se si shpërndarja e pabarabartë e njohurive dhe aftësive midis anëtarëve të organizatës pengojnë pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes. Për të arritur pjesëmarrje në nivel lokal, është e nevojshme të ketë mbështetje teknike nga ekspertë me qëllim për të siguruar aftësitë e nevojshme për të zhvilluar pjesëmarrje aktive në aktivitete dhe projekte të planifikuara nga organizatat vullnetare.

Jenkins (1999) zbulon kufizimet në përfshirjen komunitare dhe trajton mungesën e *burimeve njerzore* dhe *faktorin kohë* si faktorët kryesorë që pengojnë pjesëmarrjen efektive. Ai gjithashtu argumenton se identiteti i Shoqërisë Civile nuk është ende i konsoliduar dhe zhvilluar mjaftueshëm, duke shtuar se ajo në vetvete shpesh është e dominuar nga traditat komunitare, çka mund të pengojë në arritjen e konsensusit dhe pjesëmarrjen aktive. Faktori kohë, për Jenkins është konflikti ndërmjet kohës së kërkuar për pjesëmarrje dhe mundësive që aktivistët kanë në realitet për aksione të ndryshme (Jenkins, 1999:438-42).

Studiuesit kritik të punonjësve rinor dhe pjesëmarrjes, duke përfshirë këtu Bernard Davies (2005) Jean Spence (2006), Mark Smith (2002) dhe Tony Taylor (2009) kanë identifikuar krijimin e marrëdhënieve bazuar në pjesëmarrjen vullnetare si një pikë shumë e rëndësishme fillestare për pjesëmarrjen rinore. ‘Vullnetarizmi’ është bërthama e procesit për të gjetur gjuhën e pjesëmarrjes për të nxitur demokracinë, barazinë dhe përfshirjen duke ndikuar drejtëpërdrejtë në edukimin formal apo politik tek të rinjtë (Davies & Merton, 2009).

2.6. Pyetjet specifike kërkimore

Studimi është i bazuar në literaturën e përshkruar më sipër dhe rastet studimore me grupet rinore në nivel lokal. Pavarësisht numrit të vogël të studimeve në këtë fushë në Shqipëri, dhe rasteve të tjera të shumta kërkimore në nivel ndërkombëtar të cilat i përkasin periudhes postmoderniste, studimi im nuk mund të jetë shterrues. Megjithatë, disa prej rasteve studimore reflektojnë marrëdhëniet e forumeve rinore dhe individëve të përfshirë në procesin e pjesëmarrjes për ndryshime sociale.

Mekanizmat për të nxitur pjesëmarrjen e të rinjve në zhvillimin komunitar, me qëllim për të ndryshuar realitetin social dhe për të ndikuar në konsolidimin e demokracisë, nuk është se mungojnë, apo se institucionet dhe individët të cilët kanë rolin për të prodhuar politikat për të rinjtë nuk kanë dijeni për mënyrën se si ti përdorin këto mjete. Pavarësisht përpjekjeve në dukje për përfshirjen e të rinjve, nuk mund të ketë pjesëmarrje reale, nëse të rinjtë nuk marrin role dhe përgjegjësi, për tu shoqëruar me pushtet dhe përfitime direkte. Për këtë qëllim, gjatë këtij studimit do të arrihet që të hidhet dritë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në demokracinë e praktikuar nga grupet rinore në nivel lokal, dhe gatishmërisë së këtij grupi social për tu përfshirë në proceset politike

njësoj edhe në politikat publike të cilat lidhen direkt me zhvillimin komunitar. Kjo nënkupton se çështjet e lidhura e të drejtën e votës; politikat për edukimin me në qendër nxënësin dhe pjesëmarrja reale në zhvillimin e shkollës dhe kurrikulës për arsimin e lartë; pjesëmarrja për krijimin e hapësirave publike në zonat urbane dhe zhvillimin rural; përfshirja në programet ambjentaliste dhe kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik; janë problematikat që mund të krijojnë mundësinë e pjesëmarrjes të të rinjve, prandaj edhe do të jenë objekt i këtij studimi. Politikanët janë të prirur për të përqendruar vëmendjen e tyre për të fituar zgjedhjet e radhës drejt grupmoshës mbi 60 vjeç, por çfarë ndodh me pushtetin real të të rinjve? Cili është çelësi për të kuptuar konceptin e pushtetit të pjesëmarrjes së të rinjve në politikat publike?

Ne shpesh mendojmë se demokracia përqendrohet rreth procesit të votimit. Por demokracia është shumë më tepër sesa kaq. Tomas Xheferson⁶ nxjerr në pah se përtej pushtetit për të votuar, njerzitet duhet të kenë rrugë të tjera për të “shprehur, diskutuar dhe vendosur”. Në një farë mënyre, këto bashkëveprime janë më të rëndësishme sesa procesi i të votuarit. Votimi mund të ndodhë vetëm një herë në vit, çdo dy vite apo çdo katër vjet. Procese të tjera demokratike mund të ndikohen nga veprimet e përditshme të njerëzve dhe të cilat më pas krijojnë kushtet për procesin e votimit.

Suzanne Morse (2004) tërheq vëmendjen se; “Diskutimi (*deliberation*) publik, bërthama e demokracisë tonë, mbetet mundësia për të diskutuar dhe vendosur se cili është interesi i publikut. Objektivat e vendosura kanë për qëllim të përgatisin njerëzit për të vepruar si qytetarë të përgjegjshëm dhe për të skalitur mënyrat se në cilin kuptim pjesëmarrja është e realizueshme dhe e mundur. Diskutimi publik krahasuar me debatin publik, është një

⁶ Tomas Xheferson është një ndër rthemeluesit e Amerikës dhe autori kryesor i Deklaratës së Pavarësisë në 1776 dhe Presidenti i tretë i SHBA-së (1801-1809. Ai ishte përfaqësues i demokracisë dhe përqafoi principet e republikanizmit dhe të drejtat e njeriut me një ndikim të të gjithë botën.

mundësi për tu bashkuar me të tjerët për të mësuar, diskutuar dhe kuptuar perspektivat e shumëfishta të cilat gjallërojnë demokracinë”.

Ndryshimi social, zhvillimi dhe ngritja komunitare kërkon pjesëmarrje komunitare. Roli i shtetit mund të zvogëlohet dhe të bëhet akoma më i padukshëm në të ardhmen, ndërsa energjia vullnetare që komunitetet lokale prodhojnë, mund të jenë vendimtare për shërbimet sociale, shëndetësore, ambientaliste dhe edukimin. Të gjitha këto kanë të bëjnë direkt me angazhimin e të rinjve në çështjet publike, nën vëmendjen e qartë duke shpërndarë përgjegjësi dhe duke iu dhënë role që në moshe të re. Atëherë duhet të rikthehemi tek pohimi që kemi bërë pak më sipër; Nëse dikush mund të ngreje një kompani kompjuterike në një bodrum apo mund të mirëmbaje rrjete të mëdha kompjuterike nga dhoma e gjumit, mundet gjithashtu ti dëgjohet zëri i tij në këshillin vendor, apo mund të ndihmojë në përgatitjen e kurrikulave dhe programeve mësimore, ndërsa dikush tjetër që merret me modën, kulturën dhe artin që në rini, patjetër që ka diçka për të thënë në lidhje me zhvillimin urban.

Analiza përveç asaj teorike përdor më shumë të dhëna empirike të mbledhura në terren për të trajtuar pyetjen kryesore që vijon:

1. Çfarë roli mund të luajë pjesëmarrja aktive e grupeve rinore lokale në konsolidimin e demokracisë?

Pyetje të tjera shtrohen për të kuptuar më mirë demokracinë praktikuese që lidhet direkt me pjesëmarrjen e të rinjve në jetën sociale, politike dhe ekonomike;

- a. Çfarë praktikash do të ndikonin në pjesëmarrjen reale të të rinjve, duke përdorur modelet më të mira, apo duke u mbështetur në modelet vendore për të ndëzuar ndjenjen qytetare?
- b. Cili është çelësi për të kuptuar konceptin e pushtetit të pjesëmarrjes së të rinjve në politikat publike?
- c. A duan të rinjtë të marrin pjesë dhe nëse vërtet ju intereson zhvillimi komunitar dhe demokracia?

Nuk mund të ketë përgjigje të thjeshtë e cila mund ti përgjigjet secilës situatë, por duke analizuar nivelet dhe potencialet e përfshirjes në demokraci të të rinjve dhe grupeve të vogla lokale, do të mund të kuptojmë efektet që mund të sjellë pjesëmarrja dhe vendimarrja komunitare në një kontekst më të gjerë.

Kapitujt në vazhdim na japin mundësinë gjithashtu të qartësojmë rolin që mund të marrin dhe përgjegjësitë që të rinjtë mund të zhvillojnë.

2.7. Hipoteza kryesore dhe hipotezat ndihmëse

Në përgjigje të pyetjeve të mësipërme, shfaqet hipoteza kryesore: *Angazhimi i të rinjve në proceset demokratike të konsideruar si partnerë nga aktorët politikëbërës dhe qeverisës, duke ndarë me ta pushtet dhe përgjegjësi, është hipoteza që vë theksin se të rinjtë kanë potencial për të sjellë ndryshime pozitive, duke kontribuar në vendosjen e paqes dhe zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe demokratike.*

Hipoteza të tjera ndihmëse (të ndërmjetme):

- a) Pjesëmarrja e të rinjve në nivel komunitar është e domosdoshme si kusht për demokratizimin dhe njohje me realitetin, për të lënë kështu mënjane praktikave

importuara nga vendet e zhvilluar gjatë periudhës së tranzicionit, tashmë eksperimente të dështuara.

b) Aktivizimi i të rinjëve si të barabartë në forumet politike dhe përmes grupeve civile rinore lokale në proceset demokratizuese, do të përmirësojë shërbimet ndaj tyre dhe standartet e demokracisë në Shqipëri.

c) Heqja dorë e përdorimit dhe manipulimit të të rinjve gjatë fushatave elektorale për qëllime pushteti nga të rriturit dhe kryesisht politikanët, do të kthente besimin dhe do të rriste dëshirën për anagzhim komunitar dhe pjesëmarrje në zhvillimin e demokracisë.

Me qëllim për të trajtuar këto hipoteza, nevojitet një qasje holistike duke përdorur analizat në nivel lokal për të lëvizur drejt atij kombëtar, për të kuptuar marrëdhëniet ndërmjet të rinjëve dhe pjesëmarrjes, dhe interesit për aktivizimin e tyre. Mendoj se është shumë e nevojshme të aplikohet qasja holistike e përdorur kryesisht nga studiuesit Sherry Arnstein (1969) dhe Roger Hart (1992), e cila trajton nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes komunitare dhe në veçanti të të rinjve. Ndryshe nga periudha komuniste, pjesëmarrja e të rinjve në jetën social-politike gjatë periudhës së tranzicionit ka pësuar ndryshime të rëndësishme, të cilat janë trajtuar shumë pak nga studiuesit. Duke pasur parasysh ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri në kontekstin makro dhe mikro, është e nevojshme për të analizuar ndërveprimet midis të rinjve dhe forumeve/grupeve rinore, komuniteteve lokale dhe institucioneve vendore dhe atyre qendrore, të përfshira në procesin e demokratizimit. Do të merren në konsideratë dy çështje kryesore: *pjesëmarrja e të rinjve* dhe *ndikimi tek procesi i demokratizimit*. Në veçanti, duhet të vështrojmë impaktin që mund japë pjesëmarrja e grupeve rinore në nivel lokal në përmirësimin e standarteve të demokracisë dhe demokratizimit.

2.8. Përshkrim i përgjithshëm dhe motivimi

Konsolidimi i demokracisë dhe pjesëmarrja e të rinjve në jetën politike dhe publike është një çështje e ripërsëritur në diskursin politik për shkencat politike dhe disiplinat e tjera të lidhura me të. Shumica e diskutimeve në këtë studim sugjerojnë se egziston një lidhje direkte midis fuqisë reale të pjesëmarrjes të të rinjve dhe gatishmërisë së tyre për tu përfshirë në proceset politike dhe politikave publike. Kjo ka të bëjë me të gjithë llojet e përfshirjes, sikurse e drejta për të votuar në një moshë më të re se 18 vjeç; politikat me në qendër nxënësit, për të mbërritur tek zhvillimi real i pjesëmarrjes në shkolla; pjesëmarrja në krijimin e hapësirave publike në zonat urbane dhe zhvillimin rural; përfshirja në programet ambjentaliste dhe pranimi i statusit të një konsumatori të madhi të rinjve dhe prej këtij tek kontributi i tyre në ekonomi.

Natyra e ndryshimeve të shpeshta dhe të shpejta e politikave publike në fushën rinore, nga qeveria tek qeverisja, nga veprimi i shtetit drejt shoqërisë civile, përfshirë këtu shoqatat apo grupet e vogla rinore, tregon qartë se roli i shtetit duhet të jetë akoma edhe më pak i dukshëm në të ardhmen, dhe se energjia vullnetare e këtij shteti do të ishte e mundshme për të mobilizuar fusha të ndryshme si ato të shërbimeve sociale, ambjentit, edukimit dhe kujdesit shëndetësor. Të gjitha këto kanë të bëjnë me përpjekjet dhe arritjen për të përfshirë të rinjtë në çështjet publike, me vëmendjen e veçantë për tu dhënë atyre role dhe përgjegjësi në një moshë shumë të re. Prandaj është shumë e nevojshme të merret në konsideratë pjesëmarrja si veprim social, për të ndikuar dhe ndryshuar realitetin social, për të afruar rreth debateve për hartim politikash targetin e synuar dhe përfituesit direkt, duke shmangur kështu importimin e praktikave nga vendet e zhvilluara, të cilat kanë treguar se nuk përshatet me realitetin dhe nevojat në vend.

Të gjithë politikanët e pëlqejnë pjesëmarrjen e të rinjve – por në çfarë mënyrë egzaktesisht mendojnë politikanët se duhen përfshirë të rinjtë, apo nëse politikanët do të dëshironin të përfshinin të rinjtë në një projekt bashkëpunimi që paraqet rrezik në realizim? Nëse kjo lloj pjesëmarrje vazhdon të mungojë dhe mund të jetë e rëndësishme për proceset politike, duhet kuptuar gjithashtu se pjesëmarrja e të rinjve nuk mund të përfitohet falas, por duhet të konsiderohet fakti i një oferte reale për të ndarë pushtet, dhe kjo duhet të ndodhë, përndryshe pjesëmarrja e të rinjve do të vazhdojë të mbetet i një roli periferik.

Pjesëmarrja në jetën sociale, në një shoqëri demokratike është më shumë sesa pjesëmarrja në votime apo në fushatat zgjedhore, megjithëse këto janë elementë të rëndësishëm. Pjesëmarrja dhe qytetaria aktive është të pasurit të drejtë, mjete, hapësirë, mundësi dhe mbështetje për të marrë pjesë, me qëllim për të influencuar në vendimmarrje dhe një angazhim për të kontribuar në konsolidimin demokratik të një shoqërie më të mirë. Kjo lloj pjesëmarrje e munguar në komunitetet lokale në Shqipëri, ka penguar edhe konsolidimin e demokracisë duke ndihmuar në zgjatjen e tranzicionit.

Më saktësisht, fokusi në këtë hulumtim është për pjesëmarrjen e të rinjve duke nisur me grupet e vogla në nivel lokal, qofshin këto grupe të shoqërisë civile apo forume politike, por që lidhen direkt me qytetarët dhe grupet komunitare dhe nevojat e tyre. Për këtë qëllim, është i domosdoshëm një debat dhe ndërgjegjësim mbi pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal, përmes grupeve të vogla, të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin komunitar.

Gjatë periudhës së tranzicionit, Shqipëria më shumë se kushdo vend tjetër në Europë, ka *eksperimentuar* me politikanët e rinj deri në nivelet më të larta qeverisëse. Ky fenomen ndodhi ndoshta për ti dhënë freskinë sistemit të ri politik apo edhe për të importuar

modellet demokratike nga shkollat perendimore ku kishin studiuar të rinjtë. Pavarësisht këtyre përpjekjeve gjatë njëzet viteve të fundit, për të krijuar një pamje të re, Shqipëria nuk mundi të integrohet për një kohë të gjatë në strukturat Europiane, duke u vlerësuar ende si qeverisje në tranzicion dhe regjim hibrid (Freedom House, 2013).

Implikimi i politikës me shoqërinë civile dhe anasjelltas, bazuar në njohje dhe marrëdhënie reciproke, më shumë sesa në ide konkrete, është një nga karakteristikat kryesore të tranzicionit në Shqipëri. Gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, është bërë e modës që ministrat, deputetët apo këshilltarët e tyre të krijojnë OJF-të e tyre, fondacionet apo institutet (Krasniqi, 2009). Ky model, nuk mund të nxisë pjesëmarrjen e grupeve rinore dhe shoqërisë civile, duke lënë vend për dyshime se në këtë mënyrë ata nuk mund të përfaqësojnë interesat e shoqërisë civile, për sa kohë në krye të disa OJF-ve që pretendojnë të nxisin debatin publik, qëndrojnë njerëz të veshur me pushtet politik. Prandaj është e rëndësishme që kjo trajtesë veç të tjerash të sjellë në vëmendje faktin, se shoqëria civile dhe grupet rinore janë më shumë sesa një grup i regjistruar sipas ligjit i OJF-ve. Shpesh ka ndodhur që drejtues të OJF-ve dhe forumeve rinore të prezantohen si përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, por në fakt, në shumicën e rasteve kanë faktuar se nuk kanë qenë asgjë më shumë sesa interesa të lidhura ngushtë me politikën, pa prodhuar ndryshim social dhe zhvillim komunitar. Grupe të tjera joformale, sikurse janë parlamentet rinore, qendrat rinore apo grupet e vogla nga komunitetet lokale të cilat mund të angazhohen direkt në promovimin e demokracisë, duhet të merren në konsideratë si aktor të rëndësishëm drejt zhvillimit komunitar dhe konsolidimit të demokracisë.

Duke vazhduar rrjedhën llogjike të modelit të pjesëmarrjes të grupeve rinore në nivel komunitar, kontributi i dhënë përmes diskutimit të këtyre problemeve të lidhura ngushtë me të sotmen dhe të ardhmen, përmban një motiv të rëndësishëm për perspektivën e pjesëmarrjes rinore dhe zhvillimin komunitar. Teoritë e demokracisë dhe qeverisjes, modelet e pjesëmarrjes dhe shoqërisë civile, adresojnë disa nga konceptet themelore të shkencave sociale, koncepte mbi të cilat pjesëmarrja mund dhe duhet të ndërtohet dhe të diskutohet. Prapëseprapë, fokusi i pjesëmarrjes tek të rinjtë zbulon disa kufizime dhe pengesa të pashmangshme të cilat nuk janë në harmoni me dinamikën e të rinjve dhe shoqërinë ku bëjnë pjesë. Antologjia e përdorur deri më sot, do të mund të nxjerr në pah disa aspekte të përgjithshme të pjesëmarrjes në grupet e vogla, të cilat nuk janë trajtuar më parë në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, hulumtimi që po ndërmarrim do të theksojë disa formulime të ndryshme të modelit të pjesëmarrjes të të rinjve në grupet e vogla lokale në demokracinë e praktikuar.

Për të qenë të sigurtë plotësisht, meqenëse analogjia e demokracisë lokale është e dëgjueshme, përparësia për të kontaktuar grupet e vogla rinore në nivel komunitar gjatë këtij hulumtimi është mjaft e dukshme dhe na jep një mundësi të madhe për të kuptuar më mirë analizën e demokracisë pjesëmarrëse në nivel lokal, e cila do të mundësojë dhe ndihmojë studime të tjera në këtë fushë për të kritikuar apo hapur një diskutim më të gjërë lidhur me pjesëmarrjen. Pavarësisht se ky është një studim që trajton demokracinë pjesëmarrëse në nivel lokal dhe grupet rinore, qëllimi kryesor është për të arritur në përfundime në lidhje me ndikimin që këto grupe të vogla mund të sjellin në nivel përtej atij komunitar. Pengesat e mundshme janë krejtësisht të dukshme, duke u radhitur nga çështjet e analizës komplekse, si pasojë e pyetjeve dhe grupeve të ndryshme në nivel vendor e cila mund të ketë funksionim kompleks dhe të ndryshëm në rajone të veçanta,

dhe sigurisht ndryshimet dhe diferencat për ndikimet që kanë në nivel vendor për tu krahasuar pastaj me atë kombëtar.

Një arsye e fortë për të vazhduar hulumtimin mbi efektet e pjesëmarrjes në zhvillimin komunitar dhe demokracisë pjesëmarrëse, ka të bëjë me identifikimin e nevojave reale të grupeve rinore, dhe praktikatat e dështuara në lidhje me startegjitë e punësimit, edukimit dhe përfshirjes të të rinjve në proceset vendimmarrëse. Të rinjtë në Shqipëri, rezultojnë *të përdorur, të manipuluar dhe me mungesë informacioni*, pa mundur që të jenë faktor dhe pjesë e përfitimeve të pushtetit. Një tjetër argument që lidhet me motivin për të hulumtuar aspektin e pjesëmarrjes, lidhet me kërkime të mëparshme të cilat mbeten të pjesshme dhe të paplotësuara. Shumica e kërkimeve të cilat lidhen me demokracinë pjesëmarrëse në Shqipëri, janë të përqendruara më së shumti në qeverisjen qendrore, zgjedhjet dhe zhvillimet e ndryshme kaotike gjatë periudhës së tranzicionit apo me tranzicionin e gjatë, por që nuk kanë zbritur në nivelin komunitar, aty ku duhet të ndodh llogaridhënia vertikale me tre tiparet e saj kryesore, *informimin, justifikimin dhe ndëshikimin* (2005) dhe që të trajtojnë pjesëmarrjen direkte të grupeve të vogla rinore civile ose jo.

Kapitulli III: TEORITË E DEMOKRACISË PJESËMARRËSE DHE REFERENDUMET LOKALE

Democracia direkte, në teori dhe praktikë, gjithnjë kanë shënuar contrast në demokracinë përfaqësuese, duke ju mundësuar qytetarëve mundësi të mëdha për pjesëmarrje në nivele të ndryshme. Përpjekje për të kritikuar demokracinë liberale-përfaqësuese janë bërë nga studiues të cilët kanë zhvilluar demokracinë pjesëmarrëse (Pateman 1970; Bachrach 1970). Kur debati mbi zgjerimin e demokracisë nisi në fund

të viteve 1960 dhe fillim të viteve 1970, shumë studiues nuk dhanë detaje mbi demokracinë e drejtëpërdrejtë, si një formë e pjesëmarrjes së zgjeruar. Megjithatë, nuk ka dyshim se teoritë e demokracisë pjesëmarrëse, në të cilën gjithashtu zabtohen edhe teoritë për demokracinë e drejtëpërdrejtë, duhet të jenë baza e demokracisë. Megjithatë, ky nuk është qëllimi i këtij tudimi për të përsëritur këto modele të përmendura me arsyetimet e njohura, por në vënd të kësaj, do të merremi me teoritë e përgjithëshme pjesëmarrëse, kryesisht në nivel local dhe të kuptojmë sesi ata ndërthurën me demokracinë e drejtëpërdrejtë. Përplasjet teorike për një kohë të gjatë janë të dukshme, dhe reflektohen në punën e grupeve dhe organizatava rinore në mbarë Evropën, duke qenë të vetdijshëm për mangësitë e kapaciteteve të tyre përfaqësuese, të demokracisë së brendëshme në organizatat të cilat advokojnë për çështje të ndryshme rinore, por në fakt nuk mund të pretendojnë të përfaqësojnë opinionet e të rinjve të cilët nuk janë pjesë ose anëtarë të tyre. Megjithatë, sikurse del edhe në rastet studimore nga rrethet e ndryshme, është e dukshme një dëshirë për të advokuar për të rinjtë në përgjithësi.

3.1. Pjesëmarrja e të rinjve në Europe: Vendet e Lindjes përballë Perendimit

Realitetet sociale dhe politike në Europe pas luftës së II-të Botërore janë të ndryshme dhe sigurisht që kjo situatë ka ndikuar përmes modeleve të qeverisjes dhe sistemeve politike në përfshirjen dhe aktivizimin e të rinjve në jetën sociale dhe politike. Sistemet politike - në veçanti në vendet e Lindjes - pas Luftës së Dytë Botërore duke iu bashkuar Bashkimit Sovietik, reflektojnë ndryshime të mëdha krahasuar me situatën e të rinjve në vendet perendimore, atje ku sistemet politike i përkasin demokracisë. Për shkak të këtyre ndryshimeve të mëdha gjatë periudhës pas luftës së Dytë Botërore deri në rënien e Murit të Berlinit, nuk është e vështirë të dallojmë pjesëmarrjen reale ndaj asaj fiktive.

Sipas disa studiuesve të Europës Lindore, rinia nën regjimin komunist ishte një objektiv i ndërhyrjes së qëllimshme të shtetit dhe u interpretua si agjent kolektiv i transformimit social që mbante përgjegjësinë kryesore për realizimin e idealit komunist – shoqëritë e klasës së bashkuar (Kitanov K. , 1981). Edukimi ideologjik, pjesëmarrja në ekonominë e centralizuar, shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe ofrimi i mirëqenies sociale, kanë qenë pjesë e edukimit sistematik në vendet ish-komuniste (2012, p. 36).

Sipas Livingstone (2011) konteksti kombëtar në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjëve në jetën demokratike, është shumë i ndryshëm në të gjithë Bashkimin Evropian dhe ka tendencë të rritet bashkë me disa çështje të tilla si trainimi dhe arsimi i lartë, tranzicioni nga arsimi në punësim, mundësia për vullnetarizimin, për punë dhe për strehim. Tendencat e pjesëmarrjes rinore janë të ndryshme në vendet e Europës Veriore me ato Jugore, asaj të Përerendimit me të Lindjes, duke u lidhur kjo ngushtësisht me strategjitë dhe politikat e shteteve mbështetëse për pjesëmarrjen rinore, kryesisht për vendet e Evropës Veriore, me theksin në familje dhe shkolla për vendet post-socialiste dhe institucionet fentare për Evropën Jugore (LSE, 2013).

Në situatën e ndryshuar të shoqërisë industriale, studiuesit rinor u përballën me nevojën për të përcaktuar të rinjtë si grup shoqëror. Kjo ishte një sfidë e madhe në kushtet e dominimit të ideologjisë *Marksiste*, për të identifikuar grupet sociale dhe marrëdhëniet e tyre me mjetet e prodhimit (Mitev, 1988:68). Ndryshe nga nocioni klasik i pjesëmarrjes rinore, si një proces pasiv i integrimi në strukturat sociale, koncepti i socializimit ofronte një kuptim për të rinjtë si një grup aktiv dhe të angazhuar duke e përshkruar pjesëmarrjen si një proces të dyanshëm, ndërveprim ndërmjet të rinjve dhe shoqërisë (Kovacheva, 2005). Në këtë kontekst, të rinjtë janë parë si grupi i cili prodhon vlera të

reja përmes pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore, për të ndryshuar dhe socializuar shoqërinë. Ndërsa në kontekstet politike të shoqërive me regjime një-partiake, ky koncept u përzie me ideologjinë zyrtare.

Pavarësisht nëse mund të konsiderohet pozitiv apo negativ, përfaqësimi simbolik i të rinjve ka lënë të kuptohet se të rinjtë nëse çlirohen nga kontrolli i shtetit, do të kishin mundësi të shumta për ti përdorur në shoqërinë e tregut dhe politikës pluraliste (2012). Debati publik ka filluar me supozimin se ekonomia e tregut u jep përparësi të rinjve të cilët do të bëheshin sipërmarrësit e kompanive të reja dhe drejtues legjitim të partive politike. Periudha post-komuniste në Vendet e Lindjes e portretizoj “Elitën e re” me një mision për të ndërtuar “Botën e Re” (botën e tregut të lirë), ndërsa drejtuesit e vjetër komunist hodhën poshtë deklaratat e tyre të mëparshme në lidhje me “aftësitë” e brezit të ri për ripërtëritje të shoqërisë (Kovacheva, 1995:105).

Triumfi i të rinjve demokrat si imazh dominues në debatin e politizuar gjatë viteve të para të transformimit shoqëror, korrespondon me orientimin e ri të politikave rinore, duke theksuar vlerën e lirisë individuale, trajtim të barabartë, përfshirje sociale dhe ndërhyrje minimale të shtetit (2012). Në vendet ish-komuniste, imazhi publik i të rinjve ka ndryshuar në varësi sesi autoritetet e shihnin “nevojën e regjimit politik” (Titarenko, 2009, p. 111). Në rastet kur të rinjtë shihen si burim i nevojshëm për përçarje politike si ai i Revolucionit Portokalli në Ukrainë në vitin 2003, apo zgjedhjet e vitit 2008 në Moldavi, mbizotëron një imazh pozitiv për rininë si një forcë aktive dhe progresive. Ndërsa në vendet ku hasej vështirësi ekonomike apo politike, si në rastin e Ukrainës apo Rusia në periudhën e Yeltsin, është ndërtuar një imazh negativ për të rinjtë duke i stigmatizuar ata si një burim ekstremis dhe problem social (Titarenko, 2009).

Në shoqëritë e zhvilluara, zhvillimi i koncepteve rinore ka lëvizur nga të kuptuarit për të rinjtë si një periudhë “stuhie dhe tensioni” përmes teorisë post-moderne, në kuptimin e rinisë si një agjent aktiv në ndryshimet sociale sikurse përcaktohet në Paktin Rinor Evropian (Leccardi, 2012:54). Pjesëmarrja aktive e të rinjve në nivel lokal dhe rajonal në vendet perendimore është trajtuar si një domosdoshmëri nëse kërkohet të ndërtohet një shoqëri më shumë demokratike, gjithpërfshirëse dhe e begatë. Pjesëmarrja dhe aktivizimi i të rinjve në vendet perendimore ka të bëjë me të drejtën dhe mundësitë, apo në rastet kur është e mundur edhe me mbështetjen për të marrë pjesë dhe për të ndikuar vendimet duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të mirë (CoE, 2008).

Pjesëmarrja në jetën demokratike është konsideruar si një e drejtë themelore në Traktatin e Lisbonës (2009) dhe pjesë e pandarë e qytetarisë europiane, duke u fokusuar më specifikisht në nenin 165, ku Traktati i Lisbonës pohon se një nga qëllimet e unionit duhet orientuar drejt; ‘Nxitjes së zhvillimit të shkëmbimeve rinore dhe inkurajimit të pjesëmarrjes në jetën demokratike në Evropë’.

3.2. Grupet e vogla rinore dhe pjesëmarrja në kontekstin lokal në Shqipëri

Pavarësisht se pjesëmarrja e të rinjve në dukje ngjan me një fenomen ndërkombëtar, ajo është e lidhur ngushtë me kontekstin lokal. Në Shqipëri, pjesëmarrja e të rinjve mund të identifikohet përmes forumeve politike, strukturave të ngritura në mjediset akademike, Universitetet apo shkollat e mesme, dhe pjesa tjetër që lidhet kryesisht me edukimin joformal duke u identifikuar si shoqëri civile. Forumet rinore, me grupet e vogla të ngritura pranë shkollave dhe Universiteteve, janë mbase dhe më të dallueshmet për shkak të numrit të pjesëmarrësve në to, dhe aktivitetet që kryesisht nxiten nga mësuesit të lidhura kryesisht me zgjedhjet në parlamentet rinore, senatet e shkollave apo Unionet

Studentore. Ndërsa janë identifikuar disa Qendra Rinore në rrethe të ndryshme të vendit, të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në aktivizimin dhe rritjen e kapaciteteve të të rinjve.

Praktikat e përfshirjes të të rinjve në bordet e shkollave, këshillave bashkiak/komunal, bordeve të organizatave apo këshillave të lagjeve të qyteteve/fshatrave pothuajse mungojnë në Shqipëri. “Krijimi i hapsirave për pjesëmarrje në institucionet e përmendura më sipër, përmes kuotave dhe rregullimeve që mund të bëhen nga vetë organizatat dhe bordet, do të kishte një impakt direkt tek pjesëmarrja e të rinjve, duke zhvilluar potencialet dhe kapacitetet jo vetëm të rinjve, por edhe të bordeve, të cilat në jo pak raste diskutojnë për politika dhe çështje që lidhen kryesisht me të rinjtë, dhe gjithmonë këtë e bëjnë në mungesë të atyre për të cilët flasin”⁷. Prapëseprapë, përfshirja e të rinjve përmes kuotave në një proces që drejtohet nga të rriturit rrezikon të prodhojë “dekorimin” (Hart, 1997), duke penguar kështu mundësinë e pjesëmarrjes reale apo ndikimit esencial. Një proces i vërtetë, nuk mund të jetë ai që është përcaktuar vetëm nga të rriturit. Më qartë, të rinjtë kanë nevojë për hapësira të shumfishta që të mund të angazhohen. Në këtë mënyrë, përpjekja për pjesëmarrje e të rinjve, mund të përputhet me interesat, pasionet dhe aftësitë e tyre. Rregullat për alternativat e hyrjes në bordet dhe organizatat e ndryshme, mund të krijojnë hapësirë për të rinjtë për të ristrukturuar këto institucione të cilat ndikojnë direkt jetën e tyre.

Në vijim të rrëzikut të “dekorimit”, përfshirja e një numri të vogël si përfaqësues i një grupi më të madh mund të rezultonte në përjashtues, përmes së cilës vetëm të rinjtë të privilegjuar apo me më shumë aftësi mund të zgjidhen për të marrë pjesë. Teoricienët e

⁷ Nga intervista me Alban. N, aktivist i Shoqërisë Civile. Intervistë e zhvilluar në Tiranë në dt. 24 Maj 2012.

pjesëmarrjes publike, ngrijnë me të drejtë pyetje të rëndësishme, me qëllim për të marrë në konsideratë të menduarit për një përfshirje reale dhe të vërtetë të të rinjve (Anderson, 1998). Një ndër pyetjet kryesore, ka të bëjë me atë se kush duhet të marrë pjesë, e cila lidhet me nevojën për ta bërë pjesëmarrjen sa më përfshirëse dhe funksionale. Kjo nënkupton se duhen ngritur struktura, praktika dhe një kulturë që mbështet pjesëmarrjen e të rinjve, të cilët nuk bëhen pjesë e bordeve të përmendura më sipër, për shkak të privilegjeve dhe lidhjeve nepotike, por për shkak të aftësisë për të marrë pjesë në mënyrë efektive.

Sa e mundur është kjo për realitetin në Shqipëri, dhe a ka gjasa të ndodhë pjesëmarrja në bordet që drejtohen nga të rriturit? “Për të krijuar një mekanizëm në Shqipëri, bazuar të eksperiencat e mëparshme, rezulton se është shumë e lehtë, ndërsa funksionimi nuk garantohet, për shkak të përjashtimit të personave të cilët janë realisht të motivuar”⁸.

Përveç bordeve të shkollave, apo disa organizatave joqeveritare, a mund të ketë institucione të tjera vendore, ku të rinjtë mund të bëhen pjesë?

“Meqenëse po flasim për grupet komunitare, dhe nëse përmendim këshillat e qeverisjeve vendore, të cilët të paktën një herë në muaj mbledhen për të diskutuar dhe marrë vendime të cilat direkt ose indirekt lidhen me interesat e të rinjve, biem dakort se është e mundur të krijohet mundësia për pjesëmarrje reale. Në këtë rast nuk po kërkojmë vende të posaçme në këshillat vendor, edhe pse nuk do të kishte asgjë të keqe, por egzistojnë komisionet pranë këtyre këshillave, të cilët në fakt kanë rëndësi më të madhe sesa vetë këshilli, i cili mbledhet dhe miraton

⁸ Nga intervista me Alban. N, aktivist i Shoqërisë Civile. Intervistë e zhvilluar në Tiranë në dt. 24 Maj 2012.

propozimet që vijnë nga komisionet e vogla. Grupe të tjera të vogla, sikurse janë ato të sportit, mund të krijojnë hapësira për pjesëmarrjen e të rinjve”⁹.

Realiteti në Shqipëri, ka provuar se të rinjtë marrin pjesë dhe këtë e bëjnë me pasion për sportin, por në fakt bordet dhe strukturat drejtuese nuk kanë në përbërjen e tyre të rinjtë, të cilët janë direkt të targetuar nga sporti vetë. Vendimmarrja i përket personave të rritur, duke e justifikuar legjitimitetin e tyre, me eksperiencën e viteve të shkuara, pa marrë në konsideratë nevojat dhe kontributin që mund të vijë direkt nga të rinjtë.

3.3. Grupet e vogla¹⁰, pushteti i tyre dhe interesat e përbashkëta

John Gastil, në librin e tij *Democracy in Small Groups* ka dhënë një kontribut të madh në shpjegimin e duhur të termit dhe terminologjisë për demokracinë në grupet e vogla. Të gjithë ne, në jetën e përditshme na jepet rasti të praktikohemi në diskutime në grupet e vogla duke nisur me familjen, kolegët e punës apo miqtë në një tavolinë kafeje, kjo në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, pavarësisht aftësive apo mangësive, gjithnjë praktikojmë dhe përdorim procesin demokratik (Gastil, 1993). John Gastil shkon përtej grupeve të vogla për të vështuar se çfarë ndodh me proceset demokratike në nivelin mikro dhe makro.

Në këtë studim, kur flasim për grupe të vogla do të kemi parasysh se bëhet fjalë për; *të rinjtë në shkollë* si pjesë e parlamenteve rinore, senateve apo unioneve studentore; *klube sporti*; *qendra rinore*, ku të rinjtë mbledhen dhe organizojnë aktivitete edukative,

⁹ Nga intervista me Arta Sinamati, aktiviste e Shoqërisë Civile Kukës. Intervista e zhvilluar në dt. 15 Janar 2012.

¹⁰ Prej këtui dhe në vazhdim përdorimi i termit grup apo grup i vogël të cilin do ta gjejmë vazhdimisht të lidhur me njëri tjetërin gjatë gjithë këtij punimi, i referohet grupit të përbërë ndërmjet shtatë deri në njëzet persona (Sale, 1980). Kjo sipas Kirk Patrick Sale shpjeguar në *Human Scale*, është grupi ideal me madhësinë e duhur për diskutimin në grup ballë për ballë. Megjithatë, ka mjaft vend për diskutim në lidhje me atë se çfarë një grup mund të konsiderohet.

argëtuese apo fushata të ndryshme ndërgjegjësuere; *grupe besimtarësh* të religjioneve të ndryshme, të cilët kanë ditë të veçanta kur takohen për lutjet dhe bisedat e tyre, të cilët kanë të bëjnë jo vetëm me besimin tek i cili ata mbështeten, por edhe me realitetin social që ndodhet jashtë tyre dhe planet për të ndikuar tek të tjerët; me *komisionet e vogla të këshillave vendor*, të cilët kanë një plan pune për tu mbledhur dhe për të marrë vendime mbi shpërndarjen e buxhetit, bursave, ndihmës sociale dhe projekteve të ndryshme që ndikojnë direkt tek komunitetet e tyre; *bordet e forumeve rinore të partive politike* në nivel lokal, të cilët më së shumti janë aktive gjatë fushatave elektorale, duke organizuar fushata ndërgjegjësuere për të ndikuar tek votuesit; *komunitetet e vogla virtuale*, të cilët kanë një kuptim në ditët e sotme, përmes diskutimeve në forume të ndryshme të organizuara online, arrijnë të ndikojnë dukshëm në sjelljen e individëve apo grupeve shoqërore; *grupet e shoqërisë civile dhe gazetarët* si korrespondentë të mediave të ndryshme, të cilët shpesh herë mblidhen për të diskutuar dhe vendosur se cili ishte lajmi i ditës. Të gjitha këto, dhe të tjerë që mund të mos i kemi përmendur, kanë pushtet për të ndikuar tek sjelljet jo vetëm brenda grupit të tyre, por përtej atij, tek një grup më i madh.

Diskutimet në të shumtën e rasteve zhvillohen ndërmjet grupeve të cilët i lidh interesi i përbashkët. Kjo vlen për grupet në familje, me miqtë apo kolegët. Nëse një grup nuk ka pushtet mbi atë për çfarë mblidhet për të diskutuar, takimet nuk mund të jenë demokratike dhe nëse ky grup mund jetë në gjendje të bëjë sugjerime por jo të prodhojë politika, atëherë do të ishte mashtrim të themi se diskutimi është demokratik.

Meqenëse po diskutojmë për rëndësinë e *pushtetit* të grupeve të vogla, është e nevojshme të specifikojmë kuptimin e kësaj fjale në rast se do të tingëllonte e

pakuptueshme. Pushteti, në këtë rast ka të bëjë me mundësinë për të *ndikuar* sjelljen, besimin dhe emocionet në të ardhmen tek individët dhe grupeve e synuara. Është e rëndësishme të theksohet se pushteti ka të bëjë direkt me ndikimin që dikush ka mbi sjelljen e dikujt. “Dikush mund të përdorë pushtetin për të parandaluar apo për të shtyrë kohën që diçka të ndodhë. Pushteti lidhet me individët dhe grupet. Individët kanë pushtet për të përmbushur gjërat për veten e tyre, por nganjëherë edhe pushteti i një individi është i pallogjikshëm nëse nuk kombinohet me pushtetin e të tjerëve” (King, 1987).

Sidoqoftë, nuk do të ishte e mjaftueshme për një grup demokratik të ketë pushtet. “Një popull e shpërndan pushtetin e tij tek anëtarët e grupit të tij. Çdokush në një grup të vogël demokratik, duhet të ketë forma ndikimi ose kontrolli dhe në fund të fundit, të gjithë anëtarët e grupit duhet të kenë pushtet të barabartë në lidhje me politikën e grupit” (Gastil, 1993). Nëse të rinjtë ftohen të marrin pjesë në forume, borde apo komisionet vendore nga më të rriturit, nuk do të kishte vlerë që të jepnin sugjerime, ndërsa pushteti i tyre nuk do të ishte i barabartë me grupin ku marrin pjesë. Prandaj është e rëndësishme të theksojmë përsëri faktin se gjatë gjithë këtij studimi do të argumentojmë ndarjen e pushtetit si një mundësi për të arritur një pjesëmarrje reale të të rinjve në proceset qëndikojnë direkt në jetën e tyre dhe promovojnë ndryshime sociale në komunitetet e vogla.

3.4. Nevoja për pjesëmarrjen e grupeve të vogla në demokraci

Kërkimet teorike për demokracinë dhe pjesëmarrjen janë të përqendruara në kontekstet e niveleve përtej atij lokal. Egziston një tendencë e vazhdueshme e përqendrimit për pjesëmarrjen, duke neglizhuar aspektet e tjera të angazhimit. Për këtë qëllim, ky studim tërheq vëmendjen për pjesëmarrjen e grupeve rinore dhe kryesisht atyre në kontekstin lokal, pra në shkallë më të vogël. Për të kuptuar aspektet e komunikimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në nivelin mikro, duhet patjetër të marrim parasysh nevojat komunitare dhe rëndësinë që kanë grupet e vogla në ndikimin e politikave për zhvillimin e tyre. Pavarësisht diskutimeve të hapura në ambjente të ndryshme mes miqsh e kolegësh në kafene apo tryeza të organizuara, egziston një ndrydhje e mendimit për tu konkretizuar dhe shoqëruar me reagim qytetar. “Angazhimi demokratik në nivel komunitar në Shqipëri, dominohet nga institucionet formale dhe jo formale, ato familjare dhe shoqërore, procese të cilat improtohen nga një ambient i një niveli përtej atij vendor. Pjesëmarrja në proceset demokratike karakterizohet nga pengesat e veçanta, të lidhura ngushtë me motivimin dhe aftësitë e individit për tu përshtatur me proceset egzistuese”¹¹.

Nga analiza dhe gjetjet në terren rezulton se pjesëmarrja në nivelet komunitare, është e ftohtë dhe sporadike, e cila kulmon kryesisht në fushtat elektorale, atëherë kur partitë politike nxisin debatin për të tërhequr vëmendjen e votuesve. Megjithatë, mundësia e komunikimit përmes internetit, ka rritur mundësinë dhe reagimin e grupeve rinore, si një mundësi e thjeshtë dhe e lehtë për tu përfshirë në debatet dhe aktivitetet qytetare, ndryshe nga jeta që zhvillohej para 10-15 vitesh. Dave Briggs, një analist dhe kritik i

¹¹ Nga intervista me Sara Zekaj, aktiviste e Albanin Alliance of Students, AESSH Elbasan. Intervista e zhvilluar në dt. 17 Janar 2012.

njohur i qeverisë Angleze, në një analizë të bërë për këshilltarët vendor, shprehet se “në ditët e sotme kemi nevojë për shumë njerëz që të bëjnë më pak gjëra, më shumë sesa situata aktuale e ditëve të sotme kur vetëm pak njerëz bëjnë shumë më tepër sesa pjesa tjetër”(Briggs, 2013). Kjo situatë, është shumë aktuale sot edhe për Shqipërinë, ku një grup i vogël njerëzish; *marrin vendime, ndërtojnë rrugë, hidrocentrale, prodhojnë vezë dhe mish, posedojnë ferma*, në pak fjalë jemi një vend ku pak njerëz bëjnë shumë gjëra.

Përpjekja për zvogëlimin e pengesave për një pjesëmarrje të gjerë publike është një çështje që ja vlen, për shkak se pjesëmarrja e qytetarëve sjell kontribute të vogla por të vlefshme, pa qenë nevoja të përfshihen në një projekt të madh pjesëmarrës. Sikurse e kemi shpjeguar edhe më sipër, termi *pjesëmarrje* ka kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Ndërsa shpesh përdoret për të gjitha llojet dhe proceset të cilat kanë të bëjnë me angazhimin qytetar, në këtë paragraf po i referohem një ‘pjesëmarrje të ngushtë’ të grupeve të vogla, dhe përfshirjen e tyre në vendime të cilat ndikojnë direkt në jetën e tyre.

Pavarësisht politizimit të shqiptarëve, mundësitë për të diskutuar në kafene apo në ambiente të tjera publike për mënyrën sesi merren vendimet nga këshillat vendor janë shumë të rralla. Ndërsa këto ambiente, përdoren shumë për të komentuar mungesën e shërbimeve, problematikën me të cilën përballën qytetarët në nivel vendor, duke shprehur pakënaqësitë e tyre për drejtuesit e institucioneve vendore, por që nuk shkon më larg sesa bisedat e kafeneve, dhe sidomos kjo mënyrë reagimi përmes bisedave në grupe shumë të vogla intensifikohet gjatë fushatave elektorale. Këshillat Vendor në Shqipëri, qofshin këto Bashkiake dhe ato Komunale, kanë munguar në tablonë e diskutimeve të publikut, duke u shmangur drejtëpërdrejtë nga kritikrat e publikut

pavarësisht se janë ata që në të shumtën e rasteve marrin vendime dhe jo drejtuesit e njesive vendore.

Në respekt të konsultimeve përmes internetit (një mënyrë e mundshme kjo për pjesëmarrjen e publikut), egziston një potencial i jashtëzakonshëm për pjesëmarrjen e grupeve të vogla. Nëse këto lloje aktivitete të lehta dhe të përshtatshme praktikohen, si pjesë e procesit të angazhimit qytetar, ka premisa që pjesëmarrja të bëhet më interesante dhe të arrijë një numër në rritje të publikut (Griggs, 2008). Dhe nëse do të shtronim pyetjen, ‘A është e nevojshme pjesëmarrja e grupeve të vogla?’, sigurisht që do ta pohojmë me të madhe, duke argumentuar se pjesëmarrja në kontekstin e një demokracie *mikro* disa aktivitete do të prodhonin efekte shumë pozitive për zhvillimin komunitar. Shprehja e vlerave personale të cilat udhëheqin drejt procesit të marrjes së vendimeve; shprehja e shqetësimeve kyçe; ngritja e pyetjeve; parashtrimi i ideve; dhe renditja e prioriteteve janë disa nga efektet direkte që prodhon pjesëmarrja e grupeve të vogla, sidomos kur kjo aplikohet edhe përmes forumeve në internet. Kjo padiskutim kërkon kohe dhe energji, dhe një përqendrim të vëmendjes tek nevojat komunitare, por sigurisht që do të ketë ndikim në mikro demokraci, duke përmirësuar shërbimet dhe jetën e publikut.

3.5. Çfarë kuptojmë me pjesëmarrje komunitare?

Komuniteti në të shumtën e rasteve konceptohet si një grup më vete dhe homogjen, por në realitet sitautë është shumë më e komplikuar. Në nivelin e përgjithshëm dhe atë më minimal, komuniteti nënkuptohet si një grup njerzish me gjëra të përbashkëta dhe normalisht brenda një zone gjeografike të veçantë. George Hillery (1995) jep një përkufizim të plotë duke thënë se një komunitet “konsiston në bashkëveprimin social të

personave brenda një zone gjeografike të cilët kanë një ose më shumë lidhje të përbashkëta”. Megjithatë një numër i çështjeve janë lënë jashtë këtij përkufizimi nëse e përshtasim me ditët e sotme kur mjetet e komunikimit janë rritur, komunitetet janë më pak të lidhura gjeografikisht sesa më parë. Në realitet, komunitetet e sotme janë dukshëm të ndryshme dhe më shumë komplekse me përkufizimin që bën Hillery. Ndërsa Burns(1994) vlerëson se “komuniteti nuk është një koncept i veçantë, por në realitet përfaqëson një çadër të thjeshtë nën të cilën kuptohet çdo strehë me grumbuj njerzish të ndryshëm, me gjëra të përbashkëta dhe shpesh me konflikte interesi”. Ndërsa përpiqemi për të kuptuar këtë kompleksitet, mund të themi se shpesh na rezulton ta bashkëlidhim konceptin e komunitetit me lagjet e ndryshme të populluara.

Pjesëmarrja komunitare nuk mund të jetë e njëjtë me procesin e konsultimeve. Pjesa më e madhe e organizatave, të cilat trajtojnë problematikën e pjesëmarrjes komunitare, shpesh raportojnë se kanë strategji të pjesëmarrjes komunitare, kur në fakt ata me këtë nënkuptojnë se kanë një strategji konsultimesh. Pjesëmarrja komunitare, ashtu siç e përmendëm më sipër, nënkupton se komunitetet luajnë një rol aktiv, gjithashtu kanë një pushtet dhe influencë domethënëse. Pjesëmarrja komunitare lidhet me angazhimin e individëve dhe komuniteteve në vendimet për çështjet që ndikojnë direkt jetën e tyre. Ndonjëherë njerëzit nuk dëshirojnë të përfshihen në vendimmarrje, por pavarësisht kësaj, mbetet një detyrim se gjithkush duhet të ketë mundësinë për ta ushtruar atë. Pjesëmarrja komunitare, nuk është e njëjtë me procesin e konsultimeve, për këtë qëllim është e rëndësishme që të bëjmë dallimin midis tyre. Një pjesë e madhe e institucioneve kryesisht atyre vendore, apo edhe organizatave të ndryshme, me qëllim për të mbrojtur vendimet e tyre që lidhen me interesat qytetare, pohojnë dhe mbrojnë idenë se ata kanë një strategji të pjesëmarrjes komunitare, të cilën e praktikojnë, por në fakt, nga

intervistat në terren ka rezultuar se këto institucione kanë strategji për konsultimet dhe herë herë edhe konsultohen. Pjesëmarrja komunitare lidhet direkt me rolin aktiv dhe përgjegjësitë për të pasur pushtet dhe ndikuar në vendimmarrje.

Në gjetjet nga intervistat dhe grupet e fokusit, disa prej drejtuesve që merren me politika lokale, shprehen se janë specialistët e fushave përkatëse ata të cilët hartojnë politikat, dhe detyra e tyre është të konsultohen me qytetarët gjatë përgatitjes dhe në momentin që këto janë gati, duhet tu prezantohen qytetarëve që të informohen. Bashkë me këto pohime, shtrohen edhe pyetje, se përse është kaq e nevojshme pjesëmarrja komunitare, në një kohë kur specialistët janë përgjegjës për ato politika që prodhojnë, gjithmonë në konsultim me komunitetin. Mendoj se është e nevojshme që të shtrojmë disa arsye për nevojën e pjesëmarrjes komunitare. Pikë së pari, pjesëmarrja aktive e banorëve të përhershëm të një zone të caktuar është e domosdoshme për të përmirësuar llogaridhënien dhe shërbimin që institucionet kanë për detyrë. Së dyti, pjesëmarrja komunitare nxit kohezionin social, pasi komunitetet kuptojnë vlerën e bashkëpunimit me pjesën tjetër të komunitetit ku ata banojnë dhe agjensitë të cilat ofrojnë shërbimet ndaj tyre. Së treti, pjesëmarrja komunitare, rrit efektivitetin për sa kohë ata mund të ofrojnë eksperiencën dhe njohjen me problematikën e zonës ku banojnë, me qëllim për një përtëritje të procesit. Përkufizimi i nevojave komunitare, problemet dhe zgjidhja, janë krejt ndryshe nga ata të cilat planifikojnë plane dhe politika zhvillimore, pavarësisht se mund të jenë specialitë në atë fushë.

“Janë komunitetet lokale ata të cilët kanë pronësi mbi komunitetin e tyre, të cilët mund të rrisin besimin dhe të zhvillojnë aftësitë për një zhvillim të qendrueshëm të burimeve që ata kanë. Pjesëmarrja komunitare është

një proces dhe rezultat në të njëjtën kohë. Për të arritur pjesëmarrjen e të rinjëve në nivel komunitar, kërkohen angazhime serioze dhe rritje kapacitetesh, dhe jo më pak e rëndësishme, duhet që të përdoren metoda kreative, me qëllim për të siguruar interesin e të rinjëve”¹².

3.6. Demokracia e praktikuar, referendumet lokale.

Një konkluzion i indeksit për demokracinë, i botuar nga presigjozja britanike “The Economist”, tregon se Shqipëria është një regjim hibrid (Economist, 2012), duke lënë pas vetëm Bosnjën. Kjo analizë tregon qartë se Shqipëria ka ende edhe disa hapa dhe detyra për të përmbushur që të futet tek grupi i vendeve me demokraci gjysëm të konsoliduar, ndërsa përgjegjësitë e saj nuk mbarojnë këtu për të qenë në grupin e demokracive të konsoliduara. Stepan dhe Linz përcaktojnë tre kushtet minimale për tu plotësuar përpara se të ketë ndonjë mundësi për të folur për konsolidimin e demokracisë. Fillimisht, ata flasin për një shtet modern, me zgjedhje të lira, por që nuk janë të mjaftueshme vetëm këto, mundësi për ti kundërshtuar dhe qeverisje demokratike pa nëpërkëmbur kushtetutën dhe duke mos shkelur liritë dhe të drejtat e minoriteteve (Linz and Stepan, 1978)

Kryefjala e ditës për partnerët ndërkombëtarë lidhet direkt me procesin e integritetit të Shqipërisë, ndërkohë që kërkohet konsolidimi i institucioneve, zbatimi i ligjit, respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të individit. Një element që mbetet shumë i rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë është pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje dhe jetën publike. Për sa kohë qytetarët kanë mundësi të shprehin mendimin e

¹² Nga gjetjet e takimit me fokus grupet në Kukës, takim i zhvilluar pranë shoqatës “RSL” me dt. 26 tetor 2012.

tyre, të vendosin për çështjet që u përkasin atyre dhe të zgjedhin përfaqësuesit një herë në katër vjet, pjesëmarrja popullore vazhdon të luajë një rol periferik.

Pjesëmarrja direkte e qytetarëve në vendim-marrje zhvillon demokracinë, sikurse rrit nivelin e agazhimit të drejtëpërdrejtë qytetar në debatet që lidhen direkt me nevojat dhe çështjet publike. Demokracia direkte mund të zhvillohet në forma të ndryshme duke fuqizuar rolin e qytetarëve në vendim-marrjen lokale, ndërsa referendumi lokal mbetet një mjet efektiv në përfshirjen e qytetarëve në çështje publike që lidhen direkt me nevojat e tyre. Fakti i thjeshtë i mbajtjes së një referendumi lokal në vetvete rrit diskutimin publik për çështjen e ngritur nga grupet e veçanta. Referendumet lokale - si një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë direkte në nivel vendor - kanë përparësi në rritjen e frymës kritike të masës.

Kritikët e referendumeve kanë argumentuar se referendumet janë problematike, për faktin se dobësojnë demokracinë përfaqësuese, për mënyrën sesi ata kontrollohen; sa pjesëmarrje popullore egziston për një proces referendumi; dhe kushtet që diktojnë marrjen e vendimeve nga mënyra e demokracisë direkte. Megjithatë, eksperiencia ka treguar se referendumet kanë qenë të suksesshme kur janë përdorur rrallë, qoftë për çështje praktike në nivel lokal, ashtu edhe për rastet kur janë zhvilluar në nivel kombëtar.

Për faktin se demokracia në Shqipëri vazhdon të mos funksionojë si duhet; roli dhe zëri i qytetarëve në debatet që lidhen direkt me çështjet e tyre është i papërfillshëm; përfaqësuesit e zgjedhur të popullit për Këshillat Vendor në zgjedhjet periodike janë

larg përfaqësimit të interesave qytetare¹³; dhe roli i dobët i shoqërisë civile për të nxitur debate dhe pjesëmarrje qytetare është i papërfillshëm, unë argumentoj me forcë nevojën për zhvillimin e referendumeve lokale, si mundësi për të praktikuar demokracinë direkte. Kushtetuta e Shqipërisë, nuk i përmend aspak referendumet lokale, duke u shprehur vetëm për ato kombëtare, përderisa organizimi i një referendumi kërkon pesëdhjetë mijë (1998) firma për mbajtjen e tyre, ose me propozimin e jo më pak se një të pestës së deputetëve apo me propozimin e Këshillit të Ministrave. Me ligjin egzistues, janë të përjashtuar në mënyrë të padiskutueshme referendumet lokale, për sa kohë çdo lloj iniciative nga grupe të ndryshme në nivel lokal e ka të pamundur teknikisht të mbledhë firmat e pesëdhjetëmijë votuesve, ndërkohë që shumica e njësive vendore (Bashki dhe Komuna) në Shqipëri, kanë disa herë më të vogël numrin e banorëve të tyre sesa numri i kërkuar për një referendum. Aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë përfshirë OSBE/ODIHR kanë kritikuar ligjin për referendumet, duke propozuar rekomandime të rëndësishme për ndryshimin e tij, megjithatë, deri tani nuk janë reflektuar këto ndryshime, duke penguar disa iniciativa për zhvillim referendumi në Shqipëri.

Fuqizimi i qytetarëve në nivel lokal mund të përmes pjesëmarrjes së tyre në demokracinë direkte, duke u dhënë mundësinë përmes ligjit, zhvillimit të referendumeve në nivel vendor. Iniciativat vendore, të lidhura ngushtë me interesin e qytetarëve, duhet të kenë mundësi për vendim-marrjen direkte përmes referendumeve lokale, si një mjet efikas dhe i rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë në Shqipëri. Pavarësisht mungesës së eksperiencës në përdorimin e këtij mjeti demokratik, në do të pohojmë nevojën për pjesëmarrje direkte përmes referendumit lokal, si një mjet efektiv për të zgjidhur çështjet e komunitetit vendor, si e drejtë për tu shprehur lirisht duke

¹³Ky është perceptimi dhe pohimi i qytetarëve të përfshirë në këtë studim përmes anketave dhe grupeve të fokusit, kryesisht të rinjë të rretheve të ndryshme të Shqipërisë.

përdorur rregullin e shumicës brenda kontekstit Shqiptar. Prapëseprapë, ne pranojmë se referendumet nuk është se i zgjidhin të gjitha problemet egzistuese të demokracisë së drejtëpërdrejtë.

3.7. Praktikë Ndërkombëtare për Referendumet

Iniciativat qytetare i kanë rrënjët në politikën e SHBA-së, ku referendumet janë pjesë e legjislaturës në 24 shtete (Tolbert and Smith, 2006). Kjo i referohet modelit të demokracisë së drejtëpërdrejtë e cila përmes iniciativës së një peticioni mundëson mbajtjen e një referendumi. Ky mekanizëm ka të bëjë gjithashtu me shtetin rekord për mbajtjen e referendumeve, sistemit politik të Zvicrës, e cila zhvillon më shumë se asnjë vend tjetër në botë (Treschel, Alexandre, and Sciarini, Pascal, 1998) Prej vitit 1848 - koha e kushtetutës së Zvicrës – deri në ditët e sotme, janë mbajtur më shumë se 550 referendume në nivel kombëtar, ndërsa në nivel lokal apo kantonesh, Zvicra mban afërsisht 10 referendume në vit. Jo vetëm Zvicra, por edhe shumë vende me një histori të gjatë demokratike si Franca, Mbretëria e Bashkuar, SHBA, Gjermania, Australia etj., kanë mbajtur, sipas problematikës, mjaft referendume në nivel kombëtar apo vendor. Këtë shembull e kanë ndjekur edhe shumë demokraci të reja të Evropës Lindore apo Vendet Baltike. Por referendumet janë të hershme dhe në Amerikën Latine. Kështu, p.sh., në historinë e Kilit referendumi ndeshet që në vitin 1925(Meidani, 2010).Referendume kombëtare kujtojmë atë të Spanjës për anëtarësim në NATO, dhe tani kjo praktikë po përdoret për disa vende të Evropës për anëtarësimin e tyre në BE, gjithashtu mund të kujtojmë edhe referendumin për projekt-kushtetutën Evropiane, që i kapërcen kufijtë kombëtarë, si ai në Francë dhe Hollandë në vitin 2005, duke e hedhur poshtë miratimin e saj.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, referendumi është konsideruar si mekanizmi më i rëndësishëm i demokracisë direkte në dispozicion, për shkak të mundësisë së tij për të zhvendosur programin e debatit politik. Referendumet zhvillohen edhe në gjashtë vendet e ish-bllokut komunist (Lupia and Matsusaka, 2004). Referendumet të cilat thirren nga këshillat vendor egzistojnë edhe në këto shtete gjithashtu: Belgjikë, Çeki, Estoni, Angli, Finlandë, Irlandë, Luxembourg, Hollandë dhe Maqedoni. Në Hungari, një referendum lokal mund të thirret nga një e katërta e këshillit vendor apo nga një komision i tij¹⁴, duke siguruar një mënyrë mjaft efektive për insitucionet qeverisëse lokale për të organizuar një referendum. Në Kroaci, një grup qeverisës i një njësie vetë-qeverisjeje mund të thërrasë një referendum lokal¹⁵. Në Bullgari, referendumi lokal mund të thirret nga një e katërta e këshilltarëve vendor ose Kryetari i Bashkisë/Komunës, por këshilli vendor vendos i fundit mbi kërkesën.

3.7.1. Pse Kemi Nevojë për Referendum Lokal?

Për shkak se Shqipëria vazhdon të konsiderohet si “rasti më i vështirë” i demokratizimit apo një rast i veçuar nga vendet e tjera post-komuniste, të cilat kanë përjetuar ndryshimet e regjimit, dhe nivelit të ulët të angazhimit qytetar në çështjet publike, është e domosdoshme të përdoren me efektivitet mjetet që ndihmojnë në funksionimin më të mirë të demokracisë dhe pjesëmarrjes qytetare. Qytetarët kanë një nivel të lartë apatie në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet qytetare¹⁶ (BTI, 2012)012). Ndryshimet sociale që kanë ndodhur gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, kanë ndikuar shumë në humbjen e lidhjeve midis zgjedhësve, të zgjedhurve dhe institucioneve, duke mos

¹⁴Local Referendums.Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), No. 52.Local Referendums.

¹⁵ Article 4, Croatian Law on Referendum and Other Forms of Individual Participation (1996)

¹⁶The BTI is a global assessment of transition processes in which the state of democracy and market economy as well as the quality of political management in 128 transformation and developing countries are evaluated.

lujatur rolin e përfaqësimit të grupeve sociale dhe programeve të tyre politike për të cilat garojnë në zgjedhje të përgjithshme dhe vendore. Ky është edhe shqetësimi kryesor në librin e Ingrid Van Biezen, *Partitë Politike në Demokracitë e Reja*, kur pohon se partitë në demokracitë bashkëkohore kanë ndaluar së përformuari funksionin e tyre përfaqësues dhe qeverisës (Biezen, 2013). Mungesa e përgjegjësisë së këtyre institucioneve, reflekton dhe ushqen mos-angazhimin qytetar në çështjet publike. Prandaj, nëse nuk merren masa për të adresuar këtë problem do të përballemi me një apati qytetare dhe mos-pjesëmarrje akoma e në rritje.

Nevoja për përfshirjen e publikut në procesin e vendim-marrjes është urgjente. Statistikat e zgjedhjeve tregojnë se ka zhvillime të ndryshme për fushata elektorale të ndryshme, duke treguar se niveli i pjesëmarrjes për zgjedhjet vendore është gjithnjë më i madh sesa për zgjedhjet e përgjithshme¹⁷(KQZ, 2011). Ky është një nga treguesit më domethënës, se qytetarët janë më shumë të interesuar për çështjet komunitare sesa për çështjet politike të nivelit përtej atij lokal. Një tjetër arsye për të argumentuar domosdoshmërinë e referendumeve lokale në Shqipëri është demokracia e pakonsoliduar. Përdorimi i këtij mjeti nga qytetarët, patjetër që do të ndikojë në konsolidimin e demokracisë, duke i dhënë mundësinë qytetarëve për më shumë pushtet të drejtëpërdrejtë. Kjo do të rriste lidhjet midis të zgjedhurve dhe qytetarëve, do të zhvillonte më shumë dëgjuesën publike dhe krijonte mundësi për të zhvilluar debatin publik në një masë më të gjerë. Problemet zgjedhore shfaqen edhe në aspektin e ngushtimit gjithnjë e më të madh të ushtrimit të zgjedhjes direkte. Në vitin 1991, të

¹⁷ Në zgjedhjet vendore të vitit 2011, pjesëmarrja e përgjithëshme raportuar nga Komisioni Qendror i zgjedhjeve ka qenë 50.9%, zgjedhjet vendore të vitit 2007 pjesë marrja është raportuar 52% ndërsa pjesëmarrja në zgjedhjet e përgjithëshme të vitit 2009 ka qenë 42.94%, ndërsa në vitin 2005 ishte 50 %.

gjithë deputetët zgjidheshin nominalisht dhe direkt, ndërsa në vitin 2010 asnjë institucion qendror (parlament, qeveri, president) nuk votohet direkt nga qytetarët.

Problemi i ushtrimit direkt të vullnetit të popullit mbetet një sfidë thelbësore për të ardhmen, për shkak të mungesës së përvojës dhe shanseve për ushtrim në forma të tjera të demokracisë direkte. “Një rrugëzgjidhje optimale do të duhej të ishte krijimi i mekanizmit të votimeve periodike në formën e demokracisë direkte (referendume lokale e kombëtare) për çështje të ndryshme me interes madhor, si një mekanizëm i përfaqësimit më të madh, rritjes së besimit tek institucionet politike dhe i edukimit qytetar me kulturën e zgjedhjes”(Krasniqi, 2009)Në këtë kuptim një qeverisje përfaqësuese dhe procedurat e demokracisë së drejtpërdrejtë plotësojnë njëra-tjetrën, duke përfshirë mjaft probleme konkrete në agjendën politike. Dhe po ashtu, demokracia e drejtpërdrejtë e rrit angazhimin e qytetarëve në çështje të legjislacionit, politikës, ekonomisë, mjedisit etj., duke shkundur apatinë e tyre (Meidani, 2010). Pra, demokracia e drejtpërdrejtë është jo vetëm pjesë përbërëse e edukimit politik dhe e vendim-marrjes qytetare, por edhe “ushqim” inkurajues i autonomisë sociale dhe individuale.

Shqipëria, në të gjitha raportet ndërkombëtare të institucioneve më të rëndësishme, të cilat mbështesin integrimin e vendit, përmendet për nivelin e lartë të korrupsionit të zyrtarëve të lartë, por jo vetëm. Ky tregues përbën edhe një arsye më shumë se përse duhet të ketë mundësi të ushtrimit të demokracisë së drejtëpërdrejtë. Qytetarët do të kenë në dorë një mjet më shumë për të reaguar ndaj vendimeve abuzive të shpeshta që ndodhin në Shqipëri në konflikte të pastra interesi, duke nëpërkëmbur interesin qytetar. Ithtarët e demokracisë përfaqësuese, nuk duhet të shqetësohen për demokracinë e drejtëpërdrejtë, përderisa referendumi do të mbetet një formë plotësuese dhe jo mbizotëruese, pra, sikurse e përmendëm në përkufizimin e termit referendum, kjo mund

të ndodhë vetëm për çështje shumë të veçanta, por gjithashtu, mos të harrojmë se demokracia përfaqësuese në Shqipëri nuk është se ka funksionuar në këto njëzet vite tranzicion. Gjetjet e një studimi mbi qeverisjen vendore dhe nivelin e përfaqësimit të zhvilluar në Qarkun e Kukësit nga një organizatë joqeveritare, tregojnë se tetë nga dhjetë persona nuk besojnë se këshilltarët vendor përfaqësojnë interesat e tyre dhe të komunitetit¹⁸. Ka plot çështje të cilat lidhen me legjitimitetin e institucioneve politike, dhe impaktin e vogël të tyre në jetën komunitare, të cilat rrjedhin nga mungesa e angazhimit të qytetarëve.

Impakti i referendumeve lokale në funksionimin e qeverisjes vendore është një tjetër çështje e rëndësishme e këtij debati. Një nga parimet kryesore të qeverisjes vendore ka të bëjë me zgjedhjet direkte të komunitetit ku ata shërbejnë. Përfaqësuesit e zgjedhur të qeverisjes vendore – këshilltarët – duhet të luajë rolin e zërit qytetar në qeverisjen vendore, duke mbrojtur interesat e komunitetit, në politikat vendore dhe menaxhimin e tyre. Ata në mënyrë vendimtare duhet të jenë llogaridhënës tek ata që përfaqësojnë për vendimet dhe veprimet që ndërmarrin. Nëse duhet të jetë kështu, dhe nëse ndodh kjo, ka pak gjasa të na hyjë në punë mjeti i demokracisë së drejtëpërdrejtë, *referendumi*. Për këshilltarët dhe zyrtarët vendor, sigurisht se përgjigjia nëse do të na duhej një referendum vendor do të ishte negative. Një mekanizëm për ta penguar demokracinë e drejtëpërdrejtë do të ishte lënia dorë këshilltarëve vendor për të vendosur për lejimin ose jo të zhvillimit të referendumit.

¹⁸ Studimi mbi situatën Social Ekonomike të Grave në Qarkun e Kukësit, 2010.

3.7.2. Informacioni dhe vështirësitë e përcjelljes tek publiku

Marrja e vendimeve të rëndësishme kërkon informim të aktorëve të përfshirë në proces. Mbështetësit e demokracisë përfaqësuese dhe kundërshtarët e referendumeve do të theksonin me forcë si argument kryesor aspektin e informimit dhe atë populist të demokracisë së drejtëpërdrejtë. Sipas kritikëve të referendumit, qytetarët të cilët marrin pjesë në votim, nuk janë të mirëinformuar sa duhet për të marrë vendime të rëndësishme, prandaj edhe mund të manipulohen nga personalitete me ndikim në shoqëri dhe nga propaganda përmes medias. Në mbështetje të këtyre argumenteve, mund të gjejmë plot pretendime se përmes demokracisë së drejtëpërdrejtë mund të shfaqen ‘tiranitë e shumicës’, duke sjellë në vëmendje periudha shumë të errta historike, si ajo e Hitlerit dhe Musolinit, të cilët përdorën demokracinë e drejtëpërdrejtë për të fuqizuar rolin e tyre shtypës. Një rast i ngjashëm i mëvonshëm është dhe ai referndumi i vitit 1978 në Kili, kur klika ushtarake në qeverisje pyeti popullin nëse e mbështeste këtë qeverisje dhe rezultati doli 95% në favor të saj. Ndërsa po në këtë vend në 1988, përmes referendumit iu dha fund regjimit të Pinochetit, për të kaluar në një qeverisje demokratike. Megjithatë, mos të harrojmë se kjo trajtesë merr në shqyrtim dhe mbron idenë e referendumeve lokale, si një mjet i rëndësishëm për angazhimin e qytetarëve dhe konsolidimin e demokracisë në vend.

Këshilltarët vendor dhe Kryetarët e qeverisjes vendore janë zgjedhur për aftësitë e tyre për të marrë vendime të rëndësishme dhe për të informuar qytetarët. Është roli i tyre për të përfaqësuar interesat e tyre dhe për të marrë vendime të pjekura, duke informuar qytetarët sa herë iu prekën interesat. Megjithatë, edhe ky mekanizëm informimi është po aq i mangët sa edhe përfaqësimi i tyre përballë interesave qytetare. Këshilltarët dhe të zgjedhurit e tjerë vendor, mund të përdorin mjetet e ndryshme për të mbrojtur qytetarët

ndaj keqinformimit, ose për të manipuluar mbi vendim-marrjen, pra kjo është e dyanshme, ndërsa zgjedhja i lihet në dorë qytetarit.

Pavarësisht mbështetjes për demokracinë e drejtëpërdrejtë, duhet të pranojmë faktin se një mungesë e theksuar e pashmangshme ka të bëjë me informimin e publikut në rastet kur kërkohet të hidhet për referendum një çështje e caktuar. Megjithatë, palët e interesuara të cilat mendojnë ndryshe, në kushtet e demokracisë dhe fjalës së lirë, kanë të gjitha mjetet për ta kundërshtuar dhe për të informuar qytetarët që të marrin vendimin e duhur. Unë do të argumentoja, përderisa referendumet lidhen vetëm me një çështje të veçantë, është kohë e mjaftueshme për të zgjedhur atë që përputhet me interesat e qytetarëve. Qytetarët janë po aq të barabartë sa edhe kur zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Ata asnjëherë nuk kanë 100% informacionin e duhur për kandidatët që u serviren atyre, megjithatë prapë ata votojnë për ti zgjedhur në mënyrën që ata mendojnë. Do të ishte naive dhe jorealiste, të presim që të gjithë votuesit të jenë të informuar po aq sa janë të zgjedhurit. Këtë argument mund ta përdorin kritikët e referendumit, për të theksuar mungesën e informimit dhe arsyet për të kundërshtuar atë. Por deri në çfarë mase shtrihet ky problem? Hulumtuesit pohojnë se votuesit janë më të aftë sesa vendimarrësit në proceset e votimeve. Shumica e votuesve të painformuar, mund të përcaktojnë vendimet e tyre në bazë të informacioneve të marrë në rrugë të ndryshme. Në këto raste vlejnë debatet e ndryshme publike në media, që zhvillohen midis aktorëve të përfshirë në kundërshtitë për zhvillimin e referendumit, prandaj kjo është një mënyrë e mirë për të marrë informacion dhe vendimin për të votuar pro dhe kundër.

3.7.3. Historiku dhe Praktikën me Referendumet në Shqipëri

Fillimisht, duhet të shpjegojmë termat *referendum* dhe *referendum lokal*, me qëllim për të shmangur keqkuptimet dhe për të mundësuar një kuptim më të mirë të këtij mjeti demokratik në duart e qytetarëve. Referendumi ka të bëjë me demokracinë e drejtëpërdrejtë, një mjet demokratik që i jep rolin qytetarëve për të kontrolluar pushtetin. Kjo nënkupton një votim për të pranuar apo për të hedhur poshtë një propozim apo disa propozime për një çështjetë dhënë (Meidani, 2010). Nëse i referohemi fjalorit të gjuhës shqipe, fjala *referendum* ka të bëjë me ‘formë e shprehjes së mendimit të popullit me votim të përgjithshëm për një çështje shtetërore a shoqërore me rëndësi të veçantë (2006). Referendumet mund të organizohen për çështje të ndryshme, si ajo në rastin për adoptimin e një kushtetute të re (në 1994 dhe 1998 në Shqipëri), apo për raste të tjera të lidhura me miratimin e amendamenteve kushtetutese, (si ato në Francë për reduktimin e mandatit të presidentit nga 7 vjet në 5 vjet), aprovimin e traktateve (në rastet për vendet që i bashkohen BE-së) apo në rastet kur shkëputen nga një shtet (si rasti i Malit të Zi nga Serbia në 2006, dhe rastet e përsëritura të Kebekut në Kanada për shkëputje). Referendumi pra, është një formë e ushtrimit të demokracisë së drejtëpërdrejtë, duke mishëruar realizimin e vlerave demokratike universale. Ai mund të iniciohet nga autoritetet politike, si legjislativi, presidenti apo qeveria, gjithashtu edhe nga vetë qytetarët.

Deri tani kemi sjellë përkufizime dhe shembuj për referendumet popullore në nivel kombëtar, ndërsa kjo trajtesë nuk ka të bëjë direkt me to, por çështja kryesore këtu shtrohet për referendumet lokale. Referendumi lokal është një formë direkte e demokracisë, duke i dhënë banorëve një mekanizëm për të bërë të njohur pikpamjet e tyre mbi çështjet lokale (Government of UK, 2011). Referendumi lokal ka të bëjë me

çështjet komunitare, për një territor të caktuar brenda një njësie të qeverisjes vendore, që mund të jetë në nivel Qarku, Bashkie ose Komune. Referendumet lokale, lidhen me nevojat e një komuniteti të veçantë, të cilët mund të kenë kundërshtime në lidhje me politikat e qeverisjes qendrore apo lokale në dëm të interesit të tyre. Një rast për të organizuar një referendum lokal do të ishte, përcaktimi i sheshit Skenderbej në Tiranë pas zgjedhjeve vendore të vitit 2011. Megjithatë, në këtë rast, prapë kemi të bëjmë me një çështje që lidhet direkt me kryeqytetin e vendit dhe masa që prekët nga ky vendim lidhet me një numër popullsie që i kapërcen kufijtë e njësisë vendore të Tiranës. Një tjetër rast mund të ishte mbajtja e një referendumi për ndërtimin e parkut industrial të Vlorës. Kjo është një çështje tipike lokale, e cila ka të bëjë me industrinë e turizmit të qytetarëve të vlorës.

Në të shkuarën historike, që prej krijimit të shtetit Shqiptar në 1912 e deri në ditët e sotme, Shqipëria ka mbajtur shumë rrallë referendume të mëdha. Pas një hulumtimi të dokumenteve themeltare të shtetit Shqiptar, duke filluar prej Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare të vitit 1928, më pas me Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946, dhe për të vazhduar me Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1976, nuk gjenden praktika të sanksionuara me ligj. Mbajtja e referendumeve në Shqipëri ka ndodhur tri herë, dhe për këtë ka menduar vetëm politika, pra, nuk kanë qenë nisma të qytetarëve. Referendumi i parë është mbajtur në 1994, për miratimin e Kushtetutës, referendumi i dytë u mbajt bashkë me zgjedhjet e vitit 1997 dhe kishte të bënte me zgjedhjen e formës së regjimit midis Republikës dhe Monarkisë, ndërsa referendumi i fundit është mbajtur në 1998 përsëri për miratimin e Kushtetutës së Shqipërisë. Pavarësisht tentativave të fundit për referendum për çështjen e importit të plehrave nga Aleanca Kundër Importit të

Plehrave, dhe së fundmi nisma e ‘Aleancës Kuq e Zi’ për Bashkim Kombëtar, nuk është bërë e mundur organizimi dhe mbajtja e tyre.

3.7.4. Kush përfiton nga referendumet lokale, shumica apo pakica?

Ndoshta kriticizmi më i madh për referendumet lidhet me atë për çfarë Tokëvilli shprehet në librin e tij *Demokracia në Amerikë* duke shfaqur termin ‘tirani e shumicës’ (Tocqueville, 2002). Me pak fjalë, demokracia direkte kërkon shumicën e votuesve për të mbështetur një çështje të veçantë dhe për pasojë minoritetet në këtë rast janë në disavantazh (Tolber and Smith, 2006). Megjithatë ky argument nuk vlen shumë për rastin e referendumeve lokale në rastin e Shqipërisë, meqenëse egziston një popullsi homogjene në dominancë dhe përfitimi nga referendumet lokale shkon për demokracinë dhe të gjithë aktorët vendor. Pakicë në këtë rast mund të konsiderojmë zyrtarët vendor në funksion qeverisjeje, ndërsa tek shumica futen qytetarët pa dallim.

Rishikimi i literaturës akademike – veçanërisht për shtetet si SHBA-ja, Zelandë e Re dhe Zvicër, të cilat kanë një histori në organizimin e referendumeve – kanë identifikuar dy aspekte kryesore përfituese: ka të dhëna se referendumet prodhojnë një efekt të lartë edukativ në termin e rritjes së mundësisë së qytetarëve për të votuar në SHBA (Tolbert, 2003), prezenca e referendumeve rrit pjesëmarrjen rreth 5%, ndonëse në Europë kjo praktikë nuk është provuar ende, megjithatë kjo ndikon shumë në rritjen e angazhimit qytetar (Qvortrup, 2007). Efekti i dytë ka të bëjë me përfaqësimin: ka të dhëna nga SHBA-ja, të cilat sugjerojnë se shtetet të cilat praktikojnë modelin e referendumeve lokale, kanë politika më të përshtatshme me opinionin publik sesa ato shtete të cilat nuk e kanë këtë mekanizëm. Përveç kësaj, vëzhgimet në Europë dhe në SHBA zbulojnë nivele të larta të mbështetjes publike për referendumet si një mekanizëm i demokracisë direkte (Lupia and Matsusaka, 2004).

Një tjetër argument për përfitimet nga referendumet tregojnë se ato sigurojnë një drejtim efektiv për politikën kur ndërmerren përmes referendumeve. Sipas Tolbert dhe Smith shtetet të cilat kanë modelin e referendumeve kanë reduktuar pjesërisht shpenzimet e përgjithëshme për shkak të reduktimit të taksave dhe rritjes së kërkesës së përdoruesve. Organizimi i referendumeve redukton shpenzimet e përgjithëshme; shtetet me modelet e demokracisë së drejtëpërdrejtë shpenzojnë 4% më pak sesa ato që nuk e ushtrojnë këtë organizim; shtetet që organizojnë referendumet janë më të përgjegjshme ndaj opinionit publik; iniciativat qytetare kanë tendencë për të prodhuar politika të përgjegjshme financiare; studimet për cilësinë e vendimeve politike – edhe pse kanë pasur problem në metodologjinë e tyre – kanë qenë të prirur për të treguar një rritje më të shpejtë ekonomike dhe efikente për ato shtete që organizojnë referendum. Ky varg argumentash, na jep mundësinë të pranojmë faktin se shumica, e cila përbëhet nga shtresat e mesme dhe të ulëta të popullsisë, të cilat nuk mund të kenë përfaqësimin e duhur në këshillat vendor dhe zëri i tyre dëgjohet rrallë ose shumë rrallë, është përfituesi kryesor, dhe për pasojë, është vetë sistemi që do të përfitojë më shumë, pra demokracia direkte do të prodhojë qeverisje më të përgjegjshme për qytetarët e saj.

Kapitulli IV. PJESËMARRJA E GRUPEVE RINORE LOKALE GJATË PERIUDHËS SË TRANZICIONIT

4.1. Të rinjtë dhe e ardhmja e demokracisë në Shqipëri

Demokracia është një formë e qeverisjes në të cilën qytetarët marrin pjesë të barabartë, në mënyrë direkte ose indirekte përmes të zgjedhurve. Ndonëse egzistojnë variante të ndryshme të demokracisë, ne do të përqendrohemi në dy format bazë që lidhen me; *demokracinë direkte*, në të cilën të gjithë qytetarët kanë të drejtë pjesëmarrje direkte dhe

aktive në vendimarrje dhe; *demokracia përfaqësuese* e cila siguron pjesëmarrjen e qytetarëve përmes delegimit të interesave tek të zgjedhurit e tyre në nivele të ndryshme, vendore dhe kombëtare. Me qëllim për të qënë të fokusuar rreth studimit tonë, që lidhet me sfidat dhe mundësitë e grupeve rinore lokale për të marrë pjesë në proceset demokratike, propozoj që të përdorim një përkufizim të demokracisë i cili nuk merr përsipër ndonjë format të veçantë të ndonjë institucioni. “Demokracia moderne politike është një regjim apo sistem qeverisës, në të cilin sundimtarët japin llogari për veprimet e tyre në fushën publike para qytetarëve, duke vepruar në mënyrë indirekte përmes konkurrencës dhe bashkëpunimit të përfaqësuesve të tyre”(CoE, 2004).

“Në ditët e sotme, disa nga tiparet kryesore për të cilat sulmohet demokracia dhe politika në Shqipëri, ka të bëjë me pakënaqësinë e qytetarëve me politikën dhe politikanët, të cilët më shumë sesa zgjidhin probleme, prodhojnë konflikte dhe politika të pazbatueshme; dhe së dyti me mungesën e besimit ndaj sistemit të demokracisë që aplikohet në Shqipëri, i cili gjatë gjithë periudhës pas sistemit komunist ka prodhuar korrupsion, përjashtim dhe padrejtësi sociale”¹⁹. Ky perceptim përshtatet edhe me gjetetjet e tjera të mbledhura gjatë këtij studimi përmes intervistave dhe pyetsorëve, gjithashtu edhe me raporte dhe studime të organizatave dhe institucioneve kombëtare dhe kombëtare. Ato janë rezultat i një perceptimi kritik dhe kundërshtar i qytetarëve ndaj politikanëve, partive politike, zgjedhjeve të kontestueshme gjatë gjithë tranzicionit, debateve shterpë të parlamentarëve dhe qeverisjeve në përgjithësi, e cila përbën familjen politike.

¹⁹ Nga gjetjet e takimit me fokus grupet në Kukës, takim i zhvilluar pranë shoqatës “RSL” me dt. 26 tetor 2012.

Pakënaqësia ndaj politikës e shprehur përmes opinioneve, qendrimeve dhe veprimeve tregon pakënaqësinë dhe zemërimin e përditshëm të qytetarëve, të cilët në shumicën e rasteve reflektohen me miqtë dhe të afërmit, më shumë sesa në ambiente publike. Pjesa e madhe e zëmërimeve dhe pakënaqësive mund të reflektohen përmes procesit të votimit, duke votuar një parti të re ose duke ndryshuar partitë politike, apo në rastet kur konkurojnë si të pavarur. Kalimi nga një parti tek tjetra për arsye të pakënaqësive, ka ndodhur shpesh kohët e fundit në Shqipëri, fenomen ky i shfaqur deri në nivelet më të larta të politikës duke tërhequr pas vetës mbështetës dhe militantë të forcave politike. Për tu përmendur vlejné shkëputja e Genc Pollos në vitin 2000 nga Partia Demokratike, duke krijuar Partinë Demokratike të Re; Ilir Meta ndahet nga Partia Socialiste për të krijuar Lëvizjen Socialiste për Integrim, me fillimet e saj në gjysmën e dytë të vitit 2003, e paraprirë nga dorëheqja e tij nga posti i Zv/Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm, dhe e motivuar fort nga mungesa e theksuar e demokracisë së brendshme në funksionimin e partisë nga një frenim kritik i procesit të integritit europian me pasojë izolimin e vendit dhe frenimin e rritjes ekonomike dhe shtimin e varfërisë dhe papunësisë (LSI, 2003). Ndërsa rasti më i freskët ka qenë shkëputja nga Partia Socialiste e tre Deputetëve, Kastriot Islami, Asllan Dogjani dhe Gjovalin Kadeli dhe disa drejtuesve të njërive vendore në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të 2013.

Nga analiza me grupet rinore dhe aktivistët e shoqërisë civile, pjesëmarrës në këtë studim, mund të pohojmë se pakënaqësitë ndaj politikës apo sistemit të demokracisë, përmes së cilit legjitimohet veprimtaria politike në Shqipëri, lidhen me dy faktorë kryesor; *edukimi*, *ekonomia*. Rritja e nivelit të edukimit ndikon në rritjen e aftësive politike. Sa më shumë qytetarë të edukuar, aq më shumë mendje kritike dhe në mënyrë direkte do të ketë rritje të kërkesave për drejtuesit dhe përfaqësuesit e tyre. Ndërsa niveli

ekonomik jo i mirë dhe papunësia në rritje ndikon në rritjen e pakënaqësisë ndaj politikave dështake dhe një perceptim se korrupsioni është fenomen që ka përfshirë politikanët dhe drejtuesit e institucioneve të pavarura në Shqipëri. Dhe natyrisht, pas argumentave të cilët vijnë nga të anketuarit, grupet e fokusit dhe intervistat, lind pyetja nëse pakënaqësia ndaj politikës dhe politikanëve në rritje ka rëndësi dhe ndikon në të ardhmen e demokracisë apo jo.

Raporti më i fundit i Freedom House, për “Vendet në Tranzicion 2013” tregon një rënie të treguesve kryesorë të demokracisë në Shqipëri. Sipas këtij raporti, korrupsioni është thelluar, ndërsa vendi vijon të ketë problem me qeverisjen demokratike dhe pavarësinë e gjyqësorit (FreedomHouse, 2013). Ky raport nuk është i vetmi sigurisht, pasi ka raporte të tjera serioze të institucioneve ndërkombëtare, si Banka Botrore apo FMN, të cilat japin sinjale të forta se në Shqipëri demokracia nuk funksionon dhe se pas 22 vite tranzicion, nuk premtan një premisë për konsolidim të demokracisë në vend. Pakënaqësitë ndaj vendimeve dhe politikave jo vetëm të qeverisë dhe politikanëve, por edhe institucionet e drejtësisë, ndikojnë dukshëm në mungesën e besimit tek sistemi që shqiptarët kanë gritur këto vite tranzicioni.

Të rinjtë, më shumë se askush tjetër, janë viktimë e sistemit, i cili çdo ditë prodhon papunësi, emigracion, mungesë sigurie dhe perspektive për një jetë më të mirë. Modelet e praktikuara për punësimin e të rinjëve jo sipas meritokracisë, por sipas preferencave politike dhe nepotike, po kultivojnë një kulturë e cila do të ndikojë në të ardhmen e demokracisë në Shqipëri. Numri i lartë i të rinjve të arsimuar të cilët kërkojnë të largohen nga vendi për shkak të papunësisë dhe mungesës së besimit për ndryshim social dhe konsolidim të demokracisë, është tregues i një perspektive aspak premtuese.

Funksionimi i shoqërisë civile, (analizë e cila do të trajtohet gjerësisht në kapitullin e katërt të këtij studimi), do të ishte një premisë e mirë për të ardhmen e demokracisë. Praktikisht një pjesë e madhe e të rinjve të anketuar gjatë këtij studimi, pranojnë se prezenca e një shoqërie civile të shëndetshme, e cila ushtron presion autoriteteve për të rritur vëmendjen ndaj të drejtave dhe interesave të qytetarëve, kontribon në mënyrë pozitive në cilësinë dhe vazhdimësinë e demokracisë. Grupet e shumta dhe të ndryshme të shoqërisë civile mund të kufizojnë veten e tyre duke kërkuar të influencojnë pa zëvendësuar zyrtarët e zgjedhur, duke pranuar që të trajtojnë njëri tjetrin me respekt, por prezenca e tyre në jetën politike nuk është një bekim i pazbatueshëm.

Pengesa kryesore për të vlerësuar ndryshimet në rolin e shoqërisë civile, është vazhdimësia e natyrës së ndryshueshme për subjektin e tyre. Ndryshe nga besimi i publikut për institucionet, kur vjen puna tek shoqëria civile, grupet e interesit, lëvizjet sociale dhe fondacionet e bamirësisë të cilat e formësojnë atë, nuk mbeten të fiksuara në formën dhe funksionet e tyre. Me përjashtim të disa organizatave, për të cilat është e detyrueshme anëtarësia dhe fusha e interesit është e përcaktuar nga ligjet në fuqi - sikurse janë dhomat e tregtisë dhe sindikatat, shumica e grupeve të tjera që përbëjnë shoqërinë civile - janë të lira të zgjedhin se cilin grup dëshirojnë të përfaqësojnë dhe sesi do të përcaktojnë misionin e tyre. Me gjithë respektin për sindikatat, ka tregues që na bëjnë të besojmë se organizimi 'tradicional' për të përfaqësuar interesat e shtresave sociale, sektoret e ekonomisë dhe profesionet e specializuara, aktivitetet e tyre janë dukshëm të segmentuara për shkak të politizimit të tyre gjatë periudhës së tranzicionit (Lubonja, 2010). Duke mos mbrojtur kështu interesat e grupit që përfaqësojnë, numri i anëtarësisë së tyre ka rënë dukshëm, ndërkohë që ka një mungesë besimi të madh ndaj tyre. Ajo çfarë është më pak e dukshme janë marrëdhëniet e aktivitetit të shoqërisë

civile me format tradicionale të pjesëmarrjes demokratike; zgjedhjet e bordeve të tyre, procesi i votimit, anëtarësia dhe përtëritja e drejtuesve të tyre. Nuk është as e qartë nëse të rinjtë, të cilët përbëjnë pjesën dërmuese të pjesëmarrësve në këto rrjete dhe grupe shoqërore, do të ulet interesi i tyre ndaj shoqërisë civile, për tu bashkuar me partitë politike apo grupet e tjera sociale sikurse prindërit e tyre.

4.2. Pjesëmarrja e të rinjve në forumet politike

Pjesëmarrja e të rinjve në politikë mbetet një proces shumë i rëndësishëm për përgatitjen e klasës së re politike, gjithashtu edhe për të përfaqësuar zërin dhe shqetësimet e një grupi të madh shoqëror, siç janë të rinjtë. Të rinjtë e moshës 15-25 përbëjnë një të pesëtn e popullsisë së botës (UNDP, 2012), dhe prapëseprapë kanë ndikim të kufizuar në institucionet politike. Sfidat e pjesëmarrjes politike të të rinjve dhe angazhimi i tyre vazhdon të mbetet e madhe, ndërkohë që asnjë sistem politik demokratik nuk mund të pretendojë të jetë legjitim nëse të rinjtë janë të përjashtuar dhe të paangazhuar në proceset demokratike²⁰ (IDEA, 2013). Mos-angazhimi i të rinjve në politikën tradicionale përkthehet në mungesë përfaqësimi të këtij grupi shoqëror si duhet në institucionet demokratike.

Pjesëmarrja reale e të rinjve në forumet rinore kërkon që drejtuesit dhe pjesëmarrësit e këtyre forumeve të kenë mundësi për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të përfituar nga mjesidi dhe programet e politikave rinore në të gjitha nivelet. Arritja e të drejtës së pjesëmarrjes²¹ dhe përfshirjes rinore në proceset demokratike është gjithashtu me shumë

²⁰ IDEA, Annual Democracy Forum 2013. Youth Participation in Political and Elections

²¹ Pjesëmarrja është një nga parimet kryesore të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe e drejta e të rinjve për pjesëmarrje është konsideruar e rëndësishme në marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare. Në vitin 1994, 179 vende të Kombeve të Bashkuara kanë njohur rëndësinë e 'integritimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në të gjitha sferat e shoqërisë, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në procesin politik dhe përgatitjen për rolet drejtuese'.

rëndësi për të siguruar arritjen e objektivave të politikës shqiptare në axhendën e zhvillimit dhe integritetit Europian.

Të dhënat e gjetura gjatë këtij studimi mbi pjesëmarrjen e të rinjve politikë në Shqipëri tregojnë se të rinjtë janë grupi më i pa-angazhuar dhe më dyshues në institucionet politike të vendit. Nga pyetsori që kemi kryer gjatë këtij studimi me të rinjë, rezulton se vetëm 12% e tyre janë të interesuar për pjesëmarrje në politike dhe pjesa më e madhe e tyre janë meshkuj. Gjetjet rreth angazhimit të të rinjve në politikë, nuk nënkuptojnë se ata nuk janë të interesuar për problemet sociale dhe ekonomike. Duke vëzhguar lëvizjet e fundit të grupeve të ndryshme shoqërore, protestat për importin e armëve kimike nga Siria apo çështje të tjera që lidhen me mbrojtjen e ambjentit, tregon qartë interesin dhe vëmendjen e grupeve rinore ndaj problemeve dhe shoqërisë ku bëjnë pjesë.

Sipas disa të dhënave të mbledhura nga analizat e ndryshme në mediat e ditëve të sotme²² dhe vëzhgime në terren, rezulton se të rinjtë e sotëm, janë më pak të angazhuar politikisht sesa gjeneratat e kaluara. Një vëzhgim gjatë fushatës elektorale në disa nga selitë e partive kryesore, u konstatua se partitë politike hasnin në vështirësi për të tërhequr të rinj të cilët kanë kapacitete dhe janë premtues për ndryshimet social ekonomike në vend. Një tjetër vëzhgim, në zgjedhjet e drejtuesve të Forumit Rinor të Partisë Demokratike në Qarkun e Kukësit, i mbajtur në 25 Janar 2013, tregon qartë interesin e ulët që kanë të rinjtë ndaj politikës. Përveç pjesëmarrjes, e cila faktoi se të ftuarit të cilët do të kishin të drejtën për të votuar dhe zgjedhur forumet drejtuese nuk ishin anëtarë të forumit, edhe debatet midis kandidatëve, të cilët më shumë se të propozuar nga vetë të rinjtë ishin të emëruar nga forumet e partisë, munguan gjatë fjalës

²² Janë monitoruar mediat kryesore vizive, dhe përkatësisht kanalet: Top-Channel, TV Klan, Vizion Plus dhe Ora News. Monitorimi ka vlerësuar analistët dhe debatet politike përgjatë një periudhe 3 mujore e cila përkon me periduhën parazgjedhore të 2013.

së tyre para të pranishmëve të cilët kishin tagrin e votuesve. Të dhënat e mbledhura nga takime të ngjashme gjatë këtij studimi, tregojnë qartë mungesën e interesit të të rinjëve me kapacitete reale për tu angazhuar politikisht.

Pavarësisht situatës aktuale, e cila rezulton në një mungesë interesi dhe përfaqësimi të të rinjëve në nivelet politike, tranzicioni i gjatë, ka provuar përfshirjen e të rinjëve deri në nivel më të lartë vendimmarrëse, si prurje këto të forumeve rinore të partive përkatëse, në periudha kur këto kanë qenë në pushtet. Ky rast na jep të drejtë ti referohemi dy ish Kryeministrave Z. Pandeli Majko dhe Ilir Meta, të dy ish anëtarë të FRESH, apo Sokol Olldashit nga FRPD-ja në postet e ndryshme, pa përjashtuar se ka edhe raste të tjera. Megjithatë, përsëri, mund të lindë pyetja, nëse pozicionet e mbajtura erdhën si propozim dhe presion i forumeve rinore ku bënë pjesë, apo si konjuktura politike të momentit? Fatkeqësisht, rezulton të jetë kjo e dyta, pasi të dy rastet që lidhen me prurjet nga FRESH erdhën si rezultat i debateve politike të asaj kohe dhe influencës direkt të drejtuesit të Partisë Socialiste, i cili tregoi se ishte ai që kishte bërë këtë lëvizje, përderisa i shkarkonte sa herë i interesonte atij dhe grupit mbështetës.

Apatia drejt politikës dhe politikanëve dhe një mungesë motivimi për të marrë pjesë përmes kanaleve tradicionale (partive politike, fushatave zgjedhore, procesit të votimit në strukturat politike), duket se i karakterizon të rinjtë në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Interesat e konkurrencës dhe ato ekonomike, shfaqin prirje për të rinjtë që të angazhohen në fusha të tjera të ndryshme nga politika dhe shërbimet publike. Mungesa e një stabiliteti të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës së tranzicionit për punonjësit e administratës, ka dekurajuar të rinj me aftësit të mira për tu angazhuar politikisht, për shkak se vendi i tyre i punës do të rrezikohet menjëherë sapo të ketë ndryshim

pushteti²³. Për këtë arsye, pjesëmarrja e të rinjve në ditët e sotme, tenton të fokusohet drejt shërbimeve të veçanta, bizneseve dhe në raste jo të pakta drejt emigracionit, më shumë sesa drejt politikës.

Të rinjtë më shumë gjasa, nuk preferojnë strukturat politike që të rriturit praktikojnë, veçanërisht taktikat dhe modelet e debateve të politikanëve të përhershëm në parlament, ndërsa në të njëjtën kohë, ata theksojnë se përsëri ka një interes të fortë për politikën dhe çështjet sociale. Të rinjtë e intervistuar gjatë këtij studimit, rezultojnë të jenë të lodhur nga politikanët, por nga çështjet politike. Megjithatë, do të pranojmë faktin se Shqipëria, do të vazhdojë të vuajë mungesën e pjesëmarrjes reale të të rinjve me kapacitete për të sjellë ndryshime sociale dhe të gatshëm për të promovuar demokracinë funksionale, kjo për shkak të zhgënjimeve të shpeshta nga përfitimet e pandershme të militantëve dhe të paafteve përgjatë gjithë periudhës së tranzicionit në Shqipëri.

Për pasojë të kësaj situate, e cila lidhet me mungesën e reagimit qytetar, egziston një kërkesë e vazhdueshme e institucioneve ndërkombëtare, të cilat janë të gatshme për të mbështetur përmes donacioneve tek shoqëria civile, por edhe drejtëpërdrejt iniciativa të cilat mbështesin përfshirjen e të rinjve në zhvillimin e demokracisë. Aksioni më i fundit ACT Now i Ambasadës së SHBA-së, me iniciativën dhe mbështetjen direkte të vetë Ambasadorit Amerikan Z. Arvizu, i cili synon në forcimin e principeve demokratike, duke angazhuar qytetarët shqiptar në katër çështje kryesore: Kujdes shëndetësor, Edukim, Ambjent dhe Qeverisje (USEmbassy, 2012). Një pjesë e mirë e të angazhuarve në këtë iniciativë kanë qenë të rinjtë, në rajone lokale të ndryshme të vendit. Pavarësisht mbështetjes së Ambasadës Amerikane për rastin në fjalë, apo projekteve të tjera të

²³ Nga gjetjet e takimit me fokus grupet në Kukës, takim i zhvilluar pranë shoqatës “RSL” me dt. 26 tetor 2012.

vazhdueshme të cilët lidhen direkt me aktivizimin dhe fuqizimin e politikanëve të rinj në nivel lokal dhe kombëtar, egziston një boshllëk i madh midis normave dhe realitetit. Shumica e projekteve vuajnë nga fragmentizimi me aktorë të ndryshëm dhe periudha e shkurtër e mbështetjeve që u jepet, ndërsa koha për të sjellë rezultate kërkon një periudhë të gjatë. Në mënyrë të qartë, duhet të pranojmë faktin, se nuk mund të ketë modele dhe formula të posaçme të cilat garantojnë pjesëmarrjen dhe suksesin e angazhimit të të rinjve, por ka njëdakortësi në lidhje me atë se mundësia më e mirë për ti angazhuar të rinjtë dhe për të mbijetuar këto nisma, është përmes delegimit dhe ndarjes së roleve në zbatimin e këtyre iniciativave.

4.3. Shoqëria civile dhe grupet lokale rinore në Shqipëri (1991-2012)

Përderisa nuk kam përcaktuar në mënyrë të ndarë rolin e shoqërisë civile nga ai i grupeve lokale rinore në fillim, është me rëndësi të bëjmë dallimin midis grupeve lokale rinore komunitare, të cilat nuk janë të regjistruara sipas ligjit por që mund të përfshihen në sektorin e shoqërisë civile, dhe perceptimit të publikut në Shqipëri lidhur me shoqërinë civile, të cilët e lidhin vetëm me OJF-të e regjistruara në gjykatë. Debatet rreth përcaktimit të termit të shoqërisë civile, kanë vazhduar prej kohësh, pavarësisht analizave dhe përfundimeve të herë pas hershme, prandaj edhe çështja e përcaktimit të termit të shoqërisë civile mbetet problematike për shumicën e kërkuesve, sigurisht edhe për njerëzit në përgjithësi. Megjithatë, ajo çfarë ndez më shumë debatin ka të bëjë në dallimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në veçanti me shoqërinë civile në përgjithësi.

Identifikimi i shoqërisë civile vetëm me OSHC-t në Shqipëri, ka lënë në hije grupet e tjera të cilat kanë një rol të ngjashëm me OSHC-t. Në kuptim të studiuesve, “shoqëria

civile” është ajo pjesë e shoqërisë e cila qëndron ndërmjet familjes dhe tregut, dhe funksionon përtej kufijve natyror të shoqërive kombëtare politike dhe ekonomike (Anheier & Themudo, 2002, p. 193). Megjithatë është e rëndësishme të rikujtojmë një tjetër pohim se roli i shoqërisë civile – dhe veçanërisht i OSHC-ve – është të plotësojnë boshllëkun në një demokraci të shëndetshme dhe jo të zëvendësojnë qeverisjen (Edwards, 2000:15). Edwards gjithashtu e përshkruan shoqërinë civile si “një fushë ku njerëzit mbledhen sëbashku për të brojtur interast e tyre të përbashkëta pa qëllim përfitimi politik, por sepse kujdesën rreth diçkaje të përbashkët”(Edwards, 2000). Modeli i organizatave dhe grupeve të cilat përbëjnë shoqërinë civile (OSHC-t), janë padiskutim të ndryshme në termat e fushave ku operojnë, aktiviteteteve që kryejnë dhe interesave të grupeve të cilat përfaqësojnë. Pavarësisht faktit se OSHC-t nuk janë grupet dhe organizatat e vetme që përfaqësojnë ‘shoqërinë civile’ prapëseprapë ky term vazhdon të përdoret gjerësisht duke përgjithësuar grupet e ndryshme të organizatave joqeveritare.

Një trajtim interesant për rastin e OSHC-ve dhe ndarjen e tyre nga shteti është ai i Prof. T. Gjuraraj kur pohon se “Në regjimet totalitariste ndarja që ekziston mes shtetit dhe OJF-ve zhduket, pasi shteti dominon në çdo sektor të shoqërisë. Në regjimet demokratike liberale, përkundrazi, kjo ndarja midis shtetit dhe OJF-ve është i qartë. Madje, vetë shteti favorizon një ndarje me OJF-të, të cilat karakterizohen nga liria e veprimit, konkurrenca në treg dhe përfaqësimi i grupeve të ndryshme sociale duke prodhuar një diversitet social interesash” (Gjuraj, 2011:32).

Në fakt, përdorimi i këtyre termave në rastet e shumta varet nga vendi, koha, shteti dhe struktura legale egzistuese për regjistrimin e organizatave të shoqërisë civile. Ndonëse, do të preferoja që shoqërinë civile ta kuptoja si “*fusha që nuk i përket familjes, shtetit dhe tregut, aty ku njerëzit mbledhen për interesa të përbashkëta*”(CIVICUS), ashtu

sikur edhe përkufizimi i Bankës Botërore, i cili ka përshtatur një përkufizim të shoqërisë civile të zhvilluar nga një numër qendrash kërkimore që e lidh me (OSHC), duke iu referuar një grupi organizatash si: grupe komunitare, organizata jofitimprurëse (OJF), sindikata, grupe indigjene, organizata bamirësie, organizata fetare, shoqata profesionale dhe fondacione”(WorldBank). Këto përkufizime të gërshetuara dhe të kombinuara, do të mund të plotësohen nga kontributet dhe perceptimet e punonjësve rinor dhe aktorë të tjerë të kësaj fushe, për të formuluar në mënyrë më të qartë konceptin e asaj çfarë synoj ti referohem gjatë këtij punimi.

Për të ndjekur strukturën e arsyeshme, do të fokusohem në kontekstin lokal, aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri, me të cilët kam ndërmarrë disa intervista, duke arritur kështu të bëj lidhjet e konceptit të shoqërisë civile më atë çfarë adresohet gjatë këtij hulumtimi. Për punonjësit rinor dhe drejtuesit e (OSHC) në Shqipëri – të intervistuar gjatë këtij studimi – përshtypja e parë se çfarë nënkupton për ata shoqëri civile është e organizuar si më poshtë:

“Organizatë, bashkim, vullnetarizëm, angazhim, pjesëmarrje” (Olsa²⁴);

“Ndonëse ka shumë përkufizime për shoqërinë civile, në opinionin tim dëshiroj të cek përkufizimin e Hegelit, duke e përcaktuar si “Grupazhi i shoqatave të cilat nuk janë as shteti as familja e zgjeruar; shoqëria civile përfshin shoqatat vullnetare, dhe organizmat e firmave apo kompanive ...” (Anisa²⁵);

²⁴Olsa Vila, ish-drejtoreshë për marrëdhëniet me jashtë e Sindikatës së Pavarur, Shqipëri, intervistuar në 15 Janar 2012 në Tiranë.

²⁵Anisa Hysesani, koordinatorë e Youth Peace Ambassador CoE në Shqipëri. Intervistë e zhvilluar në 9/04/2012.

“Të gjithë individët e lirë, të cilët ndihen anëtarë të një shoqërie apo shteti me të drejta të plota; qytetarët të cilët dëshmojnë në çdo mënyrë, kudo ndodhen një kulturë të përgjithshme” (Arta²⁶)

“Një grup njerëzish, të organizuar mbi baza vullnetare, të cilët ndajnë vizion të përbashkët, marrin pjesë aktivisht dhe në mënyrë të pavarur në zhvillimin e komunitetit të tyre dhe shtetit që i përkasin” (Doriana²⁷);

Edhe pse fjala *shoqëri* gramatikisht është në numrin njëjës, shoqëria civile nënkupton një grup njerëzish, të bashkuar nga ide dhe nocione drejt një mirëqenie. Shoqëri civile nënkupton “*to think big*”, të mendosh përtej vetë tënde për të përmbushur një qëllim të caktuar. (Uarda²⁸)

Duket e arsyeshme të shkojmë një hap përtej përkufizimeve të studiuesve të shoqërisë civile në zhvillimin e konceptit, së bashku me përkufizimin e grupeve rinore komunitare. Grupet rinore lokale përfshijnë; parlamentet rinore, unionet studentore, qendrat rinore, lëvizjet rinore, forumet e ndryshme, grupet religjioze, ekipet sportive dhe grupet e tifozave të skuadrave të tyre, të cilët jo domosdoshmërisht janë të regjistruara sipas ligjit. Këto grupe lokale, shpesh janë mënjeluar nga emërtimi dhe ekuivalentimi i shoqërisë civile, prandaj edhe kontributi i tyre është nënvleftësuar madje nuk është marrë në konsideratë ndonjëherë. Prej vitit 1991, kur shoqatat e para në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kanë filluar të kryejnë aktivitetet e tyre në rajone të ndryshme në Shqipëri, ka qenë e pamundur që projektet e tyre të zbatohen pa krijuar lidhje me komunitetet, grupet apo individët në nivel lokal, por prapëseprapë, kontributi i

²⁶ Arta është aktiviste e Këshillit Rinor, Lezhë. Intervistë e zhvilluar në 11/03/2012.

²⁷ Doriana Gjuta është Pedagoge në UT, dega Kukës dhe koordinatore projektsh RSL-s në Kukës. Intervistë e zhvilluar në 6/06/2013.

²⁸ Uarda Begaj, është drejtuese e Parlamentit Rinor dhe anëtare aktive e shoqatës “Epoka e Re” në Fier. Intervista e zhvilluar në 23 Janar 2012

grupeve lokale dhënë për zbatimin e këtyre projekteve, nuk është identifikuar si i një rëndësie të veçantë, ashtu siç duhet të jetë.

Sikurse është përcaktuar në këtë dokument nga punonjësit rinor dhe aktivistët, shoqëria civile është e lidhur me komunitetin, vullnetarizmin, angazhimin, pjesëmarrjen, shoqërinë apo grupe njerzish, kontributi i të cilëve shkon për komunitetin e tyre dhe demokratizimin. Asnjë perceptim i tyre nuk është i lidhur apo duhet të ketë ngjashmëri me partitë politike. Nga ana tjetër, punonjësit rinor, raportet e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, studiues dhe politikanë, theksojnë se pjesa më aktive dhe e rëndësishme e shoqërisë civile në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit është implikuar në politikë dhe anasjelltas. Pavarësisht natyrës dhe përbërjes së shoqërisë civile, e cila mund të ndryshojë nga një shtet në një tjetër, mbetet e qartë se shoqëria civile duhet të jetë autonome dhe e pavarur nga politika, në mënyrë të veçantë, për Europën Lindore, aty ku rrethanat kanë ndiuar që shteti të kontrollojë shoqërinë civil gjatë periudhës komuniste, aty edhe pasojat janë ndjerë gjatë tranzicionit (G.Ekiert & D. Ziblatt, 2012), dhe në këtë rast, Shqipëria nuk përbën një përjashtim. Për sa kohë ka lidhje dhe interesa të përbashkëta midis partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile, pengesat për demokratizim do të mbeten një sfidë e madhe.

Opinionet dhe qasjet e aktorëve të shoqërisë civile si kontribut i këtij studimi, orvaten të argumentojnë rolin e shoqërisë civile në Shqipëri, duke qenë të ndërgjegjshëm për dobësinë dhe infektimin e OSHC nga politika, pa fshehur mungesën e pavarësisë dhe profesionalizmit. Përballë tyre sjellim grupet lokale dhe përpjekjet e tyre për të mbijetuar dhe për të krijuar një tjetër imazh. Dyshimit tim nëse në Shqipëri ka një shoqëri civile reale dhe të organizuar, i bashkohen shqetësimet e individëve të angazhuar në këtë fushe duke u shprehur se: “OSHC-të po bëhen çdo ditë e më shumë

profesionale për të thithur fonde nga donatorët, por prapëseprapë nuk janë të pavarura nga politika, ato mbeten të lidhura me segmente të ndryshme politike dhe shumica prej drejtuesve apo bordet e këtyre organizatave janë njerez të përfshirë në politikë”²⁹.

Anisa, e cila është 26 vjeçe dhe e angazhuar në shoqërinë civile prej tetë vitesh konstaton se “vitet e fundit, kam vënë re se shoqëria civile në Shqipëri (megjithëse jo të gjithë kanë interesa qytetarë, pavarësisht asaj që deklarojnë) është përpjekur të shkëputet nga mbivendosja politike ... dhe sigurisht që kemi parë ndryshime pozitive të OSHC-ve”.

Ndërsa Sana, një aktiviste rinore në Elbasan, e angazhuar me shoqërinë civile që prej vitit 2008 shprehet se “... po, ka një shoqëri civile në Shqipëri, por unë dyshoj nëse ajo është e mirëfilltë, dhe sigurisht që shqetësimi im vjen si rezultat i lidhjeve të forta që disa OSHC kanë me politikën dhe vëmendjen e tyre karshi përfitimeve ekonomike”.

Këto komente dhe analiza të bëra nga aktor të OSHC-ve ndryshojnë nga perceptimi i qytetarëve, të cilët janë plot dyshim për pavarësinë e OSHC-ve. Ndërsa mungesa e besimit drejt partive politike dhe qeverisjes është dukshëm i theksuar, supozohet që në këtë rast shoqëria civile duhet të jetë më e fortë dhe besimi në drejtim të saj duhet të ishte më i madh, por fatkeqësisht të dy sektorët vuajnë nga mungesa e besimit. Mungesa e besimit ndikon pikësëpari aktivitetet e shoqërisë civile, ku bie në sy mungesa e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe së dyti, mbështetja dhe përfshirja e donatorëve.

Nëse kthehemi mbrapa në kohë, mund të pohojmë se nuk kemi trashëguar një traditë të mirë në fushën e shoqërisë civile për shkak të periudhës komuniste. Fillimisht, grupet e

²⁹ Pohim i disa aktivistëve lokal, pjesëmarrës në takimin e fokus grupit të dt. 17 Gusht 2013, në Kukës.

para sociale nisën të organizohen para Luftës së Dytë Botërore, duke vazhduar me formën që disa të tjera morën gjatë sistemit komunist. Sistemi totalitar ishte i infektuar në të gjitha qelizat e jetës shoqërore, duke e transformuar atë plotësisht. Pas ndryshimeve demokratike, nevoja për shoqëri civile erdhi si domosdoshmëri për të themeluar strukturën e re sociale. Tradita e brishtë, rifilloi pas vitit 1991 me OJF-të e para të cilat ishin regjistruar si OJF kombëtare, por faktikisht aktiviteti i tyre ishte i kufizuar në dy tre qytetet kryesore të vendit. Për shkak të mungesës së traditës dhe kulturës, roli i vërtetë i shoqërisë civile ka munguar ose të paktën është lënë në hije, për shkak se shumica e OJF-ve u krijuan për të thithur fonde nga donator të ndryshëm, më shumë sesa për të kontribuar në demokratizimin e vendit³⁰. Në Shqipëri janë të regjistruara 2,231 shoqata, 311 fondacione dhe 552 qendra. Shumica e OSHC-ve, të cilat marrin fonde nga donatorët ndërkombëtar janë të regjistruara sipas ligjit dhe pjesa më e madhe janë themeluar në Tiranë dhe vlerësohen si organizata me burime të mira njerëzore krahasuar me grupet e tjera qytetare përtej Tiranës (TACSO, 2010). Prapëseprapë, edhe përtej kryeqytetit ka grupime të tjera shoqërore komunitare të cilat japin një kontribut po aq të vlefshëm sa edhe OSHC-të të regjistruara sipas ligjit, edhe pse nuk përfitojnë fonde njësoj me OSHC-të.

Kur kanë kaluar më shumë se njëzet vjet nga rënia e komunizmit, pavarësisht disa arritjeve positive, Shqipëria ende edhe sot vazhdon përpjekjet për zhvillimin e një shoqërie civile të paanshme dhe të konsoliduar. Megjithatë, pavarësisht progresit, shoqëria civile mbetet e dobët dhe e paorganizuar (GTZ, 2010)³¹. Duhet gjithashtu të pranojmë se shoqëria civile ka njohur edhe zhvillime negative për shkak të rrethanave të

³⁰Shkëputur nga intervista me Olsa Vila, ish-drejtoreshë për marrëdhëniet me jashtë e Sindikatës së Pavarur, Shqipëri, intervistuar në 15 Janar 2012 në Tiranë.

³¹ GTZ është Programi Gjerman për Asistencë Teknike, për një zhvillim të qëndrueshëm,

ndryshme politike të këtyre njëzet viteve. Komentet e analistëve politik iu referohen viteve 1997 – 2005 kur shoqëria civile është identifikuar dhe si më aktive për këto njëzet vite. Në lidhje me këtë, do të sjell në vëmendje Lëvizjen MJAFT, me protestat kundër qeverisë së Partisë Socialiste (1997-2005). Pavarësisht komenteve të analistëve të politikës, në atë kohën ish-Kryeministri Berisha akuzonte se Lëvizja MJAFT ishte produkt i mbështetur nga Z. Rama për të protestuar në emër të shoqërisë civile, duke mos pasur lidhje me qytetarët, por me pushtetin (Standart, 2011). Pas këtyre akuzave të Kryeministrit dhe lëvizjeve të mëvonshme të drejtuesve të Mjaft drejt politikës, gjithkujt i lind e drejta të ngrejë dyshime për aktivitetin e Lëvizjes MJAFT për lidhje të ngushta me politikën dhe interesa mes tyre, duke dëmtuar imazhin e shoqërisë civile në tërësi³². Gjatë dhjetë viteve të fundit, OSHC-të kanë arritur të mobilizojnë qytetarët për të marrë pjesë në vendimarrje dhe në fushata të ndryshme advokimi. Përfshirja e shoqërisë civile në vendimarrje ka qenë një nga kriteret e vendosura nga KE për tu plotësuar gjatë procesit të integritetit. Për këtë arsye, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritetit 2007-2013 “inkurajon pjesëmarrjen aktive të OSHC-ve dhe shoqërisë civile në përgjithësi në procesin e vendimarrjes dhe përcakton vizionin e saj në zhvillimin e vendit, bazuar në një proces të hapur dhe transparent, i cili garanton përfshirjen e gjerë të shoqërisë civile, qeverisjes vendore, komunitetit dhe biznesit, botës akademike, spektrit politik shqiptar dhe grupet e tjera të interesit”.³³

OSHC-të me kapacitete për të lobuar dhe advokuar ka shumë në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër e vendit ka mungesë të theksuar kapacitetesh organizative. Megjithatë, pavarësisht regjistrimit të shumtë në gjykata për veprimtari në nivel vendor, OSHC që ushtrojnë

³² Komentet dhe akuzat për Lëvizjen Mjaft, janë nga një pjesë e madhe e të intervistuarve të cilat reflektohen përgjatë këtij studimi.

³³ Këshilli i Ministrave, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet 2007-2013,

veprimtari të vazhdueshme jashtë Tiranës numërohen me gishta. Kjo ndodh për shkak të mungesës së fondeve, të cilat kufizojnë mbajtjen në punë të stafit të kualifikur. Shumica prej OSHC-ve që kanë aktivitet mbajnë një deri në tre persona me kohë të plotë ose të pjesëshme dhe kontrata të shkurtra.

Duke marrë në konsideratë numrin e lartë të OSHC-ve të regjistruara sipas ligjit, vetëm disa prej tyre janë në gjendje të marrin fonde dhe të zhvillojnë veprimtarinë e tyre, duke u bazur në objektivat dhe statusin që mbajnë. Mungesa e eksperiencës dhe edukimi i munguar për fushën përkatëse ka ndikuar në menaxhimin dhe orientimin e OSHC-ve. Bazuar në intervistat me punonjësit rinor dhe aktivistë të shoqërisë civile në Shqipëri, kam identifikuar disa nga pengesat dhe problemet që shoqëria civile ka hasur gjatë tranzicionit, si:

- a) OJF-të fillimisht janë krijuar nga njerëz jo-profesional, me mungesë kapacitetesh dhe të pa orientuar si duhet;
- b) OJF-të, fillimisht nuk janë bazuar në nevojat sociale, por sipas thirrjeve për projekte të donatorëve dhe të përshtatura për të përfituar fonde me qëllim për tu punësuar;
- c) Koncepti i vullnetarizmit nuk është perceptuar si një domosdoshmëri e funksionimit të shoqërisë civile, për shkak të keqpërdorimit të këtijtermi gjatë sistemit komunist;
- d) Shoqëria kolektiviste dhe origjina totalitare sëbashku me mungesën e informacionit, kanë qenë zanafilla për të nisur keq rrugëtimin shoqëria civile;

Këto gjetje nga terreni, shkojnë paralel me komentet dhe gjetjet e studiuesit A. Krasniqi, kur komenton krijimin e shoqatave pas 1991, duke pohuar se “idetë e para në Shqipëri

për lëvizje qytetare, debatet e hapura dhe iniciativat e shoqërisë civile nuk erdhen nga akademikët ... nga ana tjetër, pjesa e madhe e OSHC-ve dhe shoqatat e tjera nuk u krijuan nga elita akademike, por nga njerez të thjeshtë, apo të tjerë nga ish-sistemi burokratik komunist” (Krasniqi, 2004). Duke qenë të ndërgjegjshëm për ulje-ngritjet e shoqërisë civile gjatë periudhës së gjatë të tranzicionit në Shqipëri, dhe faktit se grupet lokale nuk janë përmendur apo marrë në konsideratë si pjesë e shoqërisë civile deri tani, duhet të pranojmë se grupet komunitare kanë një rol të rëndësishëm dhe kontributi i tyre duhet marrë në konsideratë për të mundësuar një angazhim dhe partneritet me aktorë të tjerë të shoqërisë.

Nga perceptimi i parë, mund të pranojmë lehtësisht se OSHC-të kombëtare kanë më shumë eksperiencë, janë më të organizuara dhe sigurisht se mund të kenë më shumë influencë në komunitet. Edhe pse grupet e vogla në nivel lokal kanë problematikë më të kufizuar për të trajtuar, ata mund të jenë shumë më të lidhura me komunitetin sesa OSHC-të në nivel kombëtar dhe ato rajonale³⁴. Shqetësim tjetër është se shumica e OSHC-ve janë të varura direkt nga donacionet e huaja, ndërsa grupet e vogla rinore lokale në shumicën e rasteve, në ndryshim me OSHC-të, organizojnë aktivitetet e tyre pa asnjë lloj varësie nga donatorët. Pavarësisht rrjeteve të ndryshme të ngritura kohët e fundit, të cilat mund të krijojnë partneritet midis OSHC-ve, prapëseprapë, gara për fondet e limituara bën që shumica e OSHC-ve të punojnë veçmas (TACSO, 2010).

4.4. Roli i shoqërisë civile në demokratizim

Shpesh, kur ndeshim fjalën *demokratizim*, në mënyrë instiktive i referohemi demokratizimit të lidhur me qeverisjen qendrore, palamentin, pozitën dhe partitë

³⁴Shkëputur nga intervista me Uarda Begaj, 23 Janar 2012, drejtuese e Parlamentit Rinor dhe anëtare aktive e OJF-së Epoka e Re, Fier.

opozitare; aktorët të cilët janë të përqendruar në zhvillimin e politikave në nivel qendror. Ditët e sotme, kur të gjithë ne jemi pjesë e influencës së globalizimit, demokratizimi duket sikur e kapërcen diskutimin kombëtar. Prapëseprapë, decentralizimi i pushtetit në nivel vendor theksohet me forcë dhe mbështetet nga vendet e zhvilluara. Në demokracitë e konsoliduara, aty ku presioni social përftohet nga influenca e globalizimit dhe migracioni është në rritje, është dashur të rishikohen politikat lokale me syrin sesi mund të përballen më mirë me sfidat e zhvillimit demografik. Rishikimi përmes procesit të demokratizimit për këtë interes është një rigjallërim i demokracisë lokale për shumë arsye të ndryshme. Demokracia në nivel komunitar, gjithnjë është në kërkim të instrumentave të rinj për qeverisje demokratike, me qëllim për të administruar sfidat dhe për t'iu përgjigjur mundësive urbane të ditëve të sotme, si një koncept dhe mjet i nevojshëm për të rritur demokracinë vendore. Ajo përfaqëson ide, mundësi zgjedhje, burime dhe metoda për të praktikuar demokracinë e praktikuar në mënyrë të arritshme. Demokracia në nivel lokal përfshin dialogun e vazhdueshëm, debatin dhe diskutimet me qëllimin për të zgjidhur problemet, të cilat janë vendimtare për komunitetin (IDEA, 2011).

Gerry Stoker, Profesor në Universitetin e Strathclyde, ndërsa analizon demokracinë në nivel lokal, adreson rolin e qeverisjes vendore në demokratizim në nivel komunitar duke identifikuar dy sfida kryesore: “lidhjen e vazhdueshme dhe lëkundjen e qeverisjes vendore demokratike në botën e globalizuar; dhe administrimin si duhet të shoqërisë civile si autonome, vetëorganizimin e shoqatave komunitare të cilat kufizojnë pushtetin e shtetit dhe sigurojnë alternativë bazë për politikat dhe shërbimet e nevojshme” (Stoker, 2010). Përveç pjesëmarrjes në zgjedhjet vendore, qytetarët janë të përfshirë direkt në proceset konsultuese. Ky mekanizëm i konsultimeve, nuk është aplikuar si duhet në

Shqipëri nga zyrtarët vendor, ndoshta dhe nga OSHC-të deri diku, prandaj mund të themi se edhe ky komponent i demokracisë ka munnnguar.

Si mund të provohet nëse ka lidhje lidhja midis shoqërisë civile dhe procesit demokratik? Prof. Thomas Goll, nga Universiteti i Dortmundit, gjatë një konference mbi “Promovimin e Demokracisë dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar” të mbajtur në Kolorado në 2006, ka vënë dukje lidhjen e ngushtë midis shoqërisë civile dhe demokracisë. Ndër të tjera ai argumenton se, promovimi dhe zhvillimi i demokracisë duhet patjetër të fokusohet tek shoqëria civile, me qëllim për ta bërë këtë zhvillim më të suksesshëm (Goll, 2006).

Kjo nuk mund të jetë kaq e thjeshtë sa duket, meqenëse pak më lart kemi përmendur rolin e shtetit dhe njerëzve të veshur me pushtet, dhe lidhjet e tyre me OSHC-të. Për këtë qëllim, *DUHET* të provojmë këtë lidhje dhe në mënyrë kritike të vëzhgojmë rolin e shoqërisë civile që mund të ketë në demokratizim. Egzistojnë studime të mjaftueshme në Europën Qendrore dhe Lindore, të cilat tregojnë ndikimet e shoqërisë civile drejt demokratizimit (Forbrig, 2003).

Linz dhe Stepan (1996) sugjerojnë kushte paraprake për konsolidimin e demokracisë dhe nevojën e shoqërisë civile. Teoria normative e shoqërisë civile duhet të përfshijë funksionet e mëposhtme: mbrojtjen e qytetarëve nga abuzimi i pushtetit të shtetit dhe sektorit privat, ndërhyrjen ndërmjet shtetit dhe sektorit privat, socializimin, integrimin dhe komunikimin (Schneider, C. and Schmitter, P.C., 2004). Meqenëse ky sektor konsiderohet jashtë politikës, supozohet se duhet të luajë një rol të rëndësishëm në demokratizim duke ruajtur pavarësinë e tij. Prapëseprapë, kjo është një çështje e diversitetit të OSHC-ve dhe kontributit të tyre direkt në konsolidimin e demokracisë.

Pavarësisht lidhjeve të OSHC-ve me politikën në Shqipëri, duhet të pranojmë se ka edhe OSHC të papërfshira dhe pa lidhje me politikën dhe “të painfektuara”, të cilat orvatën të mbijetojnë dhe të krijojnë një terren social të favorizuar për grupet e tyre të synuara. Duke ndjekur kritikizmin e kësaj qasje ndaj OSHC-ve dhe shtetit, duhet të pranojmë se roli i OSHC-ve në demokraci është i pazëvendësueshëm. Megjithë këtë rol të madh që i atribuojmë këtij grupi social, duke mos lënë jashtë kësaj game të gjerë edhe aktorët ndërkombëtarë të përfshirë prej vitit 1991 në konsolidimin e demokracisë, na rezulton se nuk kanë arritur qëllimin e tyre ose kanë dështuar, të paktën deri tani. Ky kontribut i munguar, vjen për shkak se aktorët e OSHC-ve në nivele të ndryshme kanë humbur lidhjet me realitetin, me komunitetin dhe me njëri tjetrin gjithashtu.

Ndërsa Havel (1993) argumenton se, një shoqëri civile e fortë është kushti themelor për demokraci të fortë, Giovanni Sartori (1998) në librin e tij, *Çfarë është demokracia?*, vë në dyshim demokracinë brenda vetë OSHC-ve, kur pohon se, “nëse vëzhgojmë të gjithë sektorët e organizuar të jetës politike, është e mundur se asnjë nga institucionet nuk mund të ketë më shumë demokraci sesa ne vërejmë tek organizimet politike”. Por le mos të harrojmë edhe faktin se partitë politike ndryshojnë shumë në misionin e tyre nga OSHC-të. Ndërsa partitë politike garojnë për pushtet, OSHC-të nuk e kanë si qëllim këtë, prandaj edhe pohimi i Sartorit mund të mos ketë marrë parasysh garat për pushtet dhe sigurisht që kjo e përligj luftën e tyre, duke i dhënë nota demokracie brenda këtyre organizatave. Nga ana tjetër, do të bie dakort me pohimin e Sartorit, përderisa kemi shumë raste kur të njëjtët njerëz drejtojnë OSHC-të për njëzet vite me rradhë, duke ngritur dyshimin mbi funksionimin e demokracisë brenda organizatave të shoqërisë civile, dhe sigurisht duke ngritur pyetjen nëse këta grupe sociale mund të ndikojnë në konsolidimin e demokracisë apo jo.

Një nga aspektet kur OSHC-të tregojnë dobësinë e tyre, lidhet me aktivitetet që kryejnë, duke u fokusuar kryesisht në fushata ndërgjegjësuere, ngritjen e kapaciteteve të bordeve dhe stafit të tyre. Ndërsa shumica e këtyre organizatave vuajnë nga mungesa e antarësisë, pavarësisht se disa nga OSHC-të shpesh marrin përsipër të flasin në emër të grupeve specifike sociale, sikur janë të rinjtë, gratë, grupet e përjashtuara dhe të tjera si këto.

“Disa prej OSHC-ve karakterizohen nga vlera jo demokratike, përderisa nuk tregojnë transparencë për vendimet e tyre, apo drejtohen nga të njëjtët njerëz prej më shumë se 15 vitesh, dhe nuk kanë lidhje të forta me grupet e synuara apo të kenë anëtarësi prej këtyre grupeve”³⁵.

“Shumica e organizatave të shoqërisë civile janë më pak demokratike sesa institucionet publike të cilat kritikohen për mungesë demokracie nga OSHC-të. Ndërsa ka vend në shoqërinë civile për shumë forma organizimi, roli që mund të luajnë lëvizjet e organizuara demokratike, duke qenë transparente ndaj komunitetit të tyre, mund të jenë realisht ndikuese në mbështetje të demokratizimit lokal në Shqipëri”(OPIC, 2011).

Të dy komentet e mësipërme të bëra nga aktorë të shoqërisë civile, kritikojnë demokracinë e brendshme të OSHC-ve. Duke u mbështetur në këtë, mund të risjellim pyetjen që sapo ngritëm pak më sipër, nëse OSHC-të janë vërtet të interesuara në konsolidimin e demokracisë në Shqipëri?, përndryshe duhet të pranojmë faktin se

³⁵Marrë nga intervista e 24 Maj 2012, zhvilluar në Tiranë, më Alban. N. ish anëtar aktiv i shoqërisë civile në Shqipëri. Ajo argumenton se shoqëria civile në Shqipëri ende nuk ka mundur të demokratizohet për veten e saj, prandaj edhe nuk mund të pretendojmë ose të presim që kjo pjesë e shoqërisë të konsolidojë demokracinë, për aq kohë sa janë mbyllur brenda strukturave që kanë krijuar, në rastet kur këto organizata përbëhen nga 2-3 njerëz dhe që për të shumtën e rasteve janë të ngritura mbi bazë lidhjesh familjare, duke përjashtuar përfaqësimin e interesave qytetare.

OSHC-të kanë dështuar në demokratizimin e vetes së tyre pikë së pari, dhe më pas në konsolidimin e demokracisë në Shqipëri. Prapëseprapë, duhet të jemi ë ndërgjegjshëm për vështirësitë që OSHC-të hasin, sikurse është mungesa e besimit nga qytetarët, mungesa e donatorëve apo mbështetjes së strukturave të shtetit, polarizimi, shpërndarja gjeografike e OSHC-ve dhe mungesa e kapaciteteve për të ushtruar veprimtarinë jashtë Tiranës³⁶.

Duke qenë të varur nga fondet e donatorëve, prioritetet e tyre, më shumë sesa nevojat e vendit (UNDP, 2009), OSHC-të në Shqipëri nuk mund të veprojnë bazuar në misionin e tyre, qëllimet dhe objektivat për të cilat janë themeluar. Kështu që roli i tyre në konsolidimin e demokracisë është i paracaktuar dhe nuk mund të na udhëheqë drejt demokratizimit, nëse ato nuk mund të ndjekin lirisht vlerat dhe misionin e tyre për të cilat janë themeluar prej fillimit. Aktiviteti i tyre duhet të përfaqësojë grupet e papërfaqësuara dhe të përjashtuara, për faktin e mungesës së pushtetit dhe që të mund të ngrihet zëri i munguar për këto grupe. Në këtë kontekst, do të sjell një shembull konkret nga fushata për zbatimin e kuotave për gratë në Shqipëri dhjetë vitet e fundit. Duke vënë re nivelin e ulët të pjesëmarrjes së grave dhe përfaqësimit të tyre në politikë, USAID³⁷ sëbashku me agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara, gjatë zgjedhjeve të zhvilluara në 2003, kanë theksuar rëndësinë e rolit të grave në politikë, duke e mbështetur me thirrje për projekte, që do të zbatoheshin nga OSHC-të. Të tjerë donator dhe agjenci të ndryshme u bashkuan me këtë iniciativë për të mbështetur veprimtarinë e

³⁶Të gjitha këto pohime, janë mbledhur nga intervistat dhe takimet e organizuara me të rinjtë, dhe drejtuesit të disa OJF-ve në nivel vendor jashtë Tiranës.

³⁷United States Agency for International Development. Që nga viti 1992, USAID-i ka dhënë ndihmë për të mbështetur zhvillimin e Shqipërisë, stabilitetin dhe integrimin në Evropë. Programet e USAID-it në Shqipëri forcojnë institucionet demokratike, promovojnë shoqërinë civile, ulin korrupsionin, promovojnë barazinë gjinore dhe, në të njëjtën kohë, krijojnë një mjedis më të favorshëm për rritjen gjithë përfshirëse ekonomike – të gjitha të domosdoshme që Shqipëria të ecë përpara më shpejt drejt demokracisë më të madhe ndërkohë që përmbush kriteret që janë thelbësore për realizimin e aspiratave të saj Evropiane.

OSHC-ve në Shqipëri. Kjo iniciativë ka vazhduar për vite me rradhë të jetë prioritet i donatorëve dhe në interesin e OSHC-ve gjithashtu, duke punuar në fuqizimin dhe përfaqësimin e grave në politikë. Përveç OSHC-ve rinore dhe atyre të grave, shoqata të tjera ishin të gatshme për të përfituar nga këto thirrje, edhe pse në programin e tyre nuk kishin lidhje me çështje të barazisë gjinore apo fuqizimin e grave në vendimarrje.

Që prej zgjedhjeve të vitit 2003, kjo situatë nuk ka ndryshuar shumë për gratë në politikë, por prapëseprapë, thirrjet për projekte në fushën e fuqizimit të grave në politikë mbeten me interes për shumicën e OSHC-ve, pavarësisht misionit të tyre për çfarë janë krijuar, ndryshe nga grupet komunitare të grave dhe të rinjtë, të cilët nuk mund të marrin pjesë në këtë garë për shkak se nuk janë të regjistruara në gjykatë si OJF. Megjithatë, roli i grupeve komunitare nuk ka munguar, dhe shpesh janë përdorur nga OSHC-të për të koordinuar punët e tyre në terren.

Aktorë të tjerë të përfshirë në procesin e demokratizimit në Shqipëri, të përmendur më sipër, janë organizatat ndërkombëtare si; OSBE, UN, ODHIR, të cilat kanë një influencë të dukshme në politikë dhe opinionin publik. Roli i tyre nuk ka qenë vetëm ai i monitorimit apo moderimit të procesit të demokratizimit, por ata kanë luajtur një rol të rëndësishëm në orientimin e reformave dhe balancimin e pushtetit, duke bërë që ndonjëherë të mos funksionojë mekanizmi i demokracisë dhe duke krijuar konfuzion në shoqëri (Bumci, 2004).

4.5. Shoqëria civile gjatë periudhës së tranzicionit

Nëse hedhim një vështrim në zhvillimet politike gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, do të mund të vërejmë një dinamizëm me zhvillime të ndryshme si; parti të reja; shkëputje e grupeve politike kryesisht deputetë nga partitë për të krijuar parti të

reja; lëvizje qytetare që transferohen në forca politik, rasti i Aleancës Kuqe e Zi apo drejtuesit e Lëvizjes Mjaft; demonstrate të dhunshme dhe paqësore kryesisht për qëllime pushteti; ndryshime të pushtetit në kohë krize dhe mosnjohje zgjedhjesh të shoqëruara me greva urie, rasti i zgjedhjeve kontestuar nga Partia Socialiste në vitin 2009; mjete këto të përdorura në një shoqëri demokratike, për ta konsideruar “si një demokraci në veprim” sikurse Sekretarja Amerikane e Shtetit, Znj. Clinton, u shpreh në fjalën e mbajtur në Parlamentin Shqiptar në 1 Nëntor 2012. Pavarësisht përdimit të të gjitha këtyre mjeteve demokratike, ndoshta duke e kapërcyer disa herë edhe kufirin, për shkak të presionit ndërkombëtar, apo në rastet kur dhuna ka mposhtur arsyen, duket se konsolidimi i demokracisë mbetet akoma i brishtë, për shkak të konflikteve politike, korrupsionit, zhvillimit të ulët ekonomik dhe apatisë qytetare. Kjo e fundit është ngushtësisht e lidhur me konceptin e shoqërisë civile. Na duhet të pranojmë faktin se shoqëria civile, si një aktor i rëndësishëm në demokratizimin e shoqërive demokratike, nuk ka mundur të faktorizohet për të ndikuar sa duhet në zhvillimin demokratik të vendit.

Nëse kthehemi mbrapa në kohë njëzet vite më parë, të gjithë pranojmë se të rinjtë ishin i vetmi grup social në Shqipëri dhe më i konsoliduari që solli ndryshimet demokratike. Përveç partive politike që lindën gjatë viteve të para të 90-ës, grupime të tjera shoqërore u krijuan në vend si; sindikata, shoqata të ndryshme politike dhe jopolitike. Megjithatë, këto grupe të krijuara rishtazi, vuanin nga mungesa e eksperiencës për të luajtur një rol të rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë. Prapëseprapë, edhe pse eksperiencia e grupeve shoqërore sot nuk mungon, impakti i tyre në konsolidimin e demokracisë, nëse e krahasojmë me rolin e shoqërisë civile në vendet e tjera të Ballkanit, rezulton se

grupet e shoqërisë civile në Shqipëri janë dukshëm më pak aktive ose në disa raste të politizuara deri në masën e mungesës së një dallimi të shoqërisë civile nga ajo politike.

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme gjatë njëzet e dy viteve tranzicion, Shqipëria konsiderohet një qeverisje në tranzicion apo regjim hibrid (Freedom House, 2013). Megjithëse, burime të ndryshme, duke iu referuar raportit të FRIDE³⁸ apo deklaratat inkurajuese të intitucioneve Europiane, organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare theksojnë se është bërë shumë drejt konsolidimit të demokracisë dhe në fushën e zbatimit të ligjit, veçanërisht në letër, por kur vjen puna e zbatimit në praktikë të demokracisë së praktikuar dhe zbatimit të ligjit, egziston një hendek i madh midis tyre (FRIDE, 2010). Nga ana tjetër, vitet e fundit, kërkesat për konsolidim të demokracisë dhe shtetit ligjor kanë njohur zhvillime të reja dhe kanëshfaqur interes të veçantë nga partnerët ndërkombëtar dhe veçanërisht institucionet Europiane dhe SHBA, duke kushtëzuar procesin e integritimit me reforma konkrete.

Implikimi i politikës me shoqërinë civile dhe anasjelltas, bazuar në njohjet apo lidhjet individuale më shumë sesa idetë konkrete, është një nga karakteristikat e tranzicionit Shqiptar. Gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, ka ndodhur shpesh që ministrat, anëtarët e parlamentit apo këshilltarët e tyre të krijojnë OJF, fondacione apo institute (Krasniqi, 2009) duke implikuar kështu drejtëpërdrejtë shoqërinë civile dhe anasjelltas, ka ndodhur e kundërta kur shpesh që partitë politike dhe drejtuesit e tyre të implikojnë shoqërinë civile, duke përdorur grupet dhe individët si energji të re e cila do të sillte zhvillim dhe të demokratizonte partitë e tyre. Deklarata e liderit të opozitës bërë, në TV

³⁸FRIDE është një mekanizëm European në arenën ndërkombëre, i cili siguron analiza rigoroze dhe mendim novator për çështje thelbësore në marrdhëniet ndërkombëtare. E vendosur në Madrid, FRIDE synon të rrisë perspektivën e Europës së Jugut në debatet e BE dhe perspektiven Europiane në Spanjë.

News24³⁹, kur siguroi se koalicioni i tij do të zgjerohej me grupe nga shoqëria civile (Rama, 2012), nuk është e vetmja, pasi raste të tjera kemi gjatë gjithë shtrirjes së tranzicionit dhe kryesisht në prag fushate zgjedhjesh. Në pamje të parë, kalimi i individëve për tek sektori i politikës nuk do të kishte asnjë problem, sa kohëkëta të fundit nuk ndikojnë direkt në funksionimin e organizatave edhe pasi marrin pozicionet politike. Në të kundërt, do të dëmtojnë imazhin sikurse dhe ka ndodhur në disa raste, dhe sigurisht se ky afrim, nuk mund të përfaqësojë interesat e shoqërisë civile, për sa kohë njerëz të veshur me pushtet politik vazhdojnë të drejtojnë një pjesë të mirë të OJF-ve në vend. Për të kapërcyer përtej konceptit të shoqërisë civile të përqendruar në mjediset politike dhe zonave kryesore urbane, pak më sipër kemi trajtuar faktin se shoqëria civile është më shumë sesa OJF-të e regjistruara sipas ligjit, dhe se grupe të tjera joformale, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në komunitetet e vogla, sikurse janë grupet rinore, të cilat janë të lidhura direkt me promovimin e demokracisë, duhet të konsiderohen aktorë të rëndësishëm, të cilat mund të ndikojnë dukshëm në zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë. Përgjatë këtij kapitulli do të marrim në konsideratë dy çështje të rëndësishme që ky studim ka në fokusin e tij, pjesëmarrjen e të rinjve dhe komunitetet e vogla lokale; të dyja si pjesë e shoqërisë civile, të cilat mund të ndërmarrin dhe ndikojnë në ndryshimet sociale në nivel komunitar, duke transferuar procesin e konsolidimit të demokracisë në një kontekst më të gjerë.

Tranzicioni në Shqipëri ka provuar së mund të jetë një eksperiencë e keqe dhe se mund të zgjatet më shumë sesa pritet. Iniciativat e ndryshme politike dhe jopolitike për të sjellë ndryshime sociale dhe për të stimuluar grupet e ndryshme drejt konsolidimit të demokracisë, në fakt nuk kanë rezultuar në sukses, për të mos thënë se shumica e tyre

³⁹Kryetari i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Z. Edi Rama, i ftuar në emisionin 5 Pyetje nga Babarama në 8 Shkurt 2012.

kanë dështuar. Përderisa polarizimi politik në Shqipëri është i dukshëm dhe i madh, diskursi politik për një demokraci të brishtë vazhdon të jetë prezent edhe pas njëzet vitesh. Atëherë me të drejtë na lind dyshimi dhe ngrejme pyetjen nëse egziton një shoqëri civile e vërtetë e cila mund të ndikojë në demokratizimin e vendit apo jo? Dhe çfarë të mire do të sillte nëse procesi i demokratizimit nis nga poshtë, me pjesëmarrjen e të rinjve në grupet e vogla në nivel lokal?

Bazuar në ato çfarë kemi shprehur më sipër, duhet të theksojmë se aktorë të tjerë – ndryshe nga OJF-të e regjistruara, të cilat shpesh herë marrin meritat dhe përgjegjësitë kryesore në sytë e opinionit publik –duhet të angazhohen dhe të merren në konsideratë. Grupet e vogla, pa marrë parasysh nëse është një grup nxënësish të një klase në një shkollë, një grup komunitar në një lagje periferike, familje apo një grup që merr pjesë në vendimarrje, apo që zhvillohet sipas parimeve të demokracisë duhet të konsiderohet gjithashtu. Për fat të keq, aplikimi i demokracisë pjesëmarrëse në grupet e vogla, nuk është praktikuar në shoqërinë shqiptare. Asgjë nuk është më e rëndësishme sesa shëndeti i demokracisë, gjë e cila mund të ndodhë përmes angazhimit të grupeve dhe individëve rinor, të cilët mund të marrin pjesë direkt dhe lehtësisht në vendimarrjen lokale (Institute for Youth, 2010).

Politikat për rininë zakonisht janë promovuar nga organizatat kombëtare dhe ato ndërkombëtare në Shqipëri, ndërsa organizatat lokale nuk janë marrë shumë në konsideratë për tu konsultuar në përgatitjen e strategjive dhe politikave jo vetëm lokale (CoE, 2010). Pa u larguar nga organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare, duhet të pranojmë faktin se ata i kanë humbur lidhjet me komunitetet lokale, për sa kohë iniciativat e tyre nuk sjellin rezultate. Një tjetër fakt për të mbështetur këtë pohim lidhet edhe me importin e praktikave më të mira nga vendet e zhvilluara, të cilat nuk mund të

përshtaten me realitetin shqiptar, dhe kjo është një nga arësyet kryesore pse nuk kanë gjetur zbatim me kontekstin lokal në Shqipëri. Qeverisja vendore nga ana tjetër duket se nuk ka mundur të krijojë mundësi pjesëmarrjeje, konsultimi dhe angazhimi për grupet e ndryshme komunitare dhe në veçanti ato rinore, në mënyrë për të identifikuar ashtu si duhet nevojat për ndryshimet demokratike. Me këtë arsye, shtrojmë një pyetje tjetër të rëndësishme: *Çfarë e shkakton mungesën e komunikimit midis grupeve komunitare dhe lokale me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare?*

Fillimisht, ndërsa analizojmë performancën e shoqërisë civile në lidhje me promovimin e demokracisë gjatë peridudhës së tranzicionit në Shqipëri (1991-2012), mendoj se organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare i kanë humbur ose apo në rastin më të keq nuk kanë krijuar lidhje me realitetin lokal dhe grupet vendore të cilat janë aktive. Nga ana tjetër, për shkak të lehtësirave dhe mungesës së eksperiencës, janë importuar modele nga vendet ish komuniste apo perendimore, por në fakt për kontekstin shqiptar kanë rezultuar në një dështim. Ky argument mund të jetë pengesë për demokratizimin e shoqërisë, duke humbur kohë në përshtatjen e ekspertizës ndërkombëtare me komunitetin vendor. Në të njëjtën kohë më lind dyshimi dhe pyetja rreth rolit të organizatave dhe grupeve që përfaqësojnë interesat e shoqërisë civile. A janë vërtet ato të interesuara në demokratizimin e vendit?, apo mos duhet të mendojmë për mekanizma të tjera, sikur edhe i përmendëm më sipër; *grupet rinore lokale*, të cilat kanë interes të drejtëpërdrejtë dhe impakti i pjesëmarrjes së tyre do të sillte ndryshime të prekshme?

Pyetja e ngritur së fundmi, do të na ndihmojë të argumentojmë rolin e vërtetë që kanë patur organizatat e shoqërisë civile në demokratizimin dhe më vonë në përligjen e veprimtarisë së tyre gjatë periudhës së tranzicionit. Duke vëzhguar veprimtarinë dhe përfshirjen e qytetarëve në aktivitetet e tyre, do të mund të kuptojmë se sa afër dhe

ngushtë janë të lidhura interesat e tyre me ato komunitare, fillimisht si një mjet i domosdoshëm për legjitimimin e tyre dhe më pas impaktin në demokratizimin e shoqërisë, duke argumentuar se deri në çfarë mase pjesëmarrja e të rinjve mund të luajë një rol të rëndësishëm duke influencuar demokratizimin në Shqipëri.

4.6. Grupet e vogla rinore në nivel lokal

Secili prej nesh, në rrethana të ndryshme, ka patur mundësi për të qenë pjesë e diskutimeve në grupe të vogla. Një grup i vogël konsiston në më shumë se dy persona të cilat kanë perceptimin e qëllimeve të përbashkëta, një rrjet komunikimi, norma dhe interesa të ndërruar, dhe të përbashkëta (Gastil, 1993).

Kur ka një vendimarrje, duke përfshirë më shumë sesa një person, atëherë kjo procedurë në të shumtën e rasteve konsiderohet si demokratike. Një grup i vogël është demokratik atëherë kur ai ka shpërndarë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë vendim-marrjen, pushtetin, ka arritur përfshirje të antarësisë së angazhuar për demokracinë dhe praktikon metoda demokratike për rrahje mendimesh. Përgjithësisht kur flasim për demokraci, shpesh nëkuptojmë zgjedhje, debate parlamentare, lobim dhe të tjera si këto. Ndërsa për të tjerë, demokracia nënkupton diskutime të hapura dhe barazi në vendimarrje.

Pjesëmarrja e të rinjve në vendimarrje, në ato raste kur kjo e fundit ndikon direkt tek të rinjtë vetë apo jetën komunitare, angazhimi i tyre është i vëlfshëm dhe sjell një varg rezultatesh pozitive. Pjesëmarrja e të rinjve nuk mund të ketë një stacion të fundit, por ajo nënkupton prezencën direkte për të arritur ndryshime pozitive në jetën e tyre duke ndërtuar një shoqëri më të mirë (CoE, 2008). Angazhimi i të rinjve në jetën komunitare përmes diskutimeve në grupe të vogla, me pjesëmarrjen direkte, e cila çon drejt një perspektive demokratike për edukim qytetar, do të merrej në konsideratë, të mbështetëj

dhe motivohet nga masa. Në këtë kontekst, të rinjtë duhet të ndihen të lidhur dhe të mbështetur nga njerëzit, komunitetet, idetë dhe lëvizjet (Jans, M and De Backer, K, 2002). Kjo nënkupton se ata duan të jenë në dijeni se nuk janë të vetëm dhe se mund të mbështetën në një grup apo institucion.

Organizatat komunitare janë gurë-themeli i demokracisë (Toronto, 2004). Për të qenë të suksesshme, këto organizata duhet të reflektojnë nevojat dhe pikpamjet e anëtarëve të tyre dhe partnerëve mbështetës – pasi fuqia e vendimarrjes lidhet ngushtë me aftësinë për të qenë përfaqësuese dhe përfshirëse. Një grup demokratik, i cili përbën ndoshta më shumë sesa 25% të popullsisë – sikurse janë të rinjtë, të cilët në shumicën e rasteve janë burime të pashfrytëzuara – apo në shumicën e rasteve janë të injoruar dhe se nuk vihen re kur vjen puna për të marrë vendime. Ndoshta mund të ketë disa arsye përse organizatat e shoqërisë civile dhe qeverisja vendore nuk angazhojnë të rinjtë në procesin e vendimarrjes. Dikush mund të bazohet në keqkuptimin apo në pasigurinë sesi mund të krijohen urat e bashkëpunimit midis këtyre grupeve. Megjithatë duhet të rikujtojmë se po flasim për grupe të vogla vendore, të cilat mund të mos jenë të regjistruara sipas ligjit si OJF, por që kanë një veprimtari dhe përfaqësojnë interesat qytetare dhe punojnë për demokratizimin njëllor sa forumet, apo OJF-të e regjistruara të cilat përfitojnë donacione të shumta nga donator të ndryshëm.

“Grupet e vogla janë të afta të kapërcejnë stereotipet negative për të rinjtë; ato kanë treguar aftësi të mjaftueshme për të zhvilluar demokracinë lokale duke qenë aktor të rëndësishëm në nivel vendor⁴⁰”. Të rriturit, shpesh ulen dhe diskutojnë për problemet rinore duke mos marrë mendimin e tyre dhe pa i bërë pjesë të këtyre diskutimeve.

⁴⁰Marrë nga intervista me Frensis Dule, drejtuese e Social Youth Forum, pjesë e SANSUS NGO, datë 25 Janar 2012, në Tiranë.

Shumica e këtyre kuvendimeve për të rinjtë mbahen pa prezencën e të rinjve në panelet drejtuese, apo në të shumtën e rasteve ata përdorën si modeli që duhet krijuar, pavarësisht se nuk marrin fjalën asnjëherë dhe dukshëm na mbushet mendja se nuk mund të drejtojnë konferencat e këtyre niveleve.

Prandaj, duhet ta themi me forcë se barazia për mundësi është e rëndësishme në grupet demokratike. Ashtu sikurse Dahl argumenton për anëtarët e demosit të cilët “duhet të kenë mundësi të mjaftueshme për të shprehur preferencat e tyre për rezultatin final” gjithashtu edhe për “të ngritur pyetje mbi programin dhe shprehur arsytet e tyre në rastin kur miratojnë një rezultat apo në rastin kur e pranojnë një tjetër” (Dahl, 1991). Pavarësisht sa të vogla janë grupet, është shumë e rëndësishme të dëgjohet zëri i tyre, me qëllim për të arritur pjesëmarrje dhe mundësi për debatin demokratik.

4.7. Pjesëmarrja rinore dhe ndikimi në demokratizim

Deri tani jam përpjekur të analizoj dhe të sjell në vëmendje performancën e OSHC-ve në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit dhe rolin e tyre në procesin e konsolidimit të demokracisë në vend. Fillimisht, është e nevojshme që të qartësoj termin *pjesëmarrje* dhe qëllimin e përdorimit të tij në këtë rast. Kjo trajtesë, ka të bëjë me pjesëmarrjen në proceset demokratike, çfarë nënkupton pjesëmarrje të individit personalisht dhe në mënyrë aktive në vendimarrje dhe konsultimet komunitare, pjesëmarrje që i përket njerëzve në nivelin komunitar, marrë përsipër dhe realizuar nga ata vetë. Askush nuk ka mohuar faktin se *pjesëmarrja* është thelbi i mikro-demokracisë në superstrukturen e shtetit” (Sartori, 1998). Veç kësaj, ne po flasim për një grup specifik të shoqërisë, *të rinjtë dhe grupet e vogla* në nivel komunitar. Kështu që është e rëndësishme të

theksojmë pjesëmarrjen e të rinjve, si një grup i veçuar, meqenëse mund të ketë qasje të ndryshme të pjesëmarrjes, dhe interesat ndryshojnë nga një grup tek një tjetër.

Për të kuptuar më mirë pjesëmarrjen rinore, do të shikojmë qasjen e të rinjve, punonjësve social dhe aktivistëve rinor, arsyen përse ata duhet të shqetësohen për demokratizimin dhe më pas të përpiqemi të analizojmë nëse angazhimi i tyre dhe aktivitetet që ata organizojnë mund të përmirësojnë jetën e tyre, apo përtej kësaj mund edhe të ndikojë në konsolidimin e demokracisë. Gjatë intervistave të zhvilluara me këtë grup social, ne kuptojmë perceptimin e tyre për demokracinë dhe demokratizimin. Shkurtimisht, demokraci dhe demokratizim për të rinjtë do të thotë; “mundësi të barabarta, qeverisje e mirë, lëvizje e lirë, cilësi edukimi, argëtim, siguri, zgjedhje të lira dhe të ndershme, transparencë, llogaridhënie, drejtësi dhe përfshirje sociale”⁴¹. Të gjitha këto fjalë kyqe, bëjnë kuptim për të rinjtë dhe mund të lehtësojnë përpjekjet e tyre për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shoqëri.

Të rinjtë kanë të drejtë për marrë pjesë në vendimet që u përkasin atyre, prandaj kjo mund të jetë një arësye kryesore, për faktin se ata duhet të shqetësohen për pjesëmarrjen. Në shumicën e rasteve të rinjtë në Shqipëri ballafaqohen nga vendime të cilat janë marrë pa qenë farë pjesë e diskutimeve apo konsultimeve me të rinjtë. Rasti më i fundit lidhet me provimin e TOEFL-it⁴², ku Ministria e Arsimit e ish-Kryeministrit Berisha, kishte vendosur si kriter për të gjithë ata që ndjekin studimet Master në Universitetet shqiptare, ndërkohë që pjesa më e madhe e studentëve kanë kundërshtuar këtë vendim. Për shkak mungesës së konsultimeve paraprake me grupet e interesit,

⁴¹Përveç intervistave me aktivistë rinor, kam patur rastin të organizoj një takim me grupe të fokusuara me të rinjtë në Qarkun e Kukësit. Të rinjtë pjesëmarrës kanë shprehur kuptimet e tyre për demokratizimin, duke e parë atë si një process ku duhet të angazhohen të gjithë pa paragjykime.

⁴²Test i gjuhës Angleze, i cili është një kërkesë hyrje për studentët që nuk e kanë gjuhën Anglezë gjuhë të tyre amtare, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në kolegje apo universitet ku mësimi zhvillohet në këtë gjuhë.

vendimi i marrë nga Ministria në fjalë, ka mobilizuar të rinjtë me protesta në rrugë, në media dhe përmes internetit në rrjetet sociale.

Lidhur me pyetjen e ngritur, se përse të rinjtë duhet të shqetësohen për pjesëmarrjen e tyre, përsëri do të sjell kontributin e mbledhur nga punonjësit rinor dhe aktivistët gjatë intervistave të kryera me ta;

“...është një mundësi për të rritur kapacitetet tona, të njohim më shumë njerëz, dhe të mësojmë më shumë sesi funksionon sistemi”(Denis⁴³); “...për të krijuar një rrjet komunikimi me njerëz të tjerë, për të kontribuar në komunitet, për miqtë dhe familjen”(Blendi⁴⁴); “... është kënaqësi të jesh pjesë e grupeve rinore. Mua më pëlqen të marr pjesë në konsultime dhe vendimarrje, sepse mund të përfitoj indirekt, gjithashtu për komunitetin ku unë bëj pjesë dhe njerëzit me të cilët përshëndetem në rrugë çdo ditë, do të jetë shumë mirnjohës.Kjo gjë më bën të ndihem e vlefshme (Uarda)”; “... pjesëmarrje! Është mahnitëse kur je pjesë e shoqatave rinore, prandaj jam shumë e interesuar të bahkohem me bashkëmoshatarët e mi” (Sara); “...duke marrë pjesë në vendimarrjen komunitare apo duke diskutuar për politikën e ardhshme, mund të ketë një ndikim transformues sesi të rinjtë mendojnë për veten e tyre dhe rolin e tyre në shoqëri. Kjo më ka bërë mua të kuptoj se kontributi im si qytetar është shumë i rëndësishëm, veçanërisht në kontekstin tim lokal (Olsa).

⁴³Shkëputur nga intervista me Denisin, në 28 Janar 2012.Ai është anëtar i Parlamentit Rinor Shkodër.

⁴⁴Shkëputur nga intervista me Blendin, në 16 Janar 2012 në Tiranë.ish-drejtues i Unionit Studentor.

Duke ndjekur shpjegimin e termit *pjesëmarrje* është e nevojshmetë fokusohemi më shumë lidhur me mjetet dhe mekanizmat që të rinjtë mund të përdorin me qëllim që të marrin pjesë. Faktori i parë që mund të përmendim janë *zgjedhjet, votimi*, por për shkak se në po flasim për të rinjë duhet të kemi parasysh dhe të konsiderojmë faktin se vetëm të rinjtë që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç mund të votojnë. Megjithëse, nuk ka formë të autorizuar për pjesëmarrje direkte në qeverisjen e demokracive moderne; modelet e pjesëmarrjes bashkëkohore janë dhe duhet të jenë mundësi për të shprehur opinionin duke votuar apo duke dhënë mendimin përmes konsultimeve. Të rinjtë duhet të ftohen në diskutimet kur merren vendime, të cilat janë të lidhura dhe kanë ndikim direkt tek ata (CoE, 2010). Në ditët e sotme, pjesëmarrja po bëhet e shumëllojshme, me kuptimin se ata mund të përdorin disa mënyra pjesëmarrjeje, përderisa përdorimi i teknologjisë dhe internetit është përhapur deri në zonat më të thella, prandaj edhe kjo mundësi komunikimi duhet të shpërndahet dhe të nxitet me të rinjë. Pjesëmarrja e të rinjve lidhet me përfshirjen e tyre, në këtë mënyrë ata mund të shprehin mendimin e tyre, atëherë kur është më e përshtatshme për ta. Kjo përfshin të rriturit në dëgjuesën ndaj të rinjve dhe përfshirjen e ideve që vijnë nga të rinjtë në vendimarrje (ACT, 2010).

Ka disa mënyra pjesëmarrjeje për të rinjtë në nivel lokal, ku disa forma shfaqen më tërheqëse sesa të tjerat. Edukimi jo formal, puna vullnetare, këshillat rinor, klubet rinore, OJF-të, bojkotimi i produkteve, firmosja e peticioneve, fushatat ndërgjegjëse, forumet politike, unionet dhe marrja pjesë në zgjedhje⁴⁵ (për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur) janë disa nga format e pjesëmarrjes që të intervistuarit e rinj kanë shprehur gjatë këtij kërkimi.

⁴⁵ Pohimet e mbledhura nga takimi me të rinjë të Qendres Rinore, Kukës, 17 Gusht 2013.

Duke ndjekur diskutimin lidhur me pjesëmarrjen, duhet të marrim në konsideratë *Shkallën e Pjesëmarrjes Qytetare*, të cekur në kapitullin e parë, metodë kjo e zhvilluar nga Sherry Arnstein. Studiuesja argumenton se pjesëmarrja është e vlefshme atëherë kur “shpërndajra e pushtetit mundëson qytetarët e munguar... për tu përfshirë me paramendim në ta ardhmen (Arnstein S. , 1969, p. 36)”. Kjo “shkallë” përmban gjashtë ndarje: manipulimin, terapinë, informimin, konsultimin, pozitën, delegimin e pushtetit dhe në fund kontrollin qytetar. Kjo perspektivë, është e vlefshme për faktin se modeli i prezantuar për të mbështetur pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal, duhet të adresojnë çështje të lehtësimit dhe këshillimit, me qëllim për të përfituar një vlerë bazuar në perspektivën rinore, pushtet i kërkuar për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre.

Pyetja në vazhdim është e lidhur me pëlqimin dhe përfitimin e të rinjve. Nëse është i përshtatshëm dhe argëtues për të rinjtë procesi i demokratizimit dhe çfarë përfitimesh do të kenë prej pjesëmarrjes së tyre.

Të rinjtë, më shumë se ndonjë grup tjetër kanë nevojë të gjejnë një ambjent argëtues, në mënyrë që të bëhen pjesëmarrës⁴⁶. Veç kësaj, ata duhet të përfitojnë direkt nga pjesëmarrja, duke u dëgjuar për shqetësimet e tyre dhe të tjera që lidhen me to. Duhet të përfshihen përfitimet për të rinjtë, duke i bërë argëtuese, edukative apo në disa raste duke siguruar pagesa të veçanta për grupet e konsultuara për çështje specifike. Ndërsa të rinjtë mund të kenë dëshirën dhe vullnetin për tu angazhuar në nivelin lokal, kombëtar dhe atë global, ata nuk janë shumë entuziast për proceset politike dhe demokratike. Ky shqetësim mund të shtrojë për diskutim çështjen e motivimit dhe frymëzimit tek të rinjtë në procesin e pjesëmarrjes dhe konsolidimin e demokracisë.

⁴⁶Marrë nga opinionet e të rinjve në fokus grupin e Kukësit, 17 Gusht 2013.

Megjithëse të rinjtë shfaqin një kuptim të gjerë të kuptimit mbi demokracinë në vendin tonë, strukturat tradicionale politike dhe qeverisja mund të shfaqen pa lidhje me situatën e tyre (Collin, 2008). Motivimi i të rinjve kërkon; pavarësi në vendimarrje, ambjent të sigurtë, mbështetje financiare për idetë dhe fushatat, edukim formal dhe joformal të integruar në jetën e përditshme tek të rinjtë, gjithashtu edhe aktivitete dhe shkëmbime rinor të fokusuara në tranzicionin që prek të rinjtë nga edukimi tek punësimi. Më e rëndësishmja sipas vetë të rinjve për të siguruar pjesëmarrje dhe motivimin e tyre, lidhet direkt me ndarjen e pushtetit. Të rinjtë nuk mund të kenë vetëm detyrime, por duhet të kenë dhe përgjegjësi, duhet të përfitojnë direkt nga politikat, të kenë zërin e tyre dhe të kenë pushtet kur vjen puna për zbatimin e projekteve apo edhe përmenaxhimin e fondeve⁴⁷.

Nga eksperiencia e aktorëve vendor

Pyetja drejtuar të intervistuarve të OSHC-ve dhe aktivistëve rinor, nëse grupet rinore mund të ndikojnë në demokratizimin në Shqipëri, është komentuar në mënyrë pozitive “...demokratizimi është një proces; në këtë kontekst, pjesëmarrja e të gjithë aktorëve është shumë e vlerësuar, ndërsa grupet e vogla rinore mund të japin kontributin e tyre në këtë proces duke reaguar dhe ofruar alternativa për zhvillim. Aktivizimi i grupeve rinore do të inkurajojë aktorët lokal për të krijuar politika të përfshirjes sociale, promovim të vullnetarizmit dhe pjesëmarrjen në vendimarrje, instrumenta të cilët na udhëheqin drejt konsolidimit të demokracisë në nivel lokal” (Dori)

“...duke qenë më afer se OSHC-të, grupet e vogla rinore, janë gjithmonë më të informuara dhe të lidhura me shqetësimet lokale të ditës, dhe për shkakun e thjeshtë se

⁴⁷Nga intervista me B. Mataj, drejtue i forumit rinor të Partisë Socialiste në Kukës. Intervistë e zhvilluar në 8 Prill 2013.

ata njohin më mirë mentalitetin e komunitetit të tyre, prandaj ata janë të zotët të kontribojnë direkt në komunitetin e tyre vendor” (Olsa)

“...sigurisht, këto grupe janë të afta të kontribojnë në demokratizimin e vendit; ata kanë lidhje shumë të mira me komunitetin e tyre, janë fleksibël dhe mund të organizohen shumë më lehtë, gjithashtu ato karakterizohen nga sensi i besimit dhe mirëkuptimit të përbashkët, cilësi këto që i ndihmojnë ata të kenë sukses më shumë së çdo grup tjetër” (Anisa)

“... jam e sigurtë se grupet e vogla mund të ndikojnë në konsolidimin e demokracisë, por vetëm nëse ata nuk janë të përdorur për dekorim nga partitë politike” (Sara⁴⁸).

Pas kontributeve të mbledhura nga të rinjtë dhe aktivistët e OSHC-ve në Shqipëri, do të sjell një shembull nga një shoqatë rinore, pjesë e së cilës kam qenë gjatë projektit “Promovimi i aktivizimit rinor në rajonin e veriut” zbatuar nga RSL dhe mbështetur nga NED⁴⁹. Kjo shoqatë rinore me aktivitet në Qarkun e Kukësit, gjatë viteve 2010-2013, ka zhvilluar debate publike dhe diskutime në grupe të vogla, fokusuar rreth subjektit të demokracisë, të lidhura plotësisht me shqetësimet komunitare. Ata kanë mundur të nxisin aktivizimin rinor në jetën sociale përmes debateve publike, tavolinave të rrumbullakta, trainimeve, seminareve, fushatave ndërgjegjëse, shfaqjeve në rrugë dhe debateve të zhvilluara në klasat e shkollave të mesme. Këto veprime përmbajnë dhe nxisin vlera demokratike të cilat mund të përdoren dhe aplikohen nga aktor të ngjashëm në vend. Ka patur shumë raste gjatë këtij projekti, kur të rinjtë me pikpamje të ndryshe

⁴⁸ Nga intervista me Sara Zekaj nga Elbasani, anëtare e Albanian Alliance of Students AESSH, 17 Janar 2012,

⁴⁹ The National Endowment for Democracy (NED) is a U.S. non-profit soft power organization that was founded in 1983 to promote democracy. It is funded primarily through an annual allocation from the U.S. Congress, within the budget of USAID, the U.S. agency for development assistance, which is part of the U.S. State Department.

politike kanë debatuar brenda një grupi të vogël me një komunikim shumë demokratik për çështje që lidhen me komunitetet e tyre, karakteristikë shumë e ndryshme nga ajo çfarë ne ndjekim dhe dëgjojmë në Parlament nga të zgjedhurit tanë. Këto grupe të vogla mund të jenë një shëmbull i mirë për politikanët, sesi mund të komunikohet dhe të punohet sëbashku edhe kur kemi pikpamje dhe bindje të ndryshme politike.

Duke analizuar shembujt e mësipërm, aktorët e OSHC-ve dhe teorive të pjesëmarrjes, duhet të mendojmë nëse angazhimi dhe pjesëmarrja e tyre mund të ndikojë procesin demokratik në të vërtetë dhe nëse mund ta përmirësojë atë.

Nuk ka dyshim për atë se të rinjtë duhet të projektojnë të ardhmen e tyre, bazuar në ëndrrat e tyre. Eksperienca në vendet Ballkanike si ish-Jugosllavia, Rumania apo përtej , ka treguar se revolucionet e organizuara nga organizatat dhe grupet rinore kanë dhënë rezultat në demokratizmin e vendit. Nga pjesëmarrja e të rinjve në jetën sociale, ekonomike dhe politike, ndikimi në demokratizim do të sigurojë mundësi ndërhyrje për të rinjtë, një proces përfshirës vullnetar, çështje konkrete të përceptuara dhe të lidhura me të rinjtë, përgjegjësi dhe llogaridhënie, shpërndarje të pushtetit në vendimarrje, krijimin e një ndjesie të përkatësisë komunitare, pronësinë në këtë proces, siguri dhe krenari, ndarje rolesh dhe krijim mundësish, zhvillim aftësish në lidërsip, ngritjen e rrjeteve për të qenë aktiv dhe krijuar fushata të ndryshme, ndërgjegjësim inkurajues për komunitetin, përgjegjësi dhe besim tek vetja.

4.8. Pjesëmarrja e të rinjve në demokraci, mënyrat institucionale dhe të përditëshme; perspektivat ndërkombëtare

Egziston një interes në rritje në nivelin ndërkombëtar në kuptimin sesi të rinjtë marrin pjesë në demokraci, veçanërisht në kontekstin e formave tradicionale të demokracisë

pjesëmarrëse. Studimet e ndryshme në Europë dhe SHBA pohojnë se vitet e fundit të rinjtë kanë qenë më pak të angazhuar në proceset zgjedhore sesa grupi tjetër me moshë më të rritur (IDEA, 1999)(US Census, 2007). Kërkimet lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve, janëpërshtatur nga njëvarg perspektivash teorike për demokracinë dhe të tjera të lidhura me të drejtat dhe përgjegjësitë qytetare. Lidhur me të drejtat e pjesëmarrjes, në Shqipëri, të rinjtë kanë të drejtën për të votuar në moshën 18 vjeç, ndërsa gëzojnë të drejtën për tu punësuar në moshën 16 vjeç.

Sociologjia për të rinjtë ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e pjesëmarrjes rinore, duke demonstruar se të rinjtë janë shpesh të përjashtuar nga proceset sociale, më shumë sesa pa aftësi për të marrë pjesë (Wite, R & Wyn, J, 2004).

Duke përdorur një qasje të bazuar në rritjen e kapaciteteve, studiues të tjerë kanë argumentuar se përkufizimet dhe modelet e pjesëmarrjes duhet të rimendohen. Në veçanti, të rinjtë duhet të njihen për mënyrën se si dhe çfarë kontribuojnë në një mjedis social të ndryshueshëm, i karakterizuar nga rreziku dhe individualizimi (Harris, A. Wyn, J. & Younes, S., 2007). Atëherë duhet të shtrojmë pyetjen: Çfarë duhet të mendojnë të rinjtë për demokracinë? A marrin pjesë ata dhe nëse po, si? Pjesëmarrja e të rinjve në demokraci është e konceptuar në dy mënyra – përmes aktiviteteve si individ ose në mënyrë kolektive, me qëllim për të ndikuar opinionin publik dhe rezultatet politike (Collin, 2008), megjithatë, kemi përmenduar gjatë këtij studimi në kapitujt paraardhës se pjesëmarrja mund të konceptohet gjithashtu edhe si diçka e mbështetur nga qeverisja qendrore apo lokale dhe organizatat joqeveritare, përmes krijimit të strategjive dhe mekanizmave për të përfshirë anëtarët e komunitetit në vendimet e lidhura me politikat që lidhen me interesat e tyre.

Mënyrat e pjesëmarrjes institucionale

Qasja e parë lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në mënyrë institucionale ka të bëjë me “shtetësinë e detyruar” (Bennett, 2007). Kohët e fundit qeveritë e ndryshme dhe sektori joqeveritar kanë hartuar strategji për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrjepërmes formalizimit të ‘pjesëmarrjes të të rinjve’ me disa grupe ose komitete këshillimore. Shumica e këtyre rasteve në Shqipëri janë prezantuar nga sektori i shoqërisë civile, megjithatë nuk ka munguar edhe mbështetja nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Një tjetër mënyrë e pjesëmarrjes institucionale për të rinjtë ka të bëjë me procesin e votimit. Në këtë rast nuk po flasim vetëm për zgjedhjet politike, por proceset e ndryshme që lidhen kryesisht me vendimarrjen në shkolla, forumet rinore ku ata bëjnë pjesë dhe sigurisht edhe detyrimin për zgjedhjet periodike.

Mënyrat e pjesëmarrjes në jetën e përditshme

Qasja e dytë e cila lidhet me jetën e përditshme, në një farë mënyrë sfidon paradigmën e pjesëmarrjes tradicionale (O'Toole, 2003). Kjo qasje nuk ka të bëjë vetëm me aktivitetet dhe nivelin e angazhimit, por edhe me qendrimet dhe perceptimet e pjesëmarrjes me qëllim për të njohur dhe kuptuar më mirë përgjegjësinë qytetare. Mënyra e pjesëmarrjes në jetën e përditshme lidhet kryesisht me kushtet e shkollës apo procesin e edukimit, dhe mund të sjellë në një tryezë diskutime që lidhen me çështjet të cilat nuk zgjidhen vetëm nga institucionet zyrtare. Këto mënyra pjesëmarrjeje kanë shumë gjasa të përfshijnë edhe aktorët e politikës tradicionale, sikurse janë këshilltarët vendor, kryetarët e Njësive Vendore, zyrtarët e Unioneve dhe Konfederatave, gjithashtu edhe profesionistët e fushave të ndryshme, sikurse janë doktorët, mësuesit, arkitektët, kolegë të ndryshëm, miq dhe familjarë. Me pak fjalë, format e pjesëmarrjes në politikën

mikro sikurse e quan Bang, zhvillohen në fusha dhe mbi çështje që njerëzit e ndiejnë se janë të aftë të bëjnë ndryshimin (Bang, 2005).

Një tjetër mënyrë e pjesëmarrjes në jetën e përditshme lidhet me internetin dhe rrjetet sociale, duke pranuar faktin se ditët e sotme ato përbëjnë një revolucion të vërtetë për komunikimin dhe po luajnë një rol të jashtëzakonshëm në jetën sociale dhe politike të qytetarëve.

4.9. Përdorimi i medias sociale dhe pjesëmarrja e të rinjve përmes internetit.

Hyrja në tregun e mediave e rrjeteve sociale ka sjellë një transformim të madh të komunikimin publik. Përveç argëtimit dhe kulturës, të rinjtë dhe grupet rinore të organizuara po i përdorin rrjetet sociale për organizime dhe fushata të ndryshme për të ndikuar tek grupet e synuara. Sipas Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), “përdorimi i internetit në Shqipëri ka arritur në shkallën 48.1%, duke konfirmuar kështu përdorimin dhe përhapjen e madhe të medias sociale në Shqipëri. Sipas të dhënave të ITU, internetin e përdorin rreth 1.44 milionë shqiptarë, nga rreth 2.9 milion banorë që rezultuan nga regjistrimi i fundit të popullsisë (ITU, 2012)”. Nga një studim i Institutit të Shëndetit Publik⁵⁰ në Shqipëri, mbi “Sjelljet e shëndetshme të fëmijëve në moshën shkollore” rezulton se përdorimi i internetit dhe rrjeteve sociale i mban të rinjtë me orë të tëra para forumeve sociale. Megjithatë pyetja që mund të ngrihet lidhur me rrjetet sociale dhe qllimin e trajtimit në këtë studim ka të bëjë me përdorimin e tyre për qëllime të aktivizimit dhe organizimit të grupeve rinore për të ndikuar në opinionin publik. Rastet e përdorimit për qëllime organizimesh dhe protestash nuk mungojnë qoftë në nivel ndërkombëtar, sikurse ishin ngjarjet e ‘pranverës arabe’ por edhe rasti në nivel

⁵⁰ Raporti vjetor i Institutit të Shëndetit Publik për vitin 2011.

kombëtar që lidhet me ‘importin e mbetjeve të armëve kimike’ nga Siria, raste të cilat do të trajtohen më gjërë në kapitujt pasardhës.

Pjesëmarrja e të rinjve përmes internetit.

Gjatë 10 viteve të fundit media sociale online, ka ndryshuar mënyrës sesi njerëzit komunikojnë me njëri-tjetrin dhe të ndërveprojnë me zyrtarët e tyre. Media sociale është vërtet shumë e re, pasi është shfaqur vetëm dhjetë vitet e fundit përmes forumeve të ndryshme, ndër to më populloret ditët e sotme janë Facebook, LinkedIn dhe Twitter. Përveç këtyre rrjeteve sociale, sigurisht që ka edhe të tjera si Myspace, Friendster, Google+ etj, por sipas një studimi të kryer nga Sensis⁵¹ në 2012, - Facebook është rrjeti kryesor që dominon komunikimin e rrjeteve sociale, duke u përdorur nga 97% e pjesëmarrësve në rrjetet sociale, apo 6 në 10 përdorues të internetit.

Për të gjitha përdoruesit e internetit, ky mjet e ka bërë më të lehtë pjesëmarrjen në aktivitetet qytetare dhe politike. Sipas studimit të përmendur më sipër, gjysma e përdoruesve të sotëm preferojnë të marrin pjesë në jetën demokratike përmes internetit. Studimi paraqet një panoramë të një popullsie virtuale, e cila është e përfshirë në mënyrë aktive në jetën qytetare dhe politike, të cilët e shikojnë internetin si një përfitim për këtë mundësi përfshirje.

Përdorimi i internetit në Shqipëri ka arritur në shkallën 48.1%. Kjo është statistika më e fundit e publikuar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), që konfirmon një përparim të shpejt të penetrimit të internetit në shoqërinë shqiptare. Krahëuar me vitin 2007, penetrimi i internetit është rritur me tre herë, ndërsa krahëuar me vitin 2009 me rreth 2.5 herë (CIO, 2012). Sipas të dhënave të ITU, internetin e përdorin rreth 1.44

⁵¹Source – Yellow Social Media Report, Sensis, June 2012

milione shqiptarë, nga rreth 2.9 milionë banorë që rezultuan nga regjistrimi i fundit i popullsisë. Me një penetrim internetit prej 48.1%, Shqipëria paraqitet tashmë shumë afër niveleve mesatare të përdorimit të internetit në rajon, ndërkohë që është ende më poshtë se mesatarja prej 61.3% e 27 vendeve të Bashkimit Evropian.

Për shkak të rëndësisë dhe numrit në rritje të përdoruesve, ku pjesa më e madhe e tyre janë të rinjtë, gjatë këtij studimi u pyetën 60 të rinjë lidhur me mundësitë dhe pengesat që ofron interneti në pjesëmarrjen qytetare dhe atë politike. Përdoruesit e pyetur gjatë këtij studimi shprehen se nuk dëshirojnë një marrëdhënie pasive, çka do të thotë të lexosh vetëm statuset e politikanëve të tyre të zgjedhur, sikur edhe ndodh shpesh ditët e sotme. Ata dëshirojnë të komunikojnë dhe të angazhohen, të ndjekin dhe kontribojnë në debatin demokratik, duke kërkuar edhe nga politikanët një përfshirje direkte me qytetarët. Mundësia për të marrë pjesë përmes këtij mjeti të ri komunikimi është për shumicën e të rinjve, duke qenë përdorues të përditshëm të internetit në forma të ndryshme, përmes kompjuterit ose telefonit. Mjafton qetë krijohet mundësia nga ana e të zgjedhurve dhe zyrtarëve lokal për të marrë pjesë në forume për çështje që lidhen me interesat e tyre.

Sa i përket pjesëmarrjes politike dhe qytetare, 80% e të intervistuarve shprehen se nuk kanë patur mundësi të përfshihen në forume debatesh, qofshin këto politike apo komunitare deri para zhvillimit të zgjedhjeve. Interneti, për të pyeturit gjatë këtij studimi, siguron mundësi pjesëmarrje për shumicën e njerëzve, të cilët për shkaqe të shumta janë të heshtur, dhe krijon një mundësi të madhe për njerëzit për të marrë pjesë. Kur u pyetën nëse ata e shikojnë median sociale si më të dobishmen për komunikimin përmes internetit apo si një mjet për angazhimin komunitar, shumica e të intervistuarve

(55%) e vlerësojnë atë si një mjet për angazhimin qytetar, ndërsa 20% e tyre e shikojnë atë si një mjet të përshtatshëm vetëm për komunikim.

Rasti i organizimit të protestës kundër importit të armëve kimike nga Siria në muajin Nëntor 2013, është ndoshta shembulli më i mirë i përdorimit të medias sociale për qëllim të mobilizimit komunitar në mbrojtje të interesave të vendit. “Organizatorët e kësaj proteste - e cila nisi fillimisht në rrjetet sociale – kanë pohuar dhe vlerësuar faktin se protesta ishte një reagim i qytetarëve, që iu përgjigjiën ftesës së bërë përmes rrjeteve sociale dhe se tubimi nuk kishte të bënte me parti politike apo shoqata të caktuara (Zeri i Amerikës, 2013)”. Protesta fillimisht mbledhi qytetarë në Tiranë, ndërsa rrjetet sociale dhe mediat ndikuan që kjo protest e organizuar nga grupe rinore të përhapëj në qytetet kryesore të Shqipërisë, duke bërë kështu të mundur reagimin më të madh qytetar gjatë periudhës së tranzicionit i organizuar nga të rinjtë, pa mbështetje politike, dhe i aritur përmes rrjetit social.

Motivimi për tu përfshirë përmes internetit

Faktorët që motivojnë individët për tu përfshirë në jetën qytetare dhe politike variojnë sipas çështjeve dhe interesave të lidhura direkt me ta. Funkzioni publik është një ndër faktorët kryesor që ndikon në motivimin për përfshirje në debatet publike online. 65% e të anketuarve shprehënse ajo që i motivon ata për të kontaktuar të zgjedhurit lokal, kryesisht Kryetarin e Bashkisë - pasi të tjerët shumë pak komunikojnë përmes internetit - bëhet për çështje dhe interesa të lidhura direkt me ta. Tjetër argument lidhet me moshën mesatare të përdorimit të internetit, ku pjesa më e madhe që përdorin rrjetet sociale janë të moshës 14-30. Kjo moshë pjesën më të madhe të kohës së lirë e kalon në internet, prandaj edhe koha në dispozicion për tu përfshirë në debatet publike dhe

politike është e mjaftueshme. Debatet online tregojnë se çështjet e lidhura me politikën lokale dhe ato komunitare tërheqin vëmendjen e grupeve rivale mes të rinjveduke shtuar kështu numrin e përdoruesve dhe komunikimin në favor të mbledhjes së opinioneve për hartim politikash të përshtatshme nga autoritetet vendore.

Të anketuarit - të rinjë nga Kukësi - shprehen se kanë mundur të komunikojnë përmes faqes zyrtare të Bashkisë Kukës, duke e praktikuar disa herë këtë mundësi, për shkak se komunikimi ka qenë direkt me Kryetarin e Bashkisë dhe se ju është përgjigjur në kohë reale. Ata shprehen se ky është komunikimi i vetëm që kanë me të zgjedhurit e tyre, pasi pjesa tjetër e zyrtarëve, pavarësisht se janë në rrjetet sociale nuk i përdorin për çështje publike. “Këshilltarët apo zyrtarët e tjerë publik lokal, freskojnë statuset e tyre me informacione të cilat nuk provokojnë debat, dhe asnjëherë në interes të komunitetit, prandaj edhe nuk na jepet rasti të komunikojmë me këshilltarët vendor⁵²”.

Këshilltarët dhe zyrtarët lokal përballë komunikimit të rrjeteve sociale

Gjatë këtij studimi, përveç qytetarëve si përdorues të internetit janë intervistuar shtatë këshilltarë të Bashkisë Kukës dhe tre zyrtarë të institucioneve të ndryshme lokale, me qëllim për të provuar nëse interneti dhe mediat sociale kanë një rol në komunikimin mes tyre dhe komunitetit. Të gjithë pohojnë se interneti ka rritur mundësitë për një komunikim më të shpeshtë me zgjedhësit dhe përfituesit e shërbimeve, megjithatë, ata ngrejnë shqetësimin për pengesa dhe rreziqe në përdorimin e medias sociale. Të intervistuarit u pyetën se çfarë konsiderojnë si barrierat kryesore për tu përshtatur me median sociale nga ana e qeverisjes vendore, dhe se cilat janë rreziqet për qeverisjen vendore në përdorimin e kësaj media. Pengesat kryesore për t’u përfshirë lidhen

⁵²R.Omuri. 23 vjeç, i anketuar gjatë këtij studimi. Intervistë e zhvilluar në dt. 19 Mars 2013, në Kukës

kryesisht me kohën në dispozicion dhe angazhimet në punë. Neglizhenca, ishte një arsye më e vogël, e cila shpesh herë mund të sjellë pengesa në komunikimin midis dy palëve. Pengesë tjetër është edhe mungesa e njohurive nga vetë këshilltarët lokal të cilët shprehen se nuk kanë njohuritë e duhura për të përdorur internetin në komunikimin me qytetarët, por rreziku më i madh i identifikuar nga këshilltarët e intervistuar është “reagimi negativ i komunitetit gjatë debateve në forumet sociale i personave me identitet të maskuar, prishja e imazhit dhe reputacioni”:

*“Rreziku kryesor ka të bëjë me shpifjet e mundshme dhe sulmet për drejtuesit lokal të zgjedhur në forumet publike”...“Ekspozimi i keq, komentet e papërshtatshme për zyrrëtarë lokal, inatet personale dhe shpifjet, të cilat në shumicën e rasteve bëhen nga persona anonim”.*⁵³ Megjithatë, është e evidentueshme se ende nuk egzistojnë politika për të zhvilluar komunikimin midis qytetarëve dhe të zgjedhurve lokal. Për momentin, janë të rinjtë ata të cilët krijojnë mundësi dhe i shfrytëzojnë ato, për faktin e thjeshtë se janë përdoruesit më të shumtë të internetit, dhe mundësitë për të marrë pjesë në diskutime dhe forumet egzistuese është mëi madh për këtë grup social sesa për pjesën tjetër të popullsisë që kanë shumë pak mundësi dhe kohë në dispozicion për komunikimin përmes rrjeteve sociale.

Mundësitë dhe efektiviteti i përdorimit të medias sociale

Kur të anketuarit përmes internetit u pyetën nëse ata e shikonin median sociale më të vlefshme sesa atë audiovizive si mjet për mobilizimin komunitar, pjesa më e madhe (55%) e konsideronin atë si mjet shumë të rëndësishëm për angazhim dhe mundësi pjesëmarrjeje, ndërsa 20% konsiderojnë median audiovizive më të rëndësishme. Ndërsa

⁵³ Shkëputur nga pohimet e (A.D. dhe T.C), këshilltarë të Bashkisë Kukës. Intervistë e zhvilluar në dt. 24 Nëntor 2012.

komentojmë të dhënat, nuk duhet të harrojmë se mosha mesatare e të anketuarve është vetëm 22 vjeç. Duhet të pranojmë faktin, se në Shqipëri, mediat audiovizive kanë një rol të rëndësishëm tek të rriturit, për shkak të mospërdorimit të internetit. Është interesant fakti se vetë drejtuesit vendor dhe të zgjedhurit, e konsiderojnë internetin një promovues shumë efektiv për shumë çështje dhe projekte të ndryshme komunitare, megjithatë, kjo kryesisht shfrytëzohet për turizmin apo ngjarjet e rëndësishme kur kërkohet pjesëmarrja komunitare, dhe aktorët kryesor në këtë rast janë të rinjtë, të cilët jo vetëm konsumojnë informacionin për veten e tyre, por shërbejnë si shpërndarës të informacionit pa kosto. Nga intervistat me këshilltarët dhe zyrtarët e ndryshëm lokal, bëhet e ditur se as 10% e tyre nuk e përdorin median sociale për qëllime të funksionit të tyre publik, por ajo përdoret kryesisht si mjet komunikimi për stafet e brendshme ku ajo egziston. Një rast i ngjashëm është përdorimi i Skype nga stafi i Bashkisë Kukës, gjatë orarit të punës.

Për të përblëdhur gjetjet në terren dhe analizën tonë në lidhje me mundësitë e pjesëmarrjes përmes medias sociale, duhet të pohojmë se interneti e bën të thjeshtë, të lehtë dhe të lirë komunikimin për përdoruesit e sotëm. 60% e të anketuarve pohojnë se preferojnë internetin si mjet për të marrë pjesë në jetën publike dhe politike, ndërsa 40% preferojnë metodat e kombinuara, përmes kontakteve direkte dhe ato të internetit gjithashtu. Ndërsa ky komunikim vazhdon e bëhet çdo ditë dhe më i përdorshëm, vetëm një numër shumë i kufizuar ka mundur të jetë në kontakt me të zgjedhurit e tyre. Megjithatë, mundësitë për përfshirje janë të shumta, pasi komunikimin përmes internetit të jep mundësi për analiza, sondazhe të ndryshme, vlerësime, të cilat arrihen në kohë reale dhe pa koste të mëdha.

4.10. Ndryshimet sociale përmes pjesëmarrjes së të rinjve

Të rinjtë shqiptarë në ditët e sotme përballen me sfida të shumta, përfshirë këtu; papunësinë, lëvizshmërinë, mungesën e përditësimit të burimeve të informacionit për edukim, standart jetese të nivelit të ulët, korrupsion dhe mungesa e politikave rinore të qëndrueshme. Sipas një raporti të UNV⁵⁴ “të rinjtë shpesh ndihen të përjashtuar prej pjesës më të madhe të shoqërisë, pavarësisht faktit se ata përbëjnë një grup të madh shoqëror”(UNV, 2009). Raporti shpjegon se pavarësisht faktit se shumica e njerëzve i kuptojnë përfitimet e angazhimit qytetar, egzistojnë ende mentalitete për vullnetarizmin për periudhën e kohës komuniste, prandaj edhe gjenerata e vjetër nuk inkurajon të rinjtë për të kryer punë vullnetare apo për tu përfshirë në nivel lokal apo atë kombëtar (Ibid).

Ideja se të rinjtë mund dhe duhet të punojnë me të rriturit për të përmirësuar kushtet në komunitetet e tyre ka fituar terren prej kohësh. Të rinjtë kryesisht ftohen të bëhen pjesë e bordeve, të paraqesin ide dhe të mbështesin përpjekjet e grupeve të ndryshme përmes një strukture vullnetare, dhe në fakt vetë ata, pavarësisht kontributit nuk presin të pyetën. Megjithatë, sikurse ndodh me gjëra të ndryshme, nuk është e qartë pse të rinjtë duhet të inkurajohen për të marrë pjesë. Për të mbushur kohën boshe?, Për të mësuar nga njohuritë akademike dhe eksperiencia përmes punës komunitare?, Për të zhvilluar traditën e vazhdueshme?, apo Për të kontribuar tek komuniteti i tyre? Sa shpesh angazhohen të rinjtë, sepse në besojmë se ata mund të bëjnë një ndryshim të vërtetë në gjërat e rëndësishme për të rriturit? Sa herë të rriturit kanë mbështetur iniciativat rinore me ide të rëndësishme për vetë këtë grup?

⁵⁴**The United Nations Volunteers** (UNV) program is a United Nations organization that advocates the role and benefits of volunteerism for development, integrates volunteers into development programmes, and mobilises volunteers for development projects.

Për t'ju dhënë përgjigjie këtyre pyetjeve, kemi marrë mendimin e vetë të rinjve, duke mbledhur histori të ndryshme për angazhimin e tyre për ndryshime sociale. Ndryshimet sigurisht që kërkojnë kohë, por pavarësisht zhvillimeve të ndryshme social ekonomike dhe politike, lëvizjet e ndryshme rinore në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit kanë treguar se mund të sjellin ndryshime të rëndësishme.

Një nga organizatat me kontribut të rëndësishëm në nivel kombëtar është Lëvizja Mjaft e themeluar në vitin 2003. Lëvizja Mjaft! Gjatë një periudhe 4-5 vjecare, kohë kjo kur ishte shumë aktive dhe e prekshme nga qytetarët në mbarë vendin, promovonte qytetari aktive, demokracinë, ndryshimet e arritshme, komunitete të forta, mundësi të barabarta, solidaritet, vullnetarizëm dhe debat të fortë, duke inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në të dy nivelet, atë lokal dhe kombëtar dhe duke riparuar modelin e protestave në një mënyrë shumë qytetare dhe kreative. Kjo mbetet një nga lëvizjet më angazhimin më të madh qytetar të periudhës së tranzicionit, duke shtrirë degët e saj në 18 qytete përmes ngritjes së klubeve qytetare, të cilat provokuan ndryshim në nivel lokal duke arritur një anëtarësi prej 8000 personash, të cilët merrnin pjesë në mënyrë aktive në ngjarjet e organizuara nga Mjaft!, dhe mbi 1000 vullnetarë të angazhuar direkt në përgatitjen e aktiviteteve të shpeshta në të gjithë vendin (MJAFT!, 2010).

Përveç Lëvizjes Mjaft!, në vend egzistojnë grupe të tjera rinore të cilat përmes aktiviteteve dhe angazhimit të tyre të përditshëm ndërmarrin hapa të rëndësishëm për të përmirësuar kushtet e tyre dhe të komuniteteve ku ata janë pjesë. Në kapitull e katërt, kemi rastet e grupeve dhe shoqatave rinore lokale të vëzhguara në rrethet Fier, Tiranë, Shkodër, Elbasan, Lezhë, Pukë, Vlorë dhe Durrës, ndërsa është marrë si rast studimor një organizatë rinore shumë aktive, e themeluar në Kukës prej vitit 2001, “Rinia në

Sipërmarrjen e Lirë” RSL⁵⁵ e cila promovon aktivizim qytetar, debat demokratik, pjesëmarrje në vendimarrje lokale, barazi gjinore dhe edukim joformal për të drejtat e njeriut. Drejtues dhe aktivistë të kësaj organizate të angazhuar në periudha të ndryshme janë intervistuar duke sjellë në vëmendje aktivizimin e tyre dhe ndryshimet sociale përmes kontributit të grupeve rinore të përfshira në këto iniciativa lokale.

4.10.1 Aksione rinore me impakt komunitar

Pyetjes nëse mbajnë mend gjatë periudhës së angazhimit të tyre me grupet rinore lokale që të kenë ndikuar në ndryshime sociale sado të vogla të jenë ato, apo nëse kanë patur impakt në komunitet dhe mbështetje komunitare për iniciativat e tyre, i japin përgjigje bazuar në praktikat dhe eksperiencat e tyre duke përshkruar aksionet e ndryshme.

Hedhje kripe në trotualet e mbuluara me akull:

“Gjatë periudhës së dimrit, në vitin 2005 në Kukës, përveç rrugëve të mbuluara me akull ishin edhe trotualet, të cilat përbënin një rrëzik për jetën e kalimtarëve. Ato ditë, mbaj mend se jemi organizuar nga drejtuesit e organizatës dhe kemi porositur thasë me kripë. Aksioni ka vazhduar në trotualet kryesore të qytetit, duke përfituar kështu një mbështetje të madhe qytetare dhe reagimin e menjëhershëm të qeverisjes vendore e cila

Pjesëmarrja e të rinjve dhe ushtrimi i përgjegjësisë është thelbësorejo vetëm për faktin se do jenë përfitues, por sepse shumica e tyre luajnë role të rëndësishme në komunitetet e tyre.

deri atë ditë nuk kishte reaguar. Prej asaj kohe, komuniteti lokal na ka mbështetur në shumë iniciativa lokale, dhe shpesh here e kemi ndjere veten të detyruar për të marrë përsipër aksione vullnetare, me qëllim për të

përmbushur pritshmëritë e komunitetit, por edhe për të rritur angazhimin e grupeve rinore, gjë e cila ka ndodhur. Impakti ka qenë i menjëhershëm, përmes reagimit qytetar,

⁵⁵www.rsl-al.org ose <https://www.facebook.com/rsl.kukes>

reagimit të institucioneve përkatëse të cilat e kishin për detyrë mirëmbajtjen e rrugëve, por edhe nga vetë banorët⁵⁶”

Protesta për mungesën e energjisë elektrike:

“Kukësi, më shumë se asnjë qytet tjetër në Shqipëri ka vuajtur ndërprerjet e energjisë elektrike, pavarësisht se banorët e këtij qyteti kishin tokat e përmbytura në liqenin e Fierzës, i cili vazhdon të prodhojë energji për të gjithë vendin. Klubi Qytetar Mjaft! në

Të rriturit duhet të kenë më shumë besim tek të rinjtë, ndërsa mbështetja ndaj tyre nuk duhet vetëm morale, por edhe financiare. Ne duam të vendosim vetë për aktivitetet dhe programet që lidhen direkt me ne.

Kukës, në bashkëpunim me shoqatën lokale RSL, gjatëperiudhës së parë të vitit 2004 organizuan disa protesta qytetare për të ngritur zërin ndaj padrejtësisë që lidhej më ndërprerjen e energjisë në mënyrë kolektive dhe faturimet afrofe të asaj kohe. Protesta e parë jopolitike, me një pjesëmarrje masive qytetare e

udhëhequr nga drejtues të grupeve rinore, solli një ndryshim të madh në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe aktivizimin për çështje komunitare. Kanë qenë ditë me emocione, shumë të ngarkuara me organizimin e protestave, por kemi marrë mbështetjen e qytetarëve për reagimin ndaj padrejtësive⁵⁷” Përgesë e faturave të energjisë elektrike: “Unë jam përfshirë me grupet rinore prej kohës së gjimnazit, ndërsa koha më aktive ka qenë kur u aktivizova me shoqatën RSL në Kukës. Jam përfshirë në fushata të ndryshme në nivel lokal, por një ndër ato që më ka bërë përshtypje dhe mendoj se ka sjellë një ndryshim social ka qenë demonstrimi nga një grup të rinjesh më librezat e energjisë elektrike drejtuar sportelit të KESH për të paguar fatuarat e rradhës, të cilat në Kukës nuk paguheshin për shkak të mungesës së energjisë elektrike. Unë mendoj se çdo

⁵⁶Nga intervista e realizuar në 6 Qershor 2013 me Gazmend Dulla, ish-aktivist dhe anëtar i shoqatës “RSL” gjatë periudhës 2001 – 2009.

⁵⁷Shkëputur nga intervista e realizuar në 7 Qershor 2013, me B.Veliu. ish-aktivist i Klubit Qytetar Mjaft Kukës dhe anëtar i shoqatës RSL.

person ka të drejtë të përfitojë shërbimet bazike të nevojshme për jetesë, por gjithashtu jam i ndërgjegjshëm për faktin se ne kemi edhe përgjegjësi për të përmbushur detyrimet si qytetar. Kjo fushatë, në të cilën kam qenë i përfshirë, kishte të bënte direkt me rritjen e përgjegjësisë qytetare së pari, për të kërkuar edhe shërbimet që na përkasin më pastaj. Pavarësisht faktit se të rinjtë në këtë rast nuk

ishin kryefamiljarë, ky ishte një gjest qytetarie me qëllimin e mirë për të ftuar të rriturit në një bashkëpunim të mëtijshëm. Ky aksion solli ndryshim social në perceptimin e detyrimeve dhe mbështetjen e KESH për një bashkëpunim

Puna me të rinjtë ka qenë sfiduese dhe shpërblyese në të njëjtën kohë. Kërkon një durim të madh, besim të patundshëm dhe energji të pashtershme, por nga ana tjetër, eksperiencia të ofron një kënaqësi të jashtëzakonshme për të rindërtuar dhe rivendosur besimin për të ardhmen.

komunitar për shërbime më të mira⁵⁸”.

Aksionet për pastrimin e Liqenit të Fierzës dhe qytetit në ditën e ambjentit:

“Përfshirja ime në aksionet vullnetare promovuese ka filluar gjatë periudhës së angazhimit me Ambasadorët e Natyrës, për të vazhduar më shoqatën RSL Kukës. Kam patur më shumë mundësi angazhimi se një pjesë e mirë e të rinjve në Kukës në aksionet qytetare, për shkak se jam trajnuar në mbrojtjen e ambjentit, të drejtat e të rinjve dhe mbrojtje ndaj HIV/AIDS. Eksperiencia në pastrimin e Liqenit të Fierzës, pjesën që

Tani që kujtoj ato ditë të ngarkuara, me aksione vullnetare, pranoj faktin se kanë ndryshuar mënyrën e reagimit qytetar ndaj padrejtësive, pavarësisht nivelit të ulët të besueshmërisë për zgjidhjen e problemeve.

ndodhet në Kukës, dhe gjatë Ditës Ndërkombëtare të Tokës, mendoj se ka ndikuar tek komuniteti lokal për një ambjent të pastër dhe mbrojtje të tokës.

Aktivitetet me pjesëmarrje të rinjë, janë transmetuar për fat të mirë edhe nga media lokale, prandaj edhe impakti ka qenë më i madh. Ndërgjegjësimi për ambjentin e pastër

⁵⁸Nga intervista e realizuar në 5 Qershor 2013 me D. Hoxhaj, ish-aktiviste dhe anëtare e shoqatës “RSL” Kukës gjatë periudhës 2004 – 2007.

ka filluar tek zona e banimit, me miqtë dhe familjarët, për ta shpërndarë mesazhin tek të tjerët. Mendoj se jo vetëm të rinjtë mund të sjellin ndryshime sociale, për faktin se ata janë më së shumti të angazhuar në programet vullnetare, ndërsa të rriturit janë të ngarkuar me punë, duke shtuar edhe mentalitetin e gabuar për punën vullnetare⁵⁹”

Promovimi i turizmit në Qarkun e Kukësit:

“Nga viti 2009 dhe deri këtë verë (2013), kam marrë pjesë nëkampingjet verore të zhvilluara nga shoqata lokale RSL në Kukës. Më përpara nuk e kisha imagjinuar se mund të akomodoheja në çadër kampingu në një zonë malore, për shkak të frikës,

Fillimisht më ka mbështetur një mësues për të marrë pjesë në aktivitete shoqërore, pastaj ka qenë shoqëria dhe familja që ma mbështetur. Mendoj se roli im në komunitetin lokal ka një impakt në komunitet dhe mbështetet nga të rinjtë.

por edhe për kushtet e rehatshme që isha mësuar në shtëpi. Kemi udhëtuar në zona të ndryshme turistike në Qarkun e Kukësit me një grup nga 25 deri në 35 persona të moshës 16 – 25 vjeç. Përveç kënaqësisë që kam përfituar gjatë kësaj kohe, kam mësuar shumë nga eksperiencat e ndryshme sociale të të rinjve, pjesë e këtij grupi dhe ndiej një dëshirë për të qenë aktiv në nivel lokal. Jam i bindur se aktivitetet promovuese të turizmit do të sjellin më shumë turistë dhe një ndërgjegjësim më të madh për banorët dhe komunitetin lokal për të gjitha pasuritë natyrore që kemi, por që nuk i shfrytëzojmë⁶⁰”

“**Nga eksperiencia ime** në punën e përditshme si drejtues i një organizate lokale që merret me edukimin joformal të të rinjve, duke u fokusuar kryesisht në nxitjen për pjesëmarrje aktive në vendimarrje; trainime; shkëmbime rinore; fushata të ndryshme ndërgjegjëse; duhet të pranoj faktin se kam përjetuar eksperiencë të jashtëzakonshme

⁵⁹Nga intervista e realizuar në 6 Qershor 2013 me Dorian Gjata, aktiviste dhe drejtuese e shoqatës “RSL” Kukës gjatë periudhës 2008 – 2013.

⁶⁰ Shkëputur nga intervista e realizuar në 9 Qershor 2013, me Vladimir Gashi, vullnetar dhe aktivist i shoqatës RSL dhe drejtues i FRPD Kukës

duke njohur të rinjë të motivuar dhe me përgjegjësi. Jam i bindur, pavarësisht se ndryshimet e vogla mund të jenë të padukshme në shikim të parë, për faktin se njerëzit kanë shumë halle dhe probleme të tjera, por aksionet vullentare dhe pjesëmarrja e të rinjve në nivel komunitar sjell ndryshime të rëndësishme. Gjithashtu, dua të shtoj se të rinjtë nuk duhet të përdoren vetëm për të promovuar iniciativat vendore, por atyre u takon të marrin përgjegjësi dhe pushtet për çështje që lidhen direkt me interesat e tyre⁶¹”.

Histori të tilla, të treguara nga aktivistët përshkruajnë punën dhe rolin e grupeve rinore në komunitetet lokale në Qarkun e Kukësit, dhe sigurisht që duhet të frymëzojnë të rinjtë dhe komunitetet e ndryshme në Shqipëri. Pavarësisht kontekstit lokal, ndryshimet janë të prekshme sa herë ka pjesëmarrje, prandaj edhe kërkohet një bashkëpunim dhe besim më i madh nga të rriturit dhe institucionet vendore në mbështetje të këtyre iniciativave që promovojnë ndryshime sociale dhe aktivizim qytetar. Të rinjtë vetë shprehen se janë të gatshëm për pjesëmarrje dhe angazhimi nuk ka munguar asnjëherë për sfidat e reja. Pikërisht, përpjekjet e përmendura më sipër nga të rinjtë përmes aksioneve domethënëse, janë jo vetëm një mbështetje për shoqatat dhe grupet ku janë përfshirë, por ata krijojnë impakt tek komuniteti ku bëjnë pjesë. Të rinjtë kanë nevoja thelbësore dhe të drejtë për të marrë pjesë në zhvillimin komunitar, dhe sigurisht që duhet të pranojmë faktin se ka ende shumë punë për të bërë për të siguruar që të rinjtë të kenë zërin e tyre në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre.

⁶¹Shkëputur nga intervista e zhvilluar në 9 Shtator 2013, me drejtuesin e shoqatës “Rinia në Sipërmarrjen e Lirë” Kukës, Z. Lavdrim Shehu.

4.11. A janë të rinjtë të interesuar për ndryshim social?

Qëllimi i pjesëmarrjes publike është i pakufizuar, pasi qytetarët duhet të kenë të drejtë për t'u përfshirë në vendimet që kanë lidhje me një sërë veprimtarish, politikash dhe bërjen e planeve apo ligjeve, për sa kohë ata do të preken nga këto masa. Përderisa veprimtaritë e shumta të ndërmarra nga të rriturit kanë një ndikim të madh në jetën e të rinjve, atëherë të gjithë pranojmë faktin se duhen ofruar dhe krijuar mundësitë për të shprehur mendimin dhe për të marrë pjesë të rinjtë.

Gjatë analizës së deritanishme dhe pas gjetjeve në terren, kemi mundur të sjellim argumenta të ndryshëm lidhur me pjesëmarrjen e të rinjve në grupet e vogla komunitare, prapëseprapë, ne ende nuk i kemi dhënë përgjigje një pyetje që ngrihet prej fillimit të këtij studimi, nëse të rinjtë janë të interesuar për pjesëmarrje dhe ndryshim social?

Gjatë intervistave të kryera në terren, kemi mundur të bisedojmë edhe me të rritur për të marrë perceptimin e tyre lidhur me pjesëmarrjen dhe ndryshimet sociale që të rinjtë mund të sjellin në jetën komunitare. Për t'u shënuar janë disa gjetje të cilat do ti sjellim në vijim të këtij kapitulli. Një punonjës pranë qeverisjes vendore, me eksperiencë të gjatë punë, shprehet se “të rinjtë e sotëm nuk janë të motivuar për t'u përfshirë në jetën publike. Ata preferojnë ta kalojnë kohën me lojërat elektronike, rrjetet sociale, internetin dhe telefonat⁶²”

Komenti i mësipërm, nuk është vetëm mendimi i të intervistuarit, pasi kjo gjë haset edhe në debatet e sotme mediatike, të cilat shpesh herë i përshkruajnë *të rinjtë* si të ngurtë nga ana sociale, të mbyllur në grupin e tyre, me pak ose aspak interes për zhvillimet

⁶²Shkëputur nga intervista me P. Z. punonjës i administratës së Qeverisjes Vendore në Kukës. Intervista e kryer 21 Qershor 2013.

sociale dhe kryesisht proceset që lidhen me politikën. Është e vërtetë se një pjesë e madhe e të rinjve në moshën mbi 18 vjeç nuk marrin pjesë në votime dhe janë shumë pak të interesuar për zhvillimet politike, por sikurse Roger Hart sugjeron në studimin e tij *“Shkalla e Pjesëmarrjes”*, të rinjtë shprehin interes të madh për çështjet politike dhe janë vazhdimisht në kërkim për mënyra të ndryshme për të shprehur idetë e tyre. Hart pohon se mungesa e interesit nga ana e të rinjve për procesin e votimit, nuk nënkupton se të rinjtë janë apatik: “në kundërshtim me portretizimin e njerëzve, kjo gjeneratë nuk kërkon të distancohet nga komuniteti, por janë në kërkim të mënyrave të reja dhe dalluese për tu lidhur me njerëzit dhe çështjet që i rrethojnë ata (Hart, 1997)”.

Në aspekte të rëndësishme, reflektohet një nivel i ulët i pjesëmarrjes nga të rinjtë. Megjithatë, pohimet e vetë të rinjve zbulojnë një grup nevojash, të cilat kërkojnë metoda të reja për ta bërë pjesëmarrjen tërheqëse dhe kuptimplote. Megjithatë para se të hedhim dyshimet se të rinjtë nuk janë të interesuar për pjesëmarrje dhe ndryshim social, duhet të bëjmë kujdes që të mos kufizohemi vetëm tek disa tregues dhe komentet në mediat e sotme.

Gjetjet nga intervistat e mësipërme tregojnë qartë se aktivistët e rinj kanë ndërmarrë role në aspekte të ndryshme të jetës së tyre sociale dhe komunitare. Sipas pohimeve, ata jo vetëm tregojnë për një angazhim serioz, por edhe për kuriozitetin në funksionimin e botës rreth tyre. Këto gjetje, i përforcon edhe pohimi tjetër i një punonjësi rinor me një eksperiencë të gjatë në fushën e shoqërisë civile duke treguar për një aktivist të zellshëm:

“Një aktiviste e re, e lidhur ngushtë me çështjet e ambjentit që kur ishte fëmijë, por që nuk kishte dijeni sesi të angazhohej e të bënte diçka për

lagjen ku banonte, inkurajohet nga një mësues i shkollës së mesme ku ajo studionte për të marrë pjesë në aktivitete vullnetare me forumet rinore. Vajza gjeti mbështetjen dhe aktivistë të tjerë të rinj, të cilët ishin po aq të inkurajuar, duke e frymëzuar atë me përkushtimin dhe pasionin e tyre për të vazhduar pjesëmarrjen aktive në jetën komunitare. Ajo u bë një aktiviste e dalluar, ndërsa sot vazhdon të merret me çështjet të ndryshme sociale⁶³.

Të rinjtë kanë interes dhe kapacitete për të qenë agjentë të ndryshimit social, dhe shpesh ata janë të motivuar, por ndodh që nuk kanë hapësirë – fizike, politike, shoqërore apo burimet financiare, teknike – që nevojiten për të vepruar.

4.12. Pjesëmarrja si kontribut vullnetar

Egzistojnë lidhje shumë të rëndësishme midis vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes; organizatat komunitare shpesh mundësojnë rritjen e aftësive dhe të eksperiencës për drejtuesit e tyre lokal, duke ndikuar kështu direkt në pjesëmarrjen politike. Niveli i ulët i pjesëmarrjes qytetare nënkupton gjithashtu edhe mundësi më të vogla të adresuara për interesat dhe nevojat e banorëve të atij komuniteti tek qeverisja e tyre lokale. Përkufizimi ynë për vullnetarizmin, lidhet me ato aktivitete që njerëzit ndërmarrin për grupet e ndryshme komunitare pa shpërblimin e punës së tyre përmes pagesës apo ndonjë forme tjetër shpërblimi materiale. Kështu pra, vullnetarizmi përfshin aktivitetet në emër të grupeve fetare, shoqatave të prindërve & mësuesve dhe pleqësitë e lagjeve. Duhet të pranojmë faktin se ky përkufizim është i kufizuar për shkak të fokusit të këtij studimi i cili lidhet me pjesëmarrjen komunitare.

⁶³ Shkëputur nga intervista e dt. 9 Shtator 2013, me Z. Lavdrim Shehu, tranier dhe drejtues i projekteve të ndryshme, me eksperiencë lokale dhe ndërkombëtare mbi dhjetë vite.

Duke trajtuar *pjesëmarrjen* si një fenomen social, ku gjithmonë kërkohet prezenca e njerëzve për të realizuar aksionet e ndryshme, harrojmë të sjellim në vëmendje se shpesh herë mundësia e pjesëmarrjes lidhet edhe me faktorin kohë. Të marrësh pjesë në aksione të ndryshme në komunitet, do të thotë të lësh pas dore detyrime të tjera të cilat mund të jenë po aq të rëndësishme sa edhe pjesëmarrja në një tubim, tryezë, debat, votim, fushatë apo argëtim⁶⁴. Në pjesën më të madhe të rasteve, pjesëmarrja në aktivitetet e ndryshme komunitare, publike dhe politike nuk kompesohen për kohën e shpenzuar. Kjo është e drejtë kur ndihmojmë të tjerët, pasi vullnetarizmi këtë kuptim ka. Nëse sjellim në vëmendje angazhimin e grupeve apo individëve të veçantë gjatë fushatave elektorale, kohën e tyre të vënë në dispozicion të forumeve politike, kandidatëve apo komisioneve të ndryshme, duhet të pyesim nëse ky kontribut merret në konsideratë si vullnetarizëm.

Dëshira dhe interesi për çështje që lidhen direkt me pjesëmarrësit është treguesi i parë për të marrë pjesë vullnetarisht në aksione të ndryshme. Kjo është gjetje nga analiza e 128 personave të anketuar gjatë këtij studimi. Një tjetër opinion interesant i përfituar nga intervistat dhe anketat gjatë këtij studimi lidhur me ditën e zgjedhjeve, rezulton se 85% dëshirojnë që dita e zgjedhjeve nuk duhet të mbahet gjatë ditës së Shtunë apo e Dielë, sikurse janë mbajtur zakonisht, por një ditë jave dhe e paguar për administratën⁶⁵. Kjo për shkak se politikanët nuk mendojnë për ditën e pushimit, si kohë e lirë që njerëzit duhet ta shpenzojnë për vete dhe familjet e tyre. Të anketuarit pohojnë gjithashtu se nëse dita e zgjedhjeve do të ishte një ditë jave e Hënë – e Premte, atëherë edhe përqindja e votuesve do të rritej.

⁶⁴ Participation and Activism: Young People shaping their worlds. Kalbir Shukra and Katy Brown. Youth & Policy, 2012.

⁶⁵ Nga intervista e kryer në 15 Maj 2013, në Kukës, E. Cahani, Forumi Rinor i PD-s.

Gjatë këtij studimi, në kapitujt paraardhës, është theksuar dhe argumentuar niveli i ulët i pjesëmarrjes, por pa përmendur faktorin kohë dhe kontributin vullnetar që secili prej pjesëmarrësve dhuron në aksionet komunitare. Të marrësh pjesë në një fushatë ndërgjegjëse kërkohet kohë dhe përkushtim, e njëjta gjë vlen edhe për fushatën zgjedhore apo edhe ditën e votimit, sidomos kur kjo qëllon ditën e pushimit dhe njerëzit në vend që kohën ta shpenzojnë me familjet e tyre, duhet ta shpenzojnë në shërbim të një interesi komunitar. 25% të anketuarve gjatë këtij studimi, e pohojnë faktin se nuk kanë votuar edhe për shkak të ditës së pushimit kanë preferuar ta shpenzojnë me familjen.

Studiues të ndryshëm të cilët kanë trajtuar sjelljen politike, përcaktojnë angazhimin qytetar në përfshirjen e aktiviteteve që janë në mënyrë të veçantë të lidhur me politikën – procesin e votimit, pjesëmarrja në debatet publike dhe petitionet për zyrtarët e zgjedhur – gjithashtu edhe aktivitetet e lidhura me pjesëmarrjen vullnetare në sektorët e shoqërisë të cilët janë jashtë fushës së politikës, familja dhe tregu (Putnam, 1993). Për një pjesë të vogël të individëve, angazhimi në vullnetarizëm komunitar shërben si një zëvendësim për pjesëmarrje politike; kjo vlen veçanërisht për të rinjtë, të cilët priren të favorizojnë komunitetin me shërbimet gjatë pjesëmarrjes politike si një mjet i drejtëpërdrejtë për të përmirësuar komunitetet ku bëjnë e tyre (Longo, N. & Meyer, R., 2006).

Pjesëmarrja në aktivitetet komunitare bashkon njerëzit në politikë në mënyra të ndryshme; ndihmon individët të zhvillojnë aftësitë e tyre, të cilat janë të lidhura me politikën; i siguron njerëzve *mundësi për tu mobilizuar* përmes fushatave zgjedhore, duke dhënë kontributin e tyre vullnetar (Rosenstone and Hansen, 1993). Prandaj, për shumë arsye, për të kuptuar rolin e pjesëmarrjes në angazhimin komunitar, kërkohet një

vëmendje ndaj përfshirjes në aktivitetet që janë të lidhura veçanërisht me politikën, gjithashtu edhe ato që klasifikohen si “kapital social” apo “aktivitete vullnetare”.

Sa i përket vullnetarizmit në Shqipëri, puna vullnetare përgjithësisht deri në fillimi të shekullit XX trajtohej si ndihme që duhej ti jepej çdo individ i rritur familjarëve të tij, anëtarëve të fisit, miqve, fqinjëve e deri të njohurve, madje edhe të panjohurve, veçanërisht kur këta ndodheshin në vështirësi ose pësonin fatkeqësi (Dervishi, 2004). Ndërsa gjatë periudhës komuniste, veçanërisht gjatë viteve 1980-90, puna vullnetare u kthye në një detyrim për të ndihmuar ekonominë e rrënuar të asaj kohe duke shpërdoruar kohën e lirë të qytetarëve për disa degë të ndryshme të industrisë, infrastrukturës dhe ekonomisë, për të përmendur këtu aksionet vullnetare për ndërtimin e hekurudhave, hidrocentralet, apo ato në bujqësi. Detyrimi për të kryer punë vullnetar gjatë periudhës komuniste ka ndikuar dukshëm edhe për periudhën post komuniste, duke injoruar deri në masë të madhe bojkotimin e vullnetarizmit në komunitet dhe përtej tij. Një vështrim në të kaluarën e Shqipërisë nxjerr në pah se ndjenja e vullnetarizmit dhe ajo komunitare nuk ka qenë e zhvilluar edhe para ardhjes së komunistëve në pushtet. Një individ kishte më tepër gjasa të kontribonte për komunitetin kur ia kërkonte i pari i fisit apo i fshatit se sa për shkak të ndjenjes së të qenit pjesë e komunitetit⁶⁶.

Duke u rikthyer në ditët e sotme, mund të thuhet se mungesa e ndjenjes së vullnetarizmit në funksion të përmirësimit të komunitetit, është një handikap i madh për zhvillimin e Shqipërisë. Për të ilustruar këtë vlerësim na vjen në ndihmë studimi i Robert Putnam, “Çfarë e bën demokracinë të funksionojë”, i cili merr në fokus krahasimin e rajoneve të ndryshme në Itali. Gjata analizës Putnam konstaton se

⁶⁶Nga intervista me Ismet. B, datë 27 Tetor 2012, aktivist i Shoqërisë Civile, Kukës

diferencat midis rajoneve të ndryshme nuk mund të shpjegohen vetëm me diferencat në kapitalin natyror, por është kapitali social ai që ka ndikuar më shumë në zhvillimin e diferencave të rajoneve. Dhe ajo që Putnam quan kapital shoqëror nuk është tjetër gjë veçse prania e pjesëmarrjes vullnetare dhe ndjenja komunitare në një krahinë të caktuar (Putnam, 1993).

Realiteti i sotëm shqiptar, ku pjesëmarrja komunitare për interesa të përbashkëta pothuajse nuk egziston, ka një domethënie të madhe që mund të lidhet me analizën e Putnam. Kapitali shoqëror dhe ndjenja komunitare nuk kanë nivelin e duhur për të bërë gjërat të lëvizin, për sa kohë secili sheh punën dhe interesat personale, duke lënë në dorë të politikanëve qeverisës përmirësimin e gjithçkaje.

Një studim i kryer nga Fondacioni “Fridrih Ebert” i publikuar në fillim të vitit 2013, ka trajtuar në detaje psikologjinë dhe mendimet e të rinjve shqiptarë, duke i intervistuar për disa çështje kryesore, ndër to edhe pjesëmarrja vullnetare në komunitet. Sipas këtij studimi, vetëm 16 % e të anketuarve shprehin dëshirë për pjesëmarrje vullnetare, ndërsa pjesa tjetër, pjesëmarrjen përmes organizatave të ndryshme qofshin këto politike apo civile, e shikojnë si burim të ardhurash dhe mjet punësimi (FES, 2013). Sipas këtij studimi, rezulton se të rinjtë shqiptarë janë aktiv në zgjedhje por jo vullnetarë. Ata marrin pjesë nëpër fushata zgjedhore dhe 93% e tyre votojnë rregullisht, por vetëm 3% e tyre ndjen të përfaqësuar në politikë prej të rinjve (Ibid).

Pjesëmarrja qytetare ka një domethënie të madhe në zhvillimin komunitar dhe të ardhmen e vullnetarizmit. Pjesëmarrja qytetare, e njohur gjithashtu si vullnetare, ka të bëjë me anëtarësimin dhe përfshirjen në grupe komunitare, qofshin këto pleqësi lagjesh, qendra rinore, këshill prindërisht etj. Analistët e politikave kanë filluar të fokusohen tek

vullnetarizmi për disa arsye; ndoshta më kryesorja se pabarazitë në grupet vullnetare mund të çojnë në ndryshime të vazhdueshme në pjesëmarrje dhe ndikim të politikë⁶⁷. Shumë analistë janë të shqetësuar se niveli në rënie i pjesëmarrjes vullnetare do të çojnë në uljen e vazhdueshme të interesit publik në të ardhmen. Disa prej tyre gjithashtu besojnë se nivelet e ulëta të vullnetarizmit do të ndikojnë negativisht në sigurimin e të mirave publike dhe shërbimeve komunitare, veçanërisht për skurtimin e shpenzimeve qeveritare për shërbimet sociale dhe ato për shoqatat vullnetare (Putnam, 1993) (Ramakrishnan and Baldassare, 2004).

Të dhënat e marra nga intervistat dhe anketat në rajone të ndryshme në Shqipëri gjatë këtij studimi tregojnë se pjesëmarrja është më interesante dhe ka një interes shumë më të madh për proceset politike sesa për ndonjë aktivitet tjetër komunitar. Në rajonet e Tiranës, Kukësit, Vlorës dhe Fierit, të anketuarit pohojnë se janë mbledhur disa herë për çështje politike, kryesisht gjatë fushatave elektorale, ndërsa nuk janë mbledhur për çështje komunitare. Një rast i veçantë lidhet me qytetin e Kukësit në verën e vitit 2012, pavarësisht përpjekjeve të disa grupeve rinore lokale për të organizuar protesta qytetare në lidhje me mungesën e ujit, ishte e pamundur pjesëmarrja qytetare duke dështuar për disa herë në përpjekjen për të ndikuar në përmirësimin me ujë të pijshëm⁶⁸.

4.13. Mobilizimi dhe pjesëmarrja e grupeve rinore

Mobilizimi social dhe angazhimi qytetar në thelb janë rrugë përmes të cilave kanalizohet përfshirja e qytetarëve në vendim-marrjet politike. Pjesëmarrja në demokraci ka për qëllim të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë pjeshtarët e një shoqërie për të kontribuar realisht në procesin e marrjes së vendimeve nga autoritetet

⁶⁷ Youth Policy in Albania. Council of Europe, 2009.

⁶⁸ Shkëputur nga takimi me grupin e fokusit të shoqatës RSL Kukës, zhvilluar në dt. 17 Gusht 2013.

përgjegjëse, si dhe t'u garantojë atyre një akses dhe përfitime të barabarta nga shërbimet që ofrohen nga institucionet e shtetit.

Duke analizuar pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë këtij studimi, dallohet qartë se për të mundësuar pjesëmarrjen kërkohet angazhimi i dy palëve, *pushtetit* dhe *komunitetit*. Detyrimi për të provuar një qeverisje të mirë bie mbi qeverinë, e cila përmes votës demokratike merr përsipër të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët e saj, megjithatë edhe qytetarët janë aktor shumë të rëndësishëm, të cilët duhet të luajnë një rol të madh për të garantuar përfshirjen e tyre aktive në proceset nga të cilat merren vendime që ndikojnë në jetën e tyre. Për të qenë aktiv qytetarët së pari duhet të informohen për çështje që lidhen me interesat e tyre. Prej këtu fillon edhe mobilizimi komunitar, duke siguruar minimumin e pjesëmarrjes që është opinion qytetar.

Hantington e përkufizon mobilizimin social si 'dukurinë që shfaqet tek masa e individëve për të zgjidhur interesat e tyre nëpërmjet aksioneve politike, ndryshe nga periudhat e kaluara ku interesi i masës së gjerë për pjesëmarrjen në hartimin e politikave dhe në qeverisje ishte i papërfillshëm' (Filo, 2011). Për studiues të tjerë 'Mobilizim social do të thotë të organizosh individët në grupe komunitare për të arritur qëllime dhe objektiva specifike, në përputhje me nevojat lokale të identifikuara dhe objektivat e programit apo të projektit. Është një përpjekje për të bashkuar dhe rritur kapacitetet njerëzore...' 'Mobilizimi i mirë social fuqizon pjestarët e grupit përmes proceseve demokratike të pjesëmarrjes dhe veprimit, si dhe përmes ngritjes së kapaciteteve' (Biggs, S, Gurung, S, Messerschmidt, D., 2004).

Ndryshe nga mobilizimi i grupeve komunitare në moshë të rritur, çka ka treguar se pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme ka rezultuar jo i suksesshëm, mobilizimi i

grupeve rinore është i mundshëm dhe i arritshëm⁶⁹. Angazhimi dhe pjesëmarrja e grupeve rinore, siguron rritje të kapaciteteve, mundësi e mirë kjo për të siguruar interesin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në dialogun për çështje lokale. Një rol të rëndësishëm në këtë mes kanë mobilizuesit social, punonjësit social, lidhësi i grupeve rinore, të cilët sëbashku krijojnë premisat për të krijuar lidhet midis qytetarëve dhe zyrtarëve, duke rritur kapacitetet e grupeve rinore, për të adresuar nevojat komunitare tek aturoitetet vendore. “Mobilizimi i individëve dhe grupeve rinore në nivel lokal është e mundur dhe ka impakt të drejtëpërdrejtë në shërbimet komunitare. Punonjësit social, drejtuesit e shoqatave dhe forumeve rinore mund të bëjnë mobilizimin e të rinjve përmes informimit për çështje të rëndësishme komunitare, organizimin e grupeve të interesit dhe trainime për rritjen e kapaciteteve për çështje të veçanta, duke nxitur kështu diskutimin në grup⁷⁰”.

Për angazhimin qytetar sigurisht që egzistojnë mekanizma ligjor, duke përcaktuar qartë detyrimet e autoriteteve vendimarrëse në nivel lokal të cilë duhet ti përdorin këto mekanizma për të mundësuar konsultimin me grupet komunitare, megjithatë duket se në Shqipëri këta mekanizma nuk janë funksional dhe shpesh kanë rezultuar joefektiv. Njësoj si politikat dhe strategjitë e importuara nga vendet e zhvilluara - të analizuara në kapitullin e parë - edhe mekanizmat për mobilizimin qytetar janë importuar nga vende me eksperiencë pozitive, por që nuk kanë gjetur zbatim në shoqërinë shqiptare.

Aktivistët rinor në nivel lokal, pjesëmarrës në grupet e fokusit dhe anketimet gjatë këtij studimi, pohojnë se të rinjtë kanë nevojë për rritjen e kapaciteteve për çështje të veçanta, ndërsa mobilizimi nga ana e institucioneve mungon. “Mobilizimi bëhet nga drejtuesit e

⁶⁹ Nga intervista e zhvilluar në dt. 8 Prill 2013, me Znj. L. Gjani, punonjëse sociale pranë Shërbimeve Sociale, Bashkisë Kukës.

⁷⁰ Intervistë e dt. 6 Qershor 2013, në Kukës, me Znj. D. Gjuta Pedagoge në UT dega Kukës dhe Koordinatorë projektsh e Shoqatës “RSL” Kukës, gjatë periudhës 2008 – 2013.

grupeve rinore zakonisht për aktivitete argëtuese, dhe rrallë herë kur ka fushata që lidhen me interes të komunitetit. Gjatë fushatave elektorale, ka ndodhur gjithmonë që të rinjtë mobilizohen në forumet e ndryshme politike, duke u përdorur mediatikisht më shumë sesa për t'u dëgjuar. Megjithatë, mobilizimi i grupeve rinore dhe të rinjve në përgjithësi është i mundur dhe siguron një rol të rëndësishëm në reagimin qytetar⁷¹.

4.14. Pjesëmarrja, një mjet për të luftuar korrupsionin

Pjesëmarrja duhet të jetë një proces i vazhdueshëm i cili mundëson një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet vendimarrësve dhe komuniteteve, duke u dhënë mundësi zyrtarëve që të jenë koherent, të njohin nevojat dhe prioritetet e komuniteteve lokale⁷². Nevojat dhe prioritetet, të cilat identifikohen përmes dëgjësive publike janë orientimi më i mirë për vendimarrësit në planifikimin e projekteve komunitare duke i përdorur ato sipas nevojave reale të komunitetit. Informimi i vazhdueshëm ul ndjeshëm shanset për korrupsion, ndërkohë që niveli i ulët i korrupsionit sjell edhe përdorim të plotë të burimeve lokale në favor të komunitetit⁷³, që do të thotë efektivitet në qeverisje.

Sipas raporteve të institucioneve ndërkombëtare të cilat mbykqyrin progresin e Shqipërisë, korrupsioni mbetet një problem i madh për shoqërinë shqiptare, duke u bërë pengesa kryesore në procesin e integritetit. Një raport i Transparency International, “Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2012” e ka renditur Shqipërinë në vendin e 113-të, duke rënë 18 pozicione krahasuar një vit më parë (TIA, 2012). Korrupsioni është fenomen me forma të ndryshme duke përfshirë zyrtarët dhe ryshfetet, abuzimin me kontratat dhe tenderat publik, financim i paligjshëm politik në kurriz të qytetarëve dhe

⁷¹ Intervistë e zhvilluar në dt. 9 Qershor 2013 në Kukës, me Vladimir Gashi, aktivist dhe vullnetar i shoqatës RSL, anëtar i kryesisë së Forumit Rinor të PD-s Kukës.

⁷² Raporti i Progresit për Shqipërinë për vitin 2013, Komisioni Europian

⁷³ Gjatë fokus grupit mbajtur në Kukës, në dt. 17 Gusht 2013, me 5 aktivistë rinor dhe punonjës social në Qarkun e Kukësit

shërbimeve publike. Pavarësisht legjislacionit të përshtatur për të luftuar korrupsionin, partnerët tanë ndërkombëtar vazhdojnë të theksojnë me forcë nevojën për një luftë më të fortë ndaj këtij fenomeni shumë të përhapur në shoqërinë shqiptare.

Pyetjes nëse pjesëmarrja në vendimarrje lufton korrupsionin, i janë përgjigjur 35 të rinj të anketuar në rrethet Fier, Kukës, Elbasan dhe Tiranë. 75 % e tyre mendojnë se pjesëmarrja aktive lufton korrupsionin, ndërsa pjesa tjetër shprehen skeptik. Këta të fundit, mbështeten tek aktivitetet e shumta të agjensive ndërkombëtare në Shqipëri, të cilat jo vetëm mbështesin organizata të ndryshme në vend, por ato shpenzojnë fonde të mëdha për të rritur kapacitetet e zyrtarëve dhe institucioneve të cilat e kanë për detyrë luftën kundër korrupsionit, dhe fatkeqësisht këto praktikat nuk kanë rezultuar të suksesshme. “Për sa kohë, luftën ndaj korrupsionit e drejtojnë zyrtarët e veshur me pushtet, deputetet, prokurorët apo gjykatësit, të cilët përfliten si aktorët kryesorë të përfshirë në korrupsion, nuk mund të ketë ndryshim të situatës. Pjesëmarrja aktive qytetare në proceset e buxhetimit, planifikimit të zhvillimit të rajoneve të banuara dhe dëgjuesat publike të organizuara në funksion të transparencës dhe llogaridhënies, do të ishin mjete efikase në luftë kundër korrupsionit”⁷⁴.

Eksperienca nga vendet në zhvillim ka treguar se përfshirja komunitare përmes mobilizimit social jep rezultate positive. Një raport i *Transparency International* në Bangladesh - një vend në zhvillim - tregon për vullnetarët e përfshirë në fushatë kundër korrupsionit në të gjithë vendin. Pjesëmarrja e qytetarëve në këtë vend në luftën kundër korrupsionit përmes grupeve *watchdog* të njohura si *Komitetet të Shqetësimeve Qytetare*, ka dhënë rezultatet pozitive në përdorimin e fondeve për zhvillimin

⁷⁴ Intervistë e zhvilluar në Kukës, në dt. 9 Maj, 2013 me Erion.V. 28 vjeç, aktivist i Forumit të Shoqërisë Civile Kukës.

komunitar. Përzierja e mbështetjes dhe liria ka lejuar qytetarët të lulëzojnë. 45 grupe në 60 provinca operojnë në të gjithë vendin e përbërë nga 21 vullnetarë dhe një numër i pakufizuar anëtarësh, të cilët i kanë bërë institucionet më transparente përmes iniciativës llogari-dhënëse sociale, sikurse janë kutitë e ankesave, debatet publike dhe buxhetet e hapura (TIB, 2012). Praktika të ngjashme janë tentuar edhe në Shqipëri përmes projekteve pilot, duke synuar kyresisht buxhetimin me pjesëmarrje, por për fatin e keq këto praktika nuk kanë ruajtur vazhdimësinë, dhe kanë përfunduar bashkë me përfundimin e projekteve në rajone të ndryshme. Një ish punonjës i UNDP, i cili ka drejtuar një program zhvillimi LGP⁷⁵ në Qarkun e Kukësit, pohon se zhvillimi komunitar duke përzgjedhur prioritetet nga vetë qytetarët gjatë vitit 2002 -2005 ka qenë praktika më e suksesshme për të përmbushur interesat komunitare dhe eliminuar procedurat burokratike dhe korrupsionin. Praktikën e ngjashme janë të domosdoshme për të nxitur jo vetëm pjesëmarrjen komunitare, por edhe për të zvogëluar mundësitë e përfshirjes në korrupsion, duke bërë që përfituesit e shërbimeve të jenë drejtëpërdrejt qytetarët, në vend të zyrtarëve të korruptuar.

4.15. Sektori jofitimprurës në qeverisjen vendore

Një çështje e rëndësishme e këtij studimi, lidhet me sektorin jofitimprurës, dhe kryesisht me shoqërinë civile, por që do të zhvillohet më tepër në kapitullin pasardhës. Megjithatë në vijim të praktikave të mësipërme të cilave nxisin pjesëmarrjen qytetare, është e nevojshme të trajtojmë një marrëdhënie të këtij sektori me qeverisjen vendore.

⁷⁵ Local Governance Program, është një iniciativë e UNDP që ka mbështetur qeverinë shqiptare në procesin e decentralizimit dhe demokratizimit. Ky program është zbatuar në tre qarqe të Shqipërisë: Fier, Gjirokastrë dhe Kukës. Programi kishte në fokus qytetarët, ngritjen e organizatave me bazë komunitare CBO, të cilat bënin prioritarizimin e nevojave duke përzgjedhur projektin më të rëndësishëm përmes një pjesëmarrje të gjithë komunitetit, dhe më pas merrte përgjegjësi për mbikqyrjen deri në zbatimin e projektit. Kompanitë zbatuese ishin direkt të varura nga CBO-të. Kjo mënyrë përzgjedhjeje e projekteve dhe zbatimi deri në përfundimin e punimeve ka shmangur korrupsionin, duke përfshirë qytetarët dhe mbrojtur interesat e tyre.

Rritja e numrit të shoqatave të ndryshme me aktivitet në nivel lokal kërkon një qasje përfshirëse dhe bashkëpunuese me qëllim për të maksimizuar efikasitetin e shërbimeve në drejtim të grupeve të synuara. Për sa kohë nuk egziston një traditë e mirë e shpërndarjes së shërbimeve nga vetë qeveria vendore dhe institucionet e tjera në nivel lokal, domosdoshmëria për koordinim, bashkëpunim dhe përfshirje do të rrisë cilësinë e shërbimeve dhe inkurajimin për pjesëmarrje në shpërndarjen e shërbimeve. Ky bashkëpunim i pushtetit vendor me sektorin jofitimprurës, duhet të ketë arsye të ndryshme për të ndodhur; mungesa e kushteve për të ofruar shërbimet në sektorin shtetëror; qëllimi për të forcuar shoqërinë civile; dhe sfidat e shtetit ndaj tregut, të cilat kombinohen më së miri përmes pjesëmarrjes së publikut (Pinto, 1998). Përfshirja në qeverisjen vendore të sektorit të tretë; grupet vullnetare, OJQ-të, grupet komunitare të lagjeve, shoqatat me bazë komunitare, kooperativat e ndryshme dhe organizata të tjera shoqërore, merr forma të ndryshme në zhvillimet komunitare dhe aktivizimin qytetar. Grupeve të lartpërmendura mund t'ju pëlqejnë fakti se do të konsultoheshin për çështje të ndryshme. Ata mund të përpiqen të mbrojnë interesat e grupeve të tyre apo në rastet më të mira mund të marrin rolin e shpërndarjes së disa shërbimeve. Shpërndarja e shërbimeve nga sektori i tretë mund të shtrihet nga qeverisja vendore si një shtrirje e autoritetit të saj përmes nën-kontraktorëve, në këtë rast sektori i tretë, duke siguruar pjesë të veçanta të një shërbimi (si rasti i kujdesit për moshat e treta apo edukimi joformal, trainimet, fushatat ndërgjegjësuere) tek komuniteti apo një grup i caktuar për të cilin bien dakort për standartet që do të ofrohen. Në këtë rast politikat vendosen nga autoritetet vendore pas konsultimeve me organizatat joqeveritare të interesuara për këto shërbime.

Rritja dhe forcimi i sektorit të shoqërisë civile, sikurse në vendet e tjera në zhvillim edhe në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit është mbështetur nga agjencitë ndërkombëtare dhe ambasadat e vendeve të zhvilluara. Varësia në burimet ndërkombëtare shpesh ka shkaktuar problem në orientimin e aktiviteteve të sektorit jofitimprurës, për shkak se prioritetet janë përcaktuar nga jashtë, më shumë sesa nevojat lokale.

Përfitimet e qeverisjes vendore nga bashkëpunimi dhe përfshirja e sektroit të tretë janë të shumta dhe përfshijnë shërbimet me kosto të ulëta dhe cilësore gjithashtu edhe përfshirjen e komunitetit dhe pranimin nga ana e tyre të objektivave të autoriteteve vendore. Përfshirja në këtë lloj bashkëpunimi rrit burimet njerëzore, zhvillon kapacitetet teknike, siguron informacion dhe menaxhim më të mirë të burimeve financiare, duke sjellë më shumë kreativitet dhe inovacion (Fiszbein, 2000). Ky shërbim i decentralizuari cili kërkon qasje të re për qeverisjen vendore, kufizon shpërdorimin e mjeteve për mobilizimin dhe ofrimin e shërbimeve, duke ruajtur një stabilitet më të mirë për buxhetin e saj gjithmonë në vështirësi. Prapëseprapë, duhet të pranojmë se gjithmonë egzistojnë rreziqe të cilat mund të çenojnë të drejtën për pjesëmarrje në komisionet e ndryshme nga zyrtarët e lokal, apo në rastet kur disa grupe të sektorit të tretë mund të kenë mungesë kapacitetesh dhe njohurish për të siguruar një shërbim të caktuar.

Të gjithë biem dakort se angazhimi i sektorit joqeveritar në qeverisjen vendore mund të kontribuojë në forcimin e demokracisë lokale në mënyra të ndryshme. Udhëzimet dhe kushtet që shpeshherë vendosen nga partnerët ndërkombëtar, lidhen me bashkëpunimin ndërmjet qeverisjes vendore dhe sektorit joqeveritar, me qëllim forcimin e shoqërisë civile dhe konsolidimin e demokracisë. “Bashkëpunimi midis qeverisjes vendore dhe sektorit të tretë ndihmon gjithashtu të vendoset legjitimiteti i politikave për të shmangur

konfliktin, centralizimin, autoritarizmin dhe mungesën e besimit tek institucionet. Ngritja e rrjeteve qeveritare dhe agjencive joqeveritare mbështet besimin dhe kapitalin social duke forcuar më tej demokracinë” (Fiszbein, 2000).

Përfshirja e sektorit të tretë dhe bashkëpunimi për shërbimet të ndryshme do të ishte mbështetës dhe do të ndikonte në konsolidimin e demokracisë. Gjatë një takimi të mbajtur me një fokus grup të shoqërisë civile në Kukës, janë shënuar disa rekomandime të rëndësishme nga aktivistë të këtij sektori. *Fillimisht*, ata nënvizojnë se lëvizjet qytetare, shoqatat dhe grupet e interesit, gratë apo të rinjtë pranojnë rëndësinë e qeverisjes së fortë demokratike. Këto grupe mund të organizojnë fushata të ndryshme ndërgjegjëse duke kërkuar demokratizimin e qeverisjes vendore dhe duke monitoruar një pjesë të madhe të shërbimeve për qytetarët. *Së dyti*, grupi i fokusit nënvizon grupet e ndryshme komunitare (të cilat për fat të keq nuk janë shumë aktive) apo forumet e partive politike të cilat rrisin demokracinë e praktikuar përmes negociatave dhe marrëveshjeve me qeverisjen vendore. *Së treti*, pjesëmarrja e organizatave me bazë komunitare, pëgatit njerëzit për pjesëmarrje në reformat e një qeverisje të demokratizuar duke bërë me shumë gjasa që kjo qeverisje vendore të ketë sukses. Kjo është gjithashtu edhe një mënyrë e mirë për të legjitimuar autoritetin e qeverisjes vendore. Dhe *së fundmi*, grupet qytetare me veprimtari vendore mund ti bashkohen qeverisjes vendore për advokim dhe lobim tek qeverisja vendore në emër të kërkesave të qytetarëve⁷⁶.

⁷⁶ Rekomandimet janë marrë nga takimi i dt. 13 Shkurt 2013, me përfaqësues dhe aktivistë të shoqërisë civile në Kukës, takim i organizuar nga Shoqata Rinia në Sipërmarrjen e Lirë, në kuadër të projektit “*Strengthening democracy and insuring officials’ accountability actively involving local actors and community groups*” mbështetur nga Olof Palme International Center.

4.16. Barrierat e pjesëmarrjes rinore

Pavarësisht nevojës për të rritur pjesëmarrjen e grupeve të vogla dhe në veçanti ato rinor, jemi të ndërgjegjshëm për faktin se ka disa barriera që pengojnë angazhimin e tyre. Për njerëz të zgjedhur dhe aktor të tjerë vendor, konsolidimi i demokracisë në nivel lokal përmes pjesëmarrjes së të rinjve mund të jetë një nocion utopik. Nivele të larta mosbesimi apo ndonjëherë edhe çështje që janë për tu zgjidhur bëhen shumë të vështira dhe komplekse. Metodat pjesëmarrëse dhe përfshirëse nuk janë zgjidhjet apo gjetjet më të mira për të rriturit dhe të zgjedhurit vendor. Në këtë kuptim, preferoj të sjell në vëmendje disa pengesa që të rinjtë aktivistë hasin në jetën e përditshme, si;

- mungesa e angazhimit të qeverisjes vendore,
- mungesa e vullnetit për ti dhënë grupeve rinore kontrollin e disa programeve të lidhura me ta,
- mungesa e besimit ndërmjet qeverisjes vendore dhe grupeve komunitare,
- mungesa e kapaciteteve brenda qeverisjes vendore për të zhvilluar një komunikim dhe konsultim

Duke qenë të ndërgjegjshëm për faktin se Shqipëria pas 20 vitesh tranzicion ende mbetet një vend me demokraci të pakonsoliduar dhe se konfliktet e vazhdueshme politike nuk po i shërbejnë debatit demokratik, por qëllimeve të ngushta të partive politike për pushtet, duhet të jetë qëllim kërkesa për të motivuar dhe mbështetur grupet rinore që të marrin pjesë aktivisht përmes OSHC-ve dhe grupeve të vogla, për të zhvilluar kështu leadershipin e tyre. Me fjalë të tjera, të rinjtë kanë nevojë për mundësi për të mësuar dhe për të praktikuar demokracinë në mënyrë kuptimplote dhe të mirëfilltë.

Zhvillimi i grupeve lokale rinore dhe lidërshipt të saj do të jepte një kontribut të madh në zhvillimin pozitiv të vetë të rinjve dhe të komunitetit ku ushtrojnë veprimtarinë. Veç kësaj, duke ndihmuar të rinjtë për të zhvilluar cilësitë drejtuese, i aftëson ata më se miri në zgjidhjen e problemeve komunitare dhe rrit pjesëmarrjen qytetare (O'Brien, J., & Kohlmeier, 2003).Fuqizimi i të rinjve do të ndihmonte OSHC-të e tjera për të rritur rolin dhe ndikimin në komunitetet vendore.

Përtej pengesave që të rinjtë dhe OSHC-të hasin çdo ditë duke përmendur këtu edhe apatinë qytetare, burimet për të riaktivizuar shoqërinë civile kërkojnë motivim dhe mbështetje. Grupet lokale rinore duhet të merren në konsideratë në këtë rast. Meqenëse ky hulumtim është bazuar kryesisht në të dhëna empirike, nuk mund të anashkaloj disa komente të bëra nga të rinj dhe aktivistë të OSHC-ve të lidhura me aktivitetin dhe pengesat e tyre, të cilët pohojnë se;

“Shqipëria nuk duhet të njësohet vetëm me Tiranën, Durrësin, apo Elbasanin (të cilat sigurisht që janë qytetet më të mëdha), pasi realiteti është në çdo qytet apo qytezë të vogël, fshat apo lagje ku jetojnë njerëz. Politikat sociale përfshirëse për grupet lokale të vogla duhet të jenë në zhvillim konstant dhe me prezencën e vetë të rinjve” “... zëri ynë duhet të dëgjohet, OSHC-të rinore duhet të tregojnë më shumë besim tek vetja, të rrisin bashkëpunimin me grupet e tjera lokale dhe kombëtare dhe sigurisht të shmangin anshmëritë politike”...“nëse themelet e piramidës janë të forta mjaftueshëm (çka simbolizon grupet lokale rinore), e gjithë struktura e OSHC-ve do të jetë e qëndrueshme deri në majë, dhe mund të jenë interesat e qytetarëve ato që mund të lidhin grupet e OSHC-ve, ...ndërsa pjesëmarrja e grupeve rinore duhet motivuar, pasi janë të rinjtë

grupi i parë shoqëror i cili përcakton ndryshimet që duhet të vijnë”...“
nevojitën më shumë mjete financiare për grupet rinore, ... një analizë
situate e mirëfilltë dhe identifikim i nevojave është i domosdoshëm,
sepse pjesa më e madhe e problematikës që ne adresojmë në komunitet
janë anashkaluar dhe rezultatet e pritshme mungojnë”⁷⁷

Pas këtyre pohimeve, të cilat ofrojnë një paraqitje të shkurtër të shpresës dhe problematikës së grupeve rinore lokale bashkë, të lidhura ngushtë me pjesëmarrjen e të rinjve, bashkohem me shqetësimin dhe theksoj se aktivistët e rinj dhe OSHC-të nuk duhet ti kërkojmë vetëm nga qytetet e mëdha, pasi edhe qytetet e mëdha kanë lagjet e tyre të vogla, dhe përtej këtyre qyteteve të mëdha ndodhet një realitet tjetër, i cili nuk mund të shpëputet nga pjesa tjetër e vendit. Në ditët e sotme kur globalizmi është një fakt, ka një kërkesë akoma edhe më të madhe për të zhvilluar e mbështetur grupet e vogla komunitare, duke i bërë palë në procesin e demokratizimit dhe më pas për tu përballur me sfidat në shoqërinë ku bëjnë pjesë.

Mbështetja financiare është një tjetër pengesë kryesore për mbijetesën e OSHC-ve.

Ndërsa egzistojnë organizatat me bazë komunitare, apo grupet e vogla rinore që kanë burime njerëzore të konsiderueshme për të zhvilluar dhe influencuar demokratizimin me më pak para të shpenzuara, krahasuar me strukturat e konsoliduara të OSHC-ve, prapëseprapë nevojiten burime financiare si nevojë për të komunikur, bashkëpunuar dhe për tu dëgjuar në komunitetet ku operojnë.

⁷⁷Shkëputur nga intervistat me aktivistë të rinjë nga Kukësi, Fieri, Elbasani dhe Tirana.

Kapitulli V: RASTE STUDIMORE ME SHOQATA DHE GRUPE KOMUNITARE NË KUKËS, PUKË, FIER, TIRANË DHE VLORË

Hartimi i këtij rasti studimor është zhvilluar për të ndihmuar shpërndarjen e eksperiencave dhe ideve brenda organizatave komunitare dhe ato të shoqërisë civile në nivel lokal dhe për të mbështetur konceptet kërkimore, teoritë dhe modelet e ofruara gjatë trajtimit të pjesëmarrjes. Grupet rinore lokale të përfshira në këtë studim, janë përzgjedhur me qëllim për të siguruar një përfaqësim të grupeve rinore lokale me shtrirje gjeografike përtej qendrave të mëdha urbane, të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike gjithashtu edhe për një diversitet të të rinjve të përfshirë në pjesëmarrjen aktive. Rastet studimore janë përmbledhje e takimeve dhe kontakteve të drejtpërdrejta me drejtues dhe aktivistë të këtyre forumeve rinore gjatë periudhës Maj – Nëntor 2013.

Të gjitha rastet e përmbledhura përfaqësojnë qëndrimin e grupeve lokale të cilat përshkruajnë praktikën e pjesëmarrjes përmes eksperiencës dhe praktikave të vazhdueshme që zhvillojnë, pavarësisht faktit se organizohen në një kontekst të mbyllur dhe shpesh herë të paeksponuara për publikun e gjerë. Një tipar i rëndësishëm i rasteve studimore në këtë hulumtim ka të bëjë me kulturën e tyre organizative dhe aktivizimin e të rinjve në këto forume rinore. Rastet e vëzhguara reflektojnë një kulturë që respekton të rinjtë dhe njeh vlerat e pjesëmarrjes rinore. Çdo pjesëmarrës tregon aftësitë e kësaj grupmoshe për të kontribuar në vendimet dhe çështjet që prekin jetën e tyre. Grupet rinore të marra si raste studimore, treguan angazhimin e tyre për pjesëmarrjen e të rinjve në mënyrat e mëposhtme:

- Angazhim për pjesëmarrje brenda organizatave dhe forumeve
- Ndarje përgjegjësish dhe pushteti
- Respekt për të ardhurit rishtaz
- Trainime dhe mbështetje për të rinjtë që dëshirojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre
- Minimizim i pengesave për të mundësuar pjesëmarrjen e të rinjve.

5.1. Rasti Studimor Kukës: Shoqata Rinia në Sipërmarrjen e Lirë dhe Qendra

Rinore

Aktivizimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në forume dhe shoqata rinore.

E themeluar në Kukës si një shoqatë lokale nga një grup të rinjesh në Maj të vitit 2001, me fokus të rinjtë dhe me synimin për të rritur rolin e të rinjve në jetën publike si aktivistë, promotorë të ndryshimeve sociale dhe mbrojtës të të drejtave të njeriut.

Praktikat e pjesëmarrjes së shoqatës *Rinia në Sipërmarrjen e Lirë* (RSL) tregojnë për një ndryshim nga organizatat e tjera të vëzhguara gjatë studimit, për shkak të organizimit të saj dhe lidhshërisë. Gjetjet tregojnë se individët dhe grupet rinore të përfshira në këtë shoqatë në aktivitete dhe struktura të ndryshme janë gjithmonë të organizuara si duhet dhe luajnë një rol të përcaktuar mirë prej fillimit të angazhimit të tyre. Angazhimi i të rinjve me RSL-n sjell përfitime për të rinjtë drejtëpërdrejtë dhe komunitetin ku vepron ky forum rinor lokal. Përfitimet që të rinjtë marrin gjatë angazhimit në këtë forum rinor lidhen me marrëdhëniet që krijojnë midis bashkëmoshtarëve të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë dhe përtej saj, përmes shkëmbimeve rinore që zhvillohen si pjesë e aktiviteteve të projekteve. Të rinjtë përmes

aktivizimit të tyre, rrisin reputacionin e tyre dhe njëkohësisht edhe të organizatës ku janë të angazhuar⁷⁸.

Kjo shoqatë rinore lokale praktikon shkallën e pjesëmarrjes, të Roger Hart - të cilën e kemi trajtuar në kapitullin e I-rë të këtij studimi - e cila përshkruan tetë nivelet e ndryshme që ndodhin gjatë pjesëmarrjes, me qëllim për të rritur pjesëmarrjen brenda këtij forumi. RSL ka përshtatur version e Shkallës së Hart sipas modelit të mëposhtëm:

8. Të Rinjtë & të rriturit marrin pjesë njësoj në vendimarrje	Të rinjtë kanë idetë, zbatojnë projektet dhe ftojnë të rriturit që të bashkohen në vendimarrje
7. Të rinjtë ndërmarrin dhe drejtojnë veprimin/aksionin	Të rinjtë kanë idetë e para dhe vendosin se si duhet të zbatohet projekti.
6. Të rriturit konsultojnë vendimet me të rinjtë	Të rinjtë kanë idetë e para, por ata janë të përfshirë në çdo hap të planifikimit dhe zbatimit të projektit. Pikëpamjet e tyre jonetëm që merren në konsideratë, por ata ftohen në vendimarrje
5. Të rinjtë të konsultuar dhe informuar	Projekti ideohet dhe zbatohet nga të rriturit, por të rinjtë janë të konsultuar. Ata kanë dijeni për procesin dhe opinionet e tyre merren seriozisht.
4. Informim i të rinjve	Të rriturit vendosin për projektin, ndërsa të rinjtë janë vullnetar në projekt. Të rinjtë kanë dijeni për projektin dhe se kush merr vendimet. Të rriturit respektojnë idetë e të rinjve.
3. Tokenizm për të rinjtë	Të rinjtë pyeten se çfarë mendojnë rreth një çështje, por kanë shumë pak ose aspak zgjedhje për mënyrën se si i shprehin pikpamjet e tyre, dhe pak rezultat në lidhje me idetë që kanë shprehur.
2. Të rinjtë përdoren për dekorim	Të rinjtë marrin pjesë në një aktivitet, por në fakt nuk e kuptojnë se për çfarë bëhet fjalë.
1. Të rinjtë janë të manipuluar	Të rinjtë shprehin/bëjnë atë çfarë të rriturit sugjerojnë, por nuk kanë dijeni mbi ato çështje dhe projekte. Ndonjëherë të rinjtë pyetën për mendimet e tyre, ndërsa të rriturit i përdorin ato pa u

⁷⁸ Intervistë me L. Shehu, Koordinator Projektesh pranë shoqatës, Rinia në Sipërmarrjen e Lirë, Kukës. Intervistë e zhvilluar në dt. 9 Shtator 2013.

	treguar se çfarë ndikimi do të kenë në vendimin përfundimtar.
--	---

Shkalla e pjesëmarrjes nga të rinjtë, rasti i Kukësit.

Tre nivelet e fundit, *Tokenizmi, Dekorimi dhe Manipulimi*, janë përshkruar nga Hart si mos-pjesëmarrje. Rasti studimor që po trajtojmë reflekton praktika të ndryshme me raste reale të pjesëmarrjes. Për të ndodhur një pjesëmarrje kuptimplotë, RSL sugjeron se shoqatat rinore duhet të kenë struktura dhe aktivitete të mjaftueshme për të ndihmuar dhe lehtësuar aktivizimin e të rinjve. Gjithashtu, këto shoqata rinore duhet të tregojnë angazhim për pjesëmarrjen rinore; të jenë organizata që në fokus kanë të rinjtë; të ofrojnë trainime dhe mbështetje për të rinjtë që duan të zhvillojnë kapacitetet e tyre; dhe të respektojnë të rinjtë me aftësi të ndryshme.

Sipas drejtuesve të forumeve rinore në Kukës, pjesëmarrja e të rinjve bazohet në parimet e zgjedhjes; sfidës; ndërgjegjësimit; dhe lidhjeve të interesave. Për të rinjtë është shumë e rëndësishme që të rriturit të njohin kontributet e tyre dhe të vlerësohen në kohën e duhur. Është shumë e rëndësishme për forumet/shoqatat rinore që të identifikojnë pengesat e mundshme për pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve, që në disa raste me ose pa dashje diskriminojnë të rinjtë me aftësi të ndryshme; “ambjentet nuk janë miqësore dhe padashur mund të krijojnë një ambjent shumë zyrtar; në disa raste forumet rinore bëjnë shumë kërkesa për të rinjtë pjesëmarrës në një kohë të shkurtër; ndodh që krijojnë formate dhe procedura të komplikuara anëtarësimi; disa organizata kanë vendosur kuota të larta pjesëmarrjeje; apo rastet kur përdorin gjuhë akademike dhe zyrtare gjatë komunikimit”⁷⁹.

⁷⁹ Nga takimi me grupin e fokusit të shoqatës Rinia në Sipërmarrjen e Lirë, mbajtur pranë kësaj shoqate në Kukës në dt. 17 Gusht 2013, me pjesëmarrjen e 13 aktivistëve dhe drejtuesve të Qendres Rinore.

5.2. Mbështetja e të rinjve për të marrë pjesë

RSL ka një politikë nxitëse dhe mbështetëse për përfshirjen e të rinjve në jetën aktive dhe pjesëmarrjen e tyre në forumet rinore lokale. Një grup vullnetarësh të motivuar brenda kësaj shoqate, tërheqin të rinjë të grupeve të ndryshme, duke ju bërë me dije se përfshirja në këtë grup është i vlefshëm. Sugjerimet e mëposhtme bëhen nga të rinjtë aktivistë të cilët kanë provuar eksperiencë pozitive:

Një organizatë rinore ka nevojë për njerëz të cilët mund të japin mesazhe pozitive dhe kapërcejnë përmes procedurave burokratike. Nuk është e thënë që patjetër duhet të jesh i ri në rolin për të promovuar dhe nxitur të rinjtë, por duhet dikush që respekton opinionin e të rinjve dhe që ka provuar më parë një eksperiencë pozitive, me qëllim për ta transmetuar tek një grup tjetër. Organizatorët dhe vullnetarët të cilët nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në forumet rinore duhet të kuptojnë rëndësinë e opinionit të të rinjve në vendimarrje (Koordinatori i Qendrës Rinore).

Brenda shoqatës RSL Kukës egziston një besim se pjesëmarrja dhe aktivizimi i të rinjve është i vlefshëm dhe shpërblehet përmes aktiviteteve dhe përfshirjes së individëve duke marrë role dhe përgjegjësi brenda grupit:

Pjesëmarrja e të rinjve është me të vërtetë e rëndësishme dhe shpërblehet gjithmonë në forma të ndryshme. Të merresh me të rinjë është me të vërtetë emocionuese dhe motivuese (Koordinatori i Qendrës Rinore).

Egziston një mirënjohje e veçantë për të rinjtë të cilët luajnë një rol të rëndësishëm brenda organizatës. Aktivistët e zellshëm shpërblehen jo-vetëm me rolet dhe

eksperiencën që marrin brenda organizatës, por atyre u jepet mundësia të jenë pjesë e aktiviteteve jashtë Shqipërisë, kur mbahen trainime dhe aktivitete të ndryshme në partneritet me aktorë të ndryshëm ndërkombëtar.

Gjetjet tregojnë se të rinjtë aktivistë të kësaj shoqate marrin pjesë dhe aktivizohen në forma të ndryshme, duke filluar me lehtësimin e disa aktiviteteve me grupe të vogla, organizimin e fushatave dhe trainimeve me të rinj, apo edhe organizimin e aktiviteteve argëtuese dhe sportive. Një shembull i pjesëmarrjes të të rinjve brenda kësaj organizate ka të bëjë me sezonin veror, periodhë kjo kur të rinjtë studentë përfshihen në *internship*. Rreth 30 të rinj çdo vit nga muaji Qershor deri në fund të Gushtit, janë pjesë e programit veror të punësimit sezonal të punësimit, duke marrë role të ndryshme në organizimin e aktiviteteve rinore në Kukës.

Programi i verës me shoqatën RSL është shumë i rëndësishëm për ne të rinjtë, pasi nuk kemi shumë alternativa të tjera në Kukës, gjithashtu kemi gjetur një ambjent fantastik ku ndërveprojmë me njëri-tjetrin, marrim role dhe ndajmë përgjegjësi. Ne kemi organizuar në pavarësi të plotë aktivitete për të rinjtë dhe ja kemi arritur të kemi sukses. Jemi ndjerë të vlersuar dhe kemi provuar një eksperiencë që do të na vlejë në të ardhmen (V.Gashi⁸⁰, aktivist & vullnetar).

Përveç pjesëmarrjes në aktivitetet që organizohen në terren, të rinjtë e kësaj organizate kanë mundësi të marrin pjesë gjithashtu edhe përmes forumeve të ndryshme të ngritura posaqërisht për diskutim në internet. Prej kohësh përveç faqes në internet, është ngritur një rrjet rinor lokal në facebook, ku organizohen debate të ndryshme për çështje lokale.

⁸⁰ V. Gashi është një activist i shoqatës RSL prej vitit 2010 dhe në vazhdim. Ai ka përfituar nga pjesëmarrja në këtë shoqatë rinore pjesëmarrjen e tij në një program “European Voluntary Service” duke zhvilluar një praktikë vullnetare në një Qender Rinore në Finlandë për një periudhë 5 mujore.

Ky rrjet menaxhohet nga vetë të rinjtë vullnetarë, duke promovuar fushata rinore dhe debate lokale për të promovuar ndjenjen e qytetarisë dhe rëndësinë për të kontribuar në komunitetet lokale.

Të rinjtë si vendim-marrës

Veç organizimit të aktiviteteve të planifikuara për shkak të disa projekteve në zbatim, të rinjtë aktivistë të kësaj shoqate kanë mundësi të organizojnë aktivitete të ndryshme bazuar në iniciativat e grupeve ku ata bëjnë pjesë. Gjithashtu, vetë të rinjtë çdo vit janë pjesë e procesit të zgjedhjeve brenda kësaj shoqate për të marrë pjesë në bordin e shoqatës. Bordi drejtues përbëhet nga shtatë antarë, të cilët zgjidhen nga vetë aktivistët dhe vullnetarët në një proces të rregullt diskutimi dhe konkurrimi. Anëtarët e këtij bordi përveç rolit mbikqyrës, kanë mundësi vendimmarrje për të organizuar aktivitete në mënyrë të pavarur. Disa nga vendimet që ky grup ka ndërmarrë, kanë të bëjnë me organizimin e fushatave ndërgjegjësuere për ambjentin, protestat dhe shfaqjet në rrugë si reagim ndaj mungesës së ujit të pijshëm, ndërtimeve pa leje dhe kaosit në trafik⁸¹.

Stafi i RSL-s shprehet se me përfshirjen e sa më shumë të rinjve dhe marrjen në konsideratë të opinioneve të tyre ka ndihmuar në suksesin e vetë shoqatës dhe impaktit që kjo shoqatë ka në komunitet. Për shkak të aktiviteteve dhe seriozitetit të shoqatës, çdo ditë ka interesim nga të rinjtë djem dhe vajza për të marrë pjesë dhe për tu përfshirë në aktivitetet që organizohen⁸².

⁸¹Gjatë muajit Gusht të vitit 2013, vullnetarët e RSL-s kanë organizuar një protestë në rrugë përmes një shfaqje artistike, duke targetuar problematikat e; mungesës së ujit të pijshëm, kaosit në trafik dhe ndërtimet pa leje që i kanë marrë frymën qytetit. Protestat janë të përvitshme dhe janë nismë e vetë grupeve rinore. Paroditë dhe format e protestës diskutohen dhe marrin fillimisht edhe mendimin e të rinjve në forumin social, për të mundësuar kështu edhe pjesëmarrjen dhe mbështetjen e opinionit publik.

⁸² Intervistë me L. Shehu, Koordinator Projektsh pranë shoqatës, Rinia në Sipërmarrjen e Lirë, Kukës. Intervistë e zhvilluar në dt. 9 Shtator 2013.

5.3. Ndarja e pushtetit me të rinjtë

Gjatë këtij studimi, në kapitujt e mësipërm është theksuar se nevojitet ndarje përgjegjësish nëse synohet përfshirja dhe pjesëmarrja e të rinjve, e cila lidhet direkt me një lloj pushteti që mund të ndahet me aktivistët e rinjë të cilët bëjnë pjesë e forumeve rinore qytetare dhe politike, për të kontribuar në demokratizimin e vendit. Historia dhe eksperiencat e hasura gjatë këtij studimi tregojnë për pengesa të shumta në pjesëmarrjen e të rinjve në forumet dhe shoqatat rinore. Disa organizata mund të argumentojnë se të rinjtë nuk janë ndoshta të interesuar shumë për pjesëmarrje apo se nuk kanë nevojë të “mbrohen” nga pengesat që mund të hasin. Në disa raste, vetë të rriturit mund të ndihen të kërcënuar nga pjesëmarrja e të rinjve dhe një perceptim i humbjes së pushtetit. Realiteti i organizatave dhe forumeve të cilat kanë në fokus pjesëmarrjen e të rinjve përveç se drejtohen nga të rritur, ndodh dukshëm që këta të fundit të kenë një nivel më të madh pushteti në krahasim me të rinjtë. Gjetjet gjatë këtij studimi tregojnë se egzistojnë raste të veçanta me shoqata dhe forume rinore të suksesshme kur ka një ndarje pushteti me të rinjtë, duke krijuar kështu një mundësi të mirë për të dy palet dhe impakt në komunitet.

Në të gjitha forumet dhe grupet rinore të shoqërisë civile të vëzhguara gjatë këtij studimi rezulton të ketë një respekt ndaj të rinjve, respekt ndaj asaj se çfarë të rinjtë janë të aftë të bëjnë.

Të rriturit mund të mësojnë nga të rinjtë dhe këta të fundit mund të sjellin ide dhe kreativitet për organizatën apo forumin ku bëjnë pjesë. Eksperienca e jetës është me të vërtetë e mirë (cilësi kjo për të rriturit), por mund të krijojë gjithashtu edhe pengesa duke menduar për rreziqet që mund të ndodhin nga eksperiencat e mëparshme. Ndërsa të rinjtë

mund të japin një kontribut me ide novative dhe të freskëta, pa paragjykime dhe organizatat e tyre mund të përfitojnë nga kjo gjë (Koordinatori i RSL-s Kukës).

E njëjta eksperiencë vlen edhe për institucionet politike dhe administrative, të cilat vazhdojnë të flasin për përfshirjen e të rinjve në vendimarrje, por në fakt ngurrojnë të ndajnë pushtetin e tyre me përfituesit e shërbimeve që shpeshherë janë kontribues të iniciativave për ndryshim dhe zhvillim. Të rinjtë kanë nevojë për besim dhe pushtet, për të provuar përgjegjësitë dhe vendimarrjen për interesat në favor të tyre.

Përfitimet e të rinjve dhe vetë forumeve nga pjesëmarrja

Pjesëmarrja e të rinjve në forumet rinore për rastet studimore ka treguar se sjell përfitime të cilat lidhen direkt me aktivistët në aspektin individual dhe në grup. Disa nga përfitimet e reflektuara nga vetë aktivistët e intervistuar gjatë këtij studimi kanë të bëjnë me; *rritjen e kapaciteteve* në fusha të ndryshme; *krijimin e lidhjeve* dhe njohjeve me të rinj nga rrethe dhe vende të ndryshme; *sfidat* dhe stereotipet e hasura; *marrja e njoftimeve* të ndryshme për trainime dhe bursa studimore; *pjesëmarrje në trainime* dhe seminare në nivel ndërkombëtar; *punësim sezonal* dhe *referenca* për pozicione të ndryshme; *argëtim* dhe *promovim*.

‘Angazhimi me RSL-n më ka ndihmuar të forcoj besimin tek vetja, fillimisht si një lider grupi me mundësinë për ta zhvilluar këtë mundësi në të ardhmen. Gjithashtu, kam patur rastin jo-vetëm të organizoj aktivitete në bashkëpunim me kolegët e mi aktivistë, por kam udhëtuar jashtë Shqipërisë në trainime dhe seminare, me shpenzimet e mbuluara nga organizatorët. Kjo ka qenë një mundësi e mirë jo vetëm për të rritur

kapacitetet e mia në një fushë të caktuar, por më ka dhënë mundësi të praktikoj gjuhën angleze, të vizitoj disa vende dhe kultura të ndryshme dhe të krijoj miq të rinj me të cilët mund të organizoj aktivitete në të ardhmen (B. Mataj⁸³)’

Përveç përfitimeve që të rinjve kanë nga pjesëmarrja në organizatat dhe forumet e ndryshme, janë edhe vetë këto të fundit të cilat përfitojnë nga pjesëmarrja e të rinjve. Aktivizimi dhe pjesëmarrja e të rinjve kontribon në një kulturë organizative duke krijuar një impakt në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme në komunitet. Pjesëmarrja e të rinjve sjell eksperiencë dhe ide për organizatat dhe i frymëzon ato për aksione të reja. Përfshirja dhe pjesëmarrja legjitimon veprimtarinë dhe rolin e forumeve rinore në mbrojtjen e interesave dhe përfaqësimin e zërit të grupit për të cilin advokojnë. Kjo i ndihmon shumë organizatat dhe forumet, të krijojnë besueshmëri tek komuniteti, donatorët dhe partnerët lokal me të cilët ndërveprojnë. Pjesëmarrja dhe aktivizimi i të rinjve në forumet lokale, i ndihmon ato gjithashtu të ofrojnë shërbime më cilësore dhe të krijojnë një vazhdueshmëri dhe qëndrueshmëri në praktikën dhe projektet që zbatohen. Kjo pjesëmarrje nxit aktivizimin e më shumë të rinjve, përmirëson kapacitetet e organizatës për të arritur qëllimet, ndikon në suksesin e fushatave dhe ngjarjeve të ndryshme që kërkojnë pjesëmarrje dhe kontribon në politikën e vetë organizatave për të qenë aktor të rëndësishëm në komunitet.

5. 4. Rasti Studimor Pukë: Qendra Levizja rinore për Demokraci (LRD)

“Mundësia për të patur të rinjë të shkollave të mesme të përfshirë në organizatë ka të bëjë me fuqizimin e tyre dhe ndikimin që ata mund të

⁸³ B. Mataj, aktivist i shoqatës RSL prej vitit 2010-2012. Ai gjithashtu prej vitit 2012 është edhe drejtues i Forumit Rinor Euro-Socialist të Kukësit. Intervista është marrë në Kukës, në dt. 12 Korrik 2013.

kenë tek bashkëmoshatarët e tyre. Gjatë aktivizimit të tyre ata rrisin aftësitë e tyre të cilat mund ti përdorin gjatë jetës në vazhdim. Është detyrë e drejtuesve të forumeve rinore që të informojnë të rinjtë rreth programit, aktiviteteve, qëllimeve dhe donatorëve, me qëllim që të rinjtë të kenë mundësi të zgjedhin për angazhimin e tyre. Të rinjtë gjithashtu kanë nevojë për stimuj mbështetës, pasi jo gjithmonë janë të gatshëm për të dhënë kontributin e tyre në mënyrë vullnetare” (Drejtoresha e Qendrës LRD⁸⁴).

Rreth LRD-s

Qendra LRD është ngritur nga një grup intelektualësh të rinj me qëllim për të mbështetur të rinjtë që të jenë aktiv në jetën komunitare, në vendimmarrje dhe iniciativat e tjera lokale. LRD është një organizatë joqeveritare, jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse. Në fokus të kësaj qendre janë të rinjtë gjimnazistë, klasat e nënta dhe të rinjtë e papunë. Kjo qendër nxit të rinjtë për tu bërë pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes komunitare dhe politike në përmirësimin e së ardhmes së tyre.

Përfshirja e të rinjve dhe roli brenda organizatës

Ky forum rinor, i themeluar në një komunitet lokal të vogël, ofron një ambjent të përshtatshëm për të rinjtë e interesuar për ndryshim social. Numri i vullnetarëve të angazhuar shkon në 25, ndërsa është forcuar partneriteti me disa grupe të tjera vendore, me qëllim përfshirjen e grupeve të ndryshme komunitare në aktivitetet që zhvillohen. Për të qenë pjesë e LRD-s Pukë, nuk ka procedura burokratike apo formularë të veçantë për tu plotësuar, mjafton dëshira e secilit për tu bashkuar me qëllimin për një

⁸⁴ Nga intervista e mbajtur me drejtuesen e LRD Pukës, Znj. Lindita Hyseni, dt 22 Tetor 2013.

pjesëmarrje aktive në shoqëri. Me qëllim për të rritur numrin e të rinjve të angazhuar, LRD organizon shpesh forume debati, diskutime dhe tryeza me grupet rinore lokale duke u dhënë role të ndryshme vetë të rinjve në organizimin e këtyre takimeve.

Përfitimet e të rinjve nga aktivizimi në LRD

Pjesëmarrja e të rinjve, kryesisht gjimnazistë si pjesë e LRD-s, është një situatë e favorshme për një komunitet të vogël dhe të izoluar në rastin e Pukës, pasi i ndihmon ata për të qenë në kontakt me nevojat dhe interesat e grupeve rinore pjesë e rrjeteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare ku LRD bën pjesë. Avantazhi i angazhimit të të rinjve është se ata mund të jenë në dijeni të problematikës dhe ndodhive të komuniteteve të tyre dhe mund të ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve apo të ndikojnë në vendimarrje. Angazhimi i të rinjve në LRD, i ndihmon ata në mënyrë të veçantë për të rritur aftësitë individuale, për tu përshtatur në grupe me diversitet dhe për të rritur ndjenjen e tyre vullnetare duke krijuar kështu edhe një CV të pasur që në moshë të re. Trainimet që shpesh ofrohen për aktivistët sigurojnë mundësi për të zhvilluar aftësitë e tyre në fusha të veçanta si; menaxhim konflikti, pjesëmarrje në vendimarrje, lobim, advokaci, lidërship dhe të tjera si këto. Një mundësi e mirë e të rinjve të angazhuar me LRD-n, lidhet edhe me mundësinë e tyre për të takuar njerëz të rëndësishëm me pushtet dhe me eksperiencë, me të cilët mund të shkëmbejnë ide dhe mendime për karrierën e tyre personale, duke u krijuar një mundësi identifikimi si aktor të lëvizjeve rinore, ndjesi kjo që i bën të rinjtë të ndihen të vlerësuar në çështjet rinore.

Mundësia më e mirë për tu angazhuar, është përmes fushatave të ndryshme që zhvillohen herë pas here, trainimet apo kontakteve dhe

informacioneve që shpërndajmë përmes rrjeteve sociale (Drejtoresha e LRD).

Përshtatja e të rinjve me të rriturit dhe pengesat që mund të hasen

Për shkak se kjo shoqatë rinore është e ngritur në një komunitet me një numër të vogël banorësh, aty ku të gjithë njohin njëri tjetrin, edhe përshtatja me grupet e ndryshme është shumë e lehtë. Komunikimi i të rriturve brenda këtij forumi ka lehtësuar gjithashtu edhe pjesëmarrjen e një numri të konsiderueshëm të rinjsh, duke krijuar një ambjent të përshtatshëm dhe interesant për të rinjtë. Prapëseprapë egzsitojnë pengesa për një pjesë të rinjesh të cilët nuk janë të informuar si duhet, për shkak se shpesh ndodh në fillimet e kontakteve të mendojnë se mos kjo lëvizje ka lidhje me forca të ndryshme politike. Megjithatë, aktivizimi i grupeve të para ka ndihmuar mjaft në informimin dhe shpërndarjen e informacionit, me qëllim për të thyer barrierat dhe mundësuar përfshirjen e individëve dhe grupeve të ndryshme rinore.

4.5. Rasti Studimor Fier: Qendra Rinore Epoka e Re

Qendra Rinore Epoka e Re Fier, ka nisur veprimtarinë e saj në vitin 2005 me organizimin e punës për Parlamentin Rinor Fier, mbështetur nga UNICEF. Deputetet e zgjedhur të Parlamentit Rinor nga 10 shkolla të mesme të qytetit do të advokonin dhe lobonin për çështje të ndryshme që lidheshin me interesat e tyre. Si nevojë e rritjes së kapaciteteve përmes disa aktiviteteve dhe projekteve lindi edhe Qendra Rinore e mbështetur fillimisht nga Bashkia Fier, dhe po në të njëjtin vit kjo qendër përfiton nga mbështetja e Olof Palme International Center⁸⁵ në një projekt që zgjat deri në vitin

⁸⁵ Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, është një organizatë Suedeze joqeveritare me focus në zhvillimin ndërkombëtar, bashkëpunimin dhe forimin e opinionit public rreth çështjeve politike dhe të sigurisë

2014. Qendra Rinore Epoka e Re, ka në fokusin e saj të rinjë të qytetit të Fierit të moshës 14 – 19 vjeç. Ky forum rinor ndihmon dhe lehtëson proceset e ndryshimit social, zhvillimin, procesin demokratik dhe përmirësimin e jetës së komunitetit përmes bashkëpunimit rinor (Koordinatorë e projekteve⁸⁶).

Përfshirja e të rinjve në shoqatën Epoka e Re

“Aktivizimi i të rinjve të moshave 14-19 dhe përfshirja e tyre në aktivitetet që mbahen rregullisht, inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve dhe mbështesin iniciativat e tyre. Ekspozitat, fushatat ndërgjegjësuëse në komunitet, trainimet, kapionatet sportive, aktivitetet argëtuese, pastrim i ambjenteve në komunitet dhe ndërgjegjësim për ruajtjen e ambjentit, shkolla verore Lidership – Qytetari – Komunikim, kurset dy javore në gazetari dhe fotografi, krijimi i grupeve të ndryshme brenda kësaj qendre si: Grupi i debatit, Grupi ambjentalist, Eduktatorë Bashkëmoshatarë dhe Grupi i gazetarëve të rinj; janë metodat për të tërhequr dhe përfshirë të rinj me aftësi të ndryshme” (Koordinatori projekteve).

Për tu bashkuar me shoqatën Epoka e Re, mjafton të jesh i ri/e re, grupmosha 14-19 vjeç, nxënës i klasës së 9-të deri në 12-të, (shkollë publike dhe private), të motivuar për të kryer punë vullnetare dhe për të ndërmarrë iniciativa në komunitet. Kjo qendër ka 57 të rinj aktivistë brenda qendrës, ndërsa numri i vullnetarëve dhe nxënësve të përfshirë në grupe dhe kurse të ndryshme është rreth 250, përfshirë edhe shkollën verore që organizohet çdo vit, ku marrin pjesë 100 të rinj të moshës 14-19 vjeç.

ndërkombëtare. Mbështetja për disa organizata në Shqipëri prej vitit 2005, është fokusuar në forcimin e rolit të rinjve në zhvillimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

⁸⁶ Zj. Evisa Kostrica, është koordinatorë e projekteve të Qendrës Rinore Epoka e Re Fier. Rasti studimor i Fierit është mbajtur gjatë muajit 16 Tetor 2013, përmes inetervistave dhe takimeve direkte me drejtues dhe aktivistë të kësaj qendre.

“Përfshirja në grupe dhe kurse është falas, na jepet mundësia të trajnohemi për çështje të ndryshme. Për të gjithëne të rinjtë është e mundur të mund të organizojnë aktivitete pasi të kenë rritur kapacitetet, sipas një plani që Qendra Rinore ka, duke targetuar grupe të caktuara në komunitet” (Aktivist i Qendrës Epoka e Re⁸⁷).

Drejtuesit e shoqatës, shprehen se të rinjtë janë të përfshirë direkt në aktivitetet që zhvillohen, duke rritur aftësitë e tyre në lidërsip dhe ofrues shërbimesh në komunitet. Një mundësi tjetër për përfshirjen e të rinjve dhe aktivizimin e tyre, ka të bëjë me zgjedhjet për Parlamentin Rinor në shkollat publike dhe jopublike të qytetit të Fierit. Përmes një procesi votimi të rregullt përzgjidhen 37 deputetë, të cilët përfaqësojnë bashkëmoshatarët e tyre në Parlamentin Rinor dhe ndërmarrin iniciativa që lidhen me çështjet vendimmarrëse. Çdo fillim viti shkollor nisin aplikimet për regjistrimin në grupet dhe kurset që ofron qendra. Lajmërimet dhe aplikimet shpërndahen në shkollat e qytetit, përmes koordinatorëve të Qeverisë së Nxënësve, me qëllim për të mundësuar informimin e secilit prej të rinjve që dëshiron të marrë pjesë.

Përfitimet e të rinjve, komunitetit dhe organizatës nga pjesëmarrja

“Të rinjtë aktivistë të përfshirë në aktivitetet dhe projektet e Qendres Rinore Epoka e Re janë pjesë e rëndësishme e bërthamës së organizatës. Nga përfshirja e tyre përfitojnë tre palë; vetë të rinjtë, komuniteti dhe organizata. Të rinjtë kalojnë kohën e lirë në mënyrë produktive dhe aktive, mësojnë të jenë të pavarur e të rrisin besimin tek vetja, fitojnë aftësi komunikuese dhe debatuese, mësojnë të punojnë në grup dhe të ndërmarrin aktivitete të ndryshme. Në fund të trainimeve apo kurseve që mbahen, secili pjesëmarrës

⁸⁷ Intervistë e zhvilluar në dt. 28 Tetor 2013, me S. B. aktivist, 17 vjeç, pranë Qendres Rinore Epoka e Re Fier.

paiset me çertifikatë. Komuniteti i Fierit ka përfituar gjithashtu nga aktivizimi dhe pjesëmarrja e rinjve në Qendrën Rinore Epoka e Re, përmes fushatave ndërgjegjëse, aktiviteteve për mbajtjen pastër të abmjentit, edukimin e brezit të ridhe debateve për ngritjen e zërit për të përmirësuar çështje që lidhen direkt me interesat e të rinjve. Ndërsa organizata vetë përfiton nga puna vullnetare dhe aktivitetet, duke krijuar besueshmëri në komunitet. Kjo ndikon drejtpërdrejt në vendosjen e lidhjeve me pushtetin vendor, i cili asiston dhe financon disa aktivitete të veçanta” (Koordinatori projekteve).

Iniciativat e të rinjve dhe përshtatja me drejtuesit e shoqatës

Drejtuesit e Qendrës Rinore Epoka e Re Fier, shprehin se vetë organizimi dhe struktura qëky forum rinor ka, mundëson mbështetjen dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme nga vetë të rinjtë. Kurset dhe grupet e organizuara brenda qendrës të përmendura më sipër, janë burim i planifikimit të aktiviteteve. Një shembull i mirë lidhet me mbledhjet e Parlamentit Rinor, të cilat organizohen nga grupi drejtues dhe drejtohen nga kryetari i këtij parlamenti. Një pjesë e madhe e fushatave ndërgjegjëse si ajo e 22 Prillit (Dita Ndërkombëtare e Tokës), 25 Nëntori (Dita Ndërkombëtare kundër dhunës në familje) apo “Talent Show” janë ndërmarrë direkt nga të rinjtë aktivistë të kësaj qendre (Koordinatori i projekteve).

Përshtatja e të rinjve me stafin e shoqatës është mjaft e mirë, për shkak të pasionit për punën që kanë të rriturit drejtues të kësaj shoqate, gjithashtu edhe për moshën e re që kanë, nga 26 – 36 vjeç.

Pengesat në pjesëmarrjen e të rinjve

Disa nga pengesat që ndikojnë në mospjesëmarrjen e të rinjve ka të bëjë me mentalitetin, mungesa e vizibilitetit dhe informimit për aktivitetet, besimi që këto organizata kanë tek prindërit e të rinjve, kushtet që krijohen dhe ajo çfarë ofrohet nga qendra. Për të kapërcyer këto pengesa, mundësia më e mirë është bashkëpunimi dhe shkëmbimi i aktiviteteve përtej qytetit, duke i dhënë mundësi të rinjve të udhëtojnë dhe të njohin bashkëmoshatarë të tyre dhe të mësojnë prej njëri tjetrit. Ftesa dhe përfshirja e personave me reputacion të mirë dhe peshë në komunitet në disa aktivitete që organizohen, do të ndihmonte të rriste besimin dhe inkurajonte të rinjtë për të kapërcyer pengesat e ndryshme që mund të hasin.

5.6. Rasti Studimor Tiranë: CRCA (Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri)

CRCA është një organizatë jo-qeveritare, jo-politike, jo-fetare dhe jofitimprurëse me qendër në Tiranë, e themeluar në Mars të 1997, me qëllim për të përmirësuar situatën e fëmijëve në Shqipëri. CRCA është e organizuar me dy borde; Bordi i Drejtorëve dhe Bordi i këshilltarëve. Prej vitit 2001, CRCA ka nisur procesin e ngritjes së zyrave lokale në Shqipëri, me qëllim për të siguruar një monitorim, raportim dhe mbrojtje më të mirë për fëmijët në Shqipëri. CRCA promovon në mënyrë të veçantë respektimin e të drejtave; të fëmijëve, të rinjve, të grave dhe të minoriteteve. CRCA ka si parim bazë të punës pjesëmarrjen e fëmijës dhe të rinjve në të gjithë procesin e vendim-marrjes të organizatës.

Mbështetja dhe mundësitë për pjesëmarrje

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) punon për të promovuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, për t'i mbrojtur ata nga

dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, për të zhvilluar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri, për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në nivelin kombëtar dhe lokal, nëpërmjet lobimit dhe avokatësisë, përmirësimit të politikave dhe legjislacionit, ngritjes së kapaciteteve, informimit dhe hulumtimit, si dhe krijimit të modeleve të mira të shërbimeve për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve. CRCA promovon zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardeve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Fëmijët dhe të rinjtë përfshihen në mënyrë aktive në planifikimin, marrjen e vendimeve dhe në zbatimin e programeve dhe të aktiviteteve të CRCA. E drejta e fëmijëve që të dëgjohen, që të shprehen lirisht respektohet plotësisht gjatë zbatimit të programeve dhe aktiviteteve tona. CRCA ofron mundësi të barabarta për vogëlushet dhe vogëlushët si dhe për të rinjtë që të marrin pjesë të shprehin opinionin e tyre, të merren në konsideratë dhe të ndikojnë në punën dhe programin tonë.

CRCA ka rreth 50 të rinj aktivistë të përfshirë në grupimin rinor "Leadershipi i të Rinjve të Tiranës". Të rinjtë e organizatave të ndryshme rinore në Tiranë dhe forumeve rinore të partive politike të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e grupit rinor, mund të përfshihen pasi të kenë bërë një kërkesë joformale, për të marrë më pas pjesë në të gjitha takimet konsultuese me një rol organizativ. Një mundësi tjetër për ti mbështetur dhe përfshirë janë trainimet dhe forumet që kjo qendër organizon.

Një aktivist i grupimit rinor "*Leadershipi i të Rinjve të Tiranës*" pohon se pjesëmarrja e tyre është e vlerësuar. Ky vlerësim vërtetohet nga qëndrimi që drejtuesit e kësaj organizate kanë ndaj të rinjve:

”Me qëllim për të kapërcyer burokracitë, shpesh organizatat përfshijnë të rinj që mund të punojnësi lehtësues apo organizator të aktiviteteve me të rinjë. Nuk është e thënë se duhet patjetër të jetë një person i ri në këtë pozicion, por patjetër është e domosdoshme që të jetë dikush që ka respekt për opinionin e të rinjve dhe një qëndrim të drejtë ndaj këtij grupi social. Ata duhet të kuptojnë rëndësinë e opinionit të të rinjve në vendimarrje” (Menaxhere Programi⁸⁸).

Egziston një besim brenda CRCA-s se pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve është vlersuar dhe çmuar.

”Pjesëmarrja e fëmijëve dhe të rinjve është e vërtetë shumë e rëndësishme. Ndërveprimi gjatë aktiviteteve për të mundësuar vendimarrjen apo planifikimin për programet dhe projektet e ndryshme është emocionuese dhe përmbushëse. Organizata u krijon lehtësirat e nevojshme të rinjve për organizimin e aktiviteteve, qofshin këto përmes koordinimit, lehtësimit, ndihmës financiare apo burimet njerëzore dhe ambientet e vëna në dispozicion” (Menaxhere Programi).

Përfitimet e CRCA-s dhe vetë të rinjve nga pjesëmarrja e tyre në aktivitete dhe programe

Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në vendimarrje dhe organizimin e fushatave apo aktiviteteve, siguron se mesazhet janë drejtuar në mënyrën më të mirë tek grupi i synuar. Përfshirja e të rinjve ndihmon gjithashtu CRCA-n të krijojë fushata dhe ngjarje

⁸⁸ Blerina Metaj, në rolin e Menaxheres së Programeve brenda CRCA. Intervista dhe vëzhgimi për këtë rast studimor është realizuar në 30 Tetor 2013.

me burimet njerëzore, të cilat janë shumë më të pranueshme nga vetë të rinjtë dhe ka shumë gjasa që të rritet edhe interesi i tyre për tu përfshirë në aktivitete.

“Është e rëndësishme që mesazhi që ne drejtojmë përmes fushatave të ndryshme të merret në mënyrë të kuptueshme dhe të zbatohet nga të rinjtë, përndryshe nuk do të kishte asnjë veprim dhe ndryshim. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë, është duke përfshirë opinionin e të rinjve. Aksionet që ne ndërmarrim janë më së miri të pranuar nga të rinjtë, sepse është më e pranueshme dhe reale për vetë ata kur të përfshirë janë direkt vetë të rinjtë. Kjo e bën mesazhin tonë më të pranueshëm dhe siguron përfshirjen e një numri më të madh në aktivitete” (Menaxhere Programi).

Pjesëmarrja e të rinjve në CRCA nxit punën vullnetare, ofron konsultime me grupet e interesit, sjell problematikat rinore në vëmendjen dhe punën e organizatës dhe afron më shumë organizatën ndaj grupeve të ndryshme rinore. Ndërsa vetë të rinjtë përmes pjesëmarrjes aktive përfitojnë eksperiencë, profesionalizëm, përgjegjshmëri, networking, sjellin problematikën e grupit të tyre në vëmendjen e politik-bërësve dhe përfitojnë çertifikata për pjesëmarrjen në trainime dhe seminare të ndryshme. Pjesëmarrja i ndihmon gjithashtu të socializohen me njëri tjetrin apo edhe të krijojnë grupime të tjera rinore, për të zbatuar në praktikë eksperiencën e përfituar.

Pengesat për pjesëmarrjen e të rinjve

Pavarësisht mundësive që ofrohen nga grupe dhe organizata të ndryshme, prapëseprapë egzistojnë pengesa të ndryshme që ndikojnë direkt në mospjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike apo edhe në vetë forumet apo shoqatat rinore. Një nga pengesat që të rinjtë

kanë identifikuar, lidhet me mosnjohjen e pjesëmarrjes dhe aktivizimit të të rinjve në forumet rinore në mënyrë formale dhe të standartizuar nga shteti. Nëse puna vullnetare do të njihej dhe vlerësohej nga universitetet dhe shteti, pjesëmarrja dhe përfshirja e të rinjve do të ishte më e madhe. Një pengesë tjetër mund të jetë edhe perceptimi që shpesh krijojnë të rinjtë për organizatat dhe forumet e ndryshme politike dhe jopolitike, si vende ku ata thjesht përdoren e shfrytëzohen pa vlerësuar meritat e tyre. Këto organizata në të shumtën e rasteve, vendosin veton në marrjen e vendimeve duke mos përfshirë realisht të rinjtë në harimin e politikave dhe strategjive të organizatës. Gjithashtu, edhe mentaliteti i trashëguar nga periudha e mëparshme se puna vullnetare apo grupimet në forumet dhe organizatat rinore i përkasin periudhës së komunizmit, përbën një pengesë për pjesëmarrjen e të rinjve⁸⁹.

5.7. Rasti Studimor, Qendra Rinore Vlorë

Qendra Rinore Vlorë e ka filluar aktivitetin më shtator të vitit 1998, si projekt i përbashkët midis dy shoqatave shqiptare dhe një italiane, financuar nga Departamenti i Çështjeve Sociale i Qeverisë Italiane. Meqenëse Qendra ka patur një aktivitet mjaft të pasur në shumë fusha duke bashkëpunuar me institucionet lokale, organizatat e ndryshme dhe aktorë të tjerë në rang lokal dhe kombëtar vendosën rregjistrimin e saj në gjykatë, me synim institucionalizimin e Qendrës.

Qendra Rinore e Vlorës mbështet zhvillimin e politikave rinore, mbrojtjen e vlerave dhe dinjitetit njerëzor duke promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, integrimin social të kategorive shoqërore në vështirësi duke i kushtuar vëmendje të veçantë, gjëndjes dhe problematikave që shqetësojnë të miturit, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara; angazhimi i promovimit të iniciativave rinore në çdo fushë që ato mund të

⁸⁹ Blerina Metaj, Menaxhere Programi, CRCA. Intervistë e mbajtur në Tiranë, dt. 30 Tetor 2013

shprehen; krijim artistik, studim, punësim, vullnetarizëm, kohë e lirë; marrja përsipër e shërbimeve në dobi të integritit të të rinjve në punë, studimit dhe në përgjithësi në shoqëri (Koordinator Projekti⁹⁰).

Qendra Rinore Vlorë punën e saj e ndan në disa sektorë të cilët janë:

- Fushata dhe aktivitete që promovojnë pjesëmarrjen rinore në vendimmarrje
- Fushata që rrisin ndërgjegjen dhe aktivizimin qytetar
- Aktivitete për informim social, shëndetësor dhe edukues ndaj shtresave në rrezik
- Aktivitete ambientale; sportive; kulturore
- Fushata promovuese dhe sensibilizuese
- Informim dhe orientim për të rinjtë mbi punësimin
- Ofrim shërbimesh rinore
- Lobim dhe krijime rrjetesh
- Lehtësim projektesh

Mbështetja për të rinjtë dhe mundësitë për pjesëmarrje aktive

Qendra Rinore Vlorë (QRV), koordinohet nga të rinjtë, me mbështetjen e të rriturve me eksperiencë. Mundësitë për tu bërë pjesë e aktiviteteve dhe vendimmarrjes egzistojnë për të gjithë të rinjtë të cilët mbështesin objektivat e QRV. Për anëtarësimin e të rinjve si aktivistë dhe vullnetarë është e nevojshme të plotësohet një formular, i cili gjendet në faqen zyrtare të qendrës www.vlorayouthcenter.org, dhe të dërgohet me postë elektronike ose të paraqitet pranë zyrës së kësaj qendre. Qendra është e vendosur në një zonë të përshtatshme dhe lehtësisht e aksesueshme nga të rinjtë (Koordinator Projekti). Qendra mbështet të rinjtë aktivistë të përfshirë në aktivitete si vullnetarë apo lehtësues, duke i promovuar si lider të së ardhmes dhe ofrues shërbimesh sociale. Një pjesë e

⁹⁰ Aulona Skendaj, Koordinator Projekti pranë Qendres Rinore Vlorë. Intervistë e zhvilluar në 1 Nëntor 2013.

aktivistëve të kësaj qendre janë përfshirë në hartimin e Strategjisë së Rinisë 2013 - 2020 në Qarkun e Vlorës.

Përfitimet e Qendrës nga pjesëmarrja e të rinjve aktivistë dhe pengesat për të rinjtë

Angazhimi i të rinjve aktivistë dhe vullnetarë në QRV ka ndikuar pozitivisht në vazhdimësinë e aktiviteteve dhe krijimin e një imazhi pozitiv në komunitetin lokal gjithashtu edhe me partnerët vendor dhe donatorët. Të rinjtë sjellin kreativitet dhe energji për stafin e përhershëm, gjë që ndikon drejtëpërdrejtë në motivimin dhe krijimin e një ambjete të përshtatshëm për të punuar. Prapëseprapë, gjatë punës janë identifikuar pengesa të ndryshme të cilat hasen nga të rinjtë që dëshirojnë të angazhohen në veprimtaritë e QRV-s. Pengesa kryesore lidhet me faktorin kohë, pasi pjesa më e madhe e të interesuarve për të dhënë një kontribut komunitar apo për tu angazhuar, janë student apo nxënës shkollash të mesme dhe shpeshherë aktivitetet përplasen me kohën e studimit të tyre, duke bërë që mos kenë mundësi të marrin pjesë (Koordinator Projekti).

Pjesëmarrja dhe angazhimi i të rinjve ka ndikuar direkt në rritjen e besimit ndaj partnerëve dhe donatorëve për të mundësuar edhe financimin për mbajtjen e Qendres Rinore në aktivitet të përditshëm. Aktorët vendor dhe qeverisja vendore prej kohësh kanë filluar të njohin dhe vlerësojnë kontributin e kësaj qendre dhe të rinjve të përfshirë. Vite më parë, kjo nuk është vlerësuar, por kohët e fundit, QRV është bërë një faktor i rëndësishëm për konsultimet me të rinjtë dhe të gjitha çështjet rinore që zhvillohen nga institucione vendore në Vlorë (Koordinator Projekti).

Stafi i kësaj qendre sugjeron se mbetet shumë për tu bërë që të rinjtë të vlersohen realisht për kontributin e tyre. Një shembull praktik lidhet me realizimin e një Plani

Veprimi që kjo Qendër ka realizuar në bashkëpunim me aktorët vendor dhe pret që ky plan të zbatohet në praktikë. Mbështetja konkrete e këtij Plani Veprimi kërkon jo vetëm vullnet, por edhe mbështetje financiare nga pushteti vendor. Nëse autoritetet vendore vendim-marrëse do ta marrin seriozisht është koha më e mirë për të vepruar dhe marrë në konsideratë një punë voluminoze nga të rinjtë e kësaj Qendre.

5.8. Konkluzione nga rastet studimore

Vëzhgimi i forumeve rinore të marra si raste studimore na jep mundësinë të pohojmë se të gjitha organizatat dhe forumet rinore janë përfituese direkte nga pjesëmarrja e të rinjve. Përfshirja e të rinjve bën të mundur:

- Përmirësimin e imazhit të këtyre organizatave/forumeve në komunitetet ku veprojnë
- Rrit reputacionin dhe besueshmërinë tek partnerët e ndryshëm
- Ndhmon në arritjen e objektivave dhe zbatimin e projekteve
- Ndhmon në sigurimin e mbështetjes nga autoritetet vendore dhe donatorët
- Rrit mundësitë për bashkëpunime me grupe të ndryshme rinore vendore dhe ndërkombatare
- Rrit kapacitetet dhe qëndrueshmërinë e organizatës

Secila prej organizatave të marra në studim pranon faktin se pjesëmarrja e të rinjve ka ndihmuar dukshëm në sigurimin e shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme për grupet e targetuara. Përfshirja e të rinjve në planifikimin dhe zbatimin e projekteve apo shpërndarjen e shërbimeve i ndihmon ata të reflektojnë se çfarë dëshirojnë në të vërtetë të rinjtë dhe për çfarë janë më shumë të interesuar.

Për shkak se edhe vetë ky studim trajton pjesëmarrjen e të rinjve, domosdoshmërisht që mbështet tek shkalla e pjesëmarrjes së Hart (1992), e cila në fakt u identifikua si mjet për të identifikuar pjesëmarrjen tek secila organizatë. Gjatë analizës së rasteve studimore, vihet re se RSL Kukës e përdor këtë praktikë për të përcaktuar rolet dhe vendodhjen në proceset e pjesëmarrjes rinore, megjithatë, duket qartë se nuk është e lehtë të përcaktohet roli i të rinjve në të gjitha rastet brenda këtyre forumeve rinore të cilat promovojnë pjesëmarrjen. Mungesa e vlerësimit për përfitimet e pjesëmarrjes rinore brenda organizatave, duhet të jetë praktikë e grupeve rinore, me qëllim për të treguar se përfshirja dhe pjesëmarrja ka vlerë për vetë organizatën dhe komunitetin ku zbatohen programet dhe aktivitetet e forumeve rinore.

Marrja në studim e këtyre rasteve tregon qartë se pjesëmarrja përftohet në mënyra të ndryshme. Për disa organizata pjesëmarrja dhe zhvillimi komunitar janë përfitime organizative. Megjithatë, tre palë të përfshira në bashkëveprim janë përfituese direkte për shkak të pjesëmarrjes së të rinjve; organizatat/forumet rinore, vetë të rinjtë dhe komuniteti. Kultura organizative dhe angazhimi për pjesëmarrje, diktojnë impakt direkt në pjesëmarrjen e të rinjve. Organizatat duhet të jenë të vetdijshme dhe të përgatiten për të adresuar pengesat për pjesëmarrje dhe të respektojnë mundësinë e të rinjve për të kontribuar në çështjet që u interesojnë atyre.

Kapitulli VI: ZGJEDHJET DHE ROLI I TË RINJVE

6.1. Votuesit për herë të parë: marrëdhëniet me politikën, pjesëmarrja dhe sjellja gjatë fushatës elektorale

Egzistojnë teza se votuesit e rinj janë të ndikuar dukshëm nga sjellja e familjes ndaj politikës (Krasniqi, 2013), duke lënë kështu jashtë vëmendjes kryesore të rinjtë gjatë

periudhës së tranzicionit në Shqipëri. Megjithatë kohët e fundit, sjellja e politikës duket se ka ndryshuar, duke i dhënë një rëndësi të veçantë komunikimit me këtë grup social. Prapëseprapë, vëzhgimet dhe raportet e organizatave dhe institucioneve të ndryshme të përfshira në vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri, kanë treguar se pjesëmarrja e të rinjve në fushatat zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve ka qenë disa herë më i vogël, sesa rasti i votuesve në moshë më të rritur.

Çështja e sjelljes elektorale të votuesve për herë të parë është një temë shumë interesante për të cilën janë zbatuar projekte të ndryshme nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile, megjithatë shumë pak raste studimore janë ndërmarrë nga studiues në Shqipëri.

Marrëdhëniet dhe sjelljet e votuesve për herë të parë me politikën dhe fushatën zgjedhore, rezultojnë në mungesën e dëshirës dhe interesit për të marrë pjesë për disa arsye të ndryshme:

- a) Të rinjtë që votojnë për herë të parë nuk janë të përfshirë në forumet politike dhe se nuk kanë vendosur se për cilën parti politike do të votojnë.
- b) Mungesa e besimit tek politika dhe politikanët, të cilët shikohen nga votuesit e rinj si përfitues direkt nga zgjedhjet dhe dështakë në realizimin e premtimeve.
- c) Mungesa e aktiviteteve argëtuese dhe informuese për të rinjë, largon vëmendjen e votuesve të rinj për tu angazhuar.
- d) Neveria dhe mosbesimi ndaj politikanëve të përhershëm në skenën politike, të cilët nuk kanë ditur të realizojnë ndërrimin e pushteteve sipas rregullave demokratike.

Veç fakteve të përmendura më sipër, të rinjtë votues për herë të parë, me sa duket nuk kanë provuar rezultate konkrete nga aktiviteti i parlamentarëve të mëparshëm, që të ketë tërhequr vëmendjen e tyre për tu angazhuar gjatë fushatës elektorale.

Zgjedhjet shihen si një mundësi për qytetarët për të ndikuar drejtuesit politik, por ato gjithashtu shërbejnë si një mjet për të mobilizuar partitë dhe kandidatët në proceset demokratike. Teorikisht, zgjedhjet demokratike duhet të bëjnë që qytetarët të ndjehen më mirë për institucionet dhe procesin politik të tyre. Në të vërtetë, një lidhje midis tyre mund të gjendet midis pjesëmarrjes politike, zgjatjes dhe efikasitetit politik (Finkel, 1987). Me qëllim për të kontribuar në debatin lidhur me pjesëmarrjen e votuesve për herë të parë në zgjedhje, është e rëndësishme të kuptojmë se cilët janë faktorët që ndikojnë tek të rinjtë për të marrë vendimin për të votuar ose jo, për tu përfshirë në fushatat zgjedhore ose jo. Gjithashtu është shumë e rëndësishme për të kuptuar aspektet e fushatave zgjedhore të cilat mund të kenë ndikim direkt në mobilizimin e të rinjve për forcat e ndryshme politike.

Të rinjtë në Shqipëri sikurse edhe në shumë vende të tjera, kanë shkruar historinë e demokracisë duke shembur komunizmin në vitin 1991. Gjatë fillësës së periudhës së tranzicionit, roli i të rinjve në politikë ka qenë shumë i rëndësishëm, për vetë faktin se sollën ndryshimet e shumëpritura, dhe u bënë pjesë e forumeve më të larta politike të asaj kohe. Por me kalimin e kohës, vihet re një dobësim i rolit të tyre në politikëbërje, duke bërë gjithashtu që ëndrrat e tyre për Europën të mbeteshin të porealizuara për dekada.

Përdorimi i të rinjve vetëm si fasadë gjatë zgjedhjeve ka vazhduar gjatë gjithë fushatave elektorale të partive kryesore për periudhën e tranzicionit deri në ditët e sotme, por pa i

dhënë rolin përcaktues në politikat që i përkasin interesave të tyre. Prapëseprapë, krijimi i forumeve rinore pranë partive politike, ka mundësuar pjesëmarrjen deri diku të të rinjve të cilët kanë aderuar në politikë, duke sjellë të rinjë deri në majat e vendimarrjes politike në Shqipëri. Ndër këta të rinjë kanë qenë dy ish-Kryeministrat Pandeli Majko dhe Ilir Meta, të cilët dolën nga FRESSH, apo Sokol Olldashi nga FRPD. Megjithatë, duket qartë se kjo nuk ka ndryshuar asgjë në pjesëmarrjen apo sjelljen e politikës ndaj të rinjve, pasi përfshirja e tyre në zgjedhje mbetet shumë e ulët.

Ky kapitull fokusohet në faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e votuesve për herë të parë, duke analizuar dhe matur se sa ndikojnë prindërit tek fëmijët e tyre, aktiviteti politik dhe komunikimi publik i politikanëve gjatë fushatave elektorale dhe sjellja e tyre me votuesit e rinj në Shqipëri. Duke përdorur qëndrimet e të rinjve të mbledhura nga intervistat në terren, ky informacion do të krahasohet me sjelljen e votuesve në zgjedhjet e mëparshme për të vëzhguar nëse kjo situatë do të përsëritet gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të verës 2013. Studimi sjell në vëmendje faktin se të rinjtë të cilët kanë prindërit e tyre aktiv në politikë, kanë më shumë gjasa për të marrë pjesë në zgjedhje sesa pjesa tjetër e cila nuk ka lidhje të ngushta dhe aktive me politikën.

6.2. Ndikimi i prindërve tek fëmijët e tyre Votues për herë të parë

Vëzhgimi nga afër i procesit të zgjedhjeve dhe faktorit të pjesëmarrjes lidhet ngushtë me faktorët që ndikojnë në sjelljen e votuesve për herë të parë, dhe në mënyrë të veçantë analizon ndikimin e prindërve tek fëmijët e tyre për aktivitetet politike dhe kryesisht procesin e votimit. Studimet egzistuese të cilat lidhen me ndikimin tek sjellja e të rinjve, janë fokusuar në atë nëse të rinjtë trashëgojnë ideologjitë e prindërve të tyre dhe identifikimin me partitë që janë të lidhur. Ndërkohë është lënë jashtë vëmendjes,

fakti që lidhet me nxitjen dhe inkurajimin nga ana e prindërve tek fëmijët e tyre, duke pasur më shumë gjasa ndikimi që të rinjtë të votojnë rregullisht.

Për prindërit të cilët merren me politikë, është e rëndësishme të rrënjosin dëshirën për pjesëmarrje politike tek fëmijët e tyre, ose në të kundërt, çdo gjeneratë që vjen do të shkëputet edhe më shumë nga politika (Jones, 2007). Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrja e votuesve ka rënë vitet e fundit në Shqipëri për të gjitha grupet, duke përfshirë këtu edhe prindërit e votuesve për herë të parë të zgjedhjeve të përgjithshme të 23 Qershorit 2013. Një përqindje e madhe e prindërve, fëmijët e të cilëve janë votues për herë të parë në Shqipëri, janë të moshës rreth 40-50 vjeç, tregues ky që përputhet me votimin për herë të parë të tyre në sistemin e demokracisë, dmth pa një traditë në të shkuarën komuniste, por me zhgënjime dhe përjetime dramatike ndryshimesh në rininë e tyre. Për këtë arsye, prindërit e të rinjve të sotëm kanë më pak gjasa sesa prindërit e mëparshëm për të votuar vetë, pa folur për angazhimin e fëmijëve të tyre në proceset politike.

Dy gjëra shumë të rëndësishme që ndikojnë në orientimin e një të rrituri drejt politikës lidhen me origjinën politike dhe lidhjet e prindërve të tyre dhe presionin e shoqërisë gjatë kohës (Beck, 1991). Nëse i referohemi faktorit të parë, duhet të pranojmë se me ardhjen e demokracisë janë identifikuar dy grupime politike të dalluar prej njëri tjetrit; poli ish-komunist, që është identifikuar me grupet e majta dhe poli i qendrës së djathtë, me përfaqësuesit e rinj në politikën shqiptare. Pavarësisht përpjekjeve fillestare për të krijuar një grupim politik me të rinj që sollën ndryshimet, me kalimin e kohës pozicionet ndryshuan, duke risjellë në krye të partive të reja ish drejtues të vjetër, për të shmangur kështu rolin e të rinjve, dhe për të zbehur ëndrrat e tyre për një Shqipëri Europiane.

Pavarësisht faktit se të rinjtë ndikohen apo në disa raste të tjera urdhërohen të votojnë për të njëjtën parti politike sikur dhe prindërit e tyre, gjatë intervistave të kryera në terren me të rinjtë të cilët do të votojnë për herë të parë në zgjedhjet e Qershorit 2013, ata shprehen se:

“...ky është një fenomen që ndodh në Shqipëri por nuk do të lejoj të ndodhë me mua...unë kam bindjet e mia politike dhe do zgjedh atë që është më e mira për mua dhe familja ime nuk do të më imponojnë votën (M. Elezi⁹¹)”,

Ndërsa Altini⁹² mendon se:

“nuk ka asgjë të keqe nëse voton njësoj si familja, pavarësisht se unë jam i mendimit se të rinjtë duhet të kenë bindjet e tyre. Ka raste ka plot kur familjet e përfshira në politikë, ushqejnë fëmijët e tyre me të njëjtën bindje politike, dhe ana tjetër është presioni social, që deytron të rinjtë nga këto familje të bëjnë tifo apo të mbajnë anën e prindërve, duke u pozicionuar politikisht që në moshë të re pa qenë të bindur përse e mbështesin atë forcë politike”.

Një tjetër vajzë, Blerta⁹³ e cila voton për herë të parë mendon se

“...më shumë sesa fakti i ndikimit të prindërve, është shoqëria e shkollës që ndikon në pozicionimin e të rinjve për një krah politik. Një pjesë e

⁹¹M. Elezi. Studente në Fakultetin Ekonomik Kukës, 21 vjeçe vtouese për herë të parë. Intervisa e zhvilluar me dt. 13 Prill 2013.

⁹²Altin Zyberaj, 21 vjeç i papunë, votues për herë të parë. Intervisa e zhvilluar me dt. 13 Prill 2013.

⁹³Blerta, 18 vjeçe, nxënëse në shkollën e mesme votuese për herë të parë. Intervisa e zhvilluar me dt. 14 Prill 2013.

votuesve për herë të parë të cilët vijnë nga familje që nuk janë të lidhur me politikën nuk kanë interes fare për të votuar dhe janë të lëkundur, ndërsa ata të cilët vijnë nga familjet me prindër të cilët kanë drejtuar institucione sado të vogla - në rang drejtorësh, apo shefa departamentesh - marrin pozicionin pa filluar fushata, duke mbrojtur prindërit e tyre përballë shokëve të shkollës. Kjo e dallon prej fillimit se për cilën parti ai/ajo do të votojë në zgjedhjet e ardhshme”.

Intervistat tregojnë qartë se votuesit për herë të parë ndikohen nga prindërit e tyre, duke rritur pjesëmarrjen dhe angazhimin politik të të rinjve, megjithatë mbetet për tu vëzhguar në vazhdim nëse ata votojnë për të njëjtën parti politike, apo zgjedhin forca të reja politike. Është interesant fakti që kemi gjetur gjatë këtij studimi se pavarësisht ndikimit të prindërve tek të rinjtë për tu angazhuar në zgjedhje, në familjet e tyre nuk bisedohet asnjëherë për politikë apo të këtë raste kur prindërit këshillojnë të zgjedhin një parti të caktuar apo të bëhen pjesë e tyre. Të pyeturit shprehen se kjo zgjedhje është e fëmijeve, për shkak të sjelljes së vazhdueshme të prindërve ndaj fenomeneve politike që zhvillohen në vend. Gjithashtu, 60% e të pyeturve, pohojnë se ata mbajnë mend se prindërit e tyre kanë votuar sa herë janë zhvilluar zgjedhje në Shqipëri. Këta faktorët, sikurse përmendëm pak më sipër - që kanë të bëjnë me përfshirjen e prindërve - mund të lehtësojnë ndikimin e pjesëmarrjes rinore në fushatën zgjedhore. Të rinjtë, prindërit e të cilëve janë të përfshirë në mënyrë aktive në politikë, kanë më shumë gjasa të bëhen edhe ato vetë aktiv, ndërsa për të rinjtë, prindërit e të cilëve nuk janë pjesëmarrës në politikë, kanë më pak gjasa për tu përfshirë në aktivitetet politike (Fletcher, 2007).

6.3. Marrëdhëniet e të rinjve me partitë politike dhe pjesëmarrja në zgjedhje

Në Kushtetutën e Shqipërisë sanksionohet me ligj se “Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet” (Kushtetuta e Shqipërisë, 1998). Pavarësisht se Shqipëria është një nga vendet me përqindje të lartë të të rinjve në raport popullsie, ata prapëseprapë nuk konsiderohen pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes. Mospjesëmarrja e të rinjve në jetën publike dhe vendimmarrje është një tregues i demokracisë së brishtë që sjell pasoja të mëdha për jetën publike, duke i përjashtuar nga konsultimet për politikën që lidhen direkt me ta.

Pavarësisht përqindjes së ulët të pjesëmarrjes në zgjedhje të votuesve për herë të parë që mund të ketë patur deri tani, interesi për të votuar në zgjedhjet e përgjithshme të Qershorit 2013 duket i madh. Kjo u reflektua nga përgjigjet që morem gjatë këtij studimi kur u pyetën nëse do të shkonin për të votuar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013, ku 85% e të pyeturve pohojnë se do të votonin, 55% e tyre për arsye se prindërit e tyre janë të lidhur me partitë politike, të punësuar ose që presin të punësohen. Duke iu referuar këtij fakti, duhet të pohojmë se përqindja e të rinjve që marrin pjesë në zgjedhje duhet të jetë i lartë, pavarësisht disa studimeve të mëparshme të cilat tregojnë se vetëm grupmosha 18-35 vjeç përbëjnë vetëm 34% të votuesve në Shqipëri (Grabova, 2010). Kjo duket jo realiste, për faktin se këto studime nuk kanë marrë parasysh numrin e lartë të të rinjve që kanë emigruar në vende të ndryshme. Duhet të pranojmë faktin se përqindja e votuesve të rinj në zgjedhjet e përgjithshme duket qartë se do të jetë më e madhe se në të shkuarën, për vetë faktin e një vëmendje të veçantë që po i kushtohet këtij grupi social.

Disa nga faktorët që kanë prodhuar nivele të ulta të pjesëmarrjes rinore në politikë gjatë viteve të tranzicionit, kanë të bëjnë me mungesën e politikave të qarta dhe funksionale për të rritur përfshirjen e të rinjve në jetën publike dhe vendimmarrje, apo nënvlerësimi që i bëhet kësaj kategorie nga pushtetarët e niveleve të ndryshme. Këtyre faktorëve u bashkëngjiten edhe mosfunksionimi si duhet i forumeve rinore politike, të cilat në të shumtën e rasteve kanë rezultuar në pabarazi gjinore, duke favorizuar pjesëmarrjen më të madhe për djemtë sesa për vajzat.

Gjatë këtij studimi është evidentuar mungesa e aktiviteteve argëtuese dhe informuese për të rinjtë, e cila largon vëmendjen e votuesve të rinj për tu angazhuar. Të rinjtë kanë nevojë për aktivitete të cilat tërheqin vëmendjen e tyre dhe ofrojnë mundësi argëtuese. “Në pjesën më të madhe të rasteve, politika organizon takime dhe tryeza me të rinjtë, duke përdorur formatin e zakonshëm që përdoret edhe për të rritur të moshave të ndryshme”⁹⁴. Kjo metodë nuk mund të jetë atraktive për moshat e reja. Një tjetër faktor që ka ndikuar dukshëm në mospjesëmarrjen e të rinjve në politikë ka të bëjë me nivelin e lartë të emigracionit drejt vendeve të zhvilluara perendimore. Të rinjtë ruajnë numrin më të madh të emigracionit gjatë viteve të tranzicionit, duke ndikuar dukshëm në largimin e trurit.

Të pyeturit votues për herë të parë, të papërfshirë ende në politikë nëse do të pranonin një ftesë për tu bashkuar me një parti politike japin këto opinione; 45% përgjigjen se nuk do ta pranonin këtë ftesë, ndërsa 65% e tyre do ta kishin pranuar nëse ftesat për tu bërë pjesë e një partie përmbushin pritshmëritë e tyre duke dhënë arsye se:

⁹⁴ Altin Zyberaj, 21 vjeç i papunë, votues për herë të parë. Intervista e zhvilluar me dt. 13 Prill 2013.

“...për momentin unë kam prioritetet e tjera, dhe nga ana tjetër mendoj se duhet më shumë kohë që të forcoj apo të kuptoj bindjet e mia politike, përpara se të marr një vendim të tillë për anëtarim”⁹⁵Uarda,

“...nëse do të kishte një forcë të re politike, pse jo, pasi politikës i duhet një ndryshim rrënjësor” Xhoana⁹⁶,

“ nuk do ta pranoja për faktin se mungon besimi tek çdo parti politike” Adelina⁹⁷,

ndërsa Altini shprehet se:

“ të rinjtë përdoren nga politika vetëm për qëllime elektorale, pas zgjedhjeve të rinjtë nuk janë më pjesë e proceseve të konsultimeve, pa folur për vendim marrje. Për këtë arsye nuk do të shkoj të votoj, sepse vota ime nuk ka peshë dhe nuk do të ndryshonte asgjë”.

Një përqindje e vogël shprehen gjithashtu se do të pranonin ftesën për shkak të interesave, të cilat mund të lidhën me mundësinë për punësim, duke pohuar se,

“...Partitë politike janë kthyer në zyra punësimi. Punësohen të rinj pa merita, shpesh me lidhje nepotike, por edhe duke përfitur nga militantizmi gjatë fushatave elektorale. Prandaj mendoj se ndonjëherë duhet përdorur kjo mundësi, përderisa vazhdojmë të shikojmë të rinj me shkollë të gjysëm të mbaruara, apo të tjerë që janë servilë të cilët

⁹⁵Uarda Begaj, 19 vjeçe, studente, votuese për herë të parë, nga Fieri. Intervista e zhvilluar me dt. 17 Prill 2013.

⁹⁶Xhoana Cahani, 20 vjeçe, studente në Turqi, votuese për herë të parë. Intervista e zhvilluar me dt. 17 Prill 2013.

⁹⁷Adelina. C., maturante në shkollën e mesme Havzi Nela, Kukës, votuese për herë të parë. Intervista e zhvilluar me dt. 14 Prill 2013.

punësohen për shkak të lidhjeve të dyshimta të deputetëve apo të kryetarëve të partive në pushtet” Ardi⁹⁸.

Përveç komenteve të mësipërme, ne mund të pohojmë faktin se shkak për mungesën e interesit ndaj politikës aktive të të rinjve është mungesa e besimit se politika zgjidh problemet e tyre. Kjo vjen për vetë faktin se politikanët nuk kanë treguar seriozitet në përmbushjen e premtimeve në fushtatat elektorale para-ardhëse. Një tjetër arsye për të qenë larg politikës dhe zgjedhjeve sipas të anketuarve, lidhet me faktin se në politikë, qoftë në nivel kombëtar apo atë lokal shikojmë vazhdimisht të njëjtat fytyra. Një nga të intervistuarit shprehet se;

“...më duket se jam rritur duke parë dhe dëgjuar në televizion të njëjtët persona, të cilët në fushatat elektorale na e bëjnë të ardhmen fushë me lule, por kur vjen puna për ti zbatuar, asgjë nuk lidhet me premtimet e tyre. Prej kohës që mbaj mend e deri sot kur jam gati të votoj për herë të parë, jo vetëm në nivel qendror por edhe në atë lokal janë të njëjtit njerëz të cilët drejtojnë dhe prapëseprapë asgjë nuk po ndryshon. Nëse në rrethe ndonjëherë ndryshojnë kryetarët e partive të mëdha, kjo nuk ndodh me kryetarët e partive të vogla, të cilët kanë më shumë sesa mosha ime duke drejtuar të njëjtën parti. A mund të flitet për demokraci në këtë vënd?”

Besi⁹⁹

⁹⁸ Ardi, 20 vjeç, i papunë, votues për herë të parë, Shkolla e Mesme H. Nela, Kukës. Intervista e zhvilluar me dt. 14 Prill 2013.

⁹⁹ Besmiri, 19 vjeç, student, votues për herë të parë. Intervista e zhvilluar me dt. 18 Prill 2013, në Kukës.

6.4. Efekti i medias tek të rinjtë

Supozimet teorike për sjelljen sociologjike të votuesve janë përcaktuar në studimin e Paul Lazarsfeld në *'The People's Choice'*. Ky studim trajton dy partitë kryesore të SHBA-së, gjatë fushatës zgjedhore, për të identifikuar votuesit të cilët ndryshuan pozicionin e tyre gjatë fushatës zgjedhore, duke krahasur tre grupe: ata të cilët vendosën se për cilën parti do të votojnë para se të niste fushata, ata të cilët vendosën gjatë konventës së partive dhe ata të cilët vendosën për kë do të votojnë vetëm ditët e fundit të fushatës (Lazarsfeld, 1987).

Një numër i madh studimesh kanë hulumtuar mënyrat sesi media zgjedh të mbulojë fushatat zgjedhore, duke kontribuar kështu në rritjen dhe angazhimin qytetar në zgjedhje, megjithatë kjo nuk na tregon shumë për votuesit që votojnë për herë të parë. Media sociale sot ka pushtuar të rinjtë, të cilët janë përdoruesit kryesor, megjithatë politikanët të cilët janë të ndërgjegjshëm për rolin e të rinjve në zgjedhje, janë bërë po aq promotorë dhe përdorues të rrjeteve sociale sa edhe vetë të rinjtë, duke synuar tërheqjen e sa më shumë të rinjve rreth tyre.

Bota virtuale siguron një ambjent të ri për votuesit për herë të parë për tu angazhuar në politikë, në një ambjent i cili shoqërohet përgjithësisht me një përqindje të lartë demografike nga të rinjtë (Xenos & Foot, 2007). Media online është kthyer në një element të rëndësishëm për praktikuesit politik në fushatat zgjedhore për të komunikuar më së shumti me votuesit e rinj. Fushata zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme të Qershorit 2013, ka provokuar përdorimin e rrjeteve sociale të politikanëve të cilët deri në prag zgjedhjesh nuk kanë qenë pjesë e tyre. Kjo qasje e politikanëve ndaj rrjeteve sociale, pavarësisht moshës së tyre, lidhet direkt me interesat për të tërhequr vëmendjen

e të rinjve, të cilët përbëjnë shumicën e përdoruesve në rrjetet online. Të rinjtë shprehen se media përmes internetit është mjeti kryesor për të ndjekur zhvillimet elektorale, dhe pranojnë faktin se janë politikanët ata të cilat ndjekin të rinjtë në rrjete, më shumë sesa të rinjtë politikën. Një përdorues interneti votues për herë të parë shprehet se “ne, moshat e reja, ishim në rrjete sociale dhe përdorues të internetit para politikanëve, ndërsa sot ata na janë bashkuar dhe përpiqen të kenë sa më shumë miq dhe komente në internet¹⁰⁰”.

Të dy palët, drejtuesit e partive dhe kandidatët për tu zgjedhur në Kuvendin e Shqipërisë në zgjedhjet e 2013-ës nga njëra anë, dhe zgjedhësit nga ana tjetër kanë një qasje krejt të re për mënyrën e përfshirjes në fushatën elektorale. Nëse dikur promovimi i kandidatëve synohej të bëhej përmes takimeve direkte apo mitingjeve elektorale, me postera rrugëve apo përdorimi i televizioneve lokale, tashmë vëmendjen e votuesve e tërheqin përmes internetit, duke e përdorur si mjet komunikimi dhe promovimi. Kjo është një sjellje e re ndaj së cilës po përshtaten të dy palët, ku më të fituarit mund të jenë përsëri politikanët, duke shmangur takimet direkte dhe zvogëluar shpenzimet gjatë fushatave elektorale. Ky do të ishte edhe efekti negativ i medias, pasi politikanët do të shpenzojnë më pak kohë për konsultime direkte me qytetarët për të dëgjuar problemet dhe nevojat e tyre.

Nëse ne marrim një përgjigje për ndikimin e medias tek të rinjtë duke tërhequr vëmendjen e tyre, lind nevoja për të ngritur pyetjen tjetër: A ndikon sot media në rritjen e besimit tek politika apo ajo e dëmton atë? Studime për zgjedhjet në SHBA, tregojnë se vëmendja e medias në fushatë elektorale ka zvogëluar besimin ndaj politikës (Cahn, 1997). Megjithatë, fushatat zgjedhore, mbërrijnë fillimisht tek votuesi përmes medias, duke paraprirë dhe lehtësuar komunikimin mes dy palëve në takimet direkte. Në rastin

¹⁰⁰ A.D. 18 vjeç, shkëputur nga anketa e dt. 14 Maj 2013, Kukës

tonë, të rinjtë e anketuar shprehen se media ka ndikuar negativisht tek votuesit. Rastet e denoncimit të korrupsionit, akuzat e ndërsjellta, fyerjet dhe fjalori i përdorur në parlament dhe foltoret mediatike kanë dhënë mesazhe negative, duke prodhuar një zhgënjim dhe përbuzje popullore ndaj sjelljes së politikanëve me kundërshtarët e tyre, në mungesë të plotë të respektit ndaj qytetarëve dhe votuesve.

Pavarësisht përdorimit të madh të internetit si mjet komunikimi nga të dy palët, politikanët dhe të rinjtë zgjedhës, duhet të pranojmë faktin se media nga njëra anë krijon zhgënjim të madh për qytetarët drejt politikës dhe politikanëve, ndërsa nga ana tjetër tenton të rrisë vëmendjen dhe pjesëmarrjen në zgjedhje.

6.5. Vëmendja e politikës ndaj të rinjve

Pavarësisht rëndësisë së madhe që kanë të rinjtë në proceset demokratike dhe në zgjedhjet qofshin ato lokale apo të përgjithshme, faktet që lidhen me politikën e dështuara të punësimit apo edhe edukimit, tregojnë se ata nuk janë marrë në konsideratë përveç fushatave elektorale, kohë kjo kur politikanët kanë nevojë për votat më shumë sesa për kontributet dhe idetë e tyre. Ndryshe nga fushtatat e mëparshme, sjellja e politikës ndaj të rinjve gjatë fushatës zgjedhore 2013, ka prodhuar një sjellje dhe vëmendje të veçantë nga politikanët dhe drejtuesitë partive më të mëdha politike të vendit. Fushata e parakohshme e zgjedhjeve të përgjithshme të 2013-ës, ka provokuar debat për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik dhe vetë të rinjve duke i joshur me premtime dhe deklarata të ndryshme. Një ndër debatet e veçanta dhe më me interes ishte ulja e moshës për të votuar, deklarata kjo e ardhur nga Kryeministri i vendit në atë kohë, dhe njëherësh kryetar i PD-s, Z. Sali Berisha. Deklarata si kjo tregojnë qartë populizmin dhe kërkojnë të kenë efekte vetëm elektorale, sepse në rast të kundërt, nëse kjo do të

ishte një nismë serioze që synon përfshirjen e 16 vjeçarëve në vendimarrje, duhet që debati të ishte nisur shumë kohë para fushatës, duke konsultuar grupet e interesit dhe testuar opinionin publik.

Egziston një dallim i dukshëm midis pjesëmarrjes rituale boshe dhe të pasjes së një pushteti të nevojshëm për të ndikuar rezultatet e procesit (Arnstein, 1969). Duke ndjekur diskutimin lidhur me pjesëmarrjen, duhet të marrim në konsideratë teorinë e Roger Hart mbi pjesëmarrjen komunitare për grupet rinore i cili i bën një vlerësim të qartë niveleve të ndryshme të pjesëmarrjes, të cilin e nis me shkallën e manipulimit, tek të rinj për dekorim, informimi, konsultimi i vendimeve me të rinjtë, dhe për të përfunduar në nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, tek ndërmarrja e aksioneve të pavarura dhe marrja pjesë njësoj në vendimarrje¹⁰¹ (Hart, 1997). Për momentin, vëzhgimi gjatë këtij studimi dhe faktet e mbledhura në terren tregojnë se procesi i pjesëmarrjes në Shqipëri, është në hapin kur të rinjtë janë të manipuluar dhe përdoren për dekorim gjatë fushatave elektorale. Ajo çfarë politikanët janë të interesuar për fushatën aktuale, ka të bëjë me efektin mediatik më shumë sesa konsultim real apo aksione të ndërmarra nga të rinjtë. Kur flasim për të rinjtë, kemi parasysh se nuk po e trajtojmë këtë grup si të përgjithshëm, por duhet të sjellim në vëmendje se ka forume rinore pranë partive politike të cilat duhet të jenë të pavarura, por që në fakt deri tani kanë treguar se bëjnë shumë mirë vetëm pjesën e dytë të shkallës së Hart, *dekorimin*.

¹⁰¹Modeli i shkallës së pjesëmarrjes së Hart, në të vërtetë është një version i përshtatur i “the ladder of citizen participation” krijuar nga Sherry Arnstein, e cila shfaqet në një artikull në “Journal of the American Planning Association”, në vitin 1968

6.6. Konkluzione për votuesit për herë të parë dhe rolin e tyre në zgjedhje

Identifikimi i modeleve pjesëmarrëse, të sjelljes gjatë fushatës elektorale dhe marrëdhënieve midis politikës dhe votuesve për herë të parë, është një hap drejt kuptimit më mirë të faktorëve që promovojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në vendimarrje dhe influencën e tyre në demokratizimin e vendit. Kapitulli që sapo trajtuam vë theksin tek rëndësia e votuesve të rinj, të cilët pavarësisht përdorimit nga politika, mbeten një grup social shumë i rëndësishëm për tu konsideruar në ndikimin e rezultatit të zgjedhjeve. Në asnjë rast, ky hulumtim nuk pretendon të shterojë debatin për marrëdhëniet e këtyre grupeve, përkundrazi, synon në nxitjen për një debat kritik më të specializuar dhe më të thelluar. Prapëseprapë, duke nërmarrë kërkime në terren, ne sjellim vëzhgime të rëndësishme, të cilat pohojnë se të rinjtë votues për herë të parë nuk janë shumë të interesuar për të qënë afër politikës, për shkak të zhgënjimeve dhe papërshtatshmërisë së zhvillimit të aktiviteteve nga politika. Ata, nuk janë as të informuar dhe as të konsultuar nga politika sa duhet për çështjet që lidhen direkt me interes e tyre, por janë të ndikuar mjaftueshëm nga familjarët dhe të afërmit e tyre për të marrë pjesë dhe vendime në zgjedhjet elektorale.

6.7. Zgjedhjet e Përgjithshme të 2013-ës. Pjesëmarrja dhe roli i të rinjve në fushatën elektorale dhe zgjedhje

Zgjedhjet parlamentare të datës 23 Qershor 2013 janë konsideruar si një test i rëndësishëm për demokracinë dhe aspiratat e Shqipërisë drejt integritit në Bashkimin Evropian, kjo për shkak të polarizimit të madh dhe mungesës së stabilitetit dhe klimës së mosbesimit ndërmjet palëve në zgjedhjet e zhvilluara gjatë periudhës së tranzicionit. Gjatë gjithë fushatës parazgjedhore, partnerët ndërkombëtarë kishin vënë theksin në

domosdoshmërinë e standarteve demokratike. Kjo i jepte një rëndësi të veçantë procesit zgjedhor, për faktin se Shqipëria duhet të bënte gjithçka për të finalizuar tranzicionin në kontekstin e integritetit Europian. “Arritja e standarteve për zgjedhje të lira e të ndershme, është para-kusht për statusin e vendit kandidat dhe hapjen e negociatave për antarësim¹⁰².

Shqipëria hyri në zgjedhjet e 23 Qershorit me një kuadër të përmirësuar ndjeshëm në reformën elektorale të Korrikut 2012, prapëseprapë, zgjedhjet u mbajtën në një klimëpolitike të polarizuar, e cila ka egzistuar që pas rezultatit të kontestuar të Bashkisë së Tiranës në 2011-ën, dhe ka vazhduar me kalimin e Lëvizjes Socialiste për Integritet në krahun opozitar në muajin Prill 2013 (KVV, 2013). Megjithatë, në fundin e zgjedhjeve të 23 qershorit, ndryshe nga zgjedhjet e mëparshme, u pranuan nga të gjitha forcat politike duke shënuar një rotacion të qetë të pushtetit dhe duke legjitimuar plotësisht rezultatin e tyre.

Gjatë këtij studimi, kemi theksuar disa herë pjesëmarrjen si në proces që mundëson një komunikim të vazhdueshëm midis vendimarrësve dhe grupeve komunitare, duke u dhënë mundësi vendimarrësve që të jenë koherent dhe të njohin edhe prioritetet e komuniteteve lokale. Efekti do të ishte njësoj, nëse zgjedhjet dhe fushatat zgjedhore shfrytëzohen për një komunikim midis kandidatëve dhe qytetarëve. Megjithatë, pjesëmarrja qytetare në debatet publike nuk ka rezultuar të jetë realiste, për sa kohë në takime ftohen vetëm mbështetësit e një partie të caktuar. Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, pjesëmarrja e rinjve në procesin e zgjedhjeve ka qenë e ulët, ndërsa ndryshe nga zgjedhjet e shkuara, fushata e zgjedhjeve të 2013-s ka nxitur një diskutim

¹⁰²Catherine Ashton “Elections are a test for EU Progress”, www.tiranatimes.com

brenda forumeve të partive kryesore për të përfshirë dhe inkurajuar aktivizimin e tyre gjatë zgjedhjeve të 23 Qershorit.

Për sa kohë Shqipëria ka një popullsi të re në moshë, padiskutim që të rinjtë mund të luajnë një rol vendimatar në drejtimin e zgjedhjeve. Ky argument, gjatë zgjedhjeve të fundit u përdor në mënyrën më të mirë mediatikisht nga një pjesë e madhe e forcave kryesore politike. Një nga politikanët më të rëndësishëm në vend, Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim Z. Ilir Meta, e ka vlerësuar pjesëmarrjen e rinisë në zgjedhjet e 23 qershorit, duke theksuar se ndryshimi erdhi falë të rinjve të cilët demonstruan si askush tjetër dëshirën për ndryshim dhe për të ecur më shpejt. Në një takim post zgjedhor me të rinjtë të forumit rinor LRI Z. Meta u shpreh: “Jam krenar për të gjithë të rinjtë e të rejtat e LRI-së në të gjithë vendin, për angazhimin dhe shpirtin e fitores, dhe në mënyrë të veçantë forumet rinore të Kukësit, Hasit e Tropojës, të cilët kanë punuar në kushtet më të vështira” (Balkanweb, 2013). Për shkak edhe të rezultatit pozitiv të zgjedhjeve të 23 qershorit, LSI beson se vota e të rinjve bëri diferencën. Në të njëjtën linjë më kryetarin e kësaj partie vijon edhe deklarata e drejtuesit të Lëvizjes Rinore për Integrim, Endrit Brahimllari, në një të përditshme, kur pohon se të rinjtë votuan për LSI-n duke provuar një rezultat të paparashikuar, dhe se ky besim që të rinjtë kishin te LSI mbetet detyrimi për t’iu shërbyer (Integrimi, 2013).

Fushata e zgjedhjeve të 2013-ës zgjoi interesin e të rinjvëduke u përfshirë direkt në forume politike, duke organizuar aktivitete promovuese për të nxitur pjesëmarrjen e moshatarëve të tyre dhe duket se kjo dha rezultat, për sa kohë një pjesë e partive politike ja faturojnë të rinjve rezultatin pozitiv. Të rinjtë me shumë gjasa duket se kanë besuar tek partitë politike kësaj here, por a besojnë partitë politike tek këta të fundit për ndarje

përgjegjësish? Ndryshe nga sa jemi mësuar më parë, ku retorikat e vazhdueshme kishin në fokus të rinjtë gjatë fushatave elektorale - ndërsa kur ndaheshin postet nuk rezultonte të kishin përfituar të rinjtë nga pushteti - fituesit e zgjedhjeve të 2013 kanë provuar të kundërtën, duke sjellë në postet kyqe të qeverisjes një numër të madh të rinjesh.

Qeveria e Kryeministrit Edi Rama e dalë nga zgjedhjet e 23 Qershorit, në përbërjen e kabinetit zgjodhi shumë figura të reja, duke e bërë qeverinë me një moshë mesatare 44 vjeç. Shembujt më të mirë janë; Klajda Gjoshaj 30 vjeçe Ministria e Integritetit, Sajmir Tahiri 34 vjeç Ministër i Brendshëm dhe Erjon Veliaj 34 vjeç, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Emërime të tjera të ditëve të para të qeverisë kanë provuar gjithashtu disa figura edhe më të reja në pozicionet e rëndësishme si; Elisa Spiropali 30 vjeç, Kryetare e FRESSH emruar Drejtoresha e Doganave, Ardit Çela 27 vjeç, nga LRI emëruar Drejtor i Postës Shqiptare, dhe Brisida Shehaj nga FRESSH 29 vjeç, emëruar Drejtoreshë e Përgjithëshme e Tatimeve.

Me përfaqësimin e të rinjve në pozicionet më të larta drejtuese, duket se është marrë në konsideratë roli i tyre dhe ndryshimet e rezultatit të zgjedhjeve të 23 qershorit. Vëmendja e politikanëve drejt forumeve rinore gjatë fushatës dhe mobilizimi serioz i të rinjve me forumet e tyre rezultojnë të jetë shpërblyer në mënyrën më të mirë, duke u dhënë pushtet dhe përgjegjësi. Tani mbetet për të provuar nëse ndryshimet do të sjellin një rezultat më të madh sesa në të shkuarën, për ti dhënë rëndësinë dhe vëmendjen e duhur forumeve rinore dhe përfaqësuesve të tyre.

6.8. Debatet publike me grupe rinore gjatë fushatës zgjedhore 2013

Gjatë fushatës zgjedhore të 2013, janë mbajtur forume debati në qytetet e Durrësit, Vlorës, Shkodrës, Fierit dhe Kukësit nga grupe rinore të shoqërisë civile për të nxitur

pjesëmarrjen e të rinjve. Dy prej forumeve të zhvilluara në Fier dhe Kukës¹⁰³, të cilët janë vëzhguar nga afër, provojnë dëshirën e grupeve rinore për të qenë aktiv dhe të gatshëm për të marrë përgjegjësi, pavarësisht interesit të vogël të politikanëve për të ndarë pushtet me këtë grup social. Në debatin e zhvilluar në 23 Maj 2013 në Fier, Parlamenti Rinor i Fierit shprehet se debatet mes të rinjve dhe kandidatëve gjatë fushatave elektorale janë shumë pozitive, pavarësisht se këta të fundit mund të përgjigjen politikisht, duke anashkaluar disa çështje të rëndësishme. Ajkera, 17 vjeç, shprehet se “...gjatë forumit me kandidatët për deputetë në Qarkun e Fierit, ne nuk morëm përgjigjet që prisnim, por përgjigjet që ata dëshiruan të na jepnin. Të rinjtë janë të zhgënjyer me politikanët dhe dështimet e tyre për të përmbushur premtimet e bëra gjatë fushatave të mëparshme elektorale.¹⁰⁴”

Një interes i madh për zgjedhjet politike të përgjithshme është shprehur përmes pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve rinore lokale gjatë debatit të mbajtur në Kukës, midis Forumit Rinor të Partisë Socialiste dhe Forumit Rinor të Partisë Demokratike. Forumi i debatit si rrallë herë kishte përballë të rinjë të angazhuar në forume të ndryshme politike, duke marrë përsipër të diskutojnë çështje të lidhura direkt me interesat e tyre në nivel lokal. Të rinjtë e forumeve të ndryshme politike shprehen se janë të gatshëm të marrin përsipër përgjegjësi dhe ti zhvillojnë ato, por përballë tyre është politika e vjetër që nuk lëshon pe dhe nuk ndan pushtet me të rinjtë, pavarësisht se shpesh i përdor gjatë fushatës elektorale. Vladimiri, një student i angazhuar prej vitesh me FRPD, shprehet se;

¹⁰³Forumet e debatit janë zhvilluar gjatë fushatës zgjedhore 2013, nga Shoqata për Integrim në Zonat Informale dhe Agenda Insitute dhe Rinia në Sipërmarrjen e Lirë, të mbështetura nga Olof Palme International Center.

¹⁰⁴Ajkera 17 vjeç, pjesë e Parlamentit Rinor Fier, pjesë e debatit publik organizuar nga Parlamenti Rinor Fier, 13 Maj 2013.

“Të rinjtë më shumë përdorën sesa u jepet mundësi për të provuar çfarë dijnë të bëjnë. Egzistojnë mundësi që të përfshihemi në zhvillime të ndryshme në nivel lokal, por kjo nuk ndodh, sepse politikanët egzistues të cilësdo parti qofshin, ngurrojnë të përfshijnë të rinjtë me frikën se mos u zënë vendin.” Ndërsa Besa, pjesë e FRESSH, pohon se “ ..të rinjtë mund të bëhën promotorë të ndryshimeve dhe kanë gjitha mundësitë për të sjellë ndryshime të rëndësishme, por nuk egziston besimi i atyre që kanë pushtet. Përfitojnë më shumë një pjesë e të rinjve që kanë njohje, lidhje familjare, por që nuk përfaqësojnë interesat e të rinjve”¹⁰⁵.

Këndvështrimi i të rinjve për procesin elektoral

Interesi i të rinjve në zgjedhjet e 2013-ës ka qenë i madh, kjo për shkak edhe të papunësisë dhe mungesës së alternativave për të gjetur veten e tyre në shoqëri. Gjatë intervistave dhe pyetsorëve të kryera gjatë fushatës elektorale, rezulton se të rinjtë e shikojnë si një mundësi punësimi angazhimit e tyre në forumet politike. Disa gjetje shpjegojnë gjithashtu se të rinjtë kanë një këndvështrim negativ për politikanët dhe politikën në përgjithësi, megjithatë, disa të rinj janë të detyruar që të angazhohen duke besuar për ndonjë mundësi punësimi. Sipas një ankete të zhvilluar gjatë këtij studimi me 70 të rinjë të moshës 18 – 24 vjeç, rezulton se 59% e tyre janë të interesuar për politikën, dhe mendojnë se politika ndikon direkt tek punësimi i tyre. Pavarësisht interesit për tu përfshirë në forumet rinore politike, ata nuk besojnë se mund të ndikojnë në vendimet e rëndësishme. Kështu, 48 % e të anketuarve, mendojnë se nuk kanë ndikim në vendimet që mund të merren për komunitetet e tyre, ndërsa 63 % e të

¹⁰⁵ Nga intervista me dy të rinjë pjesëmarrës (Arjeta dhe Fredi) në Forumin e debatit për Rolin e të Rinjve në Zgjedhje, mes dy forumeve rinore politike PS vs PD në Kukës, 14 Prill 2013.

anketuarve, mendojnë se nuk mund të ndikojnë në vendimet në nivelin kombëtar. Disa nga gjetjet që lidhen me apatinë e të rinjve për politikën kanë të bëjnë me:

- Mundësitë e kufizuara për të marrë pjesë në proceset politike vendimmarrëse;
- Mungesa e njohurive për përfshirje në forumet politike dhe njohjet;
- Të rinjtë mendojnë se kanë gjëra më interesante për të bërë;
- Perceptimi se pikpamjet e tyre nuk janë marrë ndonjëherë parasysh;

Konceptimi nga të rinjtë për politikën si lodhje dhe e mërzitshme ka krijuar gjithashtu edhe barriera për informim dhe kuptim të proceseve politike. Megjithatë, pjesëmarrja dhe angazhimi i të rinjve gjatë zgjedhjeve të fundit, treguan se interesi i tyre ndaj procesve zgjedhore është në rritje, ndërsa me emrimet e reja në postet drejtuese ka gjasa se do të rritet edhe më shumë oreksi për angazhimin e tyre në politikë. Gjatë një ankete të zhvilluar me 92 të rinjë në rrjetet sociale, pas zgjedhjeve dhe emrimeve të figurave që vijnë nga forumet rinore në postet e larta drejtuese, rezulton se 80% e tyre mendojnë të angazhohen në forumet politike. Kjo tregon një interes pozitiv dhe në rritje për pjesëmarrjen në proceset demokratike në ndryshim nga zgjedhjet e kaluara. Për shkak të një perceptimi negativ që të rinjtë kishin deri sot për politikanët, ata shprehen se politikanët e tyre duhet: “të flasin me ta në një gjuhë që të rinjtë e kuptojnë, të flasin direkt, rregullisht dhe në ambjetet rinore; të dëgjojnë dhe të përgjigjen pyetjeve dhe shqetësimeve; dhe të respektojnë diversitetin e tyre¹⁰⁶”.

Egziston një dakortësi e përgjithëshme nga kërkimet e mëparshme se të rinjtë ndihen shpesh të përjashtuar nga pjesëmarrja në proceset elektorale. Kjo vlen më shumë për të

¹⁰⁶Nga takimi me të rinjë të Qendrës Rinore Kukës.Dt.19 Gusht 2013.

rinjtë e moshës 16 vjeç e poshtë. Megjithatë, ndërsa të rinjtë zhvillohen dhe përgjegjësitë e tyre rriten bashkë me lidhjet sociale dhe ato familjare, shfaqet ndërgjegjësimi dhe interesi për pjesëmarrje në proceset zgjedhore. Vetë të rinjtë pranojnë se qëndrimi ndaj politikës kohën e fundit ka ndryshuar dhe interesi për pjesëmarrje dhe angazhim po rritet.

Të rinjtë e pyetur nëse lexonin literaturën apo programet politike të partive të ndryshme, përgjigjen se ata nuk e lexojnë, sepse nuk janë të interesuar në atë çfarë është thënë. Edhe në rastet kur ky informacion u është shpërndarë gjatë takimeve elektorale, ata nuk e kanë lexuar dhe nuk kanë mësuar asgjë prej tij. Një i ri pohon se, të jesh i interesuar për procesin elektoral dhe politikën “duhet të besosh në vlerat e tyre (të partive politike) për tu bashkuar me ta, dhe shumica prej tyre kanë diçka që ne nuk jemi dakort – asnjë prej tyre nuk është përfekt¹⁰⁷”. Kjo nënvizon se sa partitë politike reflektojnë nevojat për të rinjtë, apo çështjet që për këtë grupmoshë janë të rëndësishme. Të rinjtë gjithashtu theksojnë se politikanët duhet ‘*të angazhohen me të rinjtë dhe të shkojnë atje ku zhvillojnë aktivitetet e tyre*’, nëse dëshirojnë të rrisin interesin dhe pjesëmarrjen e tyre.

Kapitulli VII: PËRFUNDIME DHE KONKLUSIONE

Duke identifikuar modelet e pjesëmarrjes rinore në nivel lokal me grupet e vogla, hedhim një hap drejt zhvillimit në një kuptim më të mirë të faktorëve që promovojnë një shoqëri civile të pavarur dhe ndikimin e saj në konsolidimin e demokracisë. Ky hulumtim nënvizon rëndësinë e angazhimit të rinjëve në proceset demokratike nga elitat politike dhe politikëbërësit duke i konsideruar ata partnerë, duke ndarë me ta pushtet

¹⁰⁷B.H, 17 vjeç, nxënës i shkollës së mesme Havzi Nela, Kukës. Intervista e zhvilluar me dt. 18 Prill 2013.

dhe përgjegjësi, me qëllim për të sjellë ndryshime pozitive, dhe kontribuar në vendosjen e paqes dhe zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe demokratike.

Ky kërkim nuk pretendon të kurojë brishtësinë e demokratizimit, as politizimin apo mungesën e kredibilitetit të forumeve dhe organizatave të shoqërisë civile në sytë e opinionit publik. Megjithatë, përmes eksperiencave dhe praktikave të aktivistëve rinor dhe profesionistëve të shoqërisë civile të angazhuar në nivel lokal, sugjerojnë një perspektivë të shumëllojshme nga e cila mund të vërehet në kompleks impakti që mund të sjellin grupet e vogla lokale, dhe deri ku mund të shkojnë në konsolidimin e demokracisë. Nga gjetjet gjatë këtij studimi, duhet theksuar fakti se roli i grupeve rinore në kontekstin lokal, duhet konsideruar po aq i rëndësishëm sa edhe OSHC-të me eksperiencë dhe veprimtari të zgjeruar. Gjetjet dhe opinionet e aktivistëve gjatë këtij studimi, do të jenë një kontribut në të menduarit nga e para, për përfshirjen e grupeve të vogla në nivel lokal, sikurse edhe në krijimin e një debati për të aplikuar demokracinë me modelin nga poshtë lart, duke nisur me pjesëmarrjen dhe angazhimin e grupeve rinore në nivel komunitar.

Duke marrë parasysh preformancën e demokracisë në Shqipëri, faktin së partitë politike janë pjesa më aktive në debatet politike, të cilat duket se kanë marrë përsipër të vetme promovimin dhe fatin e demokracisë, duke lënë në hije grupet rinore dhe ato të shoqërisë civile, mund të pohojmë se pjesëmarrja e të rinjve dhe grupet e vogla që ata përfaqësojnë në komunitetet e tyre lokale, duhet të marrin një rol më të madh për të ndikuar në perspektivën e zhvillimit. Shoqëria civile, nuk është akoma e fortë dhe e pavarur sa duhet për të luajtur një rol aktiv, dhe nuk duhet të identifikohet vetëm me OSHC-të, por duhet të konsiderohet përtej tyre duke identifikuar grupet informale, rrjetet apo grupet e vogla në nivel lokal dhe të mbështetet tek ato.

Pjesëmarrja e të rinjve në grupet e vogla në nivel lokal jo vetëm që është e nevojshme, por siguron zhvillim komunitar, sjell ndryshim social dhe nxit qeverisje të mirë. Për të përfshirë të rinjtë në pjesëmarrje aktive, është e rëndësishme të ndahen role dhe përgjegjësi, me qëllim që të rinjtë të provojnë dhe të mësojnë. Gjetja shumë e rëndësishme gjatë këtij studimi, e cila mundëson një përfshirje më aktive të të rinjve, lidhet gjithashtu me heqjen dorë të përdorimit, manipulimit dhe konsiderimin e tyre si partner deri në *ndarjen e pushtetit* me të rinjtë. Ky grup social ka nevojë për pushtet kur bëhet fjalë për çështjet dhe interesat që lidhen direkt me ta. Ata duhet të jenë pjesë e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave dhe vëzhgues të zbatimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Pjesëmarrja e të rinjve në nivel komunitar është e domosdoshme si kusht për demokratizimin, dhe për një perspektivë më të mirë në Shqipëri, për të lënë kështu mënjanë praktikrat e importuara nga vendet e zhvilluar gjatë periudhës së tranzicionit, tashmë eksperimente të dështuara. Edhe vetë shoqëria civile duhet të jetë më e hapur ndaj grupeve të vogla komunitare, me qëllim për të inkurajuar iniciativat e reja, për të mbështetur grupet rinore dhe individët që mund të ndikojnë dhe frymëzojnë masën kritike. Kjo do të ndihmonte zhvillimin e demokracisë, do të mbështeste qasjet e ndryshme dhe do të prodhonte debate për një shoqëri demokratike.

Të rinjtë duhet të jenë grupi më i përshtatshëm dhe i gatshëm për të marrë përgjegjësi për të zhvilluar këto aftësi. Pas njëzet viteve tranzicion, përpjekjet e vazhdueshme drejt demokratizimit dhe arritja e standarteve Europiane janë në vëmendjen kryesore të aktorëve të ndryshëm, në veçanti të institucioneve Europiane të cilat edhe mbështesin këtë proces. Më shumë se asnjëherë, një qasje e demokracisë së praktikuar nga poshtë lart është e nevojshme për tu mështetur, duke përfshirë grupet e vogla rinore; grupet e

përfshijë komunitetet në nevojë dhe zonat periferike të përfshijë; qofshin këto në qytetet e mëdha apo të vogla. Pavarësisht diskursit politik, zhvillimi i demokracisë edhe në nivel global, varet në zhvillimin dhe konsolidimin e tij në nivel lokal, duke e bërë kështu demokracinë direkte dhe përfituese për komunitetet vendore në jetën e përditshme të tyre.

Hulumtimi cilësor në këtë studim, ka treguar se shumë të rinj nuk ishin të interesuar për politikën, sepse praktikën dhe metodat e përdorura nga politikanët duken të vjetra dhe të mërzitshme, gjithashtu edhe për faktin se të rinjtë janë përdorur dhe manipuluar vazhdimisht nga partitë politike gjatë fushatave elektorale për qëllime pushteti. Prapëseprapë, shumë prej tyre ndihen aktiv dhe të apasionuar pas çështjeve që lidhen me jetën e tyre. Pikërisht, gjatë matjeve sasiore, 55% e të anketuarve të moshës 16-15, pohojnë se janë të interesuar për politikën, për shkak të ndryshimeve dhe qasjeve që po ndodhin kohët e fundit. Ndërsa është interesant pohimi i një drejtuesi të FRESH ndërsa pohon se politika fillon e bëhet më interesante kur njerëzit bëhen taksapagues, sepse pikërisht atëherë preken direkt interesat dhe të ardhurat, për të kërkuar më shumë shërbime.

Të rinjtë gjithashtu pranojnë se organizimi i takimeve të drejtëpërdrejta me politikanët, në ambjentet ku të rinjtë kalojnë kohë e lirë dhe organizohen çdo ditë, duhet të merret në konsideratë nga politikanët. Kjo metodë, do t'ju japë mundësi të dy palëve të pyesin dhe diskutojnë me njëri tjetrin, për tu njohur më shumë dhe kuptuar siç duhet nevojat dhe mundësitë për shërbime më të mira.

Të rinjtë sugjerojnë se informacionet që mundësojnë pjesëmarrjen e të rinjve për çështje të ndryshme, qofshin këto politike apo profesionale, duhet të ofrohen përmes

platformave dhe mënyrave që të rinjtë mund ti frekuentojnë më së shumti, si; universitetet, klubet, shkollat apo rrjetet sociale. Prapëseprapë, është theksuar se të gjitha informacionet duhet të prezantohen në një formë që të rinjtë e përqafojnë lehtësisht, duke përdorur *metodë miqësore për të rinjë*. Ajo çfarë është shumë e rëndësishme dhe vjen si nevojë e identifikuar nga të rinjtë, ka të bëjë me një edukim më cilësor për kuptimin e politikës, zgjedhjet dhe procesin e votimit përmes medimeve të ndryshme, sikurse janë shkollat apo grupet rinore joformale.

Ky studim, në krahasim me studimet e mëparshme në këtë fushë, sjell një kontribut të veçantë në aspektin lokal, aty ku grupet e vogla rinore ndërveprojnë dhe krijojnë marrëdhëniet e tyre të para publike, por shpesh herë të padukshme për studiuesit dhe politikë-bërësit. Për shkak se është e pamundur të vëzhgohen të gjitha aspektet e grupeve rinore në rajone dhe zona të veçanta, është e nevojshme që në studimet e ardhshme të zbulohet më shumë rreth rolit të grupeve të vogla rinore, duke trajtuar shkaqet se përse këto grupe shpesh janë të përjashtuara. Marrëdhënia e grupeve rinore me komunitetet dhe autoritetet vendore mbetet interesante gjithashtu.

Një çështje për tu trajtuar do të jetë ajo e *pushtetit* që të rinjtë kërkojnë të ndahet në funksion të bashkëpunimit dhe përfshirjes për të sjellë ndryshime më të mëdha sociale në realitetin komunitar dhe më tej. Zhvillimi i pjesëmarrjes në funksion të fuqizimit të grupeve rinore dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve mbetet një aksion në dorën dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve vendor dhe kombëtar.

Grupet rinore të marra si raste studimore në rrethet e ndryshme të vendit nuk mund të përfaqësojnë të gjithë të rinjtë, sepse edhe nga gjetjet në terren rezulton se kanë nevoja dhe interesa të ndryshme. Nëse do të marrim një krahasim lidhur me veprimtarinë dhe

ndikimin në politikat lokale, grupet rinore në Kukës, Fier, Vlorë, dhe Durrës nuk janë aspak inferior dhe më pak aktive se ato në Tiranë, pavarësisht mbështetjes financiare që kanë. Në nivelet e përfaqësimit, këto grupe rinore të marra si raste studimore gjatë këtij hulumtimi përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të të rinjve në shqipëri, ato prapëseprapë janë organizata dhe grupe aktive, të organizuara dhe me rezultate në zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor. Ajo çfarë rekomandohet pas gjetjeve nga rastet studimore është se;

- ✓ Grupet rinore locale në nevojë kanë nevojë të trainohen dhe të angazhohen në edukimin politik
- ✓ Motivimi për angazhimin e grupeve rinore arrihet duke krijuar afërsi mes të rinjve dhe ngjarjeve politike, civile dhe publike të lidhura me realitetin vendor, sesa ngjarjet abstrakte apo ato me interes global.
- ✓ Motivimi vjen edhe nga bashkëveprimi midis të zgjedhurve vendor dhe grupeve rinore, duke kuptuar se efekti për të ndryshuar gjërat në nivel vendor është i ndërsjelltë, sidomos kur vjen puna tek çështjet rinore (parqet, klubet rinore, shkolla apo terrenet sportive/argëtuese)
- ✓ Duhet të tregohet vëmendje nga vendimarrësit për të dëgjuar shqetësimet dhe opinionet e të rinjve, duke treguar rezultate pas një periudhe të shkurtër kohore. Kjo vjen si shkak se shumë të rinjë ndihen jashtë vëmendjes dhe pamjaftueshmëria për tu dëgjuar nga elitat politike.
- ✓ Pavarësisht mungesës së besimit tek elitat politike, të rinjtë janë të interesuar të jenë pjesë e proceseve politike dhe demokratike, por duhet që të merren seriozisht në konsideratë duke përfaqësuar grupet minoritare (të papunët, të

pastrehët, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet etnike), dhe jo të ftohen vetëm përfaqësues rinor 'të përshtatshëm' për politikën dhe përfaqësuesit e tyre.

- ✓ Konsultimi me grupet rinore do t'ju japë legjitimitet politikave në shërbim të tyre dhe grupeve që janë aktive në nivel lokal, duke mundësuar një ambjent favorizues për pjesëmarrje aktive dhe reale.

Bazuar në teoritë e pjesëmarrjes të trajtuara në këtë studim, referuar Pateman, kur ajo bën dallimin midis pjesëmarrjes së plotë dhe të pjesëshme, ku me të parën i referohet fuqisë së barabartë për të përcaktuar rezlutatin e vendimeve për të gjithë pjesëmarrësit, ndërsa me të dytën i referohet konsultimit, emergjenca për pjesëmarrje të grupeve formale dhe joformale rinore nëvizohet qartë në rastet studimore. Të dhënat e mbledhura nga intervistat, rastet studimore dhe literature egzistuese, sugjerojnë se çështjet e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes të të rinjve janë një shqetësim për aktorët vendor dhe kombëtar, qofshin këto parti politike dhe forumet civile qytetare, qeverisja vendore dhe partnerët e ndryshëm që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin mbështetje në zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë në shqipëri. Megjithatë, gjatë studimit, gjithashtu është vënë re se vetëm një pjesë e vogël e të rinjve (veçanërisht atyre me edukim të mirë, të ndikuar tradicionalisht nga politika apo me sfond të ndikuar nga shoqëria civile) kanë më shumë gjasa për tu angazhuar në konsultime për politika zhvillimi apo në proceset vendimarrëse me politikanët, sesa pjesa tjetër e të rinjve që janë me më pak edukim, kanë më pak eksperiencë dhe kanë kushte jo të mira ekonomike.

SHËNIME¹⁰⁸

Kontrata Sociale, akti i parë i bashkëpunimit të grupeve rinore lokale në Shqipëri.

Zgjedhjet vendore të vitit 2015, përvec specifikës së Reformës Territoriale shënuan një zhvillim të rëndësishëm lidhur me pjesëmarrjen e grupeve lokale rinore në qytetet; Tiranë, Durrës, Kukës, Vlorë, Fier, Lezhë, Shkodër dhe Pukë. Iniciativa e këtij projekt bashkëpunimi nisi në Kukës në Shtator të vitit 2014, me pjesëmarrjen direkte të të rinjve për të ndikuar zgjedhjet vendore përmes propozimeve për zhvillim komunitar dhe kryesisht të jetës rinore. Iniciativa e grupit nga Kukësi mori përmasa komëbtare, e udhëhequr nga grupe rinore lokale në qytete të ndryshme, për tu konkretizuar në një projekt të mbështetur nga Olof Palme International Center, me financimin e Qeverisë Suedeze.

Rasti studimor i vëzhguar, është i rëndësishëm për studimin për shkak se pohon hipotezen që kemi mbrojtur prej fillimi dhe kalon nëpër etapat e '*Shkallës së Pjesëmarrjes*' të trajtuar në teoritë e këtij studimi.

Në mungesë të përfaqësimit dhe marrjes në konsideratë të zërit rinor në nivel lokal, grupet rinore kanë organizuar fokus grupe për të përcaktuar aksionin rinor të emërtuar Kontrata Sociale. Mungesa e shërbimeve për të rinjtë, politikat e munguara dhe buxhetet për rininë kanë nxitur marrjen e përgjegjësisë të forumeve rinore lokale duke e formalizuar me propozime konkrete për kandidatët për Kryetar Bashkie në zgjedhjet vendore të Qershor 2015. Konsultimet me grupet për përzgjedhjen e prioriteteve; ngritja e grupeve të punës për çdo prioritet dhe miratimi i draftit të Kontrates Sociale në

¹⁰⁸ Këtu përfshihet i gjithë materiali shtesë që nuk është integruar në tekst, për arsye të kufizimeve në numrin e fjalëve dhe për shkak se këto gjetje janë bërë në periudhën pasi drafti i parë i studimit ka qenë dorëzuar pranë udhëheqësit, dhe meqenëse gjetjet janë të periudhës 2014- 2015, periudhë që mbetet jashtë studimit të punimit.

bashkëpunim me grupet e interesit; Procesi i mbledhjes së firmave nga të rinjtë e qytetit për të mbështetur Kontratën Sociale; Takime lobuese me grupet e ngritura dhe takimi publik për nënshkrimin e kontratës me kandidatët e të gjitha forcave politike për Kreytar Bashkie përbejnë hapat që grupet rinore kanë ndjekur në të gjitha qytetet si formë konkrete e angazhimit dhe pjesëmarrjes rinore. Ky proces pjesëmarrjeje në thelb i ngjashëm për të nxitur pjesëmarrjen dhe ndikimin rinor, përmbante pavarësi për secilin grup rinor lokal, duke përshtatur prioritetet për kontratën sociale sipas realitetit lokal. Në vëzhgimin që i është bërë këtij procesi dallohet qartë identifikimi i prioriteteve nga një qytet në tjetrin. Nga gjetjet gjatë vëzhgimit veçojmë prioritetet e grupit rinor lokal në Kukës me gjashtë propozime;

- a) Vendosja e Pjerrinave/Rampave (në trotuare, në institucionet vendore si dhe në shkolla të paktën deri në katin e parë të ndërtesës),
- b) Ndërtimi dhe/ose restaurimi i terreneve sportive në lagjet e qytetit dhe zonave rurale,
- c) Të krijohet një zë i veçantë në buxhet për rininë, d) Konsultimi me grupet rinore në përgatitjen e buxhetit bashkiak,
- e) Të ofrohen ambjente falas për Qendër Rinore, f) Të ndërtohet një fushë stervitore futbollit për ekipet zinxhir.

Nëse gjatë studimit kemi pohuar se niveli i angazhimit të të rinjve në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit sipas shkallës së pjesëmarrjes së Hart mbetet tek Manipulimi, si shkalla më e ulët e pjesëmarrjes, rast i kontratës sociale tregon se të rinjtë janë premisë për demokratizimin në Shqipëri dhe kjo arrihet vetëm përmes marrjes së përgjegjësisë dhe ndarjes së pushtetit. Për herë të parë ndodhi që grupet e shoqërisë civile në rrethe të ndryshme, të marrin mbështetjen e forumeve rinore politike në

procesin e pjesëmarrjes dhe të futjes në programet elektorale të kandidatëve të partive politike kontratën sociale dhe prioritetet e përzgjedhura nga grupet rinore. Forumet rinore lokale përvec procesit deri në nënshkrimin nga një masë e gjerë e publikut dhe kandidatëve kanë ndërmarrë përsipër monitorimin e zbatimit të prioriteteve dhe ky do të ishte aksioni më i rëndësishëm në nivel lokal gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, duke treguar rolin e grupeve të vogla rinore në pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë.

SHTOJCA

Shtojca A

Lista e Personave të Intervistuar nga Institucione dhe Forume/NGO rinore

Emri/Mbiemri	Institucioni/Profesioni	Data e Intervistës/takimit
Adelina. C	Maturante, Shk. Havzi Nela, Kukës	14/04/2013
A.D.	Student (votues për herë të parë)	14/05/2013
Altin Zyberaj	I papunë (votues për herë të parë)	13/04/2013
Alban. N.	Aktivist i Shoq.Civile, Tiranë	24/05/2012
Ajkera	Parlamenti Rinor Fier	13/05/2013
Anisa Hysesani	Koordinatorë Youth Peace Ambassador CoE	9/04/2012
Arta Sinamati	Gazetare, Aktiviste e SH.C	15/01/ 2012
Arta	Këshilli Rinor Lëzhë	11/03/2012
Ardi	I papunë (votues për herë të parë)	18/04/2013
Aulona Skendaj	Koordinatorë Qendra Rinore Vlorë	1/11/ 2013
Besmiri	Student (votues për herë të parë)	18/04/2013
Blerta	Shkolla mesme Havzi Nela, Kukës	14/04/2013
B. Mataj	Aktivist i SH.C dhe Drejtues i FRESSH Kukës	8/04/2013 12/07/2013
Blendi	Unioni Studentor	16/01/2012
B.H.	Shkolla mesme Havzi Nela, Kukës	18/04/2013
B. Veliu	Ish-Klubi Qytetar Mjaft	7/06/2013
Blerina Metaj	Koordinatorë CRCA	30/10/2013
Denis	Parlamenti Rinor Shkodër	28/01/ 2012

D. Hoxhaj	Ish-aktiviste e RSL Kukës 2004-2007	5/06/ 2013
Doriana Gjuta	Pedagoge UT dega Kukës dhe Koordinatorë projektesh pranë shoqatës RSL	6 /06/ 2013
E. Cahani	FRPD Kukës	15/05/2013
Evisa Kostrica	Kordinatore e Epoka e Re Fier	16/10/ 2013
Erion. V.	Aktivist i Shoqërisë Civile Kukës	9/05/2013
Frensis Dule	Social Youth Forum, Tiranë	25/01/2012
Gazmend Dulla	Ish-themelues, shoqata RSL Kukës	6/06/2013
Ismet.B	Aktivist Shoqëria Civile Kukës	27/10/2012
Lavdrim Shehu	Koordinator Projektesh “RSL”	9/09/2013
L. Gjana	Punonjëse Sociale, Bashkia Kukës	8/04/2013
Lindita Hyseni	Drejtuese e LRD Pukë	22/10/2013
M. Elezi	Studente, UT dega Kukës	13/04/2013
Olsa Vila	Ish-drejtoreshë për marrdh me Jashtë e Sindikatave të Pavarura në Shqipëri	15/01/2012
P.Z	Punonjës i Qeverisjes Vendore, Kukës	21/06/2013
R. Omuri	Aktivist i Sh.C. Kukës	19/03/2013
Sara Zekaj	Albanian Alliance of Students, AESSH Elbasan	17/01/2012
S.B	Aktivist Epoka e Re Fier	30/10/2013
Takim Fokus grupi	Aktivistët e shoqatës RSL Kukës	26/10/2012 13/02/2012 17/082013
Uarda Begaj	Parlamenti Rinor Fier	23/01/2012 17/04/2013
Vladimir Gashi	Vullnetar, aktivist i RSL, Drejtues i FRPD Kukes	9/06/2013
Xhoana Cahani	Studente Turqi	17/04/2013
T.C & A.D.	Këshilltarë i Bashkisë Kukës	24/11/2012

Shtojca B

Formular për dhënie pëlqimi nga pjesëmarrësit në hulumtim

Titulli i studimit: Pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal.

Hulumtues: Rifat Demalija, Doktorant pranë Universitetit European të Tiranës

Përshkrimi i hulumtimit dhe pjesëmarrja juaj

Ju jeni i ftuar të merrni pjesë në një hulumtim që po udhëhiqet nga Dokt. Rifat Demalija, UET Tiranë. Qëllimi i këtij studimi është të provojmë se pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal dhe grupet e vogla, mund të ndikojë dukshëm në konsolidimin e demokracisë. Gjatë këtij studimit do të arrihet që të hidhet dritë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në demokracinë e praktikuar prej grupeve rinore në nivel lokal, dhe gatishmërisë së këtij grupi social për tu përfshirë në proceset politike njësoj edhe në politikat publike, të cilat lidhen direkt me zhvillimin komunitar.

Pjesëmarrja Juaj do të përfshijë;

Procedurat: Format i intervistës do të jetë një bashkëbisedim. Unë mendoj se intervista nuk do të zgjasë më shumë se 1 orë. Me pëlqimin tuaj, unë do të regjistroj në audio intervistën vetëm për qëllim të transkriptimit të saktë të bisedës. Me pëlqimin Tuaj, do të kisha dëshirë të bëja edhe një fotografi gjatë intervistës. Regjistrimi audio dhe fotografia, njësoj sikurse edhe transkriptimi do të ruhet në siguri të plotë nën përgjegjësinë time, duke ju vënë në dizpozicion zbardhjen e intervistës me Ju para se studimi të dërgohet për botim. Fotografia Juaj mund të përdoret për të prezantuar hulumtimin në fjalë në konferenca të ndryshme.

Mbrojta e konfidencialitetit dhe Rreziqet

Nuk egzistojnë rreziqe përgjatë këtij studimi. Ndërsa shqetësimet mund të lidhen me kohën që duhet për intervistat, përdorimi i të dhënave që do të hasen gjatë marrjes së intervistës. Prapëseprapë, ju sigurojmë se përdorimi i të dhënave do të jetë vetëm me pëlqimin Tuaj, ndërsa koha për intervistën Tuaj do të jetë në periudhën dhe vendin më të përshtatshëm për Ju. Për këtë arsye, nëse Ju dëshironi që gjatë analizës të përdorim pseudonim në vend të emrit Tuaj për të ruajtur privacinë dhe konfidencialitetin, jam i lumtur për ta përdorur atë. Në të kundërt, nëse Ju dëshironi të citoheni me emër për ndonjë gjë në veçanti, jam gjithashtu i lumtur për ta plotësuar këtë kërkesë. Dëshiroj t'ju bëj me dije gjithashtu se Ju mund të mos i përgjigjeni pyetjeve rrëth çështjeve për të cilat mund të ndiheni në siklet.

Përfitimet e mundëshme

Ky studim nuk sjell përfitime financiare për pjesëmarrjen Tuaj, por do të jetë një kontribut i madh për hulumtuesit e kësaj fushe të cilët do të përdorin këto të dhëna në

vzhdim. Ky studim do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë nga eksperiencia Juaj, gjithçka lidhet me pjesëmarrjen e të rinjve dhe rolin e tyre si aktor në zhvillimin komunitar.

Pjesëmarrja Juaj në këtë studim është vullnetare, prandaj edhe mund të vendosni të mos merrni pjesë.

Kërkesë për më shumë informacion

Nëse Ju keni ndonjë pyetje apo shqetësim rreth këtij studimi, jeni i lutur të kontaktoni në çdo moment; Rifat Demalija, në numrin e tel: **0686468125** ose përmes e-mail rifat.demalija@gmail.com apo në skype: fatialb

Dhënie pëlqimi

Unë kam lexuar këtë formë dhënie pëlqimi dhe jap mundësinë për intervistën e planifikuar. Unë jap pëlqimin tim për të marrë pjesë në këtë studim.

Nënshkrimi i pjesëmarrësit _____ Datë: _____

Një kopje e këtij pëlqimi do të mbahet nga Ju.

Shtojca C

Pyetsori i përdorur për pjesëmarrjen e të rinjve përmes internetit

Kodi i anketuesit

Nr. Pyetsorit

Ky pyetsor bëhet për qëllim studimi për të vëzhguar pjesëmarrjen e të rinjve në debatet dhe politikat publike përmes internetit dhe është anonim. Megjithatë nëse dëshironi të tregoni emrin tuaj dhe të na konfirmoni përdorimin e tij gjatë studimit me initiale ose të plotë ju lutem shkruani emrin në fund të anketës dhe firmoseni atë.

1) Moshë: a) 15 – 18, b) 18- 25, c) 25-35 **2) Gjinia:** M___/F___

3) Sa shpesh e përdorni internetin?

a) çdo ditë ___ c) një herë në ditë ___ d) një herë në muaj ___

4) Mesatarisht sa orë shpenzoni në internet?

a) më pak se 1 orë në ditë ___ b) 1-2 orë ___ c) më shumë se 3 orë ___

5) Çfarë ju pëlqen të bëni më shumë në internet?

a) chat ____ b) kërkoni informacion ____ c) muzikë ____ d) luani ____

6) A mendoni se komunikimi përmes internetit është një mënyrë e mirë për të përcjellë shqetësimet e grupeve rinore?

a) Po ____ b) Jo ____

7) A jeni në dijeni se ka programe e-qeverisje?

a) Po ____ b) Jo ____

8) A mendoni se komunikimi përmes internetit ofron më shumë mundësi për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrje?

a) Po ____ b) Jo ____

9) Dëshironi më shumë të komunikoni përmes web-faqeve zyrtare apo rrjeteve sociale me të zgjedhurit vendor (Kr. Bashkie/Komune dhe Këshilltarët)?

a) rrjeteve sociale ____ b) web-faqeve zyrtare ____

Shtojca D

Pyetsor për votuesit për herë të parë.

Kodi i anketuesit

Nr. Pyetsorit

Ky pyetsor bëhet për qëllim studimi për të vëzhguar marrëdhëniet e votuesve të rinj me zgjedhjet dhe politikën dhe është anonim. Megjithatë nëse dëshironi të tregoni emrin tuaj dhe të na konfirmoni përdorimin e tij gjatë studimit me initiale ose të plotë ju lutem shkruani emrin në fund të anketës dhe firmoseni atë.

1) A e ndjek rregullisht fushatën elektorale që po zhvillohet? Po ____
Jo ____

2) A jeni i përfshirë në mënyrë aktive më ndonjë forcë politike? Po ____
Jo ____

3) Sa e rëndësishme është për Ju personalisht të shkosh për të votuar:

- a) Shume e rëndësishme____ b) disi e rëndësishme____ c) pak e rëndësishme____
d) asapak e rëndësishme____

4) Meqenëse në Qershor do të zhvillohen zgjedhjet e përgjithëshme. A keni kontrolluar nëse emri Juaj është në listën e zgjedhësve? a) Po____ b) Jo____

5) A do të shkoni për të votuar në zgjedhjet e përgjithëshme që zhvillohen ne 23 Qershor? a) Po____ b) Jo____

Nëse jo pse? _____ apo Nuk ke besim se do të ndryshojë gjë ____

6) A mbani mend se prindërit tuaj kanë votuar:

- a) sa herë janë zhvilluar zgjedhje ____ b) vetëm në zgjedhjet e rëndësishme____ c) rrallë____ d) asnjëherë____

7) A duhet të votojnë për të njëjtën forcë politike sikurse prindërit edhe fëmijët e tyre të cilët janë votues për herë të parë? a) Po____ b) Jo____

8) Nese do tju ftonte dikush të jeni pjesë e një partie politike a do ta pranoni ftesën?

Po ____ (jepni arsyet)

.....

Jo ____ (jepni arsyet)

.....

Ju falemnderit për kohën

Shtojca E

Intervistë gjysëm e strukturuar e përdorur për Rastet Studimore

Pjesëmarrja e të rinjve (Raste studimore, Kukësi, Fieri, Tiranë, Vlora, Durrësi, Puka)

Kodi i anketuesit

Nr. Pyetsorit

Kjo intervistë është pjesë e studimit “Pjesëmarrja e të rinjëve në nivel lokal, premisë demokratizimi në Shqipëri.” Ky studim ka për qëllim të hulumtojë pjesëmarrjen e grupeve rinore në nivel lokal dhe rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit. Duke marrë në konsideratë pjesëmarrjen ose jo të rinjëve, mund të pohojmë ose mohojmë rolin e të rinjve dhe ndikimin e tyre në demokratizimin e vendit.

Emri/mbiemri: Pozicioni brenda organizatës:

Më trego të lutem rreth organizatës, procesit dhe aktiviteteve:

- Historia e ngritjes së kësaj organizate?
- Me çfarë merret/fokusi?
- Qëllimi, objektivat dhe aktivitetet?
- Cfarë kriteresh ka për të qenë pjesë e kësaj organizate?
- Nr i të rinjve aktivistë dhe vullentarë të përfshirë në këtë shoqatë?
- Si përfshihen të rinjtë dhe cfarë roli marrin gjatë aktiviteteve?
- Si mbështeten të rinjtë nga organizata?
- Përfitimet e të rinjve nga aktivizimi dhe përfshirja në këtë shoqatë?
- Përfitimet e shoqatës nga pjesëmarrja e të rinjve?

Kur dhe si ndodh pjesëmarrja e të rinjve në organizatën Tuaj?

Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e të rinjve për organizatën Tuaj?

A keni ndonjë eksperiencë kur të rinjtë janë përfshirë direkt në vendimarrje brenda organizatës dhe kur kanë organizuar aktivitete pa ndihmën Tuaj?

A është organizata Juaj e fokusuar tek pjesëmarrja e të rinjve në jetën publike?

Si përshtaten të rinjtë me të rriturit që punojnë në organizatën Tuaj?

Cfarë pengesash mendoni Ju se egzistojn për pjesëmarrjen e të rinjve në forumet dhe organizatat rinore?

A keni ndonjë këshillë për forumet rinore dhe organizatat sesi ato mund të rrisin rolin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal?

Ndonjë koment tjetër për të shtuar?

Shtojca F

Intervista gjysëm e strukturuar e përdorur për pjesëmarrjen rinore në nivel lokal

Kjo intervistë është pjesë e studimit “Pjesëmarrja e të rinjëve në nivel lokal, premisë demokratizimi në Shqipëri.” Ky studim ka për qëllim të hulumtojë pjesëmarrjen e grupeve rinore në nivel lokal dhe rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit. Duke marrë në konsideratë pjesëmarrjen ose jo të rinjëve, mund të pohojmë ose mohojmë rolin e të rinjve dhe ndikimin e tyre në demokratizimin e vendit.

Data e intervistës ____ ____ ____ Inicialet e të intervistuarit ____
 D M V (minimumi 2 shkronja)

Emri: Mosha: Profesioni:

1. Më trego të lutem për eksperiencën tënde si aktivist/e i/e forumit rinor apo shoqërisë civile prej fillimit të angazhimit? Si jeni bashkuar me këtë grup? Dhe kush ju ka mbështetur?
2. Le të flasim pak për forumin ku keni marrë pjesë fillimisht.
 - a. Çfarë ju pëlqentë më shumë brenda atij grupi të vogël?
 - b. Çfarë ju pëlqentë më pak tek ky forum?
3. A kishte mundësi për pjesëmarrje të barabartë brenda grupit kur bëhej fjalë për vendim-marrje?
4. A mbani mend të jenë zhvilluar zgjedhje brenda grupit dhe nëse po, si kanë qenë ato, a mund të na e përshkruash një process zgjedhjeje brenda forumit?
5. Nëse do të kërkonte këshillë një i ri në lidhje me angazhimin në forumet rinore, çfarë do ti sugjeroje, angazhimin në forume politike apo civile? Pse do tja sugjeroje pjesëmarrjen në këtë forum?
6. Çfarë eksperiencë keni përfituar gjatë kësaj periudhe të angazhimit me këtë forum rinor? A ka ndikuar në karrierën Tuaj profesionale?
7. Ju lutem na përshkruani një nga eksperiencat Tuaja me forumin ku ishit pjesë, të cilat kanë ndikuar në vendimarrjen përtej grupit Tuaj.
8. Sa mundësi kanë grupet rinore politike dhe civile për të sjellë demokratizimin e shoqërisë dhe ndryshimin në komunitetet ku banojnë?
9. Çfarë duhet bërë sipas Jush që grupet rinore të kenë më shumë rol në zhvillimet e vendit? Si mund të përmirësohet aktivizimi dhe roli i grupeve rinore në shoqëri?
10. A do të kishit ndryshuar ndonjë gjë nga forumi ku keni qenë pjesë? Çfarë konkretisht?
11. A keni komente shtesë në lidhje me pjesëmarrjen aktive të të rinjve përmes forumeve të ndryshme lokale në vendimarrje?
12. A keni ndonjë rekomandim për grupet rinore lokale?

BIBLIOGRAFIA

Literaturë

ACT, Y. C. (2010). *The Big Red Book: A Handbook and Directory for People who Work with Young*. Lyneham: Youth Coalition of the ACT.

Anderson. (1998). Toward authentic participation: Deconstructing the discourse of participatory reforms in education. *American Educational Research Journal* , 571-603.

Anheier & Themudo. (2002). Organisational forms of global civil society: implications of going global. *Global Civil Society, Oxford University Press* , 191-216.

Arnstein. (1969). A Ladder of Citizen Participation. *Journal of the American Institute of Planners* , 216-224.

Arnstein, S. (1969). A Ladder of Citizen Participation. *Journal of the American Institute of Planneer, Volume 35, Issue 4* , 216-224.

Bang, H. P. (2005). Among Everyday Makers and Expert Citizens' in Newman, Remaking Governance: Peoples, politics and the public sphere. *The Policy Press, Bristo*, 159–178.

Batsleer, J. (2008). *Informal Learning in Youth Work*. London: Sage.

Beck, P. A. (1991). Family Tradition, Political Periods, and the Development of Partisan Orientations. *The Journal of Politics, Vol. 53, No. 3* , 742-763.

Bennett, L. (2007). *Changing Citizenship in the Digital Age*. Massachusetts: MIT Press.

Biezen, V. (2013). *Political Parties in New Democracies*. Palgrave Macmillan.

- Biggs, S, Gurung, S, Messerschmidt, D. (2004). *An exploratory study of gender, social inclusion and empowerment through development groups and group-based organizations in Nepal: building on the positive*. Kathmandu, Nepal: Gender and Social Exclusion Assessment (GSEA) Study.
- Brett, E. (1996). The participatory principle in development projects: the costs and benefits of cooperation. *Public Administration and Development*, Vol 16 , 5-19.
- BTI. (2012). *Albania Country Report*, . Gütersloh: Bertelsmann Stiftung.
- Bumci, A. (2004). *National security issues*. Tirane: AIIS.
- Burns, D. (1994). *Burns, D et al.*, London: Macmillan.
- Cahn, S. (1997). Effect of Attention to Campaign Coverage on Political Trust. *International Journal of Public Opinion Research* , 286-296.
- Carmen Leccardi, Carles Feixa, Siyka Kovacheva, Herwing Reiter, Tatjana Sekulic. (2012). *1989: Young People and Social Change After the Fall of the Berlin Wall*. Strasbourg: Council of Europe.
- Cammaerts, B. and Carpentier, N. (2005) 'The unbearable lightness of full participation in a global context: WSIS and civil society participation', in J. Servaes and N. Carpentier (eds) *Towards a Sustainable Information Society: Beyond WSIS*. Bristol: Intellect, pp. 17-49.
- CoE. (2008). *"Have Your Say"!* Strasbourg: Council of Europe.
- CoE. (2008). European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Live. In *Have your Say* (p. 68). Strasbourg: Council of Europe.
- CoE. (2004). *The future of Democracy*. Strasbourg: Council of Europe Publishing.

- CoE. (2010). *Youth Policy in Albania*. Strasbourg: Council of Europe.
- Collin, P. (2008). *Young People Imagining a New Democracy*. Sydney: Whitlam Institute.
- Dahl, R. (1991). Democracy and its critics. In *Democracy and its critics*. New York: Yale University Press.
- Davies & Merton. (2009). Squaring the Circle?: Findings of a 'modest inquiry' into the state of youth work practice in a changing policy environment. *National Youth Agency, vol 1, chapter 6* , 234-65.
- Davies, B. (2005). Threatening youth revisited: youth policies under new labour. *Youth and Policy, No.88* , 125-57.
- Dervishi, Z. (2004). *Vullnetarizmi, ind shumwfunksional i shoqwrism*. Tirane: albPAPER.
- Edwards, M. (2000:15). *NGO Rights and Responsibilities: A New Deal for Global Governance*. London: The Foreign Policy Centre?NCVO.
- FES. (2013). *Rinia Shqiptare*. Tirane: Fondacioni Friedrich Ebert.
- Filo, L. (2011). *Sistemi politik bashkëkohor – Europa : (institucionet, politikat, zhvillimet)*. Tirane: IDEART.
- Finkel, S. (1987). The Effect of Participation on Political Efficacy and Political Support: Evidence from a West German Panel. *Journal of Politics*, 49 , 41-64.

- Fiszbein, A. (2000). *Public-Private Partnerships as a Strategy for Local Capacity Building: Some Suggestive Evidence from Latin America, Applying Public Administration in Development: Guideposts to the Future*. Chichester: Wiley.
- Fletcher, A. (2007). *Guide to Social Change Led By and With Young People*.
- FRIDE. (2010). *Democracy in Albania*. Madrid: FRIDE.
- Gastil, J. (1993). *Democracy in Small Groups*. Philadelphia: New Society Publishers.
- Girvan, N. (1993). *Working together for development: D.T.M.Girvan on cooperatives and community development, 1939-1968*. Kingston: Institute of Jamaica Publications Ltd.
- Gjuraj, T. (2011:32). Elita Politike dhe shoqëria civile në Shqipërinë postkomuniste: Një marrëdhënie problematike. *Polis Nr.10, Tiranë: UET PRESS* , 32 .
- Griggs, A. J. (2008). Parish Power In London? *The Guardian* , 2-13.
- Harris, A. Wyn, J. & Younes, S. (2007). ‘Young people and citizenship: An everyday perspective’. *Youth Studies Australia, Vol.26, No.3* , 19–27.
- Hart, R. (1997). Ladder of participation. In R. Hart, *Children's Participation: The Theory and Practice of Involving Young Citizens in Community Development and Environmental Care*. New York: UNICEF, and London: Earthscan.
- Hillery, G. (1995). Definitions of community: Areas of agreement’ in Rural sociology. In G. Hillery, *A Research Odyssey: Developing and Testing a Community Theory* (pp. 111-123). New Jersey : Transaction.
- Ibid. (n.d.).

IDEA. (1999). *Youth Voter Participation: Involving Today's Young in Tomorrow's democracy*. Stockholm: IDEA.

Integrimi. (2013, Korrik 26). Rinia e LSI-se vulosi fitoren. *Gazeta Integrimi* , pp. 4-5.

Jans, M and De Backer, K. (2002). *Youth (work) and social participation. Elements for a practical theory, Flemish Youth Council JeP!.*, Brussels.

Jenkins, P. (1999:438-42). Difficulties encountered in community involvement in delivery under the new South African housing policy. *Habitat International* , 431-46.

Jones, M. (2007, December 13). Parental Influence on the Political Participation of Young People.

Juan J. Linz and Alfred Stepan. (1996). *Problems of democratic transition and consolidation*. Baltimore: John Hopkins University Press.

King, A. (1987). *Power and Communication*. Waveland Press.

Kitanov, K. (1981). Komsomol Cadres. *Sofia: People's Youth Press*. , 125-147.

Kitanov, K. (1981). Komsomol Cadres. *Sofia: People's Youth Press* , 125-147.

Kovacheva, S. (2005). Reflections on the situation of youth research in Central and Eastern Europe. *Youth Research in Europe* , 145-167.

Kovacheva, S. (1995:105). Student political culture in transition: the case of Bulgaria. *The Puzzle of Integration. Vol 1* , 105-118.

Krasniqi, A. (2009). *Zgjedhjet ne Shqiperi*. Tirane: GEER.

Kushtetuta e Shqiperise. (1998). Parlamenti i Shqiperise.

Lane & Tribe. (2008). *Diversity in Health Care. A practical guide for health professionals on community engagement with local black and minority ethnic community groups*. NICE.

Larry Diamond, Leonardo Morlino. (2005). *Assessing the Quality of Democracy*. Johns Hopkins University Press.

Lazarsfeld, P. (1987). People's Coice. *American Political Science Review* , 197-216.

Leccardi, C. (2012:54). *Young People and Social Change After the Fall of the Berlin Wall*. Strasbourg: Council of Europe.

Linz and Stepan. (1978). *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe*. Johns Hopkins University Press.

Livingstone, S. (2011) *Media Regulation: Governance in the interests of citizens and consumers*. London: Sage.

Longo, N. & Meyer, R. (2006). College students and politics: A literatyre review. *The Center for Information and Research in Civic Learning and Engagment* , 35-41.

Lubonja, F. (2010, Korrik 30). Për një shoqëri civile ndryshe. *Panorama* , p. 17.

Lupia and Matsusaka. (2004:463). Direct Democracy: New Approaches to Old Questions. *The Annual Review of Political Science* , 463–482.

McCallum, Tritter. (2006). The snakes and ladders of user involvement: Moving beyond Arnstein. *Health Policy* , 156-168.

- Mitev, P.-E. (1988:68). Youth and Social Change. *People's Youth Press, Sofia* , 59-71.
- Morse, S. (2004). Practicing Democracy: How Communities Come Together to Solve Problems. *National Civic Review, Volume 93* , pp. 31-41.
- O'Brien, J., & Kohlmeier. (2003). Leadership: Part of the civic mission of. Washington: Heldref Publications.
- OECD (2001) *Citizens as Partners: Information, consultation and public participation in policy-making*, Paris: OECD.
- O'Toole. (2003). Tuning Out or Left Out? Participation and Non-Participation Among Young People. *Contemporary Politics* , pp. 45-61.
- Pateman, C. (1970) *Participation and Democratic Theory*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Parlamenti i Shqiperise. (1998). *Kushtetuta e Shqiperise*.
- Pinto, R. F. (1998). Innovations in the provision of public goods and services. *Public Administration and Development* 18 , 387 - 398.
- Putnam, R. D. (1993). Making Democracy Work: Civic Traditions in Modern Italy. *Princeton University Press* , 81-166.
- Qvortrup, M. (2007). *Supply Side Politics. How Citizens' Initiatives could revitalise British politics*. London: Centre for Policy Studies.
- Ramakrishnan and Baldassare. (2004). *The Ties that Bind: Changing Demographic and Civic Egagement in California*. San Francisco: Public Policy Institute of California.

- Rosenstone and Hansen. (1993). *Mobilization, Participation, and Democracy in America*. New York: Macmillan.
- Russell, A. (2002). *Voter engagement and young people*. London: The Electoral Commission.
- Sale, K. (1980). *Human Scale*. New York: Coward, McCann & Geoghegan: New Society Publishers.
- Sapin, K. (2008). *Essential Skills for Youth Work Practice*. London: Sage.
- Sartori, G. (1998). *C'ështëë Demokracia*. Tirane: Dituria.
- Schneider, C. and Schmitter, P.C. (2004). Liberalization, transition and consolidation: measuring the components of democratization. *Democratization*, 59-90.
- Spence, J. (2006). *Youth Work: Voices of Practice*. Leicester: National Youth Agency.
- Stoker, G. (1997). Local Political Participation. In C. S. Howard Davis, *New perspectives on local governance: Reviewing the research evidenc* (pp. 157-196). York: Joseph Rowntree Foundation.
- Strauss, G. (1998) 'An overview', in F. Heller, E. Pusic, G. Strauss and B. Wilpert (eds) *Organisational Participation: Myth and Reality*, New York: Oxford University Press, pp. 8-39.
- TACSO. (2010). *Civil Society Organizations' Capacities in the Western Balkans and Turkey*. Tirana.
- Thomai, J. (2006). *Fjalori i Gjuhës Shqipe*. Tirane: Akademia e Shkencave e Shqiperise.

- TIA. (2012). *Indeksi i Perceptimit te Korrupsionit 2012*. Tirane: Transparency International Albania.
- TIB. (2012). *LOCAL COMMUNITIES FIGHT CORRUPTION AT THE (GRASS) ROOTS*. Transparency International, Bangladesh.
- Titarenko, L. (2009). Youth as subject of public debate in post-soviet countries. *European Journal and Youth Research*, Vol. 3(6) , 111-118.
- Tocqueville, A. D. (2002). *Demokracia ne Amerike*. Tirane: Fondacioni Soros & Kristalina.
- Tolber and Smith. (2006). Representation and Direct Democracy in The United States. *Journal of Representative Democracy* 42.1 , 25-44.
- Tolbert, C. (2003). Cycles of Democracy: Direct democracy and institutional realignment in the American states. *Political Science Quarterly. Political Science Quarterly* , 467-489.
- Treschel, Alexandre, and Sciarini, Pascal. (1998). Direct Democracy in Europe. *European Jurnal of Political Research* , 99-124.
- UNDP. (2009). *Human Development Report for Albania*. Tirana: UNDP.
- Verba, S. (1961) *Small Groups and Political Behaviour*, Princeton, NJ: Princeton University Press.
- Wite, R & Wyn, J. (2004). Youth and Society: Exploring the Social Dynamics of Youth. *Oxford University Press, Melburn* , 93-95.

Xenos & Foot. (2007). Not Your Fathers's Internet: The Generation Gap in Online Politics. *MIT Press* , 51-70.

Burime elektronike

Annan, K. (2004). *International IDEA*. Retrieved January 15, 2012, from http://www.idea.int/publications/dll/upload/overview_English.pdf

Arnstein, S. (1969). *Designing for Civil Society*. Retrieved September 17, 2012, from http://partnerships.typepad.com/civic/2004/11/ladder_of_parti.html

Arnstein, S. R. (1969, July). *Duncan Lithgow*. Retrieved Dhjetor 09, 2011, from Duncan Lithgow: <http://lithgow-schmidt.dk/sherry-arnstein/ladder-of-citizen-participation.html>

Balkanweb. (2013, August). *Balkanweb*. Retrieved October 14, 2013, from Balkanweb: <http://www.balkanweb.com/kryesore/1/meta-fituam-deputet-ne-kukes-por-e-humben-ne-tirane--ne-kuvend-do-sjell-risi-145527.html>

Briggs, D. (2013). *Kind of Digital*. Retrieved June 17, 2013, from Kind of Digital: <http://kindofdigital.com/>

Bumci, A. (2011, Dhjetor 09). *IDEA*. Retrieved June 20, 2012, from IDEA: <http://www.gazetaidea.com/dita-e-rinise-bumci-te-rinjte-shqiptare-te-mbiperfaqesuar/>

Bumçi, A. (2011, November). *MTKRS*. Retrieved September 13, 2011, from MTKRS: http://www.mtkrs.gov.al/web/Ministri_Bumci_ne_takimin_me_te_rinjte_e_perz

gjedhur_per_trajnimin_me_teme_Pjesemarrja_e_te_rinjve_dhe_Politikat_Rinore
_ne_Shqiperi_767_1.php

CIO. (2012, Mars 31). *CIO.al*. Retrieved Gusht 4, 2013, from <http://cio.al/perdorimi-i-internetit-ne-shqiperi-arrin-ne-48-1/>

CIVICUS. (n.d.). *CIVICUS*. Retrieved January 22, 2012, from World Alliance for
Citizen Participation:
https://www.civicus.org/new/media/CSI_Methodology_and_conceptual_framework.pdf

Collin, P. (2008, August). *Foundation for Young Australians*. Retrieved November 1,
2011, from <http://www.fya.org.au/wp-content/uploads/2009/07/Collin-2008-young-people-imagining-democracy.pdf>

Economist. (2012, December). *The Economist*. Retrieved May 13, 2013, from
<http://www.top-channel.tv/english/artikull.php?id=8729>

Forbrig, J. (2003). Retrieved February 26, 2012, from
http://users.ox.ac.uk/~oaces/conference/papers/Joerg_Forbrig.pdf

FreedomHouse. (2013). *Balkanweb*. Retrieved June 18, 2013, from
<http://www.balkanweb.com/kryesore/1/fh-ne-5-vitet-e-fundit-shqiperia-renie-te-gjithe-treguesve-te-demokracise-137705.html>

G.Ekiert & D. Ziblatt. (2012, January). Retrieved March 13, 2012, from Harvard
University:
<http://hip.fas.harvard.edu/fs/docs/icb.topic1037529.files/Ekiert%20and%20Ziblatt%20EEPS.pdf>

Goll, T. (2006, September 25-29). Retrieved February 23, 2012, from Center for Civic Education: http://www.civiced.org/index.php?page=papers_speeches

Government of UK. (2011). Retrieved January 20, 2013, from Localism Bill: local referendums:
https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/6045/1829672.pdf

Grabova, E. (2010, Mars). *Avokati.org*. Retrieved April 28, 2013, from <http://www.avokati.org/>

GTZ. (2010, March). Retrieved March 23, 2012, from GTZ:
<http://www.gtz.de/en/dokumente/en-civil-society-democratic-structures-albania.pdf>

Havel, V. (1993). Retrieved February 08, 2012, from The New York Review of Books:
<http://www.nybooks.com/articles/archives/1993/nov/18/how-europe-could-fail/?pagination=false>

IDEA, I. (2011). *International IDEA*. Retrieved February 6, 2012, from http://www.idea.int/publications/dll/upload/overview_English.pdf

Institute for Youth, E. a. (2010, 08). *Municipal Research and Service Center of Washington*. Retrieved January 17, 2012, from Youth Participation in Local Government: <http://www.mrsc.org/subjects/governance/civ/youthgov.aspx>

ITU. (2012, Qershor 27). *Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU)*. Retrieved Shkurt 11, 2014, from CIO.al: <http://cio.al/perdorimi-i-internetit-ne-shqiperi-arrin-ne-48-1/>

- KQZ. (2011). *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*. Retrieved Janar 20, 2013, from
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:
http://www.cec.org.al/index.php?option=com_content&view=article&id=244%3Apjesmarrja-ne-votime&catid=121&Itemid=146&lang=sq
- Meidani, R. (2010). *Arkivat Mediatike Shqiptare: INFOARKIV*. Retrieved Janar 19, 2013, from <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/41959/titulli/A-mund-te-jete-referendumi-nje-ide-e-gabuar>
- Krasniqi, A. (2013). *Gazeta Telegraf*. Retrieved Mars 7, 2013, from
<http://gazetatelegraf.com/afrim-krasniqishqiperia-ne-22-vjet-vota-e-perhershme-dhe-votuesit-e-lekundur/>
- KVV. (2013, Shtator 27). *Koalicioni i Vezhguesve Vendor*. Retrieved October 14, 2013, from Koalicioni i Vezhguesve Vendor: <http://www.zgjedhje.al/>
- LSI. (2003). *Partia Levizja Socialiste per Integrim*. Retrieved June 18, 2013, from
Partia Levizja Socialiste per Integrim:
http://www.lsi.al/index.php?option=com_content&view=article&id=3&Itemid=107&lang=AL
- MJAFT! (2010, October 22). *MJAFT! Movement*. Retrieved June 7, 2013, from
<http://www.mjaft.org/en/organizata.php>.
- MTKRS. (2011). *Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve*. Retrieved
September 14, 2012, from
http://www.mtkrs.gov.al/web/Strategjia_per_Rinine_78_1.php

- OPIC. (2011). *Olof Palme International Center*. Retrieved January 9, 2012, from <http://www.palmecenter.org/Documents/ENGLISH%20DOCUMENTS/Western%20Balkan/OPC%20Strategy%20Western%20Balkans%202012-2015.pdf>
- Pateman, C. (1970) *Participation and Democratic Theory*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Rama, E. (2012, February 8). *BalkanWeb*. Retrieved February 9, 2012, from BalkanWeb: <http://www.balkanweb.com/kryesore/1/rama-ne-news24-vleresoj-qendrimin-e-fundit-te-nanos-81102.html>
- Right Question Institute*. (n.d.). Retrieved from <http://rightquestion.org/microdemocracy/>
- Smith, M. (2002). *Infed*. Retrieved March 26, 2014, from Youth work: an introduction', The encyclopedia of informal: <http://infed.org/mobi/what-is-youth-work-exploring-the-history-theory-and-practice-of-work-with-young-people/>
- Standart. (2011, December 5). *Gazeta Standart*. Retrieved March 22, 2012, from Gazeta Standart: <http://www.standard.al/arkiva/index.php/news/politike/13235-bashkepunimi-i-rames-per-rrezimin-e-nanos-harasani-dhe-keta-e-vertete-qe-e-njohin-te-gjithe.html>
- Stoker, G. (2010). *International IDEA*. Retrieved January 22, 2012, from International IDEA: http://www.idea.int/publications/dll/upload/overview_English.pdf
- Swainston & Summerbell. (2008). *The effectiveness of community engagement approaches and methods for health promotion interventions*. Retrieved April 13, 2013, from National Institute for Health and Care Excellence:

<http://www.nice.org.uk/nicemedia/pdf/HealthPromotionEvidenceReviewFinal.pdf>

TACSO. (2010). *TACSO Albania*. Retrieved February 01, 2012, from TACSO Albania:
<http://tacso.org/cso-db-res/Albania/?id=32>

Taylor, T. (2009). *In Defence of Youth Work*. Retrieved March 26, 2014, from
www.indefenceofyouthwork.com

Toronto, C. o. (2004). *InvolveYouth Campaign*. Retrieved January 7, 2012, from
<http://www.toronto.ca/involveyouth/pdf/guide.pdf>

UNDP. (2012). *Enhancing Youth Political Participation throughout the Electoral Cycle –A good practice guide:*. Retrieved December 21, 2013, from UNDP:
http://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democraticgovernance/electoral_systemsandprocesses/enhancing-youth-political-participationthroughout-the-electoral/

UNV. (2009). *UNICEF*. Retrieved June 7, 2013, from
<http://childfriendlycities.org/en/to-learn-more/examples-of-cfc-initiatives/albania>

US Census. (2007). *U.S. Voter Turnout Up in 2004*. Retrieved May 18, 2013, from
<http://www.census.gov/Press-Release/www/releases/archives/voting/004986.html>

USEmbassy. (2012, June 20). *Embassy of The United Stated, Tirana Albania*. Retrieved
Maj 20, 2013, from Embassy of The United Stated, Tirana Albania:

<http://tirana.usembassy.gov/embassy-events/2012-events/come-together-act-now-june-20-2012.html>

WorldBank. (n.d.). *World Bank*. Retrieved January 18, 2012, from Wolrd Bank:

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/TOPICS/CSO/0,,contentMDK:20101499~menuPK:244752~pagePK:220503~piPK:220476~theSitePK:228717,00.html>

Zeri i Amerikes. (2013, Nentor 11). *Voice of America*. Retrieved Janar 27, 2014, from

Tubim proteste ne Tirane kunder armeve kimike:

<http://www.zeriamerikes.com/content/tubim-proteste-per-armet-kimike/1789528.html>

Burime parësore

39 (tridhjetë e nëntë) Intervista gjysëm të strukturuar

8 (tetë) fokus grupe me pjesëmarrës nga 3 - 7 persona

360 (treqind e gjashtëdhjetë) pyetsorë me pjesëmarrës nga rrethë të ndryshme të shqipërisë, grupë-mosha 17-35 vjeç.